



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
NJËSIA E INSPEKTORËVE

Nr. 3408 prot.

Tiranë, më 29.12.2022

RAPORT

“PËR KRYERJEN E INSPEKTIMIT TEMATIK TË PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, ME OBJEKT: “MBI MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE NË KUADËR TË ZBATIMIT TË UDHËZIMIT TË PËRGJITHSHËM NR. 12, DATË 20.07.2020, TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM “MBI RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE MES PROKURORËVE DHE DREJTUESVE TË PROKURORISË, INFORMIMIN, TRANSPARENCËN DHE GARANTIMIN E PAVARËSISË NË PROKURORITË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM”, I NDRYSHUAR.

Sipas

VENDIMIT NR. 37, DATË 01.06.2021 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë, 29.12.2022

Titulli

Raport i inspektimit tematik “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm”, i ndryshuar.

Data e përgatitjes

29.12.2022

Përgatitur nga

Z. Julian Zonja
znj. Lindita Zigufi
znj. Elena Pelushi
znj. Alma Tafani
znj. Joana Asimi
z. Besnik Maho
z. Saimir Hoxha
Inspektorë pranë Zyrës së ILD

Për shqyrtim nga

z. Artur Metani
Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Miratoi Ndryshoi Ktheu

Datë 29 / 12 / 2022

Përmbajtja

1. Hyrje

- 1.1. Arsyet e iniciimit të inspektimit
- 1.2. Qëllimi i inspektimit
- 1.3. Objekti i inspektimit
- 1.4. Subjekti i inspektimit
- 1.5. Objektivat e inspektimit
- 1.6. Rëndësia e inspektimit
- 1.7. Metodologjia e inspektimit
 - 1.7.1. Inspektorët e ngarkuar
 - 1.7.2. Mënyra e kryerjes së inspektimit
- 1.8. Periudha e kryerjes së inspektimit
- 1.9. Periudha e mbulimit të inspektimit
- 1.10. Drejtimit e inspektimit
- 1.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit

2. Përshkrimi i të dhënave të administruara

- 2.1. Të dhënat e marra nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë
- 2.2. Të dhënat e marra nga Prokuroria e Apelit Vlorë, Prokuroria e Apelit Tiranë, Prokuroria e Apelit Shkodër, Prokuroria e Apelit Korçë, Prokuroria e Apelit Gjirokastrë, Prokuroria e Apelit Durrës
- 2.3. Të dhënat e marra nga Prokuroria e Përgjithshme

3. Gjetjet

- 3.1. Baza e vlerësimit
- 3.2. Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme detyruese nga ana e prokurorit më të lartë dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre
- 3.3. Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre
- 3.4. Mënyra e informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm

4. Konkluzione

5. Rekomandime

1. Hyrje

1.1. Arsyet e iniciimit të inspektimit

Në mbështetje të nenit 194, pika 4 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyra të prokurorive dhe administratës së prokurorisë.

Në mbështetje të nenit 38, pika 2, shkronja "i" dhe nenit 106 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë inspektime tematike ose hetime për shkeljet individuale, si dhe ka detyrimin të bashkëpunojë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për çështje në juridiksionin e tij dhe të informojnë lidhur me shkeljet disiplinore dhe problematikat që has në ushtrimin e veprimtarive të tij.

Në këtë kuadër, me shkresën nr. 2361/1 prot., datë 12.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë krahas institucionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë i është kërkuar edhe Prokurorit të Përgjithshëm paraqitja e kërkesave lidhur me tematika apo çështje, të cilat mund t'i nënshtrohen inspektimit tematik apo institucional nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në përgjigje të shkresës nr. 2361/1 prot., datë 12.05.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 783/1 prot., datë 24.05.2021 ka propozuar ndër të tjera nevojën për zhvillimin e një inspektimi tematik të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*", i ndryshuar (referuar më poshtë si Udhëzimi nr. 12/2020)¹.

Në bazë të nenit 148, pika 1 të Kushtetutës, prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Në Kushtetutë përcaktohet se prokuroria është **organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.** Gjithashtu një sërë aktesh ligjore garantojnë pavarësinë e jashtme dhe të brendshme të prokurorëve si, ligji nr. 96/2016, i ndryshuar; ligji nr. 97/2016, i ndryshuar dhe Kodi i Procedurës Penale. Kushtetuta gjithashtu parashikon si një nga kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme me shkrim për prokurorët, si dhe ushtrimin e kompetencave të tjera të përcaktuara në ligj.

¹ Ndryshuar me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 16/2020 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".



Kompetenca e Prokurorit të Përgjithshëm për të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me shkrim, parashikohet edhe në ligjin nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (neni 38, pika 2, germa "b"), kompetencë e cila parashikohet edhe për Drejtuesit e Prokurorive si prokurorë më të lartë në nenin 46, pika 4 të po këtij ligji. Prokurori i Përgjithshëm ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë, nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, si dhe kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë.

Sipas ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë bëhet në tre nivelet e organizimit të saj, respektivisht nga Prokurori i Përgjithshëm për Prokurorinë e Përgjithshme dhe nga Drejtuesit e Prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, me përjashtim të Prokurorisë së Posaçme sipas ligjit të posaçëm. Ligji e ka decentralizuar sistemin e prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm në këto tre nivele, sipas të cilit Drejtuesit e Prokurorive nuk kanë më kompetenca për të ndërhyrë në hetimet apo zgjidhjen e çështjeve konkrete nga prokurorët, veprimtaria e të cilëve dhe çdo vendimmarrje kontrollohet nga gjyqtari.

Sa më sipër për prokurorinë, duke kuptuar në këtë rast secilën zyrë të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, të cilat përfaqësohen nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe duke respektuar pavarësinë e prokurorëve është e rëndësishme që ajo të veprojë e unifikuar në drejtim të përfaqësimit të akuzës publike në emër të shtetit. Me anë të Drejtuesve në prokurori garantohet edhe ushtrimi i kompetencave të Prokurorit të Përgjithshëm, si ajo e raportimit në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend; të dhënave lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale; cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq; të elementeve të tjera thelbësore në veprimtarinë e prokurorisë, si dhe informimi mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën ndaj kriminalitetit². Roli i Drejtuesit të Prokurorisë lidhet me kompetencat e tij në drejtimin e prokurorisë dhe në ushtrimin e ndjekjes penale. Nëpërmjet kompetencave të drejtimit dhe atyre të ndjekjes penale, Drejtuesi i Prokurorisë garanton zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm³.

Ndër llojet e akteve administrative të pranishme në veprimtarinë e prokurorisë, që përdoren për përmbushje të funksioneve të saj, janë udhëzimi i përgjithshëm, i cili është akti nënligjor i Prokurorit të Përgjithshëm ose i Drejtuesit të Prokurorisë, me karakter normativ, administrativ dhe/ose procedural, i detyrueshëm për zbatim sipas nivelit të udhëzimit. Duhet thënë se miratimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, i ka paraprirë nxjerrja në datën 04.12.2019 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 8, për "Garantimin e pavarësisë së prokurorit, marrëdhëniet ndërmjet tij me drejtuesit e prokurorisë dhe informimin në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", për të cilin u njoftua pezullimi i zbatimit të tij me shkresën nr. 3173/1 prot., datë 10.12.2019 të Prokurorit të Përgjithshëm. Me shkresën nr.

² Neni 104 i ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar.

³ Nenet 42, germa g) dhe 43, germa dh) i ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar.



3173/4, datë 05.02.2020 Prokurori i Përgjithshëm, ka nisur më pas zhvillimin e një procesi konsultimi me gjithë prokuroritë, për t'u njohur me problematikat që janë hasur gjatë zbatimit të kuadrit ligjor mbi prokurorinë, e kryesisht në drejtim të funksionimit të raportit prokuror - Drejtues, dhënies së udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 8/2019, e çdo çështje që vlerësohej me rëndësi nga prokurorët. Udhëzimi jo i detyrueshëm për çështje konkrete është akti nënligjor i prokurorit më të lartë (Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë ose Drejtuesit të Seksionit) për prokurorët e prokurorisë përkatëse, me karakter shpjegues që jep urdhërime të caktuara për ecurinë e çështjes konkrete, jo i detyrueshëm për zbatim.

Udhëzimet e përgjithshme dhe jo të detyrueshme jepen me shkrim (me përjashtim të rastit kur udhëzimet jo të detyrueshme mund të jepen edhe me gojë për shkak urgjence dhe të konfirmohen me shkrim), dhe duhet të përbajnë elementët e domosdoshëm të një akti si a) autoritetin që e nxjerr aktin; b) palët të cilave u drejtohen; c) parashtrimin e fakteve; ç) bazën ligjore ku mbështetet; d) datën e hyrjes në fuqi; dh) nënshkrimin.

Në të njëjtën kohë, në analizë të raportit të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020"⁴, konstatohet se: (i) në disa prokurori, Drejtuesit e Prokurorisë kanë marrë, si masa administrative për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe/ose hartimin e planeve të veprimit për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe masa procedurale për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe/ose kërkuar informacion prokurorëve për ecurinë e çështjeve konkrete, duke garantuar pavarësinë e tyre; (ii) në disa prokurori të tjera, Drejtuesit e Prokurorisë nuk kanë marrë masa të plota administrative dhe procedurale për zbatimin e udhëzimeve dhe planeve të veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm, të nxjerrë në zbatim të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, apo për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, duke i zbatuar ato pjesërisht apo me mangësi serioze; (iii) gjithashtu konstatohet se ka patur raste të mungesës së përsëritur të informimit apo raportimit mbi zbatimin e udhëzimeve dhe ngritjes së infrastrukturës përkatëse administrative për lehtësimin e kushteve për zbatimin e tyre.

Duke qenë se, problematikat e konstatuara në raportin e Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020" kanë karakter të përgjithshëm administrativ, funksional dhe procedural, këto problematika janë të shtrira në disa prokurori, si dhe për sa është konstatuar nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, këto problematika kanë ardhur si pasojë e mungesës së kohezionit institucional, mungesës së masave administrative apo organizative, apo për shkak të parashikimeve legjislative është vlerësuar se mjeti i duhur për adresimin e tyre është zhvillimi i një inspektimi tematik me objekt: "Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në

⁴ Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2020", faqe 48.



prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar”, pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Për sa më sipër, nisur nga ushtrimi i kompetencave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me vendimin nr. 37, datë 01.06.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është vendosur: “Për kryerjen e inspektimit tematik të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm”, me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm”, i ndryshuar.

1.2. Qëllimi i inspektimit

Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Njohja e praktikave të zyrave të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm lidhur me marrjen e masave administrative nga ana e Drejtuesve të Prokurorisë për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme me karakter detyrues dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre.
- Njohja e praktikave të zyrave të prokurorive mbi marrjen e masave procedurale për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre, si dhe informimit mbi ecurinë e çështjeve konkrete apo raportimit mbi zbatimin e udhëzimeve për lehtësimin e kushteve për zbatimin e tyre.
- Evidentimi i problematikave të mundshme në raport me zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe propozime të mundshme në drejtim të rregullimit të marrëdhënieve mes prokurorëve dhe Drejtuesve në prokurori, midis Drejtuesve dhe Prokurorit të Përgjithshëm, organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, të unifikimit të praktikave, të trajnimit vazhdues e ndryshimeve ligjore.

1.3. Objekti i inspektimit

Në këtë inspektim është vlerësuar veprimtaria e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me juridiksion të përgjithshëm mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.

Në kryerjen e këtij inspektimi është vlerësuar jo vetëm aspekti sasior i akteve të nxjerra nga Drejtuesit e Prokurorive në ushtrim të kompetencave të tyre dhe përgjigjet e prokurorëve në ushtrim të të drejtave dhe detyrimeve të tyre sipas udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, por edhe në këndvështrim të përputhjes apo harmonizimit të tyre me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe udhëzimet e tjera të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të të cilave kanë dalë, si dhe ligjin.

Udhëzimi i përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm i ndryshuar, referuar drejtimeve të inspektimit tematik zbatohet me garantimin dhe lehtësimin e zbatimit të tij, duke nxjerrë dhe udhëzime të përgjithshme për këtë qëllim, nxjerrjen e udhëzimeve të tjera të përgjithshme, nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, kërkesave për informacion të Drejtuesve të Prokurorive dhe informimeve nga prokurorët, raportimit tek Prokurori i Përgjithshëm, si dhe mbajtjes së rregullt të regjistrit të korrespondencës së brendshme procedurale me pasqyrimin e këtyre akteve.

1.4. Subjekti i inspektimit

Inspektimi tematik është zhvilluar pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Prokuroria e Apelit Vlorë; Prokuroria e Apelit Tiranë; Prokuroria e Apelit Shkodër; Prokuroria e Apelit Korçë; Prokuroria e Apelit Gjirokastrë; Prokuroria e Apelit Durrës dhe Prokuroria e Përgjithshme.

1.5. Objektivat e inspektimit

- Inspektimi tematik ka karakter njohës dhe konstatues të efektivitetit të veprimtarisë së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, të juridiksionit të përgjithshëm mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.
- Në varësi të rezultateve të inspektimit, dhënia e rekomandimeve të karakterit legjislativ, administrativ, organizativ apo funksional lidhur me rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe Drejtuesve të Prokurorisë, mes prokurorëve me Prokurorin e Përgjithshëm, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.
- Zhvillimi i këtij inspektimi do të shërbejë gjithashtu, edhe si mjet për identifikimin e veprimeve/mosveprimeve apo sjelljeve të magjistratëve, të cilat në bazë të një dyshimi të arsyeshëm justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

1.6. Rëndësia e inspektimit

Inspektimi tematik paraqet rëndësi në:

- Rritjen e standardeve në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm

për unifikimin e të drejtave dhe detyrimeve të prokurorit në marrëdhëniet me Drejtuesit e Prokurorive, e këtyre të fundit me Prokurorin e Përgjithshëm, informimin dhe koordinimin e veprimtarisë së prokurorisë për të siguruar pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve të tij, si dhe mbikëqyrjen, ligjshmërinë e transparencën në prokurori.

- Inspektori i Lartë i Drejtësisë në respektim të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor aktual vlerëson të theksojë pavarësinë e prokurorit në drejtim të cilësisë së hetimit, vendimmarrjes dhe përfaqësimit të akuzës publike në gjyq, duke bërë që në praktikë pa u cenuar kjo pavarësi ajo të funksionojë në këto drejtime. Çështjet në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë përbëjnë çështje me interes publik dhe në këtë aspekt prokurorët si hallkë e rëndësishme e gjyqësorit, kanë detyrë të kontribuojnë në administrimin e duhur të drejtësisë. Ashtu si veprimtaria dhe integriteti personal i prokurorëve është një çështje që mund të jetë me interes legjitim për publikun e gjerë, është e nevojshme të mbrohen prokurorët nga ndërhyrjet, të cilat ka të ngjarë t'i prekin ata në kryerjen e detyrave të tyre dhe të dëmtojnë besimin e publikut ndaj tyre dhe zyrës së prokurorisë. Krijimi i një organi të ndjekjes penale të pavarur dhe të paanshëm është një nga parimet kryesore të një sistemi drejtësie efektiv dhe një parim thelbësor i procesit penal. Reforma në sistemin e drejtësisë garanton pavarësinë e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, dhe gjithashtu krahas forcimit të pavarësisë së prokurorit, ka parashikuar dhe krijimin e mekanizmave të kontrollit disiplinor. Prokuroria tashmë funksionon si një organ i decentralizuar, ndërsa roli i Prokurorit të Përgjithshëm mbetet i nevojshëm për të garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së prokurorisë duke respektuar pavarësinë e brendshme të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale, në përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe në plotësimin e funksioneve të tjera të parashikuara në ligj. Kuadri ligjor garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët, të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, si dhe kontrollin e ushtrimit të funksioneve të tyre për të shmangur çdo sjellje që bie ndesh me funksionin e prokurorit.
- Nga njëra anë ligji parashikon instrumentet në funksion të mbarëvajtjes dhe kontrollit të veprimeve të prokurorisë nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre, garantimit të zbatimit të tyre nga Drejtuesit e Prokurorive, kompetencat e tyre në ushtrimin e ndjekjes penale për të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme, zëvendësimi i prokurorit në rastet e parashikuara në ligj, informimit dhe raportimit periodik dhe nga ana tjetër garanton edhe parvarësinë e prokurorëve për të ushtruar ndjekjen penale, si me anë të kundërshtimit të udhëzimeve të përgjithshme, kërkimit të shpjegimeve lidhur me udhëzimet jo të detyrueshme për çështjet konkrete, kundërshtimit të zëvendësimit të prokurorit.
- Udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm ka vendosur rregulla për disiplinimin e autoritetit të prokurorëve më të lartë në raport me prokurorët e çështjes, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe pavarësisë së veprimtarisë së tyre. Prokurori është përgjegjës për çështjen që i ngarkohet dhe i pavarur gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, me detyrimin në çdo rast të ndjekë udhëzimet e natyrës së përgjithshme të prokurorëve më të lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimit të

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË



prokurorisë për problematika të caktuara, bazuar edhe në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe rezoluta të Kuvendit të Shqipërisë. Qëndrueshmëria e çdo zyre të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm duhet të sigurohet nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe udhëzimit të përgjithshëm, duke ushtruar autoritetin e tyre Drejtuesit e Prokurorive sipas akteve që parashikohen në to nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, kërkesave për informacion/informimit nga prokurori, si dhe nëpërmjet nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme për të ndihmuar ecurinë e procedimit penal, cilësinë dhe efektivitetin e ndjekjes penale, duke bërë që raportet që vendosen midis prokurorëve të çështjeve dhe Drejtuesve të Prokurorisë të bëjnë të mundur evitimin e gabimeve. Çështja e pavarësisë procedurale dhe vendimmarrëse të prokurorit të çështjes, edhe pse theksohet dhe duket se mund të shkaktojë raste të zbatimit të gabuar të ligjit material e procedural, mosngritjes së akuzës apo akuzës së pabazuar në faktet dhe provat e çështjes, dështimit të çështjes për shkak të neglizhencës, dashjes apo interesit, qëndrimeve të prokurorëve në mënyrë pasive, apo një qëndrimi të caktuar në gjykim dhe mosushtrimin të ankimit nga prokurori i çështjes kur vendimi i gjykatës së shkallës së parë mund të vlerësohet nga prokurori më i lartë në kundërshtim me ligjin, duhet të përkthehen në çështje të përgjeshmërisë dhe llogaridhënies në rast të shkakimit të pasojave në veprimtarinë e tyre në drejtim të ligjshmërisë, të drejtave dhe lirive të individit dhe procedimit objektiv dhe të paanshëm. Pavarësia e prokurorit nga njëra anë dhe përgjegjshmëria profesionale dhe personale nga ana tjetër, janë dy parime bazë për mirëfunksionimin e organit të prokurorisë. Në këtë konsideratë, ushtrimi i detyrës nga prokurori me përgjegjshmëri, shmangia e ndikimeve nga çdo element i natyrës objektive dhe subjektive që mund të vendosë në dyshim pavarësinë e tij, zbatimi i drejtë i ligjit, përbëjnë qëllim në vetvete që adreson udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm. Në udhëzim parashikohet se shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit, për të cilat Drejtuesit e Prokurorive ose Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, mund të vihen në dijeni gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të tij. Nga ana tjetër Prokuroria e Përgjithshme, në kuadër të forcimit të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit, me synim rritjen e bashkëpunimit me institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me nr. 248, datë 5.2.2021, "Për kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magistratëve/prokurorëve në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm".

1.7. Metodologjia e inspektimit

1.7.1. Inspektorët e ngarkuar

Për kryerjen e inspektimit, sipas vendimit me nr. 37, datë 01.06.2021, u angazhuan fillimisht inspektorët për të punuar në grupe, sipas ndarjes së mëposhtme:

- a) Znj. Lindita Ziguri dhe z. Besnik Maho, për Prokuroritë pranë Gjykatave të

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Shkallëve të Para Vlorë dhe Shkodër, si dhe Prokuroritë e Apelit Vlorë dhe Shkodër.

- b) Znj. Daniela Sulaj dhe znj. Alma Tafani, për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para Durrës dhe Elbasan, Prokurorinë e Apelit Durrës, si dhe Prokurorinë e Përgjithshme.
- c) Znj. Elena Pelushi dhe znj. Joana Asimi, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokurorinë e Apelit Tiranë.
- d) Z. Julian Zonja dhe z. Saimir Hoxha, për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para Fier dhe Korçë, si dhe Prokuroritë e Apeleve Korçë dhe Gjirokastrë.

Me vendimin nr. 37, datë 16.09.2021 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të largimit nga detyra të një inspektori, është ndryshuar grupi i inspektorëve lidhur me inspektimin në Prokurorinë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para Durrës dhe Elbasan, Prokurorinë e Apelit Durrës, si dhe Prokurorinë e Përgjithshme, si më poshtë:

- a) Z. Julian Zonja dhe znj. Alma Tafani.

Gjithashtu, me qëllim rritjen e efikasitetit të grupit të inspektimit dhe miradministrimit të procesit, me të njëjtin vendim është caktuar si kryetar grupi inspektori z. Julian Zonja.

1.7.2. Mënyra e kryerjes së inspektimit

Kryerja e inspektimit është bazuar sipas vendimit të inspektimit, për realizimin e tij në 4 faza:

- 1) Faza e parë: “Përgatitja e planit të punës, hartimi i kërkesave për informacion dhe akte, si dhe zhvillimin e verifikimeve apo vizitave pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me qëllim administrimin e dokumentacionit, objekt inspektimi”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Është hartuar plani i punës, i dakordësuar nga të gjithë inspektorët, në datë 07.06.2021;
 - b) Janë hartuar shkresat drejtuar zyrave të prokurorisë objekt inspektimi, sipas një modeli të dakordësuar nga të gjithë inspektorët, të cilat për të gjitha zyrat e prokurorive janë nisur në datën 16.06.2021;
 - c) Është administruar informacioni dhe dokumentacioni sipas zyrës së prokurorisë përkatëse, dhe përpunimi i tyre paraprak.
- 2) Faza e dytë: “Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur”. Kjo fazë ka përfshirë hapat si më poshtë:
 - a) Përpunimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur dhe studimi i tyre;
 - b) Vlerësuar se duhet të merren të dhëna të tjera, informacioni dhe dokumentacion plotësues, të vlerësuar sipas grupeve të inspektorëve, nëpërmjet dërgimit të shkresës, komunikimit me anë të telefonit dhe vizitës në terren.
- 3) Faza e tretë: “Hartimi i Raportit të Inspektimit”, që ka përfshirë këto hapa:

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

11



- (i) Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme detyruese nga ana e prokurorit më të lartë dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
- (ii) Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
- (iii) Mënyra e informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm.

1.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit.

Dokumentet vijuese janë baza kryesore, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së veprimtarisë së prokurorëve dhe Drejtuesve lidhur me objektin e inspektimit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Ligji për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë;
- Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokuroreve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*”, i ndryshuar;
- Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2020 dhe 2021;
- Raportet vjetore të Prokurorive pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit.



2. Përshkrimi i të dhënave të administruara

Inspektimi Tematik filloi me fazën e parë, hartimin e kërkesave për informacion dhe akteve drejtuar zyrtarëve të prokurorisë. Nga ana e inspektorëve, në funksion të realizimit të inspektimit, janë administruar të dhëna nga:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku është mundësuar marrja e informacionit dhe dokumentacioni përkatës, nëpërmjet dy vizitave të kryera nga inspektorët përgjegjës dhe nëpërmjet shkresave të dërguara nga kjo zyrë, me nr. 10521/1 prot., datë 13.09.2022⁶, nr. 13171/1 prot., datë 05.10.2022⁷ dhe nr. 14135/1 prot., datë 11.11.2022⁸.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 2708/1 prot., datë 05.07.2021⁹.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 5925, datë 18.06.2021¹⁰.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 5628/1 prot., datë 28.06.2021. Me marrjen e këtyre të dhënave, u bë një vizitë në zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në datën 19.07.2021, për marrjen e dokumentacionit shtesë, ku u kërkua vendosja në dispozicion e regjistrave të brendshëm dhe u procedua me marrjen e kopjeve të fletëve nga regjistrat. U morën sipas procesverbalit të datës 19.07.2021, fotokopje nga regjistri i vitit 2020 që fillon me nr. rendor 1, fotokopje të "Regjistri i qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale" me nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 2666 prot., datë 30.06.2021¹¹.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 4693/1 prot., datë 28.06.2021¹².

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 7455 prot P.H., datë 28.06.2021¹³.

⁶ regjistruar në ILD me nr. 2055/1 prot., datë 14.09.2022

⁷ regjistruar në ILD me nr. 2055/3 prot., datë 06.10.2022

⁸ regjistruar në ILD me nr. 2055/5 prot., datë 11.11.2022

⁹ regjistruar në ILD me nr. 2806/1 prot., datë 07.07.2021

¹⁰ regjistruar në ILD me nr. 2808/1 prot., datë 21.06.2021

¹¹ regjistruar në ILD me nr. 2796/1 prot., datë 02.07.2021

¹² regjistruar në ILD me nr. 2809/1 prot., datë 02.07.2021

¹³ regjistruar në ILD me nr. 2812/1 prot., datë 02.07.2021

Nga Prokuroria e Apelit Vlorë është përcjellë informacioni sipas shkresës me nr. 663 prot., datë 02.07.2021¹⁴.

Nga Prokuroria e Apelit Tiranë janë sjellë informacione dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresave me nr. 528/1 prot., datë 30.06.2021¹⁵, nr. 528/3 prot., datë 10.09.2021¹⁶ dhe nr. 774/1 prot., datë 08.10.2021¹⁷.

Nga Prokuroria e Apelit Shkodër është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 751 prot., datë 28.06.2021¹⁸.

Nga Prokuroria e Apelit Korçë është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 336 prot., datë 01.07.2021¹⁹.

Nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 200/1 prot., datë 01/07/2021 dhe nr. 969 prot., datë 02.07.2021²⁰.

Nga Prokuroria e Apelit Durrës është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni përkatës, sipas shkresës me nr. 738 prot., datë 28.06.2021²¹.

Nga Prokuroria e Përgjithshme është përcjellë informacioni dhe dokumentacioni me shkresën nr. 969/1 prot., datë 02.07.2021²².

Të dhënat e marra nga prokuroritë sa më sipër lidhen me informacionin dhe dokumentacionin shkresor të mëposhtëm gjatë periudhës kohore objekt të inspektimit 01.10.2020-31.03.2021:

- i) Udhëzimet e përgjithshme me karakter të detyrueshëm të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm në datën 01.07.2020, të cilat kanë qenë në fuqi gjatë periudhës kohore objekt inspektimi, si dhe praktikën dokumentare për nevojën e nxjerrjes së udhëzimeve nga Prokurori i Përgjithshëm.
- ii) Udhëzimet e përgjithshme me karakter të detyrueshëm të nxjerra nga prokurorët më të lartë.
- iii) Udhëzimet jo të detyrueshme të nxjerra nga prokurori më i lartë, përgjigjet e prokurorëve ndaj udhëzimeve jo të detyrueshme, kërkesat për informacion nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, si dhe informacionet e dhëna nga prokurori.

¹⁴ regjistruar në ILD me nr. 2810/1 prot., datë 07.07.2021

¹⁵ regjistruar në ILD me nr. 2794/1 prot., datë 01.07.2021

¹⁶ regjistruar në ILD me nr. 2794/4 prot., datë 13.09.2021

¹⁷ regjistruar në ILD me nr. 2794/6 prot., datë 11.10.2021

¹⁸ regjistruar në ILD me nr. 2811/1 prot., datë 30.06.2021

¹⁹ regjistruar në ILD me nr. 2796/2 prot., datë 05.07.2021

²⁰ regjistruar në ILD me nr. 2798/2 prot., datë 05.07.2021

²¹ regjistruar në ILD me nr. 2805/1 prot., datë 29.06.2021

²² regjistruar në ILD me nr. 2807/1 prot., datë 05.07.2021

- iv) Praktikrat lidhur me informimin dhe raportimin pranë Prokurorit të Përgjithshëm nga ana e Drejtuesve të Prokurorisë sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "g" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- v) Kopje nga Regjistri i Komunikimeve të Brendshme mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve sipas parashikimeve të nenit 20 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- vi) Praktika dokumentare të Sektorit të Monitorimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- vii) Informacion shoqëruar me të dhëna statistikore, të ndara për çdo prokurori në përputhje me të dhënat e administruara nga dokumentacioni shkresor.

A series of approximately seven handwritten signatures in blue ink, written over the footer text. The signatures vary in style, with some being more legible and others being more stylized or cursive.

3. Gjetjet

3.1. Baza e vlerësimit

Referuar qëllimit dhe objektivit të inspektimit, analiza e të dhënave të marra nga zyrat e prokurorive, është përqendruar në drejtim të (i) mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre, (ii) mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre, (iii) mënyra e informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm.

Analiza e këtyre të dhënave, është bazuar në analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, rregulloret standarde të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme, ku parashikohen dispozitat përkatëse dhe rregullat për procedurën e nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme dhe udhëzimeve jo të detyrueshme, si dhe mënyra e informimit në Prokurori.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të bëra me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, organi i prokurorisë nuk është më organ i centralizuar dhe thellësisht hierarkik. Në mbështetje të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe atyre të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se parashikimet e reja ligjore synojnë garantimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë të organit të prokurorisë dhe respektimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve, si në ushtrimin e ndjekjes penale, ashtu edhe në përfaqësimin e akuzës në gjyq.

Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka rishikuar mënyrën e organizimit të brendshëm të sistemit të prokurorisë, me qëllim garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë e organit të prokurorisë dhe uniformitetin e veprimtarisë së saj. Kjo garantohet përmes mundësisë së nxjerrjes së udhëzimeve të karakterit të përgjithshëm nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesit e Prokurorive, të cilët kanë përgjegjësi ligjore për mbarëvajtjen e punës në prokurori, si dhe dhënies së udhëzimeve, jo të detyrueshme, lidhur me çështjet konkrete²³.

Në mbështetje të nenit 6, pika 2 dhe nenit 46, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

²³ Neni 48 i ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.



prokurorët më të lartë²⁴ mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim, të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë. Udhëzimet e përgjithshme, mund të jenë të natyrës administrative ose procedurale.

Në mbështetje të nenit 38, pika 2, shkronja "b", si dhe nenit 46, pika 3 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm: (i) për koordinimin e punës ndërmjet prokurorive të ndryshme apo mes tyre dhe policisë gjyqësore, të përfshira në hetime të përbashkëta, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale; (ii) për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale, bazuar në vendimet gjyqësore; (iii) për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, për luftën kundër kriminalitetit; (iv) për raste të tjera që nuk kanë lidhje me çështje konkrete.

Në mbështetje të nenit 42, shkronja "g", nenit 43, shkronjat "b", "ç" dhe "dh" si dhe nenit 46, pika 4 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejton, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Drejtuesi i prokurorisë: (i) garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm; (ii) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerrë udhëzime me shkrim; (iii) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve, si dhe kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake; (iv) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në të njëjtën kohë, në mbështetje të nenit 42, shkronja "l" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Drejtuesi i prokurorisë informon çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit, si dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të marrë periodikisht të dhëna dhe informacione nga prokuroritë, lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm, përgatisin brenda muajit shkurt të çdo viti, raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës dhe ia paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm.

Në mbështetje të neneve 148, 148/b, shkronjat "b", "d" dhe "dh" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 38, pika 1 dhe 2, shkronjat "b", "d" dhe "f", nenit 2, shkronjat "b" dhe "c", neneve 4, 5, 6, 42, shkronjat "a", "c" dhe "g", neneve 43, 46, 47, 48, 50 e vijues të ligjit

²⁴ Në mbështetje të nenit 2, shkronja "c" të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar: "c) "Prokuror më i lartë" është: (i) Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe shkallës së parë, sipas përcaktimeve të këtij ligji; (ii) drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së apelit për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie; (iii) drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për prokurorët që ushtrojnë funksionet pranë kësaj prokurorie."

nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të neneve 24, 25, pika 2 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nenit 52 e vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 159 e vijues të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë Udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020.

Qëllimi i këtij udhëzimi është unifikimi i të drejtave dhe detyrimeve të prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me Drejtuesit e prokurorive si prokurorë më të lartë dhe informimin dhe koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, eficientën, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur. Udhëzimi nr. 12/2020, i ndryshuar, gjithashtu ka për objekt: (i) garantimin e pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në ushtrimin e funksioneve procedurale në raport me detyrueshmërinë e ndjekjes penale; (ii) përcaktimin e raporteve prokuror – prokuror më i lartë; si dhe (iii) mënyrën e informimit/raportimit në të gjitha hallkat dhe nivelet e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm²⁵.

3.2. Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme detyruese nga ana e prokurorit më të lartë dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre.

Neni 46 i ligjit nr. 97/2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", parashikon nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme nga Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesit e prokurorive. Në pikën 4 parashikohet se: "*drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas nenit 43, shkronja "dh", të këtij ligji.*

Në marrëdhëniet procedurale me drejtuesit e prokurorive neni 8, pika 2, shkronja "b" të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, ka parashikuar se "*Prokurori në ushtrimin e funksioneve në mënyrë të pavarur ka detyrimin të respektojë Kushtetutën, kuadrin ligjor të veprimtarisë, udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe/ose drejtuesit të prokurorisë ku ai është emëruar apo ushtron funksionet*".

Gjithashtu, neni 10, pika 2 i Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikon se: "*Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe pranë gjykatave të shkallës së parë garantojnë dhe lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, duke nxjerrë dhe udhëzime të përgjithshme, si dhe struktura përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme mbikëqyr zbatimin e tyre*". Po në nënin 22, pika 4 të Udhëzimit të Përgjithshëm

²⁵ Neni 1 dhe 2 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*", i ndryshuar.

nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikohet se Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

Në referim të bazës ligjore të mësipërme, nenit 46 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe zbatim të neneve 7, pika 2, shkronja "a" dhe 10, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, në marrëdhënien ndërmjet ruajtjes së pavarësisë funksionale të prokurorit në çështje konkrete dhe qëndrueshmërisë dhe uniformitetit të veprimtarisë së prokurorisë, që lidhen me mënyrën dhe procedurën që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme për prokurorët dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, në periudhën kohore të inspektimit 01.10.2020-31.03.2021, rezulton se:

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë**

Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme të detyrueshme, të cilat janë të karakterit procedural dhe administrativ, ku për periudhën e inspektimit rezulton i evidentuar një udhëzim i tillë. Ndërsa, rezultojnë edhe dy udhëzime të përgjithshme, të cilat janë nxjerrë para datës së fillimit të periudhës objekt inspektimi, por zbatimi i tyre përfshin periudhën objekt inspektimi.

Në periudhën e inspektimit evidentohet nxjerrja e **udhëzimit nr. 34, datë 05.01.2021** "Në zbatim të urdhrin nr. 164, datë 18.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Për miratimin e rregulloreve standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive pranë gjykatës së shkallës së parë me Juridiksion të Përgjithshëm".

Udhëzimi në fjalë është cilësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë si me karakter të përgjithshëm detyrues, dhe në të është përcaktuar edhe koha e hyrjes në fuqi e tij, shtrirja e efektit, si dhe mënyra e shpërndarjes për njohje dhe personi kompetent. Udhëzimi përbëhet nga 6 pika, në të cilin udhëzohen prokurorët dhe oficerët e seksionit të policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, administrata dhe shërbimet mbështetëse gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale, të zbatojnë rregulloren standard në fjalë, duke u marrë masat përkatëse të përcaktuara; për të vijuar me hyrjen në fuqi të rregullores së miratuar me udhëzimin në fjalë; caktimin e personit përgjegjës, kancelarin për shpërndarjen për njohje të rregullores së miratuar; mënyrën e të proceduarit lidhur me përcjelljen në Prokurorinë e Përgjithshme të rregullores së miratuar dhe për të përfunduar me hyrjen në fuqi të udhëzimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion me shkresë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se lidhur me udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë nxjerrë edhe dy akte me qëllim lehtësimin e zbatimit të udhëzimit në fjalë. Aktet përkatëse me të cilat ka vepruar Drejtuesi i Prokurorisë janë: udhëzim i përgjithshëm detyrues dhe urdhri "Për krijimin e regjistrit të brendshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë", dhe më konkretisht si më poshtë:

Udhëzimi i përgjithshëm me nr. 26, datë 30.07.2020 "Mbi marrëdhëniet në prokurori dhe mënyrën e informimit të drejtuesit të Prokurorisë". Ky udhëzim rezulton të jetë nxjerrë bazuar

në nenin 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 42 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Udhëzimi përbëhet nga 13 nene, duke filluar me përshkrimin e qëllimit të udhëzimit; objektin e udhëzimit; rregullimin e garantimit të pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit; qëndrimin ndaj ndërhyrjeve të paligjshme; qëndrimin e prokurorisë në raport me pavarësinë funksionale të prokurorit; marrëdhënieve ndërmjet prokurorit dhe Drejtuesit të Prokurorisë; informimin e Drejtuesit të Prokurorisë nga prokurori si gjatë ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq; informimi i Drejtuesit të Seksionit; për të vazhduar me rregullimin e qarkullimit të shkresave lidhur me aktet hetimore ndërmjet prokurorit dhe Drejtuesit të Prokurorisë, duke specifikuar pasqyrimin në regjistrin e komunikimeve të brendshme të administruar nga sekretaria pranë Drejtuesit, si dhe duke specifikuar edhe llojet e akteve konkrete që do të gjejnë pasqyrim në këtë regjistër; zbatimin e mbikqyrjen, si dhe parashikimin e nisjes së verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ose hetimit disiplinor ndaj prokurorit sipas ligjit, në rast të shkeljes së dispozitave ligjore referuese të udhëzimit në fjalë; për të përfunduar me hyrjen e menjëhershme në fuqi të këtij udhëzimi.

Nga të dhënat e administruara, evidentohet se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Tiranë është nxjerrë jashtë periudhës objekt inspektimi, edhe **udhëzimi i përgjithshëm me nr. 25, datë 28.07.2020** “Në zbatim të udhëzimit nr. 11, datë 20.07.2020 dhe urdhrin me nr. 983/3, datë 27.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm. Ky udhëzim rezulton të jetë nxjerrë bazuar në parashikimet e ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, udhëzimit nr. 11, datë 20.07.2020 dhe urdhrin me nr. 112, datë 27.07.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”, dhe duke pasur si qëllim sigurimin e një rakordimi të punës, mirëfunksionimin, si dhe vënien në zbatim të planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave. Udhëzimi përbëhet nga 6 pika, në të cilin udhëzohen prokurorët dhe oficerët e seksionit të policisë gjyqësore, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre funksionale të zbatojnë udhëzimin nr. 11, datë 20.07.2020 dhe urdhrin nr. 112, datë 27.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm; për të vijuar me prioritetet sipas drejtimeve përkatëse për t’u patur në konsideratë, si dhe masat përkatëse që duhet të ndërmerren lidhur me njohjen dhe zbatimin; caktimin e personit përgjegjës, kancelarin për shpërndarjen për njohje të udhëzimit të miratuar; mënyrën e të proceduarit lidhur me përcjelljen në Prokurorinë e Përgjithshme të udhëzimit të miratuar; dhe për të përfunduar me hyrjen në fuqi të udhëzimit.

Në kuadër të kompetencave të Drejtuesit të Prokurorisë referuar ligjit nr. 97/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, janë nxjerrë edhe një sërë urdhrash, të cilat kanë në fokusin e tyre çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë. Këto urdhra mund t’i grupojmë në ato që u drejtohen veçanërisht prokurorëve, përsa i përket mënyrës së organizimit të tyre dhe shpërndarjes së çështjeve, si dhe ato që i drejtohen kryesisht punonjësve të administratës së prokurorisë, përsa i përket mbarëvajtjes dhe funksionimit të saj lidhur me organikën, procedurat përkatëse për plotësim organik të blerjeve që kryhen, etj.

- Referuar parashikimeve ligjore sa më sipër dhe të dhënave të marra, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, vlerësohet nxjerrja për periudhën e inspektimit e **tre (3) udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme**, nga të cilat dy me qëllimin e lehtësimit të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, konkretisht atyre me nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar dhe nr. 11, datë 20.07.2020, për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020. Udhëzimi tjetër i përgjithshëm ka dalë në zbatim të urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm për miratimin e rregullores standard të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.
- Udhëzimet në fjalë, të nxjerra në bazë dhe në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij, përmbushin procedurën ligjore për nxjerrjen e tyre si udhëzime të përgjithshme të detyrueshme me shkrim dhe të arsyetuara, parashikuar nga neni 7, pika 2, shkronja "a" dhe nëndarja ii), si dhe neni 10, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Në këto udhëzime është përcaktuar fakti se janë me karakter të përgjithshëm detyrues, duke u caktuar edhe hyrja në fuqi, por nuk ka të dhëna të tjera lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Lidhur me ndjekjen e tyre, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në raportin vjetor të punës së prokurorisë për vitin 2020²⁶ është evidentuar fakti i moszbatimit të udhëzimeve nga ana e prokurorëve dhe arsytet e këtij moszbatimi i ka mbështetur tek ngarkesa e punës së tyre. Kështu, më konkretisht Drejtuesi shprehet se: *"Konstatohet se jo në çdo rast zbatohen nga prokurorët e kësaj prokurorie udhëzimet dhe kryesisht ato udhëzime që në pjesën dërrmuese nuk janë zbatuar kanë të bëjnë pikërisht me raportimin e të dhënave statistikore. Kjo vjen edhe si pasojë e ngarkesës në punën e tyre, në ushtrim të funksioneve sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kushtetutës."*
- Në veçanti nuk ka të dhëna lidhur me zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm me nr. 25, datë 28.07.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, në zbatim të nenit 10, pika 4 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, sipas të cilit prokurorët dhe Drejtuesit raportojnë si kanë ndikuar ato mbi gjendjen e kriminalitetit dhe në veprimtarinë e prokurorisë në fushat e rekomanduara, lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe elementë apo tregues të tjerë thelbësorë në veprimtarinë e prokurorisë. Por, në lidhje me këtë pikë, në raportin vjetor të vitit 2020 të Drejtuesit të Prokurorisë gjendet informacioni se: *"janë marrë masat e nevojshme organizative për zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2020. Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë nxjerrë Urdhra dhe Udhëzime të ndryshme për të mundësuar zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave"*.

²⁶ Dorëzuar në Prokurorinë e Përgjithshme me shkresën nr. Ekstra prot., datë 24.05.2021.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës**

Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është informuar se lidhur me udhëzimet e përgjithshme me karakter të detyrueshëm, në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, menjëherë me marrjen e tij janë marrë masa për shpërndarjen dhe njohjen e prokurorëve me të, nëpërmjet email-it zyrtar dhe shpërndarjes së fotokopjeve të udhëzimit, dhe më pas diskutimi lidhur me zbatimin e tij, në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve.

Nga përmbajtja e email-it zyrtar të datës 24.07.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë dërguar bashkëlidhur me dokumentacionin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës rezulton se Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 dhe regjistri i qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale u është dërguar të gjithë prokurorëve.

Sipas përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezulton se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nuk janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme, pasi është vlerësuar se udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm ka qenë i detajuar dhe drejtpërdrejt i zbatueshëm. Fillimisht, në funksion të zbatimit të udhëzimit nr. 12/2020, të ndryshuar, është administruar regjistri i brendshëm dhe është caktuar sekretarja, e cila është ngarkuar me mbajtjen e tij. Në periudhën 01.10.2020-31.03.2021, veprimtaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka qenë e kufizuar herë pas here edhe për shkak të mungesave të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës, të cilët kanë kaluar COVID-19. Për këto arsye edhe udhëzimet, kërkesat për informacion, apo akte të tjera sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 12/2020, të ndryshuar, nuk kanë qenë të shumta.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, evidentohet nxjerrja e **një (1) udhëzimi me nr. 3, datë 19.02.2021** "Për përgatitjen e raportit vjetor të Drejtuesit të Prokurorisë për vitin 2020". Udhëzimi përmban elementët e domosdoshëm të aktit normativ, duke parashikuar bazën ligjore të tij, ligjin nr. 97/2016, i ndryshuar, ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, udhëzimin nr. 02, datë 29.12.2016 "Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori", udhëzimin nr. 03, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori" të Prokurorit të Përgjithshëm dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Drejtuesi i prokurorisë, ligjin nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për statistikat zyrtare". Udhëzimi i mësipërm është nxjerrë me qëllim informimin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit, respektimin e detyrimit ligjor për mbajtjen e statistikave, marrjen në vijim të masave për parandalimin e kriminalitetit, pasqyrimin e ngarkesës së punës të secilit prokuror, apo oficer të policisë gjyqësore. Udhëzimi i drejtohet zyrës së regjistrimit për të rakorduar të dhënat me prokurorët dhe Drejtuesit e Seksioneve për veprat penale në fushën e seksionit përkatës dhe parashikon hyrjen në fuqi menjëherë.

Gjatë veprimtarisë së Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë dhe urdhri nr. 2, datë 15.01.2021 "Për miratimin e rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës", në dispozitat e të cilit parashikohen: struktura e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; kompetencat administrative dhe në

ushtrimin e ndjekjes penale të Drejtuesit të Prokurorisë; dispozita mbi llojet e regjistrave dhe për qarkullimin e brendshëm të akteve në prokurori, si dhe dispozita të tjera.

- Për sa i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe mbikëqyrjes e zbatimit të tyre, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezulton se përveç njohjes së prokurorëve me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, **nuk janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme**, për lehtësimin e zbatimit të tij, për shkak se në vlerësim të Drejtuesit të kësaj prokurorie udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm ka qenë drejtpërdrejt i zbatueshëm. Është nxjerrë një udhëzim tjetër i përgjithshëm me nr. 3, datë 19.02.2021 "Për përgatitjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë për vitin 2020". Ky udhëzim është nxjerrë bazuar në procedurën ligjore të nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme me shkrim dhe të arsyetuara, parashikuar nga neni 10, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga Drejtuesi i Prokurorisë është informuar se për të garantuar zbatimin korrekt të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, nga të gjithë prokurorët dhe stafi i kësaj prokurorie, menjëherë pas marrjes së udhëzimeve, ato i janë shpërndarë të gjithë prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe sipas rastit edhe te punonjësit e tjerë të prokurorisë. Secili prej udhëzimeve analizohet dhe diskutohet në mbledhjen e përgjithshme të prokurorëve. Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, kur është çmuar e nevojshme, janë përpiluar udhëzime me karakter jo të detyrueshëm, si dhe ju është kërkuar informacion prokurorëve lidhur me procedime penale të mbartura, apo me persona të arrestuar.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, rezulton se janë nxjerrë disa udhëzime të përgjithshme:

- 1) Udhëzim i përgjithshëm nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 "Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm të ndryshuar".
 - Në vështrim të dispozitave të këtij udhëzimi të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, rezulton se ai është nxjerrë për të lehtësuar zbatimin e Udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, ku përmbahen dispozita të ngjashme dhe në përputhje me këtë udhëzim, me ndryshime kryesisht në drejtim të formulimit dhe terminologjisë së përdorur. Udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë mbështetet në ligjin nr. 97/2016, i ndryshuar, ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar dhe

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË



24

Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar dhe Kodin e Procedurës Penale, duke parashikuar hyrjen në fuqi në datën 07.09.2020.

- Në pikat e 1, 2, 3 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë përmbahen parashikime që lidhen me veprimet e zyrës së regjistrimit për njoftimin e drejtuesit mbi çdo procedim penal dhe pasuror të regjistruar nga prokurorët, si dhe për çdo rast kur gjykata i kthen aktet prokurorit sipas neneve 329/3, 329/b/3, 332/ç, 332-dh/ç dhe 402/4 të K. Pr. Penale. Këto pika janë hartuar në referim të parashikimeve në nenit 12, pikat 1 dhe 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.
- Në pikën 4 të tij, e cila i referohet nenit 13, pika 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, ka të parashikuar se “...prokurori urdhërohet të informojë paraprakisht drejtuesin... informacioni të përmbajtje të dhëna mbi procedimin penal”, ndërsa udhëzimi nr. 12/2020, në nenin 13, pika 1²⁷, parashikon se “...prokurorët duhet të informojnë paraprakisht drejtuesin...”.
- Pika 5 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë, e cila parashikon se “në të gjitha procedimet penale në të cilat drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm, prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë jo më vonë se 20 ditë përpara marrjes së vendimit përfundimtar...”, duhet të ishte ndryshuar në përshtatje me nenin 14, pika 1 të ndryshuar me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020”, neni 2, sipas të cilit “prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë, mbi kërkesën e këtij të fundit...”. Megjithatë, në kohën e nxjerrjes së udhëzimit nr. 39, datë 07.09.2020 nga Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan, ky parashikim ka qenë në përputhje me atë të nenit 14, pika 1 të udhëzimit nr. 20/2020. E njëjta gjë edhe për pikën 6 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë, “prokurori brenda 3 ditëve nga vendimi informon me shkrim drejtuesin...” të ndryshuar, nga neni 3 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 “...prokurori informon drejtuesin e prokurorisë brenda 3 (tre) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit”.
- Në pikën 8 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë, e cila i referohet nenit 12, pika 4²⁸ të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikohet

²⁷ 1. Prokurorët, me qëllim që të mundësojnë drejtuesin për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 97/2016, përveç rasteve kur urgjenca nuk e lejon, duhet të informojnë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë, sipas organizimit të brendshëm në prokurori, për procedimin penal ku do ta nxirren urdhra ndalimi, ose do t'i drejtohen gjykatës kërkesa për caktimin e masave të sigurimit arrest në burg, arrest në shtëpi, kërkesa për aplikimin e sekuestrove preventive, konservative apo për hetimin pasuror ku do të kërkohet aplikimi i masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr. 10192/2009.

²⁸ 4. Zëvendësdrejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit, që janë të gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë, duhet të njoftojë drejtuesin e prokurorisë për çdo kërkesë drejtuar gjykatës, lidhur me arrestimet në flagrancë, ndalimet, masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror, mjetet e kërkimit të provës, sigurimin e provës, për aktet drejtuar institucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim, masat mjekësore apo shërbimeve policore, të cilat

se "në përfundim të çdo dite, zv. drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit, kur ka vepruar në mungesë të drejtuesit të prokurorisë, informon drejtuesin e prokurorisë për procedimet penale të referuara atë ditë me persona të arrestuar/ndaluar, për kërkesat e prokurorëve drejtuar atë ditë gjykatës me objekt...", duke e detajuar në krahasim me dispozitën e mësipërme të udhëzimit nr. 12/2020, të ndryshuar dhe duke shtuar "informacioni përmban të dhëna të përgjithshme mbi procedimin penal, veprën penale, personin e arrestuar/ndaluar, llojin e kërkesës së prokurorit dhe vendimin e gjykatës mbi këtë kërkesë". Në lidhje me këtë pikë, nuk konstatohet nëse është realizuar ndonjëherë në praktikë, apo nëse has vështirësi, pasi nuk ka akte që të tregojnë zbatimin e saj dhe lehtësimin e zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, pasi sipas parashikimeve të këtij të fundit "zv/drejtuesi ose drejtuesi i seksionit "njofton" drejtuesin për aktet që ka nënshkruar në mungesë të drejtuesit gjatë periudhës së gadishmërisë", të cilat përmenden në udhëzim, ndërkohë që informacioni i kërkuar sipas udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë, është se përveç materialeve të referuara me të arrestuar/ndaluar dhe për kërkesat që i drejtohen gjykatës/IEVP/Policisë, parashikon të përmbajnë një numër jo të vogël të dhënash.

- Në pikën 9 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë është shtuar parashikimi se "kur prokurori në seancë gjyqësore mban një qëndrim të ndryshëm nga sa ka parashtruar në kërkesën drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit, llojit dhe masës së dënimit, qëndrimin mbi fajësinë e të pandehurit, kualifikimin e veprës penale, sekuestrimin/konfiskimin e pasurive, përpilohet nga prokurori i seancës për drejtuesin e prokurorisë një informacion me shkrim mbi këtë fakt". Edhe në lidhje me këtë pikë nuk konstatohet nëse është realizuar ndonjëherë në praktikë apo ka vështirësi, pasi nuk ka akte që të tregojnë zbatimin e saj, Megjithatë, për këtë lloj informacioni që kërkohet nga Drejtuesi në udhëzimin e përgjithshëm të tij, sërish kemi të bëjmë me qëndrimin e prokurorit para marrjes së vendimit nga gjykata, më konkretisht përse prokurori ka ndryshuar qëndrim, ndërsa sipas nenit 15, pika 1²⁹ të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, qëllimi i informimit është me përfundimin e gjykimit, në lidhje me shkaqet e vendimmarrjes ndryshe të gjykatës nga qëndrimi i prokurorit dhe nëse në vlerësim të këtyre shkaqeve do të ushtrohet ankim ose jo. Duket se informacioni i prokurorit sipas kësaj pike ka kuptim në rastin e ndryshimit të qëndrimit të prokurorit gjatë seancave të masave të sigurimit apo atyre pasurore, akte me të cilat Drejtuesi është njohur gjatë përcjelljes së kërkesave në gjykatë, ndërsa në rastin e konkluzioneve Drejtuesi ka mundësi të njihet pasi ato janë dhënë nga prokurori dhe që njëkohësisht përbën dhe qëndrimin i tij në përfundim të gjykimit. Nëse vendimi i gjykatës do ishte i ndryshëm nga kërkesa e prokurorit, këtij

nënshkruhen nga zëvendësdrejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit, në mungesë të drejtuesit të prokurorisë.

²⁹ 1. Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarinim e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit nr. 10192/2009, prokurori informon drejtuesin e prokurorisë brenda 3 (tre) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë apelin.

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

26

të fundit do t'i duhej të bënte dy informacione, si për qëndrimin e tij të ndryshëm, edhe për vendimin e gjykatës. Edhe në rastet e masës nuk është qartësuar nëse informacioni që kërkohet në këto raste i takon rasteve të vleftësimeve/ndalimeve, rivlerësimit të masës në kuptim të nenit 246/6 të K. Pr. Penale apo marrjes në pyetje të personit të arrestuar sipas nenit 248 të K. Pr. Penale, pasi kërkesa për caktim mase sigurimi sipas nenit 244 të K. Pr. Penale, shqyrtohet në dhomë këshillimi.

- Gjithashtu, pika 11 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë, ka shtuar parashikimin se *"Prokurori informon me shkrim drejtuesin e prokurorisë mbi qëndrimin e tij në seancë dhe vendimin e gjykatës në rastet kur merr pjesë në gjykimin e kërkesave me objekt zëvendësimin/shuarjen/revokimin e masave të sigurimit personal ose pasurore të vendosura më parë nga gjykata sipas neneve 237 (me dhe pa afat) dhe 238 të K. Pr. Penale"*. Nuk konstatohet nëse është realizuar kjo pikë, pasi nuk janë vendosur akte në dispozicion edhe pse nuk ka parashikim për një informim të tillë në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Qëllimi i udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi mënyrën e informimit është që Drejtuesit e Prokurorisë të informohen mbi fillimin dhe për ecurinë e ndjekjes penale në funksion të unifikimit të veprimtarisë së prokurorisë apo vendimmarrjes së saj në raste të ngjashme edhe nëpërmjet nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme, si dhe për politikën penale që zbatohet nga prokuroria dhe gjykata. Duke qenë se udhëzimi i mësipërm i Drejtuesit të Prokurorisë ka dalë për të lehtësuar zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe jo për të shtuar detyrimet e prokurorit tej atyre që parashikon ky i fundit, duket se për këto arsye udhëzimi i ka tejkaluar parashikimet e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, ku Drejtuesi në rastin konkret parashikon detyrimin kryesisht të prokurorit të informojë pa kërkesë të tij, pasi edhe para ndryshimeve në kuadër të nenit 13, pika 2 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, informimi nga prokurori bëhet mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë.
 - Pika 13 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, parashikon krijimin e regjistrit të komunikimeve të brendshme sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1, të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ndërsa pika 14, faktin se çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.
- 2) Udhëzim i përgjithshëm nr. 44 PBD, datë 09.10.2020 *"Në bazë dhe për zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm"*, i cili i referohet seksioneve të posaçme në prokurori kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore. Edhe ky udhëzim mbështetet në bazën ligjore, në ligjin nr. 97/2016, të ndryshuar, ligjin nr. 96/2016, të ndryshuar, udhëzimin e përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kodin e Procedurës Penale dhe hyn në fuqi në datën 09.10.2020.



- Neni 17 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi zbatimin dhe mbikëqyrjen e tij parashikon se Drejtuesit e Prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm. Në këto kushte, udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan mbështetur në ligjin nr. 97/2016, të ndryshuar dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka dalë në përputhje me objektin e këtij udhëzimi, lidhur me përcaktimin e masave administrative dhe procedurale, mbi organizimin e seksionit të posaçëm nga Drejtuesi i Prokurorisë, sipas rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive, caktimin e pikave të kontaktit, në këtë rast të Drejtuesit të Seksionit, rolit dhe detyrave të tij në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, bazuar në nenin 5 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, informimin dhe raportimin e parashikuar në udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë, në përputhje me nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm.
 - Gjithashtu në udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë parashikohet dhe shkëmbimi i informacionit ndërinstytucional në përputhje me nenin 8 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe bashkërendimi dhe koordinimi në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve të këtij seksioni, me oficerët e policisë gjyqësore në strukturat përkatëse të hetimit, sipas parashikimeve të nenit 10 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm.
 - Udhëzimi i përgjithshëm i drejtuesit të prokurorisë parashikon në pikën 8 edhe nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga Drejtuesi i prokurorisë apo Drejtuesi i seksionit, për prokurorët e seksionit që drejton në momentin e caktimit të çështjes për vlerësim/ndjekje të prokurorit përkatës, sipas parashikimeve të nenit 11 të udhëzimit nr. 10, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- 3) Udhëzim i përgjithshëm nr. 55 PBD, datë 11.12.2020 "Mbi kryerjen e ekspertimeve toksikologjike-kliniciste-adiktologjike". Udhëzimi i referohet si bazë ligjore, ligjit nr. 97/2016 të ndryshuar, ligjit nr. 96/2016 të ndryshuar, si dhe Kodit të Procedurës Penale, duke parashikuar hyrjen në fuqi në datën 14.12.2020.
- Udhëzimi ka të bëjë me faktin se për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike-kliniciste-adiktologjike dhe për të përcaktuar nëse sasia e lëndës së sekuestruar personave nën hetim, përbën dozë të vogël për përdorim vetjak të njëkohshëm, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie janë caktuar ekspertë privat dhe/ose të punësuar pranë institucioneve të ndryshme spitalore të vendit.

Në pikën 1 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë udhëzohet që në kryerjen e ekspertimeve toksikologjike-kliniciste-adiktologjike, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të caktojnë ekspertë të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, me qëllim që të evitohen situata të tilla që ngrenë dyshime për integritetin dhe cilësinë e ekspertimeve të kësaj natyre të kryera nga ekspertë privat; paqartësinë e faktit nëse eksperti i caktuar ka pasur apo jo njohuritë e nevojshme për kryerjen e

ekspertimit; faktin nëse institucioni spitalor ku është i punësuar personi i ngarkuar me detyrën e ekspertit, ka apo jo pjesë të punës së tij kryerjen e ekspertimeve, etj. Nga ana tjetër, kryerja e ekspertimeve private, krijon kosto financiare shtesë dhe të panevojshme për organin e prokurorisë.

- Në pikën 2 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë përcaktohet se çdo veprim ose mosveprim në kundërshtim me sa më sipër përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, çfarë duket se vjen në kundërshtim me faktin se në përmbajtjen e udhëzimit caktimi i ekspertëve lihet në vlerësim të prokurorit, ku në paragrafin 4 të tij parashikohet se: “Në këto rrethana është e nevojshme që nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie të vlerësohet maksimalisht mundësia që në kryerjen e ekspertimeve kliniciste-adiktologjike, në procedimet penale në të cilat çmohet e nevojshme kryerja e një ekspertimi të tillë, të caktohen ekspertë të IML”, si dhe në dispozitat e K. Pr. Penale, lidhur me caktimin e ekspertit, parashikohet në nenin 179, pika “1. Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse, pika “4. Eksperti është i detyruar të kryejë detyrën e tij, me përjashtim të rasteve kur ekziston një nga shkaqet që e përjashtojnë atë nga qenia ekspert ose kur pretendon se nuk është kompetent ose nuk ka mundësi të kryejë ekspertimin dhe kërkesa e tij pranohet nga organi procedues”. Gjithashtu, udhëzimi i përgjithshëm nr. 08, datë 19.05.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, në nenin 12 parashikon: “1. Në fazën e hetimeve paraprake, prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, thërret ekspertë në një procedim penal, mbështetur në të dhënat e Regjistrat Elektronik të Ekspertëve, që administron dhe vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë, sipas kriterëve të përcaktuara me aktin normativ përkatës. 2. Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, thërret ekspertë jashtë Regjistrat Elektronik të Ekspertëve, në rastet kur për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre”. Në bazë të sa më sipër, prokurori duhet të marrë masat që kur disponon për ekspertimin të sigurohet për identitetin e ekspertit, për ekzistencën e shkaqeve që e përjashtojnë atë nga qenia ekspert, papajftshmëritë me detyrën e ekspertit, për kompetencën e tij në bazë të njohurive të posaçme, të vërtetuar me dëshmitë përkatëse dhe licencës kur parashikohet në ligj/akte nënligjore.

- 4) Udhëzim i përgjithshëm nr. 19 PBD, datë 03.03.2021 “Mbi ekzekutimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e masave të sigurimit “arrest në shtëpi”, si dhe mbi rregullat për njoftimin dhe shoqërimin e personave nën hetim/pandehur me masa sigurimi “arrest në shtëpi” me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore”. Baza ligjore e këtij udhëzimi të përgjithshëm janë nenet 43 e 46 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, ligji nr. 96/2016, të ndryshuar, si dhe Kodi i Procedurës Penale. Me anë të këtij udhëzimi, udhëzohet që:

- i) në rastet e ekzekutimit të masave të sigurimit personal “arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale, të caktuar me vendim gjykate, prokurorët duhet të caktojnë dhe organin kompetent që do të mbikqyrë zbatimin e kësaj lloji mase sigurimi, që në rastin konkret duhet të jenë si rregull shërbimet e policisë gjyqësore të komisarivateve të policisë që mbulojnë vendbanimin/vendqëndrimin e personit nën

hetim/të pandehurit: T'i dërgojnë detyrimisht edhe komisariateve të policisë që mbulojnë vendbanimin/vendqëndrimin e personit nën hetim/të pandehurit, një kopje të urdhrit të ekzekutimit të masës së sigurimit dhe vendimit të gjykatës për caktimin e kësaj lloj mase sigurimi personal.

- ii) Në rastet e njoftimit (ftesave për paraqitje) për personat nën hetim/të pandehur për nevoja të hetimit të procedimeve penale në hetim me masë sigurimi personal "arrest në shtëpi" të parashikuar nga neni 237 i K. Pr. Penale, prokurorët duhet që: Njoftimi (ftesën për paraqitje) për personat nën hetim/të pandehur t'u komunikohet atyre nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore të komisariateve të policisë që mbulojnë vendbanimin/vendqëndrimin e personit nën hetim/të pandehurit, ose nëpërmjet shërbimeve të tjera të policisë gjyqësore, të cilët janë të ngarkuar me hetimin e çështjes penale konkrete; të përcaktojnë detyrimin e shërbimeve të policisë gjyqësore (në shkresën përcjellëse) të komisariateve të policisë që mbulojnë vendbanimin/vendqëndrimin e personit nën hetim/të pandehurit, ose shërbimeve të tjera të policisë gjyqësore, të cilët janë të ngarkuar me hetimin e çështjes penale konkrete, që të shoqërojnë personin nën hetim/të pandehurin me masë sigurimi personal në prokurori, apo në vendin ku do të kryhet veprimi, si dhe, pas kryerjes së veprimeve hetimore përkatëse, të kryejnë sërish dërgimin e tij për në adresën përkatëse ku është përcaktuar zbatimi i masës së sigurimit. Në aktet që njoftojnë apo ftojnë për veprime hetimore/procedurale personin nën hetim/të pandehurin me masë sigurimi "arrest në shtëpi" për të marrë pjesë duhet të përcaktohet qartësisht data dhe periudha kohore, gjatë të cilës duhet të marrë pjesë personi nën hetim/i pandehuri, si dhe itinerari i lëvizjes së tij nga banesa ku zbaton masën e arrestit në shtëpi për në destinacion dhe kthim.
 - iii) Çdo njoftim sipas pikave nr. 1 dhe nr. 2 të sipërcituara, nuk përjashton detyrimin e prokurorit për njoftimin e shërbimit të policisë gjyqësore që ka referuar materialin dhe/ose është ngarkuar me hetimin e çështjes penale në kuadër të së cilës është masa e sigurimit "arrest në shtëpi" ndaj personit nën hetim/të pandehurit.
- Referuar parashikimeve të këtij udhëzimi të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë mbi nenin 237 të K. Pr. Penale, kjo dispozitë lë të kuptohet se vendi ku caktohet masa e sigurimit "arrest në shtëpi" siç është banesa, vend tjetër ku ai banon, vendi ku kurohet apo mbahet me asistencë, mund të jetë i ndryshëm nga vendi ku është kryer vepra penale. Në funksion të zbatimit të kësaj mase gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së saj, ndërsa prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që mund t'i jenë dhënë të pandehurit. Më e thjeshtë çështja bëhet në rastin kur vendbanimin e personit nën hetim e mbulon shërbimi i policisë gjyqësore të komisariatit, i cili është i ngarkuar dhe me hetimin e çështjes penale dhe më problematike, kur këto janë të ndryshme apo me hetimin është i ngarkuar seksioni i policisë gjyqësore në prokurori. Por, nëse kopja e urdhrit të ekzekutimit dhe vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit "arrest në shtëpi", do t'i dërgohet si rregull shërbimeve të policisë gjyqësore të komisariatit të policisë që mbulon vendbanimin/vendqëndrimin e të pandehurit siç parashikohet në udhëzim, detyrimisht edhe ftesat për paraqitje do t'i dërgohen po këtyre shërbimeve.



Pra, njoftimi duhet të bëhet në dy drejtime, si policisë gjyqësore që mbulon vendbanimin e personit nën hetim, edhe policisë gjyqësore të ngarkuar me hetimin.

- Me parashikimet e udhëzimit duhet të kuptohet dhe për vendbanimin, i cili është jashtë territorit që mbulon Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, duke nënkuptuar në këtë drejtim njoftimin e personave nën hetim/të pandehurve nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore të një rrethi tjetër, të ndryshëm nga ai që mbulon Komisariati i Policisë Elbasan, apo nëse personi kërkon të ndryshojë vendbanim brenda të njëjtit territor, ose kërkon të lëvizë për nevoja të tij, si dhe në rastin e shoqërimit të personit pasi ka përfunduar veprimi për të cilin është thirrur dhe të kryejë sërish dërgimin e tij për në adresën përkatëse ku është përcaktuar zbatimi i masës së sigurimit, apo nëse duhet që policia gjyqësore të mbajë procesverbal të ngjashëm me procesverbalin e ekzekutimit të parë të masës së sigurimit, për të vërtetuar sa parashikon udhëzimi se personi u dërgua në banesë. Për këto çështje nuk ka rregullim dhe mbase udhëzimi mund të fokusohet edhe në këto drejtime, sesa në detyrimin e shërbimeve të policisë për të shoqëruar personin kur thirret në prokurori, e cila do të ishte kosto e tepërt burimesh, përveç rastit të shoqërimit të tij në një vend të caktuar për të kryer një veprim hetimor të caktuar, ose për marrjen e një prove prej tij, apo ku/kur kërkohet prania e tij.
- Ftesa për paraqitje i referohet veprimtarisë hetimore të prokurorit dhe si e tillë nuk duhet të përmbajë parashikime jashtë atyre të përcaktuara në ligj. Neni 308 i K. Pr. Penale parashikon se çfarë duhet të përmbajë ftesa për paraqitje e prokurorit ndaj personit të cilit zhvillohen hetime, siç janë: parashtrimi i përmbledhur i faktit që rezulton nga hetimet e bëra deri në atë çast; gjeneralitetet ose të dhëna të tjera personale që vlejnjë për identifikim; ditën, orën dhe vendin e paraqitjes; llojin e veprimit për të cilin është ftuar; paralajmërimin se prokurori mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm në rast të mosparaqitjes, pa pasur pengesë të ligjshme; letrën e të drejtave në formë të shkruar, sipas nenit 34/a të Kodit. Neni 134 parashikon njoftimin e akteve të prokurorit sipas të cilit "*Njoftimi i akteve të prokurorit, gjatë hetimeve paraprake, bëhet nga policia gjyqësore ose nëpërmjet shërbimit postar, në format e parashikuara nga neni 133*".
- Edhe pse paralajmërimi për shoqërim të detyrueshëm duket se ka të bëjë me ftesën për paraqitje ndaj personit nën hetim jo me masë sigurimi "arrest", në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë, detyrimi për të shoqëruar personin nën hetim/të pandehurin me masë sigurimi "arrest në shtëpi", mund të aplikohet njësoj, në rast mosparaqitje të personit nën hetim pa pasur një pengesë të ligjshme. Masa e sigurimit "arrest në shtëpi", nuk do të thotë se pengon personin nën hetim për t'u paraqitur vullnetarisht dhe ai duhet të shoqërohet patjetër nga shërbimi i policisë, pasi një kopje të ftesës paraqitje për paraqitje që ai disponon justifikon lëvizjen e tij vetëm për këtë qëllim. Në të kundërt çdo abuzim i këtij qëllimi është në përgjegjësinë penale të personit nën hetim/të pandehurit për largim nga vendi i qëndrimit të detyrueshëm në varësi të rrethanave të rastit konkret.



- Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, rezulton se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, **duke nxjerrë 4 (katër) udhëzime të përgjithshme**, dy nga të cilat për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, atyre me nr. 12/2020, të ndryshuar dhe nr. 10, datë 17.07.2020, ndërsa dy udhëzimet e tjera të natyrës për të normuar praktikën e përditshme të punës në Prokurorinë e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Elbasan, me vlerësimet për secilin prej tyre si më sipër.
- Udhëzimet e nxjerra në bazë dhe në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij, si dhe ato mbi zbatimin e ligjit procedural në lidhje me kryerjen e ekspertimeve mjekoligjor-toksikologjik dhe mbi mënyrën e zbatimit dhe njoftimit të personave me masë sigurimi “arrest në shtëpi”, janë nxjerrë në zbatim të procedurës ligjore me shkrim dhe të arsyetuara, sipas nenit 7, pika 2, shkronja “a” dhe nenit 10, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Megjithatë në nxjerrjen e këtyre udhëzimeve të përgjithshme duhet patur parasysh harmonizimi me legjislacionin procedural penal dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, për të siguruar zbatimin e drejtë të ligjit procedural penal në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykim.
- Nuk rezulton se ka, ose të paktën nuk dokumentohet se ka zbatim të pikave të ndryshme të udhëzimeve të përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë që janë nxjerrë për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe zbatim dhe mbikëqyrje të zbatimit lidhur me dy udhëzimet e tjera të përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier**

Në bazë të akteve dhe informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier rezulton se në funksion të mbikëqyrjes dhe zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, nga Drejtuesi i Prokurorisë janë nxjerrë:

- 1) Udhëzim i përgjithshëm nr. 65, datë 04.09.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, i cili parashikon se hyn në fuqi në datën 07.09.2020, në të njëjtën datë me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit me shkresën nr. 6515, datë 04.09.2020, i është njoftuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Si bazë ligjore e këtij udhëzimi të përgjithshëm përcaktohet neni 38, pikat 1 e 3, shkronjat “b”, “d”, “f”, neni 42, shkronja “a”, “c”, “g”, neni 43 e vijues të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, nenet 24, 25, pika 2 të K. Pr. Penale dhe neni 52 i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.
- Qëllimi i udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Fier, sipas nenit 1 të tij, është të lehtësojë zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të

ndryshuar, lidhur me unifikimin e të drejtave dhe detyrimeve në ushtrimin e funksioneve të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, marrëdhëniet e tyre me Drejtuesin e Prokurorisë, si prokuror më i lartë, informimin e koordinimin e veprimtarisë së prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, efencën, ligshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, pra, në zbatim të neneve 10, pika 2 dhe 22, pika 3 të këtij udhëzimi dhe nenit 42, shkronja “g”, nenit 43, shkronja “dh” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Dispozitat e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë vërehet se janë hartuar në përshtatje të dispozitave të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Udhëzimi i Drejtuesit të Prokurorisë Fier në nenin 4 parashikon, të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve në marrëdhëniet administrative me Drejtuesin e Prokurorisë, duke shtuar parashikime mbi mënyrën e njoftimit të prokurorëve për mbledhje dhe mbi informacionin për statistika që mund të kërkohet për t’i paraqitur ato të sakta dhe të plota brenda afatit të kërkuar nga Drejtuesi, zëvendësdrejtuesi apo Drejtuesi i Seksionit.
- Neni 6 i udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë Fier, në lidhje me informimin periodik dhe përgatitjen e raportit vjetor, si dhe me raportimin në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë, ka parashikuar se në përgatitjen e këtyre raportimeve do t’i kërkohet informacion prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës, me qëllim për të raportuar të dhëna të sakta e të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe elementë apo tregues të tjerë thelbësorë në veprimtarinë e prokurorisë, detyrime që parashikohen në nenin 10, pikat 3 dh 4 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Në lidhje me informimin e Drejtuesit të Prokurorisë, nga prokurori dhe zyra e regjistrimit të prokurorisë, neni 8 i udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë Fier, ka parashikime si ato të nenit 12 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Informimi nga zyra e regjistrimit në këtë rast bëhet duke i dorëzuar Drejtuesit kopje të urdhrave të regjistrimit të procedimit penal të marrë nga prokurorët, i cili bën siglimin në këto urdhra lidhur me marrjen e tij dijëni dhe urdhëron zyrën e regjistrimit për arkivimin e tyre.
- Në lidhje me pikën 2 dhe 3, të nenit 12³⁰ të udhëzimit të uërgjithshëm nr. 12/2020, parashikohet që, si kërkesa e Drejtuesit, ashtu edhe informacioni i prokurorit bëhen me

³⁰ 2. Prokurori informon drejtuesin e prokurorisë, sipas kërkesës së tij, mbi ecurinë dhe problemet e veprimeve të para hetimore në rastet e ngjarjeve të ndodhura përgjatë kryerjes së gatishmërisë dhe/ose mbi ecurinë e procedimit penal, përpara përfundimit të tij.

shkrim. Për pikën 4 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, në udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë Fier, është shtuar parashikimi se në lidhje me të gjitha aktet që firmosen në mungesë të Drejtuesit sipas këtij neni, prokurorët do të bëjnë printimin e tyre në tre kopje, ku një kopje do t'i dorëzohet Drejtuesit ose zëvendës drejtuesit, si dhe shefit të seksionit në rast të autorizimit të tij nga Drejtuesi, gjatë mungesës së tij. Zëvendës drejtuesi dhe shefi i seksionit bëjnë dorëzimin e këtyre akteve Drejtuesit të Prokurorisë në momentin që ai paraqitet në prokurori.

- Në lidhje me nenin 13 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, Drejtuesi i Prokurorisë Fier, në udhëzimin e tij ka parashikuar se në rastin e informimit paraprak për urdhrat e ndalimit apo kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal "arrest në burg", "arrest në shtëpi", njoftimi mund të bëhet verbalisht, ose shkurtimisht me email, ndërsa për rastet e masave të sigurimit pasuror apo të aplikimit të masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr. 10192/2009, njoftimi do të bëhet me informacion me shkrim. Në rastin e pikës 3, të nenit 13 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, Drejtuesi i Prokurorisë Fier ka parashikuar se kërkesa e Drejtuesit bëhet me shkrim. Për të dhënat që duhet të përmbajë informacioni i prokurorit pjesa "*si dhe veprimet hetimore që priten të kryhen*" është hequr me ndryshimet e bëra me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020, gjë që nuk është reflektuar më pas në nenin 9, pika 3 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë Fier.

- Edhe neni 10, pika 1 i udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Fier që parashikon se "*Prokurorët informojnë kryesisht drejtuesin e prokurorisë për ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror jo më vonë se 20 (njëzet) ditë përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve.....*", nuk reflekton ndryshimet në pikën 1, të nenit 14 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, e cila është ndryshuar me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 se "*I. Prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë, mbi kërkesën e këtij të fundit, për ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror jo më vonë se 20 ditë përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve.....*". Po kështu, në lidhje me informimin sipas nenit 15 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 është shtuar parashikimi në nenin 11 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë Fier se informacioni bëhet shkurtimisht me shkrim nga prokurori, por nuk është përshtatur me ndryshimet e bëra me udhëzimin nr. 16, datë 14.12.2020 sipas të cilit "*...prokurori informon drejtuesin e prokurorisë brenda 3 (tre) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë apelim*".

- 2) Udhëzim nr. 15, datë 18.03.2021 "*Mbi verifikimin e ecurisë së hetimit të çështjeve penale*" me qëllim verifikimin e ngarkesës me çështje penale në hetim dhe kallëzime penale të prokurorëve, baza ligjore e të cilit është vendosur nga udhëzimi nr. 02, datë 29.12.2016 "Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori", nuk i referohet udhëzimit të

3. Në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit, prokurori, mbi kërkesën e drejtuesit, duhet të informojë drejtuesin e prokurorisë për shkaqet dhe ecurinë e mëtejshme të hetimit brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa.



përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Ky udhëzim është protokolluar me nr. 858, datë 18.03.2021 në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës.

- Me anë të këtij udhëzimi është kërkuar verifikimi nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, i ecurisë së çështjeve penale që janë të mbartura në hetim në vitin 2021, si dhe i materialeve kallëzuese për të cilat ka kaluar afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditor. Bazuar në nenin 43, germa "b" dhe nenin 48 të ligjit nr. 97/2016, datë 06.10.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nëpërmjet këtij udhëzimi kërkohet informacion me shkrim kundrejt nënshkrimit, nga secili prokuror për ecurinë e procedimeve penale të cilat kanë kaluar të mbartura në hetim, duke e dorëzuar informacionin tek sekretarja e Drejtuesit të prokurorisë brenda datës 25.03.2021. Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, pas marrjes së informacionit të kërkuar, nëse do të vlerësohet e nevojshme, do të bëhet analizë mbi veprimet hetimore të kryera dhe nevojshmërinë e zgjatjes së hetimeve në kohë, me prokurorin e ngarkuar për të ndjekur hetimin, dhe rast pas rasti mund të konkludohet me nxjerrjen e udhëzimeve me shkrim, sipas parashikimeve ligjore të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe Kodit të Procedurës Penale.

- Në periudhën objekt të inspektimit, përse i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme dhe mbikëqyrjes e zbatimit të tyre, nga Drejtuesi i Prokurorisë Fier, rezulton se janë nxjerrë **dy (2) udhëzime të përgjithshme**, i pari për lehtësimin e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe udhëzimi tjetër i përgjithshëm, për verifikimin e ecurisë së hetimeve të procedimeve penale të mbartura dhe materialeve kallëzuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, duke respektuar procedurën e nxjerrjes së tyre me shkrim dhe arsyetimin përkatës.
- Udhëzimet e përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë rezulton se janë në pajtim me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm në kohën e daljes së tyre, pasi, mbas ndryshimeve të bëra këtij udhëzimi, me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020, ato nuk janë përshtatur me këto ndryshime.
- Nga ana tjetër, nuk rezulton se ka ose të paktën nuk dokumentohet se ka mbikëqyrje të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë Fier.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë

Nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, në zbatim të gurmës "dh", të neneve 43 dhe 46, pika 4 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, është proceduar me nxjerrjen e një (1) udhëzimi të përgjithshëm, "Për rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë", datë 07.09.2020, e cila duhet të jetë dhe data e hyrjes në fuqi (pasi vetë udhëzimi nuk e parashikon konkretisht). Udhëzimi është nxjerrë në bazë të nenit 148/b të

Kushtetutës, neneve 38, pika 2, shkronja “b”, 46, pikat 1, 2, 3 shkronja “a” dhe “c” të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, neneve 24, 25 të K. Pr. Penale, nenit 52 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, nenit 159 të ligjit nr. 115/2016 dhe nenit 132 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative.

- Udhëzimi i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka si objekt unifikimin e zbatimit të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe garantimin e kuptimit të saktë të përmbajtjes së këtij udhëzimi, me qëllim lehtësimin dhe ravigjëzimin e elementeve thelbësore që garantojnë zbatimin me efektivitet të udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.
- Udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë Korçë “Për rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë”, datë 07.09.2020, përmban dispozita të cilat i referohen në përmbajtje plotësisht neneve të kreut III mbi “Marrëdhëniet ndërmjet prokurorit dhe drejtuesit në prokurori” dhe kreut IV “Mënyra e informimit të drejtuesve në prokurori”, të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, si dhe nenin 20 të tij “Qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore”.
- Neni 1 i këtij udhëzimi të përgjithshëm parashikon të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet administrative dhe procedurale me Drejtuesin e Prokurorisë, duke ju referuar plotësisht nenit 8 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Po kështu vijohet me nenin 2, që reflekton nenin 9 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Gjithashtu nenet 3 dhe 4 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë Korçë janë identike me nenet 10 dhe 11 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, mbi mënyrën dhe procedurën e nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme dhe jo të detyrueshme për prokurorët. Po e njëjta gjë përsëritet edhe me nenin 5 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë, mbi informimin e Drejtuesit të Prokurorisë nga prokurori, detyrimet sipas nenit 12 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Nenet 6 dhe 7 të udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë janë sërish kopje të neneve 14 e 15 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, mbi informimin per ecurinë e ndjekjes penale dhe për përfaqësimin e akuzës në gjyq, ndërkohë që mungon dispozita në lidhje me informimin mbi masat e sigurimit personal dhe pasuror, e parashikuar nga neni 13 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, si dhe neni 10 i përfshirë në udhëzimin e përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Korçë është pa vend, pasi ka të bëjë me informimin për përfaqësimin e çështjes në Gjykatën e Apelit nga prokurorët e Apelit.
- Në periudhën objekt inspektimi, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, është zbatuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, **me nxjerrjen e një (1) udhëzimi të**



përgjithshëm me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij, duke respektuar edhe procedurën e nxjerrjes së tij, ndërsa për sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të tij, nuk ka të dhëna nga kjo prokurori.

- Udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë nuk përmban detajime të tjera, përveç përsëritjes tekstualisht së dispozitave të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër**

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, konstatohet se në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm”, të ndryshuar, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, janë nxjerrë dy (2) udhëzime të përgjithshme të detyrueshme për dy llojet e marrëdhënieve procedurale/administrative, si dhe në funksion të njohjes dhe zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe dy udhëzimeve të përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë, janë thirrur dy mbledhje të prokurorëve, si dhe një informacion drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

Sipas informacionit të Drejtuesit rezulton se me administrimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të ndryshuar, janë marrë masa për shpërndarjen dhe njohjen e tij nga të gjithë prokurorët dhe njëkohësisht udhëzimi është trajtuar në mbledhjen e prokurorëve sipas urdhrit të datës 08.09.2020 “Thirrje e Mbledhjes së Prokurorëve”, ku është diskutuar për mënyrat e zbatimit të tij. Gjithashtu ka filluar zbatimi në praktikë i tij duke nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme dhe kërkesa për informacion drejtuar prokurorëve në lidhje me çështje konkrete apo procedime penale të caktuara.

Në vijim të zbatimit të këtij udhëzimi dhe me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij, nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 33, datë 04.09.2020 “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”. Me shkresën nr. 295 prot., datë 08.01.2021 me lëndë “Mbi masat e marra për zbatimin e urdhrit dhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm ku bën pjesë dhe udhëzimi nr. 12/2020”, është informuar Prokurori i Përgjithshëm lidhur me faktin se me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, janë vënë në dijeni të gjithë prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe mbi bazë të tij është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 33, datë 04.09.2020, si dhe është bërë shpërndarja e udhëzimit tek prokurorët përkatës.

1- Udhëzimi i përgjithshëm nr. 33 prot., datë 04.09.2020 “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër”, normon marrëdhëniet mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve, si dhe pasqyrimin e akteve në regjistrin përkatës.

2- Udhëzimi i përgjithshëm nr. 1, datë 06.01.2021 "Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale", i nxjerrë bazuar ndër të tjera në Udhëzimin e Përgjithshëm me nr. 15, datë 30.10.2020 "Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale", të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nr. 1460 prot., datë 30.09.2020.

Lidhur me udhëzimin e përgjithshëm nr. 33 prot., datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër "Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë" në pikat kryesore të këtij akti nënligjor evidentohet se:

- Pika 8 ^[31] e udhëzimit nr. 33 prot., datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, ka shtuar një parashikim lidhur me vendimmarrjen e arsyetuar me shkrim të Drejtuesit të Prokurorisë brenda tre ditëve për pranimin/refuzimin e deklarimit për heqje dorë të prokurorit nga hetimi i mëtejshëm i çështjes konkrete, duke ju referuar nenit 7, pika 2, germa "c" të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, në lidhje me rregullat që disiplinojnë autoritetin e Drejtuesve të Prokurorisë, si prokurorë më të lartë në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe pavarësisë në ushtrimin e funksioneve të prokurorit, në drejtim të "Respektimi i të drejtës që prokurori ka sipas ligjit për heqjen dorë nga çështja konkrete që ka në ndjekje dhe kryerja e procedurës për zëvendësimin e tij", që do të thotë se procedura e zëvendësimit të prokurorit duhet të bëhet për shkaqet ligjore të parashikuara në referim të nenit 49 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe neneve 26 e 27 të K. Pr. Penale.
- Pika 9 ^[32] e udhëzimit nr. 33 prot., datë 04.09.2020 lidhur me kthimin nga prokurorët, të përgjigjeve me shkrim në afatin e duhur subjekteve të procedimit penal për kërkesat e paraqitura, është shtuar në këtë udhëzim me qëllimin e mbrojtjes të së drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procesin penal, pavarësisht se është jashtë natyrës së marrëdhënieve që rregullon udhëzimi nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, duke pasur parasysh edhe se udhëzimi i Drejtuesit ka dalë për lehtësimin e zbatimit të dispozitave të tij, si dhe një detyrim i tillë parashikohet në ligjin procedural penal (nenet 105 dhe 110 të K. Pr. Penale). Për këto arsye, me qëllim uniformizimit të udhëzimit nr. 33 prot, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër me udhëzimin nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar vlerësohet që udhëzimi i Drejtuesit në pikën 9, të rishikohet/ndryshohet.

³¹ Pika 8. Drejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi tjetër i autorizuar brenda tre ditëve nga dorëzimi i kërkesës merr vendim të arsyetuar me shkrim për refuzimin e kërkesës apo pranimin e saj, duke vijuar me procedurat për zëvendësimin e prokurorit dhe caktimin e prokurorit të ri për atë çështje.

³² Pika 9. Prokurorët kanë detyrimin tu kthejnë përgjigje me shkrim në afatin e duhur ndaj palëve subjekte të procedimit penal për kërkesat e paraqitura, sipas parashikimeve të neneve 105, 110 dhe 11 të Kodit të procedurës penale.

- Pikat 10 [33] e udhëzimit nr. 33 prot., datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, lidhur me detyrimin e prokurorit për informacion për ecurinë e hetimeve në çështje të caktuara, gjen pajtueshmëri me nenin 8, pika 2, germa “c” dhe nenin 13 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ku thuhet se: “Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara”.
- Pika 11 [34] e udhëzimit nr. 33 prot., datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, parashikon detyrimin për informim të Drejtuesit në rastet e përfundimit të afateve tërësore të hetimit. Në udhëzimin nr. 12/2020, të ndryshuar, neni 14 që përcakton informimin për ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale e lidh detyrimin e prokurorit për informim të Drejtuesit të Prokurorisë për një afat jo më vonë se 20 (njëzet) ditë para se të vendosë përfundimin e hetimeve vetëm në dy raste: 1) kur Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë për udhëzim jo të detyrueshëm për procedimin penal, ose 2) kur nga Drejtuesi është kërkuar informacion në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij. Nëse trajtohet në kuptim të nenit 12, pika 2 apo 14 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, mundet që ky lloj informacioni të përfshihet në informacionet që Drejtuesi mundet të kërkojë për çështjen, si një nga informacionet për verifikimin e ecurisë së procedimit penal apo para përfundimit të tij. Prandaj, në qëllim nuk rezulton se ka ndonjë mospërputhje me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, por mospërputhja duket të mënyra si është parashikuar marrja e informacionit prej Drejtuesit. Në kohën kur ka dalë udhëzimi i Drejtuesit të Prokurorisë, informimi mbi ecurinë e procedimit penal sipas nenit 12, pika 2 bëhej me kërkesë, ndërsa sipas nenit 14 bëhej pa kërkesë të Drejtuesit, duke plotësuar kushtet e mësipërme. Pas ndryshimeve të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 edhe sipas kësaj dispozite informacioni i prokurorit jepet me kërkesën e Drejtuesit. Gjithashtu, nxjerrjen e udhëzimit jo të detyrueshëm Drejtuesi në këtë rast e parashikon si detyrim të tij, apo të Drejtuesit të seksionit, ndërsa udhëzimi nr. 12/2020, i ndryshuar, ka parashikimin se Drejtuesi mund të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm pas marrjes së informacionit. Afati 3 ditë për prokurorin për t’ju përgjigjur udhëzimit jo të detyrueshëm nuk është në përputhje me afatin e përcaktuar në udhëzimin nr. 12/2020, të ndryshuar, i cili sipas nenit 11 të tij është 5 (pesë) ditë.

³³ Pika 10. Prokurorët kanë detyrimin të informojë Drejtuesin e Prokurorisë, sa herë që kërkohet prej tij, lidhur me ecurinë e hetimeve të çështjeve të caktuara. Në veçanti duhet të informojë drejtuesin në rastet e procedimeve për vepra penale të rënda, me të arrestuar apo të ndaluar, procedimet me zgjatje afati apo ato që ndodhen në përfundim të hetimeve apo afateve të paraburgimit.

³⁴ Pika 11. Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë në rastet e përfundimit të afateve tërësore të hetimit, jo më vonë se një muaj para përfundimit të afatit. Drejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit brenda 3 ditëve nga dorëzimi i informacionit nxjerr udhëzim për çështjen konkrete në lidhje me veprimet që duhet të kryhen apo mënyrën e përfundimit të çështjes ose në të kundërt orienton prokurorin e çështjes për vijimin e hetimeve. Me administrimin e udhëzimit prokurori i çështjes brenda tre ditëve vendos në lidhje me marrjen parasysh ose jo të udhëzimit dhe njofton drejtuesin me shkrim.

- Pika 12 ^[35] e udhëzimit nr. 33/2020 ku përcaktohet një afat jo më i vogël se 15 ditore që prokurori i çështjes të vërë në dijeni Drejtuesin e Prokurorisë për përfundimin e afateve të paraburgimit, edhe pse ka zvogëluar afatin për Drejtuesin që të administrojë këtë informacion, nuk vlerësohet se ka ndonjë kundërshtim me nenin 13, pika 3 të udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, që në këto raste parashikon afatin jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të afateve (*paraburgimit, sekuestros apo masave ndaj pasurisë...*), si dhe me nenin 46/4 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Udhëzimet, sipas këtij neni, duhet të jepen me shkrim dhe të jenë të arsyetuara. Përfundimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht dhe brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim*”. Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm ka përcaktuar afatin maksimum, ndërsa Drejtuesi i Prokurorisë e ka zvogëluar këtë afat dhe kjo po të shikohet në frymën e udhëzimit, është kufizim kohe i Drejtuesit të Prokurorisë. Sipas nenit 13, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, edhe para se të ndryshohej udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, prokurorit i lind detyrimi për të informuar me shkrim Drejtuesin, vetëm pasi nga ky i fundit i është kërkuar informacion.
- Pika 13 ^[36] e udhëzimit nr. 33/2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër ka shtuar parashikime të cilat nuk gjenden në udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ku parashikohen rastet dhe mënyrat e informimit të Drejtuesit të Prokurorisë dhe konkretisht në lidhje me detyrimin e prokurorit të çështjes për të informuar Drejtuesin për rastet e procedimeve me të arrestuar apo ndaluar për të cilët prokurori vlerëson se duhet të ndryshohet masa e sigurimit/pushimit të çështjes, duke e bërë këtë të paktën një javë para marrjes së vendimit. Me paraqitjen e kërkesës për ndryshimin e masës së sigurimit, Drejtuesi ka mundësi të kërkojë informacion ose të kërkojë të informohet paraprakisht në bazë të nenit 13, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, ndërsa në rastin e kërkesës për pushim është rregulluar në nenin 14, pika 1 të udhëzimit. Edhe në këtë rast udhëzimi i Drejtuesit të Prokurorisë duhet të ishte përshtatur me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020 dhe me ndryshimet e bëra me udhëzimin nr. 16, datë 14.12.2020, duke parashikuar dhënien e informacionit nga prokurori mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit. Afati 3 ditë për prokurorin për t’ju përgjigjur udhëzimit jo të detyrueshëm nuk është në përputhje me afatin e përcaktuar në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, i cili është 5 (pesë) ditë.

³⁵ Pika 12. *Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë në rastet e përfundimit të afateve të paraburgimit, së paku 15 ditë para përfundimit të afatit.....*

³⁶ Pika 13. *Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë në rastet e procedimeve penale me të arrestuar apo të ndaluar, për të cilët vlerëson se duhet të ndryshohet masa e sigurimit apo të pushohet çështja, së paku një javë para marrjes së vendimit. Drejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit brenda 3 ditëve nga dorëzimi i informacionit nxjerr udhëzim për çështjen konkrete në lidhje me veprimet që duhet të kryhen apo mënyrën e përfundimit të çështjes ose në të kundërt orienton prokurorin e çështjes për vijimin e hetimeve. Me administrimin e udhëzimit, prokurori i çështjes brenda 3 ditëve vendos në lidhje me marrjen parasysh ose jo të udhëzimit dhe njofton drejtuesin me shkrim.*

- Pika 14 ^[37] e udhëzimit nr. 33/2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër lidhur me informacionet për kërkesat për sekuestrim/konfiskim, edhe pse e formuluar në referim të neneve 13 dhe 14 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, ka edhe disa mospërputhje me këto dispozita, ku ndër të tjera thuhet se pika 1: “Prokurorët, me qëllim që të mundësojnë drejtuesin për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, në përputhje me parashikimet e nenit 48 të ligjit nr. 97/2016, përveç rasteve kur urgjenca nuk e lejon, duhet të informojnë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë, sipas organizimit të brendshëm në prokurori, për procedimin penal ku ... do t’i drejtohen gjykatës, kërkesa për aplikimin e sekuestrove preventive, konservative apo për hetimin pasuror ku do të kërkohet aplikimi i masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr. 10192/2009”, ndërsa pika 3: “Drejtuesi i prokurorisë për procedimet penale ku janë aplikuar sekuestroja preventive, konservative apo për hetime pasurore ku janë aplikuar masa ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr. 10192/2009, me qëllim nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme mundet që t’i kërkojë prokurorit në momentin e regjistrimit të procedimit penal, hetimit pasuror apo përgjatë hetimit penal apo pasuror, të informohet paraprakisht, por jo më vonë se 1 (një) muaj përpara përfundimit të afateve Informacioni bëhet me shkrim.....”. Gjithashtu, sipas nenit 14, pika 1 “Prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë për ecurinë e hetimit pasuror jo më vonë se 20 (njëzet) ditë, përpara se të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin në çdo hetim pasuror, në të cilin drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme ose u është kërkuar sa më sipër nga ky i fundit në momentin e regjistrimit të hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij”. Sa më sipër, pika 14 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë ka përfshirë parashikimet e neneve 13 dhe 14 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Afati 5 (pesë) ditor i caktuar në udhëzimin nr. 33/2020, në rastin e informimit nga prokurori të Drejtuesit para paraqitjes së kërkesës në gjykatë, pavarësisht se nuk përmendet në udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020, nuk bie ndesh me qëllimet e këtij udhëzimi të parashikuara në nenin 13, pika 1 të tij, përse i përket kërkesave për sekuestrim, ndërsa kërkesa për konfiskim dhe pushimi i procedimit pasuror parashikohen nga neni 14 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, ku në dallim nga udhëzimi i Drejtuesit, afati për informim është të pakën 20 ditë përpara se të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin në çdo hetim pasuror dhe në ato raste në të cilat Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme, ose u është kërkuar ky informacion prej tij në momentin e regjistrimit të hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij. Në rastin e informimit para se të paraqiten kërkesat për sekuestrim, afati për nxjerrjen e udhëzimit jo të detyrueshëm nga Drejtuesi ose Drejtuesi i Seksionit është 1 (një) ditë dhe jo 3 (tre) ditë sa e ka parashikuar në

³⁷ Pika 14. Në rastet e hetimeve pasurore Prokurori informon me shkrim Drejtuesin e prokurorisë 5 ditë para paraqitjes së kërkesës për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë dhe 1 muaj para heqjes së sekuestros apo pushimit të çështjes, në raste kur vlerëson se duhet të hiqet sekuestroja apo të pushohet procedimi pasuror. Informacioni përmban.....Drejtuesi i Prokurorisë apo Drejtuesi i seksionit brenda 3 ditëve nga dorëzimi i informacionit nxjerr udhëzim për çështjen konkrete...Me administrimin e udhëzimit, prokurori i çështjes brenda 3 ditëve vendos në lidhje me marrjen parasysh ose jo të udhëzimit dhe njoftim Drejtuesin me shkrim.

udhëzimin e tij Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër si për rastet e parshikëuara në nenet 13, pikat 4 dhe 14, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe gjithashtu sipas nenit 11 të këtij udhëzimi, afati i prokurorit për t'ju përgjigjur udhëzimit jo të detyrueshëm parashikohet 5 (pesë) ditë dhe jo 3 (tre) ditë si në udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë.

- Pika 15 ^[38] e udhëzimit nr. 33/2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, lidhur me detyrimin e prokurorit të çështjes për të informuar Drejtuesin në rastet e kthimit të dosjes për hetime të mëtejshme, konstatohet se ky parashikim i udhëzimit nuk është në pajtim me nenin 12, pika 3 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të ndryshuar. Në udhëzimin nr. 12/2020, të ndryshuar, thuhet se: "Në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit, prokurori mbi kërkesën e drejtuesit duhet të informojë drejtuesin e prokurorisë për shkaqet dhe ecurinë e mëtejshme të hetimit brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa". Sipas këtij udhëzimi, prokurorit i lind detyrimi për informim vetëm nëse i kërkohet nga Drejtuesi dhe jo në çdo rast sikurse parashikohet në udhëzimin nr. 33/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër. Përsa i përket çështjes së afatit që parashikohet në udhëzimin nr. 33/2020, lidhur me mundësinë e nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme, vlerësohet si në përputhje me udhëzimin nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, ndërsa siç është përmendur në pikat e mësipërme afati i prokurorit për të kërkuar shpjegime/paqartësi apo për të njoftuar me shkrim Drejtuesin kur nuk do të zbatojë udhëzimet e dhëna është 5 (pesë) ditë. Në fakt dispozita e mësipërme e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikon vetëm marrjen e informacionit nga prokurori, duke mos e lidhur me nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, në kuptimin që veprimet hetimore që do të kryhen janë përcaktuar nga gjykata, ndërsa udhëzimi jo i detyrueshëm i Drejtuesit të Prokurorisë siç është parashikuar në udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, vetëm sa mbivendoset me vendimin e gjykatës. Udhëzimi jo i detyrueshëm në vetvete për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin gjyqësor duket se është i panevojshëm në kushtet kur këto veprime janë përcaktuar nga gjykata si organi kompetent për kontrollin e çështjes dhe në këtë kontroll Drejtuesi i Prokurorisë parimisht nuk mundet të ndërhyjë, pasi në të kundërt do të ishte në tejkalim të kompetencave të tij, referuar Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar. Në këto raste informacioni i prokurorit jepet brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa e Drejtuesit, i cili ka ardhur në dijeni të vendimit të gjykatës dhe kërkon informacion për shkaqet e kthimit dhe ecurinë e mëtejshme. Megjithatë, vlerësohet se informacioni që ka rëndësi për t'u kërkuar nga Drejtuesi i Prokurorisë në

³⁸ Pika 15. Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë në rastet e procedimeve penale të dërguara në gjykatë për të cilat gjykata vendos të mos pranojë kërkesën duke kthyer dosjen për hetime të mëtejshme brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit nga gjykata ose nga marrja dijeni për vendimin në rastet kur vendimi është dhënë në mungesë të prokurorit... Drejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit brenda 3 (tre) ditëve nga dorëzimi i informacionit, nxjerr udhëzim për çështjen konkrete në lidhje me detyrat e gjykatës, veprimet që duhen të kryhen apo mënyrën e përfundimit të çështjes ose në të kundërt orienton prokurorin e çështjes për vijimin e hetimeve. Me administrimin e udhëzimit prokurori i çështjes brenda 3 (tre) ditëve vendos në lidhje me marrjen parasysh ose jo të udhëzimit dhe njofton drejtuesin me shkrim.

këto raste, do të ishte ai në lidhje me ecurinë e kryerjes së detyrave të lëna nga gjykata me qëllim përfundimin e tyre nga prokurori brenda afatit të caktuar prej saj.

- Pika 16 ^[39] e udhëzimit nr. 33/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, që parashikon detyrimin e prokurorit të çështjes për të dhënë informacion në rastet e deklarimit të pafajshëm pjesërisht apo plotësisht, ndryshimit të cilësimit juridik të veprës nga gjykata, në kohën e daljes së tij ka qenë në pajtim me nenin 15, pika 1 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në rastet kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarimin e fajësisë, cilësimit juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të K. Penal ose ligjit nr. 10192/2009, prokurori brenda 3 (tre) ditëve nga dhënia e vendimit informon drejtuesin e prokurorisë për vendimin dhe faktin nëse do të ushtrojë apelim”*. Në udhëzimin nr. 33/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë, i jepet më shumë akses Drejtuesit të Prokurorisë për të patur informacion për ecurinë e procedimeve penale gjatë fazës së gjykimin, i cili tashmë pas ndryshimeve të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, i mundësohet vetëm mbi bazë kërkesë që ai duhet t'i drejtojë prokurorit të çështjes. Pikës 16 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër i mungon parashikimi i detyrimit të prokurorit për të informuar edhe në rastet e ndryshimit të llojit të dënimit nga gjykata dhe mospranimit të kërkesave për konfiskim.
- Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka marra masa me karakter të brendshëm organizativ, duke i vënë në dijeni të gjithë prokurorët në lidhje me përmbajtjen e udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm. Për një zbatim korrekt dhe në përputhje të plotë me dispozitat urdhëruese të ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm nr. 33, datë 04.09.2020 *“Për rregullimin e marrëdhënieve mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Shkodër”*.
- Në vlerësim të sa më sipër rezulton se nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, janë nxjerrë **2 (dy) udhëzime të përgjithshme**, të cilat kanë të bëjnë me lehtësimin e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm me nr. 15, datë 30.10.2020 *“Për trajtimin e njoftimeve nga viktimat akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale”* të Prokurorit të Përgjithshëm, megjithatë nuk referohen të dhëna për sa i përket

³⁹ Pika 16. *Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë në rastet e procedimeve penale të dërguara në gjykatë, për të cilat gjykata ka vendosur deklarimin i pafajshëm pjesërisht apo plotësisht të të pandehurit dhe/ose ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e vendimit nga gjykata ose nga marrja dijeni në rastet kur vendimi është dhënë në mungesë të prokurorit.*

mbikëqyrjes së zbatimit të këtyre udhëzimeve të përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë.

- Udhëzimi i përgjithshëm nr. 33/2020 i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, përsa i përket dispozitave të cilat vlerësohen se kanë mospërputhje me udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm, duhet të harmonizoheshin me këtë udhëzim, duke respektuar procedurën për marrjen e informacionit dhe në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, si dhe duhet të reflektonin ndryshimet që i janë bërë Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, me udhëzimin nr. 16, datë 14.12.2020, mbi përgatitjen e informacionit nga prokurori mbi bazë të një kërkesë nga Drejtuesi i Prokurorisë.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë konstatohet se referuar udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm *"Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm"*, i ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë **udhëzimin e përgjithshëm nr. 04, datë 04.09.2020.**

- Për sa i përket përmbajtjes së udhëzimit nr. 4, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, *(gjihtsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) dispozita me karakter rregullator të brendshëm në veprimtarinë e kësaj prokurorie)* rezulton se në të ka dispozita që vlerësohet se në pjesën më të madhe janë në harmoni me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, që janë nxjerrë në kuadrin e kompetencave që gëzojnë Drejtuesit e Prokurorive, sikurse parashikohet në ligjin nr. 97/2017 "Për organizmin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë". Në raport me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm *"Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm"*, të ndryshuar vlerësohet se:
- Udhëzimi i përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është në harmoni dhe pajtueshmëri me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, duke respektuar në këtë mënyrë urdhërimet e nenit 46/6 të ligjit nr. 97/2017 "Për organizmin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë". Në dispozitat e tij si neni 4, pika 1, shkronjat "a" dhe "f" të udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Vlorë, të cilat janë më të zgjeruara sesa në nenin 8, pika 1, shkronjat "a" dhe "dh" të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, duke parashikuar mënyrën e njoftimit të prokurorëve në lidhje me mbledhjen e thirrur nga prokurori më i lartë.

- Gjithashtu, neni 8 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, përmban pika më të zgjeruara, ndërsa pika 3 e po këtij udhëzimi, është strukturuar në rend alfabetik, si dhe ka në përmbajtje të kësaj dispozite një paragraf, ku Drejtuesi i Prokurorisë në lidhje me arrestimet në flagrancë, masat e sigurimit pasuror, mjetet e kërkimit të provës, sigurimin e provës, etj., duhet të vihet në dijeni me një kopje të aktit procedural që kanë përgatitur prokurorët përkatës nga ana e zyrës të protokollit, paragraf që mungon në përmbajtjen e nenit 12, të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020.
- Në nenin 9 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ekziston një paragraf më shumë në të cilën parashikohet se për urdhrat e ndalimit dhe masat e sigurimit “arrest në shtëpi” dhe “arrest në burg”, Drejtuesi i Prokurorisë të vihet në dijeni verbalisht nga prokurori i çështjes, ndërkohën për kërkesat për sekuestro preventive edhe konservative të vihet në dijeni me informacion të shkruar. Pavarësisht se për të lehtësuar zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, mund të kuptohet që nga ana e Drejtuesit të vlerësohet mënyra se si do të marrë informacionin në këtë rast, normalisht sipas asaj që është parashikuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm, komunikimi i brendshëm për informim midis prokurorit dhe Drejtuesit të Prokurorisë duhet të jetë me shkrim. Prandaj, edhe ky paragraf mund të ishte i njëjtit në lidhje me informacionin nga ana e prokurorëve, të cilët duhet ta japin atë me shkrim edhe në lidhje me nenin 9 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- Në nenin 11, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020, ekziston një parashikim që nuk gjendet në nenin 15 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar dhe që ka si përmbajtje *“detyrimin e prokurorit të japë informacion verbalisht duke përdorur çdo formë komunikimi dhe mund të konfirmohet me shkrim, nëse një gjë e tillë kërkohet me shkrim nga drejtuesi i prokurorisë”*. Ky parashikim edhe pse ka si qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë midis Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm, sugjerohet se duhet të ndryshojë në udhëzimin e përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 dhe të parashikohet si në udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, ku informacioni që japin prokurorët duhet të jetë i shkruar, për të rritur sa më shumë garancinë e informacionit të përcjellë. Gjithashtu, konstatohet se mënyra dhe rruga procedurale e qarkullimit të shkresave, akteve dhe materialeve hetimore është e strukturuar në rend alfabetik.
- Neni 14 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është në harmoni në pjesën më të madhe të tij me nenin 21 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar. Por, në këtë dispozitë nuk janë reflektuar ndryshimet e bëra me udhëzimin nr. 16, datë 14.12.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në*

Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", ku është shtuar fjala "mund" (të përbëjnë shkelje disiplinore) dhe hequr togfjalëshi "*dhe/ose hetimit disiplinor*", pasi një kompetencë të tillë për nisjen e hetimit disiplinor në bazë të ligjit nr. 96/2016 e ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj të gjithë magjistratëve prokurorë të të gjitha niveleve.

- Nga informacioni i mbërritur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, mungojnë të dhëna statistikore lidhur me periudhën e inspektimit me qëllim për të identifikuar plotësisht rezultatet e arritura në kuadrin e zbatimit të këtyre akteve me karakter të përgjithshëm të detyrueshëm. Nga informacioni i përcjellë nuk referohen të dhëna në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- Lidhur me të dhënat e mësipërme në aspektin e akteve procedurale të miratuara, rezultojnë se në aspektin formal janë marrë masa për njohjen e përmbajtjes së udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, nxjerrjen e një tjetër akti nënligjor në zbatim të dispozitave të këtij akti që është udhëzimi i përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- Udhëzimi i përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në shumicën e dispozitave të tij është në harmoni me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar dhe se nuk rezultojnë se janë strukturuar dispozita që vijnë haptazi në kundërshtim me udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm. Megjithatë, konstatohet fakti se ndryshimet e bëra me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*", që kanë prekur nenin 13, pika 3, shkronja "a"; nenin 14, pika 1; nenin 15, pika 1; nenin 17, pika 1; nenin 18, pika 1 dhe 2, si dhe nenin 21, pika 1, nuk janë reflektuar në udhëzimin e përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

➤ **Prokuroria e Apelit Vlorë**

Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Vlorë lidhur me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*", i ndryshuar, rezultojnë se për periudhën e kërkuar objekt inspektimi nuk janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme. Në rrethana të tilla, nuk mund të konstatohen të dhëna mbi mënyrën dhe procedurën e ndjekur mbi nxjerrjen e udhëzimeve dhe më tej mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

➤ **Prokuroria e Apelit Tiranë**

Për periudhën kohore të inspektimit 01.10.2020 – 31.03.2021, detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë e kanë ushtruar dy prokurorë, njëri prej tyre deri në datën 22.10.2020, pasi është larguar nga detyra si prokuror me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe në vazhdim me vendimin nr. 225, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, detyra e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë është mbuluar nga prokurori tjetër i komanduar në këtë detyrë.

Për periudhën kohore të inspektimit, organika e Prokurorisë së Apelit Tiranë përfshinte 9 prokurorë, ndërkohë që sipas informacionit të Drejtuesit të Prokurorisë për periudhën në fjalë, kanë ushtruar funksionin e prokurorit në mënyrë të plotë vetëm tre prokurorë. Drejtuesi i Prokurorisë e ka përshkruar mbulimin e ngarkesës nga tre prokurorët, si një ngarkesë mjaft të madhe në përballimin e çështjeve penale.

Sipas regjistrimit dhe informacionit të sjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë, për periudhën e inspektimit **nuk rezulton të jenë nxjerrë udhëzime të përgjithshme**, dhe për këtë nuk është dhënë ndonjë arsye konkrete. Në rrethana të tilla, nuk mund të konstatohen të dhëna mbi mënyrën dhe procedurën e ndjekur mbi nxjerrjen e udhëzimeve dhe më tej mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

➤ Prokuroria e Apelit Shkodër

Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Shkodër ka informuar se për periudhën kohore objekt inspektimi, në këtë prokurori kanë ushtruar funksionet vetëm dy prokurorë nga katër në organikë, ndër të cilët dhe Drejtuesi i Prokurorisë. Prokurori i cili ka qenë në detyrën e Drejtuesit të mëparshëm të kësaj prokurorie, është shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në datën 15.11.2020 dhe në datën 16.11.2020 është caktuar përkohësisht në detyrë Drejtuesi aktual.

Po sipas këtij informacioni, meqenëse nga ana e ish Drejtuesit nuk rezultonte të ishte nxjerrë asnjë udhëzim, lidhur me zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", i ndryshuar, nga ana e Drejtuesit të caktuar përkohësisht, është nxjerrë **udhëzimi i përgjithshëm nr. 50, datë 21.12.2020** "Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë, dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër".

- Në udhëzimin nr. 50, datë 21.12.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër, i është mëshuar kërkesave të nenit 8, pika 1, germat "a" deri "dh" të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, kryesisht në detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet administrative "të drejtat dhe detyrimet e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve në prokurori" si: *pjesëmarrjen në mbledhjet e thirrura nga prokurori më i lartë; zbatimi i kushteve dhe kritereve ligjore/nënligjore në*

pjesëmarrjen në shortin e shpërndarjes së dosjeve; pjesëmarrja në diskutime të natyrës profesionale, respektimi i orarit zyrtar dhe disiplinës në punë; pjesëmarrja në veprimtari jashtë funksionit; dhënia e ndihmës në organet administrative, të specifikuara këto në pikën 7 të udhëzimit nr. 50/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër. Vërehet se disa prej detyrimeve që i ngarkohen prokurorit të përcaktuara në pikën 7 të udhëzimit nr. 50/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër, përsëriten në pikën 8 të këtij udhëzimi.

- Po ashtu në vijim të pikës 7 të udhëzimit nr. 50/2020, prokurorit i ngarkohen detyrime përtej përcaktimeve të bëra në udhëzimin nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, sikurse janë detyrimi për të marrë informacion dhe të bashkërendojë punën sipas nevojës me prokuroritë e rretheve, Drejtuesit e tyre, prokurorët e çështjeve, ZVSH Provës dhe informimi për çdo vendimmarrje të gjykatës së apelit, përfshirë edhe dërgimin e shkurtimit të vendimit brenda/jashtë orarit zyrtar, në rrugë postare dhe elektronike të shoqëruar me problematikën gjatë gjykimit në gjykatën e apelit.
- Përsa i përket trajtimit përmbyllës në pikën 7 të udhëzimit nr. 50/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër, referuar përcaktimeve në nenin 18 të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, lidhur me detyrimin e prokurorit të çështjes për të informuar Drejtuesin me kërkesë të tij, jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të afatit të paraburgimit (për të pandehurit me masë sigurimi arrest në burg), vërehet se këtij konteksi i shtohet edhe detyrimi për të njoftuar Drejtuesit e Prokurorisë në rrethe dhe Drejtuesin e Prokurorisë së apelit për kalimin e afateve të paraburgimit që kanë sjellë ndryshimin/shuarjen e masës së sigurimit, i shoqëruar ky njoftim me informacionin përkatës.
- Në përmbyllje të pikës 9 të udhëzimit nr. 50/2020, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Shkodër, ndryshe nga sa parashikohet në nenin 8, pika 2, germa "dh" të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, lidhur me konstatimet e konfliktit të interesit nga prokurori i çështjes, përcakton vendimmarrje të arsyetuar për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për heqjen dorë nga hetimi i mëtejshmen i çështjes konkrete brenda një afati 3 (tre) ditor.
- Pika 10 e udhëzimit nr. 50/2020, të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër, e cila parashikon detyrimin e prokurorit të çështjes për kthimin e përgjigjeve me shkrim në afatin e duhur palëve subjekte të procedimit penal sipas parashikimeve në nenet 105, 110 të K. Pr. Penale, del përtej përcaktimeve në udhëzimin nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Siç u përmend edhe në rastin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 33, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, duke qenë se udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër ka dalë për të lehtësuar zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, detyrimi i mësipërm është një detyrim i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, neni 105 dhe neni 110 dhe nuk është qëllim apo objekt i trajtimit nga udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, duke shtuar parashikime përtej kontekstit dhe

natyrës së marrëdhënieve që rregullon udhëzimi nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.

- Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Shkodër ka përmbushur detyrimin bazuar në nenin 10, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, për të garantuar dhe lehtësuar zbatimin e këtij udhëzimi, **duke nxjerrë edhe 1 (një) udhëzim të përgjithshëm** të arsyetuar, megjithëse nuk jepen të dhëna për mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit sipas dispozitave përkatëse që ai parashikon në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë së apelit, edhe pse organika përfshin një prokuror të apelit, në marrëdhënien ndërmjet këtij dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër.

➤ Prokuroria e Apelit Korçë

Nga informacioni i Prokurorisë së Apelit Korçë, mbi udhëzimet e përgjithshme me karakter detyrues, rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë ka nxjerrë **udhëzimin e përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020**, hyrë në fuqi po në datën 10.09.2020. Si bazë ligjore e këtij udhëzimi të përgjithshëm përcaktohet neni 42 i ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016, i ndryshuar; udhëzimi i përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar dhe K. Pr. Penale.

- Udhëzimi i nxjerrë në zbatim të nenit 22, të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, ka për qëllim njohjen nga prokurorët dhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Apelit Korçë dhe lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi në tërësinë e tij, sidomos rregullimet që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë së apelit. Ky akt është dërguar edhe pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
- Udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë, në pikën 3 të tij përmban parashikime, si ato që i referohen të drejtave dhe detyrimeve të prokurorëve në marrëdhëniet administrative me Drejtuesin e Prokurorisë, bazuar në nenin 8, pika 1, shkronjat "a", "b", "c" të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, në lidhje me pjesëmarrjet në mbledhje, diskutimet profesionale në lidhje me problematikat dhe vështirësitë gjatë pjesëmarrjes në gjykimin e çështjeve, diskutimet nëse prokurori i apelit gjendet në konflikt interesi gjatë përfaqësimit të akuzës, ose në rastet kur vlerëson se duhet të heqë dorë nga ankimi, kur ndryshe nga vendimi i gjykatës, do të kërkojë masë sigurimi më të butë, pushimin e akuzave apo pafajësi në gjykimin në apel. Kjo në funksion të diskutimit paraprak me Drejtuesin e Prokurorisë.
- Udhëzimi përmban parashikime që i referohen edhe nenit 11, "Mbi udhëzimet jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale" dhe nenit 18, "Mbi informimin për përfaqësimin e çështjes në gjykatën e apelit" të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Pika 4 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë parashikon se prokurori zbaton kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas ligjit dhe/ose



me udhëzim të përgjithshëm për pjesëmarrjen në short apo në marrjen e një çështjeje që i është caktuar dhe përfaqësuar në gjykim në apel.

- Pika 5 e udhëzimit të përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë parashikon se komunikimi ndërmjet Drejtuesit dhe prokurorëve të kësaj prokurorie mbahet në formë shkresore, duke u protokolluar në librin e protokollit të brendshëm pranë kryesekretarisë. Këtu është i përfshirë rasti i nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë, si dhe detyrimi i informimit të Drejtuesit të Prokurorisë në kushtet e nenit 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Në pikën 7 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë, parashikohet fakti se prokurori i çështjes merr masa për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës së apelit që janë me ekzekutim të menjëhershëm. Në rastet e tjera shkurtimi i vendimeve i dërgohet zyrës së ekzekutimeve në prokurorinë e rrethit, si dhe prokurori i çështjes duhet të kryejë njoftimin në kohë të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së rrethit për ekstradimet dhe njohjet e vendimeve penale të huaja.
- Pika 12 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit i referohet nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, duke parashikuar se qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore, mes Drejtuesit dhe prokurorëve të parshikuara në pikën 2, të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, do të kryhet përmes protokollimit në regjistrin e komunikimeve të brendshme.
- Nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë është nxjerrë **1 (një) udhëzim i përgjithshëm me shkrim dhe i arsyetuar**, në funksion të garantimit dhe lehtësimit të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, ndërsa nuk ka të dhëna në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 dhe të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë. Përveç pikave që kanë përshtatur parashikimet e neneve 11 dhe 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, vihet re se udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë, i janë shtuar edhe parashikime jashtë qëllimit të marrëdhënieve që rregullon ky udhëzim apo duhet të lehtësohen me udhëzimin e mësipërm të Drejtuesit të Prokurorisë së apelit. Megjithëse udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë në kohën që ka dalë rezulton në përputhje me dispozitat e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, që i referohen prokurorisë së apelit, ai nuk është përditësuar më pas me ndryshimet e bëra nenit 18, pikat 1 dhe 2 me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020.

➤ **Prokuroria e Apelit Gjirokastrë**

Nga të dhënat e marra nga Prokuroria e Apelit Gjirokastër, Drejtuesi i saj, konstatohet se kjo prokurori nga muaji korrik i vitit 2019, përfaqësohet nga një prokuror i vetëm, i cili ushtron edhe detyrën e Drejtuesit të përkohshëm pranë kësaj prokurorie.

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 18, pikat 1 dhe 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Gjirokastër ka informuar se është njohur në kohë me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë së prokurorit në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*", të ndryshuar dhe me detyrimin për zbatimin e tij. Por, duke qenë se ushtron detyrën e prokurorit i vetëm në Prokurorinë e Apelit Gjirokastër, detyrimi për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme me karakter detyrues nuk gjente zbatim.

➤ Prokuroria e Apelit Durrës

Nga informacioni i Prokurorisë së Apelit Durrës, rezulton se në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, është nxjerrë **udhëzimi i përgjithshëm nr. 1, datë 07.09.2020**, hyrë në fuqi po në datën 07.09.2020 "*Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm"*", të ndryshuar". Si bazë ligjore e këtij udhëzimi të përgjithshëm përcaktohet neni 42 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 i ndryshuar; udhëzimi i përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar dhe K. Pr. Penale.

Udhëzimi i nxjerrë në zbatim të nenit 22 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, ka për qëllim njohjen nga prokurorët dhe punonjësit e tjerë të Prokurorisë së Apelit Durrës dhe lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi në tërësinë e tij, sidomos rregullimet që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë së apelit. Ky akt është dërguar edhe pranë Prokurorisë së Përgjithshme përmes postës elektronike në datën 07.09.2021.

- Udhëzimi i Përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, përmban parashikime si ato që i referohen të drejtave dhe detyrimeve të prokurorëve në marrëdhëniet administrative me Drejtuesin e Prokurorisë, bazuar në nenin 8, pika 1, shkronjat "a", "b", "c" të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, në lidhje me pjesëmarrjet në mbledhje; diskutimet profesionale; në lidhje me problematikat dhe veshitësitë gjatë pjesëmarrjes në gjykimin e çështjeve, si dhe parashikime që i referohen nenit 11, "*Mbi udhëzimet jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale*" dhe nenit 18, "*Mbi informimin për përfaqësimin e çështjes në gjykatën e apelit*", të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Si në udhëzimin e përgjithshëm të mësipërm, udhëzimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, përmban parashikime që i referohen edhe nenit 11, "*Mbi udhëzimet jo të*

detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale” dhe nenit 18, “Mbi informimin për përfaqësimin e çështjes në gjykatën e apelit”, të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.

- Pika 3 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës parashikon se prokurori zbaton kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas ligjit dhe/ose me udhëzim të përgjithshëm për pjesëmarrjen në short apo në marrjen e një çështjeje që i është caktuar.
- Pika 5 e udhëzimit të përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, parashikon se komunikimi ndërmjet Drejtuesit dhe prokurorëve të kësaj prokurorie mbahet në formë shkresore, duke u protokolluar në librin e protokollit të brendshëm pranë kryesekretarisë. Këtu janë përfshirë rasti i nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës, si dhe detyrimi i informimit të Drejtuesit të Prokurorisë në kushtet e nenit 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Në pikën 7 të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, parashikohet fakti se prokurori i çështjes merr masa për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës së apelit që janë me ekzekutim të menjëhershëm. Në rastet e tjera shkurtimi i vendimeve i dërgohet zyrës së ekzekutimeve në prokurorinë e rrethit, si dhe prokurori i çështjes duhet të kryejë njoftimin në kohë të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Rrethit për ekstradimet dhe njohjet e vendimeve penale të huaja.
- Pika 12 e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit i referohet nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, duke parashikuar se qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore, mes Drejtuesit dhe prokurorëve të parshikuara në pikën 2, të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, do të kryhet përmes protokollimit në regjistrin e komunikimeve të brendshme.
- Për sa i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme, mbikëqyrjes dhe zbatimit të tyre, nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës rezulton se në funksion të lehtësimit të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, **ka nxjerrë 1 (një) udhëzim të përgjithshëm me shkrim dhe të arsyetuar.**
- Në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 dhe të udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, përveç faktit të njohjes së tij në mbledhjen e prokurorëve, nuk ka të dhëna të tjera.
- Në udhëzimin e përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë si në rastin më lart, pikave që kanë përshtatur parashikimet e neneve 11 dhe 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, vihet re se u janë shtuar edhe parashikime jashtë qëllimit të marrëdhënieve që rregullon ky udhëzim apo duhet të lehtësohen me udhëzimin e

mësipërm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës. Megjithëse udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, në kohën që ka dalë, rezulton në përputhje me dispozitat e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, që i referohen prokurorisë së apelit, ai nuk është përditësuar më pas me ndryshimet e bëra në nenin 18, pikat 1 dhe 2 me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020.

➤ Prokuroria e Përgjithshme

Nga Prokuroria e Përgjithshme janë dërguar aktet/dokumentet e kërkuara të hedhura në CD, sipas pikave:

- a) Udhëzimet e përgjithshme nga data 01.07.2020 deri në datën 31.03.2021, të cilat kanë qenë në fuqi gjatë periudhës 01.10.2020 deri me 31.03.2021 dhe dokumentacionin që trajton nevojën për nxjerrjen e tyre:
 - i. Udhëzim i Përgjithshëm nr. 14, datë 21.09.2020 “Për ushtrimin e të drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve”. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të ushtrimit të së drejtës së hyrjes në bazat e të dhënave të të tretëve për nevoja të ushtrimit të ndjekjes penale dhe zhvillimit të hetimeve.
 - ii. Udhëzim i Përgjithshëm nr. 18, datë 31.12.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit nga struktura e posaçme në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë”. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim të unifikojë masat administrative dhe procedurale për verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, mbi kërkesën e organit kompetent drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe vendimit nr. 17, datë 04.03.2016 të Kuvendit të Shqipërisë, duke garantuar zbatimin e procesit të rregullt ligjor, dhe parimet e ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, mbrojtjes së të dhënave personale, konfidencialitetit dhe të sekretit shtetëror.
 - iii. Udhëzim i përgjithshëm nr. 17, datë 23.12.2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje.” Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim unifikimin e masave procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm që hetimet dhe ndjekja penale në çështjet për vepra penale kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë urrejtje të jenë në afate optimale (shpejta), efëcente, dhe me kërkesa për masa dënimi efektive, proporcionale e frenuese, që të kontribuojnë në parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të autorëve të këtyre formave sensitive të kriminalitetit ndaj viktimave gra. Ky udhëzim ka për qëllim, gjithashtu, plotësimin e kuadrit nënligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktimën dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në vijim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, në fuqi, në veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.



- iv. Udhëzim i përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*”, të ndryshuar. Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është për të unifikuar, të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me Drejtuesit e Prokurorive si prokurorë me të lartë dhe informimin e koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, për të siguruar pavarësinë dhe autonominë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve dhe mbarëvajtjen, mbikëqyrjen, eficientë, ligjshmërinë dhe transparencën në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur. Ky udhëzim ka për qëllim, gjithashtu, për të qartësuar kuptimin dhe zbatimin në praktikë të disa çështjeve ligjore që lidhen me respektimin e parimeve të ligjshmërisë, detyrueshmërisë së ndjekjes penale dhe pavarësisë në marrëdhëniet ndërmjet prokurorit me Drejtuesit e Prokurorive në të gjithë nivelet me juridiksion të përgjithshëm, në përfaqje me standardet dhe praktikën e mira evropiane për unifikimin dhe përmirësimin e veprimtarisë organizative dhe funksionale apo procedurale në prokurori.
- v. Udhëzim i përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 “Për disa ndryshime në udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020”.

Në referim të nenit 47, pika 1 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, i cili përcakton se: “*Prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë*”, rezulton se ndaj udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 dhe nr. 16, datë 14.12.2020 ka bërë ankim në KLP, një prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Ankuesi nëpërmjet ankesës ka kërkuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë: “*Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Udhëzimeve të Përgjithshme nr. 16, datë 14.12.2020 dhe nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm*”, duke parashtruar në ankim faktin se udhëzimi i përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm*”, të Prokurorit të Përgjithshëm, është nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin dhe nga organi kompetent, e si i tillë, është akt absolutisht i pavlefshëm.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përfundim të shqyrtimit të ankimit, me vendimin nr. 59, datë 18.03.2021, ka vendosur: Rrëzimin si të pabazuar në ligj të dy kërkesave në ankimin e prokurorit..., duke arsyetuar se “...ky udhëzim... i përmbahet në mënyrë korrekte parashikimeve Kushtetuese dhe atyre ligjore...”.

- vi. Udhëzimi i përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim të normojë dhe unifikojë masat administrative dhe procedurale penale në prokuroritë

pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe në hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkti i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, në respektim të parimeve të ligjshmërisë, detyrueshmërisë së ndjekjes penale dhe pavarësisë/autonomisë së prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe në përjasje me rekomandimet dhe standardet evropiane. Ky udhëzim synon përmirësimin e cilësisë dhe plotshmërisë sipas tipologjive të kallëzimeve penale ose referimeve dhe hetimeve të kryera nga policia gjyqësore në strukturat hetimore përkatëse dhe vlerësimit nga prokuroria të provave/indikieve që provojnë rrethanat e faktit dhe ligjin e zbatueshëm për regjistrimin e procedimit, kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, përfshi tipologjitë e rekomanduara, krimeve financiare, financimin e terrorizmit përfshi hetimet paralele të rekomanduara, hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkti i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, veçanërisht tipologjitë e rekomanduara (palët e treta të pastrimit të parave, subjekte të posaçëm/profesionist dhe nga vetë subjektet raportuese (gatekeeper) si dhe asetëve që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe/ose vlerë ekuivalente).

- vii. Udhëzimi i përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”. Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është për të unifikuar ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në kompetencë lëndore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, pa cenuar pavarësinë e prokurorisë si organ që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarisë së saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit.
- viii. Udhëzimi i përgjithshëm nr. 15, datë 30.10.2020 “Për trajtimin e njoftimeve nga viktima akuzuese dhe referimet që dukshëm nuk përmbajnë elementë të veprës penale”. Qëllimi i këtij udhëzimi është rritja e efikasitetit të veprimtarisë hetimore nëpërmjet përmirësimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe bashkëpunimit institucional, duke garantuar respektimin e parimit të aksesit në drejtësi, në lidhje me zbatimin e nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale dhe trajtimit të referimeve të tjera që dukshëm nuk përmbajnë elemente të ndonjë veprë penale të parashikuar nga ligji.
- ix. Udhëzim i përgjithshëm nr. 02, datë 31.03.2021 “Për disa ndryshime e shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 03, datë 21.06.2019 “Mbi masat administrative dhe procedurale në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm në periudhën para dhe pas zgjedhore”. Ky udhëzim i përgjithshëm ka për qëllim unifikimin e masave në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si për verifikimin e integritetit të personave/kandidatëve për t’u zgjedhur, ashtu dhe për rritjen e efektivitetit të

hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj autorëve të veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve ose të veprave penale të tjera që dëmtojnë procesin zgjedhor, në periudhën para dhe pas zgjedhore, si dhe për parandalimin e përgjithshëm të veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

3.3. Mënyra dhe procedura që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë për prokurorët dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre.

Neni 43 i ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon se, shkronja b) "Drejtuesi i prokurorisë kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji" dhe shkronja ç) "Drejtuesi i prokurorisë verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake".

Neni 48 i ligjit të mësipërm, nenet 7, pika 2, shkronja "b" dhe neni 11 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, parashikojnë mënyrën dhe procedurën për nxjerrjen e udhëzimeve për çështje konkrete, nga ana e prokurorit më të lartë, të cilat nuk janë të detyrueshme. Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete, mund të jepen nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme; Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët në prokurorinë përkatëse; Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët e prokurorisë përkatëse; Drejtuesi i Seksionit për prokurorët e caktuar në seksionin përkatës.

Në respektim të procedurës ligjore për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme nga Drejtuesit e Prokurorive, për prokurorët në prokuroritë përkatëse, duhet që udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete, të jenë me shkrim dhe të jenë të arsyetuara, ndërsa përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, ato mund të jepen verbalisht dhe, brenda një kohe të arsyeshme (48 orë), të konfirmohen me shkrim. Kur prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme lidhur me to (brenda 5 ditëve). Në rastet kur prokurori ka kërkuar shpjegime për udhëzimin jo të detyrueshëm, Drejtuesi i Prokurorisë ose Drejtuesi i Seksionit është i detyruar të japë shpjegime mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë (brenda 5 ditëve), përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr. Në rast se prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi, me shkrim, vendos të mos e ndjekë atë, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë apo Drejtuesin e Seksionit, sipas rastit, duke arsyetuar shkaqet e moszbatimit të tij (brenda 5 ditëve). Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit, i bashkëngjiten akteve të procedimit.

Udhëzimet jo të detyrueshme në lidhje me procedimet konkrete, mund të jepen me iniciativën kryesisht të Drejtuesit, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, ose më pas,



gjatë verifikimi të ecurisë së çështjes mbi bazën e kërkesës së tij për informacion ose jo, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së çështjes/procedimit apo edhe të mënyrës së përfundimit të hetimeve paraprake. Udhëzimet jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale duhet të jepen përpara se nga prokurori të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të procedimit.

Në referim të dispozitave ligjore dhe nënligjore të mësipërme, në marrëdhëniet ndërmjet prokurorit dhe Drejtuesve në prokurori që lidhen me mënyrën dhe procedurën që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët si më sipër dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre, rezulton se:

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë**

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për aq sa të dhëna janë vënë në dispozicion referuar shkresave të sjella, për periudhën e inspektimit **nuk evidentohet ndonjë udhëzim jo i detyrueshëm.** Për këtë të dhënë nuk mundemi t'i referohemi as regjistrin të korrespondencës së mbajtur për shkak të paqartësisë të konstatuar në hedhjen e të dhënave. Është për t'u evidentuar se në vizitën pranë kësaj prokurorie, jemi vënë në dijeni se ka patur udhëzime të tilla, por për shkak se Drejtuesi në fjalë, është larguar duke humbur statusin e magjistratit, nuk mund të konkludohet saktësisht lidhur me drejtimin në fjalë.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës**

Nga të dhënat e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezulton se nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme:

- 1) *"Udhëzim lidhur me kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale në procedimin penal 2474, viti 2020"*, i datës 05.03.2021, me bazë ligjore nenin 43/ç dhe nenin 48 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, si dhe nenet 24, 25 e vijues të K. Pr. Penale. Nga përmbajtja e udhëzimit jo të detyrueshëm, rezulton se shkaku si është informuar dhe mbi bazën e të cilit është nxjerrë udhëzimi nga Drejtuesi i Prokurorisë është fakti se *"Nga ana e prokurorit të çështjes është sjellë kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj R. G., pasi janë zbutur nevojat e sigurimit, pasi dëmtimet që ka pësuar E. K., nuk kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit"* dhe pasi është njohur dhe me aktet e procedimit, me anë të këtij udhëzimi është udhëzuar prokurori i çështjes për të kryer veprime të mëtejshme në procedimin penal, ku ka të vendosur masë sigurimi "arrest në burg" e caktuar me vendimin nr. 562/1, datë 30.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Veprimet konkrete të udhëzuara për prokurorin janë sekuestrimi i kartelës klinike të shtetasit E. K., dhe kryerja e një riekspertimi mjekoligjor; të kërkohet informacion IML për dërgimin e aktit mjekoligjor; si dhe të kryhen edhe veprime të tjera që mund të dalin nga dinamika e çështjes. Pas pjesës arsyetuese, në pjesën udhëzuese përveç veprimeve përcaktohet edhe fakti që udhëzimi nuk është i detyrueshëm, nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të



mëtejshme. Në rast se prokurori vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë apo Drejtuesin e Seksionit dhe udhëzimet me shkrim si dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit.

- Meqenëse jemi para rastit të procedimeve ku ka të caktuara masa sigurimi, neni 13, pika 2 e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, parashikon se: **“3. Drejtuesi i prokurorisë, për procedime penale ku janë vendosur masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, mundet që t’i kërkojë prokurorit në momentin e regjistrimit të procedimit penal, apo përgjatë hetimit penal....., të informohet paraprakisht, por jo më vonë se 1 (një) muaj përpara përfundimit të afateve të paraburgimit, për gjendjen e procedimit penal Informacioni bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë: a) Veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit penal apo hetimit e gjykimit pasuror, pyetjen e të pandehurit ose të personit nën hetim dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra. 4. Drejtuesi mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e informacionit”.**
- Në këtë rast Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm, duke pasur si qëllim që prokurori të kryejë edhe disa veprimeve të tjera para se të depozitohë në gjykatë kërkesë për zëvendësimin e masës, por ndërkohë që prokurori kishte proceduar me një vendimmarrje të tij me anë të një kërkesë procedurale për zëvendësimin e masës së sigurimit drejtuar gjykatës dhe paraqitur tek Drejtuesi për nënshkrim, çfarë bën që udhëzimi jo i detyrueshëm edhe pse mund të konsiderohet se është dhënë në proces të verifikimit të ecurisë së procedimit, rezulton të jetë jashtë kushteve të dispozitës dhe natyrës që udhëzimi i përgjithshëm i ka dhënë udhëzimit jo të detyrueshëm për të qenë efektiv para se të paraqitet kjo kërkesë e prokurorit. Në lidhje me gjendjen e procedimit me masë sigurimi “arrest në burg” është e nevojshme që Drejtuesi i Prokurorisë të informohet në kohën e duhur dhe nëse është e nevojshme të procedojë me nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për mbarëvajtjen e hetimit në ngarkim të personave të arrestuar.

2) *“Udhëzim lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme procedurale në materialin hetimor me nr. 3827/2020”*, i datës 08.10.2020, me bazë ligjore nenin 43/ç dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, si dhe nenet 24, 25 e vijues të K. Pr. Penale. Udhëzimi është nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë në momentin e referimit të veprës penale, pasi është njohur me materialin hetimor nr. 3827/2020, duke udhëzuar kryerjen e veprimeve hetimore për prokurorin të cilit i është caktuar me short ky kallëzim. Në pjesën udhëzuese përveç veprimeve nuk ka disponime të tjera mbi procedurën e udhëzimit jo të detyrueshëm si në udhëzimin e mësipërm.

3) *“Udhëzim për kryerjen e veprimeve hetimore”*, i datës 02.03.2021, me bazë ligjore nenin 48 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë edhe në këtë rast, pasi është vënë në dijeni të vendimit gjyqësor nr. 225, datë 03.02.2021, të Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Durrës, me të cilin është vendosur kthimi i akteve të këtij procedimi penal, pasi Prokuroria pranë Gjyktës së Shkallës së Parë Durrës, ka dërguar kërkesën për pushimin e çështjes penale me nr. 2264, të vitit 2019, duke udhëzuar kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata brenda afatit 3 mujor të caktuar prej saj, nëse nuk do të ushtrohet ankim. Edhe për këtë udhëzim, përveç këtij disponimi në lidhje me veprimet që ka lënë detyrë gjykata, nuk ka disponime të tjera mbi procedurën e udhëzimit jo të detyrueshëm si në udhëzimet e mësipërme.

- Udhëzimi jo i detyrueshëm ka dalë një muaj pas datës së vendimit të gjykatës për kthimin e akteve, siç duket pas momentit që Drejtuesi ka ardhur në dijeni të këtij vendimi, e lidhur kjo me faktin se në rastin e kërkesës për pushim të çështjes penale, vendimi i gjyqtarit të seancës paraprahe i njoftohet Drejtuesit të Prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 329, pikat 3 dhe 4 të K. Pr. Penale, në rastet që gjykata vendos kthimin e akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota apo kur urdhëron formulimin e akuzës dhe paraqitjen e kërkesës për gjykimin e çështjes.

4) "Udhëzim për kryerjen e veprimeve hetimore", i datës 01.03.2021, me bazë ligjore nenin 48 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është vënë në dijeni të vendimit të gjykatës nr. 14/1027, datë 26.01.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me të cilin është vendosur pavlefshmëria e kërkesës për dërgimin në gjyq të procedimit penal me nr. 1017, të vitit 2018 dhe kthimin e akteve të këtij procedimi penal. Në pjesën udhëzuese përveç veprimeve përcaktohet edhe fakti që udhëzimi nuk është i detyrueshëm, nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme, në rast se prokurori vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë apo Drejtuesin e Seksionit, dhe udhëzimet me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit. Me anë të këtij udhëzimi prokurori i çështjes udhëzohet që të kryejë veprimet hetimore plotësuese të urdhëruara nga gjykata brenda afatit 2 mujor.

- Si në rastin e mësipërm dhe për rastin konkret neni 12, pika 3 e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikon se "3. Në rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit, prokurori, mbi kërkesën e drejtuesit, duhet të informojë drejtuesin e prokurorisë për shkaqet dhe ecurinë e mëtejshme të hetimit brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa". Rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i datës 26.01.2021, ndërsa udhëzimi jo i detyrueshëm ka dalë në datën 01.03.2021, ndërkohë që zbatimi i drejtë i dispozitës, kërkon administrimin e informacionit nga prokurori brenda 5 (pesë) ditëve me kërkesë të Drejtuesit, e lidhur kjo me faktin se edhe në rastin e kërkesës për dërgim në gjyq, vendimi i gjyqtarit të seancës paraprahe i njoftohet Drejtuesit të Prokurorisë, parashikuar në nenin 332/ç të K. Pr. Penale, sipas të cilit përveçse të urdhërojë plotësimin e hetimeve ".....kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur,



urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re”.

- Siç është përmendur dhe në rastin e udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, dispozita e mësipërme e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikon vetëm marrjen e informacionit nga prokurori, pasi veprimet hetimore janë përcaktuar nga gjykata, ndërsa udhëzimi jo i detyrueshëm i Drejtuesit të Prokurorisë rezulton se vetëm e ka dubluar atë, pasi ai ka ardhur në dijeni të vendimit të gjykatës. Pra, udhëzimi jo i detyrueshëm në vetvete për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin gjyqësor del i panevojshëm në kushtet kur këto veprime janë përcaktuar nga gjykata si organi kompetent për kontrollin e çështjes. Për më tepër që referuar edhe nenit 332/ç të K. Pr. Penale të përmendur në këtë rast, veprimet hetimore kanë filluar mbi bazën e vendimit të gjykatës i cili nuk është i ankimueshëm, me qëllim që të mundësohet përfundimi i hetimeve brenda afatit dhe paraqitja në seancën e re.
 - Megjithatë në rastet e nenit 12, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, dispozita nuk e bën të qartë momentin e ardhjes në dijeni të Drejtuesit, të kthimit të akteve dhe bërjes së kërkesës për shkaqet e kthimit dhe ecurinë e mëtejshme, nëse ky moment duhet të jetë para se t’i dërgohet vendimi i gjykatës, në rast vonese të dërgimit të këtij vendimi, i cili përmban dhe shkaqet e kthimit, pasi pas ardhjes së vendimit ndodh që udhëzimi jo i detyrueshëm si në rastin e dytë të dalë rreth përfundimit të afatit dy mujor, duke e bërë atë të panevojshëm. Pasi është njohur me vendimin e gjykatës edhe pa nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, informacioni që ka rëndësi për t’u kërkuar nga Drejtuesi në këto raste, është ai në lidhje me ecurinë e kryerjes së detyrave të lëna nga gjykata, me qëllim përfundimin e tyre nga prokurori brenda afatit të caktuar prej saj.
- 5) *“Udhëzim lidhur me kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale në procedimin penal 429, viti 2019”*, i datës 12.03.2021, me bazë ligjore nenet 43/ç dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, si dhe nenet 24, 25 e vijues të K. Pr. Penale, nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë gjatë procesit të verifikimit gjendjes së procedimit/çështjes, ku Drejtuesi pasi është njohur me aktet e këtij procedimi penal, udhëzon kryerjen e disa veprimeve hetimore, por nuk rezulton mënyra se si Drejtuesi i Prokurorisë është njohur me aktet e procedimit për nxjerrjen e këtij udhëzimi. Edhe për këtë udhëzim, përveç këtij disponimi, në lidhje me veprimet që ka lënë detyrë gjykata, nuk ka disponime të tjera mbi procedurën e udhëzimit jo të detyrueshëm si në udhëzimet e mësipërme.
- 6) *“Udhëzim për kryerjen e veprimeve hetimore”*, i datës 18.03.2021, (në kuadër të procedimit penal nr. 359, të vitit 2021, me bazë ligjore nenin 48 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë gjatë procesit të verifikimit të gjendjes së procedimit, ku pasi është njohur me aktet e këtij procedimi penal, nga Drejtuesi udhëzohet kryerja e veprimeve të ndryshme hetimore, por nuk rezulton mënyra se si është njohur

Drejtuesi me aktet e procedimit, për nxjerrjen e këtij udhëzimi. Në pjesën udhëzuese përveç veprimeve përcaktohet edhe fakti që udhëzimi nuk është i detyrueshëm, nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme, në rast se prokurori vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë apo Drejtuesin e Seksionit, dhe udhëzimet me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit, i bashkëngjiten akteve të procedimit.

- 7) "Udhëzim me karakter jo të detyrueshëm në çështjen penale nr..., viti 2021", i datës 18.03.2021, me bazë ligjore nenet 43/ç dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, si dhe nenet 24, 25 e vijues të K. Pr. Penale, nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë në momentin e referimit të veprës penale, pasi është njohur me aktet e materialit nr. 700, datë 18.03.2021, ku udhëzohet kryerja e disa veprimeve hetimore. Në pjesën udhëzuese përveç veprimeve përcaktohet edhe fakti që udhëzimi nuk është i detyrueshëm, nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme, në rast se prokurori vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë apo Drejtuesin e Seksionit, dhe udhëzimet me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit.
- 8) "Udhëzim me karakter jo të detyrueshëm në çështjen penale nr. 1456, viti 2021", i datës 02.10.2020, me bazë ligjore nenet 43/ç dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, si dhe nenet 24, 25 e vijues të K. Pr. Penale, nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë gjatë verifikimit të gjendjes së procedimit, ku pasi është njohur me aktet e procedimit penal nr. 1456, datë 30.07.2020, udhëzohet kryerja e disa veprimeve hetimore, por nuk rezulton mënyra se si është njohur Drejtuesi me aktet e procedimit, për nxjerrjen e këtij udhëzimi. Në pjesën udhëzuese përveç veprimeve përcaktohet edhe fakti që udhëzimi nuk është i detyrueshëm, nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme, në rast se prokurori vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë apo Drejtuesin e Seksionit, dhe udhëzimet me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit.
- 9) "Udhëzim" i datës 22.10.2020, me bazë ligjore nenin 48/ç të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, nxjerrë nga ana e Drejtuesit të Seksionit për Hetimin e Krimeve të Përgjithshme, në momentin e referimit të veprës penale. Udhëzimi është nxjerrë në bazë të informacionit të datës 22.10.2020, të prokurorit që i është caktuar referimi i veprës penale, lidhur me materialin kallëzues me nr. 3831, të vitit 2020. Nga Drejtuesi i Seksionit sugjerohet regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të "Vrasja", parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe kryerja e veprimeve hetimore. Në pjesën udhëzuese, përveç veprimeve të udhëzuara përcaktohet vetëm fakti që të njihet prokurori i çështjes me udhëzimin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet fashikullit të prokurorit.
- 10) "Udhëzim i Përgjithshëm jo i detyrueshëm", i datës 07.10.2020, nga ana e Drejtuesit të Seksionit të trafikeve dhe narkotikëve dhe shpërdorimit të detyrës, me bazë ligjore ligjin nr. 97/2016, të ndryshuar dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të



Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, nxjerrë nga Drejtuesi i Seksionit në momentin e referimit të veprës penale dhe regjistrimit të kallëzimit nr. 3834, të vitit 2020. Nga Drejtuesi i Seksionit pas pjesës arsyetuese, udhëzohet regjistrimi i çështjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal dhe kryerja e veprimeve hetimore. Në pjesën udhëzuese, përveç veprimeve të udhëzuara përcaktohet vetëm fakti që të njihet prokurori i çështjes me udhëzimin, nëpërmjet nëshkrimit në udhëzim.

- Për sa i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre, rezulton se në periudhën e inspektimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, janë nxjerrë 10 (dhjetë) udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete. Për udhëzimet jo të detyrueshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezulton se:
- Përgjithësisht janë nxjerrë në respektim të mënyrës dhe procedurës së parashikuar nga neni 11, i udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ku 8 (tetë) prej udhëzimeve jo të detyrueshme, i përkasin kompetencës së Drejtuesit të Prokurorisë (neni 11/1-c i Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/1-c, neni 43/ç i ligjit) dhe 2 (dy) kompetencës së Drejtuesit të Seksionit për prokurorët e seksionit që ai drejton (neni 11/1-ç i Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/1-d i ligjit);
- Në 4 (katër) raste udhëzimet jo të detyrueshme janë nxjerrë kryesisht nga Drejtuesit, në momentin e regjistrimit të kallëzimit ose referimit të veprës penale (neni 11/2 i udhëzimit të përgjithshëm, neni 48/3 i ligjit); 3 (tre) raste gjatë procesit të verifikimit të gjendjes së procedimit/çështjes (neni 11/2 i Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/3 i ligjit); është nxjerrë 1 (një) udhëzim jo i detyrueshëm për rastin e procedimit penal, ku ka të vendosur masë sigurimi “arrest në burg” (neni 11/2 i Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/3 i ligjit); 2 (dy) raste janë udhëzime jo të detyrueshme, duke udhëzuar kryerjen e veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata brenda afatit të caktuar prej saj, pas kthimit të akteve prokurorit për kryerjen e hetimeve shtesë (neni 12, pika 3 e Udhëzimit të Përgjithshëm).
- Udhëzimet jo të detyrueshme janë me shkrim dhe me arsyetimin përkatës (neni 11/2-a i Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/4 i ligjit);
- Udhëzimet jo të detyrueshme nuk figurojnë të regjistruara në regjistrin e brendshëm të korrespondencës procedurale në referim neni 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar;
- Në një rast udhëzimi i është dërguar me email prokurorit dhe nga prokurori është kthyer përgjigje me email mbi zbatimin e udhëzimit jo të detyrueshëm; 9 udhëzimet e tjera i janë njoftuar prokurorit përkatës kundrejt nënshkrimit në udhëzim dhe nga prokurori ka një përgjigje, duke u bërë shënimi në udhëzim mbi zbatimin e udhëzimit, ndërsa në rastet e tjera nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos e zbatuar ose paqartësi.
- Për sa i përket zbatimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve jo të detyrueshme referohet se janë zbatuar nga prokurorët, por nuk arrihet të konkludohet si apo sa janë zbatuar veprimet e udhëzuara dhe sa ka ndikuar zbatimi i udhëzimit jo të detyrueshëm në ecurinë e hetimeve dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke raportuar thjesht se



lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjeve, ku nga Drejtuesi janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme. Në 6 (gjashtë) prej këtyre rasteve procedimet penale kanë qenë ende nën hetim, 1 (një) rast është dërguar për gjykim, dhe 1 (një) rast tjetër është dërguar me kërkesë për pushim në gjykatë. Pra nuk ka mbikëqyrje sipas nenit 8/2, pika "c" dhe nenit 14 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, "Prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë, mbi kërkesën e këtij të fundit, për ecurinë e procedimit penal.... jo më vonë se 20 (njëzet) ditë përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore në një procedim penal.... në të cilin drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme, ose u është kërkuar sa më sipër nga ky i fundit në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij".

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Nga të dhënat e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, rezulton se nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme:

- 1) "Udhëzim nr. 42 PBD, datë 09.10.2020 "Për çështje konkrete", mbështetur në nenet 41, 42, 43 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë, në lidhje me materialin hetimor nr. 2316, të vitit 2020. Prokurori të cilit i është caktuar materiali udhëzohet për regjistrimin e procedimit penal dhe kryerja e disa veprimeve hetimore. Pas arsyetimit të udhëzimit dhe veprimeve të udhëzuara, ndër të tjera përcaktohet edhe se një kopje e udhëzimit i njoftohet prokurorit kundrejt nënshkrimit, një kopje administrohet në fashikull dhe tjetra në dosjen e akteve të Drejtuesit. Gjithashtu, prokurori i çështjes duhet të njoftojë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë nëse vendos të mos e zbatojë udhëzimin dhe duhet të njoftojë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë jo më vonë se 20 (njëzet) ditë përpara përfundimit të hetimeve për këtë procedim penal. Udhëzimi regjistrohet në librin e komunikimeve të brendshme të Drejtuesit. Udhëzimi rezulton se është i regjistruar në regjistrin e komunikimeve të brendshme me nr. 860, datë 09.10.2020.
- 2) "Udhëzim nr. 43 PBD, datë 09.10.2020 "Për çështje konkrete", me bazë ligjore të njëjtë si udhëzimi i mësipërm, në lidhje me materialin hetimor nr. 2317, të vitit 2020 për prokurorin e çështjes. Prokurori të cilit i është caktuar materiali, udhëzohet për regjistrimin e procedimit penal dhe ka përcaktuar kryerjen e disa veprimeve hetimore konkrete. Pas pjesës arsyetuese dhe veprimeve të udhëzuara, në udhëzim përcaktohet e njëjta procedurë si në udhëzimin e mësipërm. Udhëzimi rezulton se është i regjistruar në regjistrin e komunikimeve të brendshme me nr. 861, datë 09.10.2020.
- 3) "Udhëzimi nr. 46 PBD, datë 13.10.2020 "Për çështje konkrete" me bazë ligjore të njëjtë si udhëzimet e tjera, në lidhje me procedimin penal nr. 1151, të vitit 2019. Rezulton se në datën 10.09.2020, prokurori i çështjes ka kryer përfundimin e hetimeve për këtë procedim penal dhe për këtë arsye ka përpiluar dhe u ka njoftuar të hetuarve aktin përkatës të

përfundimit të hetimeve. Udhëzimi ka dalë në bazë të kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë, ku prokurori i çështjes ka dorëzuar aktet e këtij procedimi penal.

Gjithashtu, me kërkesën e datës 13.10.2020, prokurori i çështjes ka deklaruar heqjen dorë nga hetimi i çështjes penale nr. 1151, të vitit 2019, ndërsa me vendimin e datës 14.10.2021, nga Drejtuesi i Prokurorisë është pranuar heqja dorë dhe është vendosur zëvendësimi i tij me një prokuror tjetër. Arsyeja e heqjes dorë në kërkesën e datës 13.10.2020 është se *"Për shkak se në përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. 1151, viti 2019, unë e kam dhënë mendimin tim dhe nëse nga ana juaj çmohet se duhen kryer veprime të mëtejshme hetimore, heq dorë nga hetimi i mëtejshëm i procedimit penal nr. 1151, viti 2019"*.

Pas shqyrtimit të akteve Drejtuesi i Prokurorisë ka udhëzuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Pas pjesës arsyetuese dhe veprimeve të udhëzuara, në udhëzim përcaktohet e njëjta procedurë si në udhëzimet e mësipërme.

- Konstatohet se vetëm për shkakun e përmendur, deklarimi për heqje dorë i prokurorit (bërë si kërkesë) rezulton i pabazuar në nenet 17, 26 dhe 27 të K. Pr. Penale dhe po ashtu dhe pranimi i kësaj kërkesë nga Drejtuesi, në lidhje me arsyetimin e shkaqeve të rëndësishme të njëanshmërisë. Pikërisht, edhe në vendimin për shqyrtimin e kërkesës për heqje dorë të datës 14.10.2020, Drejtuesi ka arsyetuar *"Nga sa më sipër, vlerësoj se në rastin konkret edhe pse nuk ekzistojnë shkaqe për përjashtimin e prokurorit B. N., nga hetimi i çështjes penale nr. 1151/2019, kërkesa duhet të pranohet dhe të vendoset zëvendësimi i prokurorit. Pranimi i kërkesës për zëvendësimin e prokurorit duhet të bëhet vetëm për arsye se në dhënien e drejtësisë është e rëndësishme jo vetëm dhënia e saj në bazë të ligjit, por edhe që për palët në proces dhe për publikun të krijohet një perceptim sa më i plotë se kjo drejtësi do të jepet"*.
- Në ligjin nr. 97/2016, i ndryshuar, sikurse në udhëzimin përkatës është parashikuar se nëse prokurori nuk është dakord me udhëzimet jo të detyrueshme mund t'i refuzojë ato duke dhënë arsyetimin përkatës dhe përkundrajt kësaj Drejtuesi i Prokurorisë nuk mund të procedojë më tej. Por, ajo që duhet të nënvizohet, është se prokurori në rast se nuk ndodhet para rasteve për heqje dorë, ka detyrimin në ushtrim të funksioneve të tij për t'i dhënë zgjidhjen përkatëse çështjes. Krahas këtij detyrimi të prokurorit të çështjes është edhe detyrimi i Drejtuesit të Prokurorisë për të respektuar Kodin e Procedurës Penale për pranimin dhe/ose zëvendësimin e prokurorit, pasi nëpërmjet zbatimit dhe respektimit të këtyre detyrimeve garantohet dhe parimi i pavarësisë së prokurorit. Nëse do të pranohet si në përputhje me parashikimet e K. Pr. Penale deklarimi i prokurorit për heqje dorë dhe vendimmarrja e Drejtuesit në këto raste për pranimin e saj, kjo do të passillte raste ku qartë, mund të abuzohej me autoritetin e Drejtuesit.
- Në këtë rast duke qenë se prokurori nuk kishte shkak për të hequr dorë nga hetimet e procedimit penal, ai duhet të kishte zbatuar kërkesat e nenit 11, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, sipas të cilit nëse nuk ishte dakord ose

kishte paqartësi lidhur me udhëzimin e dhënë, brenda 5 (pesë) ditëve kishte të drejtë të kërkonte me shkrim shpjegime të mëtjshme për udhëzimet e dhëna ose për pjesë të tyre dhe Drejtuesi ishte i detyruar t'i jepte shpjegimet. Edhe në rast se prokurori nuk do të ishte dakord me udhëzimin e përsëritur dhe nuk do ta zbatonte atë, ai duhet të njoftonte brenda 5 (pesë) ditëve me shkrim Drejtuesin përkatës për shkaqet e moszbatimit.

- 4) "Udhëzim nr. 13, datë 24.02.2021 "Për çështje konkrete", mbështetur në nenet 41, 42, 43 dhe 48 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, për procedimin penal nr. 248, të vitit 2021, në lidhje me caktimin e llojit të masës së sigurimit, ku udhëzohet prokurori që të kërkojë caktimin e masës së sigurimit ndaj dy personave të arrestuar në flagrancë, "arrest në burg", të dyshuar për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Edhe në këtë rast pas arsytimit të udhëzimit dhe veprimt që udhëzohet përcaktohet e njëjta procedurë për njoftimin e udhëzimit dhe se prokurori i çështjes duhet të njoftojë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë nëse vendos të mos e zbatojë këtë udhëzim. Referohet se në datën 25.02.2021, prokurori i çështjes ka vepruar sipas udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë.

Nga shpjegimet e prokurorit, të datës 25.02.2021 në lidhje me këtë udhëzim, rezulton se "Në përgjigje të udhëzimit tuaj jodetyrues nr. 13 datë 24.02.2021, ju bëj me dije se: Së pari, ju nuk po udhëzoni për veprime hetimore konkrete, por po udhëzoni për mënyrën e disponimit nga prokurori, çka për mendimin tim del tej konceptit që ligji i ka dhënë udhëzimit jodetyrues të drejtuesit sipas nenit 48 të ligjit nr. 97/2016. Udhëzimi jodetyrues është për kryerjen e veprimeve procedurale (veprime hetimore apo kërkesa) dhe jo për qëndrimin që duhet të mbajë prokurori i çështjes në to. Së dyti në respektim të ushtrimit të funksionit tim si prokuror, bazuar në K. Pr. Penale do të kërkoj në gjykatë vlefshësin e arrestimit dhe caktimin e mases së sigurimit ndaj shtetasve E. P., dhe A. M., bazuar në Kushtetutë, ligj dhe në provat e administruara deri në këtë moment procedural".

- Në bazë të nenit 43 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, ndër të tjera Drejtuesi i Prokurorisë ka këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale: b) kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerr udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji; ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtjshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake.
- Neni 48, i ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar "Udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete", pika 3, parashikon se "Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, mund të jepen kryesisht në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, ose më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit".

- Neni 11, pika 1 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikon *"Udhëzime jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale përpara se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes konkrete..."*.
- Neni 13, pika 1 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikon se *"Prokurorët me qëllim që të mundësojnë drejtuesin për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme,....., duhet të informojnë paraprakisht drejtuesin e prokurorisë,..... për procedimin penal ku do të nxirren urdhra ndalimi ose do t'i drejtohen gjykatës, kërkesa për caktimin e masave të sigurimit arrest në burg, arrest në shtëpi,.....2. Drejtuesi mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme brenda 1 (një) dite nga marrja e informacionit"*.
- Në bazë të këtyre akteve ligjore e nënligjore vlerësohet se udhëzimi në rastin konkret e tejkalon konceptin që ligji dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, i ka dhënë udhëzimit jo të detyrueshëm të Drejtuesit të Prokurorisë, pasi duke udhëzuar mënyrën e vendimmarrjes nga prokurori ndërhyr në pavarësinë e tij për të vlerësuar aktet dhe provat. Si rrjedhim, vlerësohet se me përgjigjen e datës 25.02.2021, të prokurorit të çështjes, jemi para rastit të parashikuar nga neni 48, pika 5 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe nenit 11, pikat 3 dhe 4 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar: *"Kur prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet e dhëna, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme lidhur me to. Drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit është i detyruar të japë shpjegime mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr. Në rast se prokurori, ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi me shkrim, vendos të mos e ndjekë atë, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit"*.
- Përgjigja e prokurorit ndaj këtij udhëzimi është brenda afatit 5 (pesë) ditor të parashikuar nga neni 11, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, si dhe udhëzimi me shkrim dhe përgjigja e prokurorit në zbatim të nenit 11, pika 5 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, i janë bashkëlidhur akteve të procedimit penal.
 - Për sa i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe mbikëqyrjes e zbatimit të tyre, rezulton se nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan është zbatuar Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, me nxjerrjen e 4 (katër) udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete. Për udhëzimet jo të detyrueshme të Drejtuesit të Prokurorisë rezulton se:
 - Janë nxjerrë në respektim të mënyrës dhe procedurës së parashikuar nga neni 11 i Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ndërsa nuk ka udhëzime jo të detyrueshme të nxjerra nga Drejtuesit e Seksioneve.

- Tre (3) prej udhëzimeve jo të detyrueshme janë nxjerrë kryesisht nga Drejtuesi i Prokurorisë në momentin e referimit të veprës penale dhe caktimit me short të materialit prokurorit (neni 11, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48, pika 3 i ligjit) dhe një (1) udhëzim është nxjerrë me kërkesë gjatë procesit të verifikimit të ecurisë së gjendjes së procedimit (neni 11, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/3 i ligjit).
- Udhëzimet jo të detyrueshme janë me shkrim dhe me arsyetimin përkatës (neni 11/2-a i Udhëzimit të Përgjithshëm, neni 48/4 i ligjit), të cilat u janë njoftuar prokurorëve nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e brendshëm të korrespondencës procedurale në referim të nenit 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar;
- Për sa i përket zbatimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve jo të detyrueshme referohet se në dy raste është marrë parasysh udhëzimi, pasi është regjistruar procedimi penal. Gjithashtu, rezulton se në dy prej tyre prokurori nuk ka qenë dakord me zbatimin e udhëzimeve të Drejtuesit, konkretisht, udhëzimi nr. 13, datë 24.02.2021, i cili është pasuar me përgjigjen përkatëse të prokurorit dhe udhëzimi nr. 46 PBD, datë 13.10.2020, ku prokurori ka deklaruar heqjen dorë nga procedimi penal. Në rastet që prokurori nuk ka qenë dakord duke kthyer përgjigjen përkatëse në zbatim të nenit 48, pika 5, të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, udhëzimi në këtë rast konsiderohet i tërhequr, përderisa nga Drejtuesi nuk është përsëritur në të njëjtën mënyrë. Në dy rastet e tjera nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos e zbatuar ose paqartësi. Në lidhje me zbatimin nuk arrihet të konkludohet si apo sa janë zbatuar veprimet e udhëzuara, dhe sa ka ndikuar zbatimi i udhëzimit jo të detyrueshëm në ecurinë e hetimeve dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke raportuar thjesht se lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjeve, ku nga Drejtuesi janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme, njëra është dërguar për gjykim dhe të tjerat ishin ende në hetim.
- Vlerësohet se me disponimin në udhëzimet jo të detyrueshme të faktit që prokurori duhet të njoftojë me shkrim Drejtuesin e prokurorisë jo më vonë se 20 (njëzet) ditë përpara përfundimit të hetimeve, plotësohet kërkesa për mbikëqyrje sipas nenit 8/2, pika "c" dhe nenit 14 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, *"Prokurorët informojnë drejtuesin e prokurorisë, mbi kërkesën e këtij të fundit, për ecurinë e procedimit penal.... jo më vonë se 20 (njëzet) ditë përpara se të vendosin përfundimin e hetimeve, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore në një procedim penal.... në të cilin drejtuesi i prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme ose u është kërkuar sa më sipër nga ky i fundit, në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij".*

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier**

Nga të dhënat e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, rezulton se nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme:

- 1) *"Udhëzim nr. 79, datë 11.12.2020 për procedimin penal nr. 1097, të vitit 2019", me bazë ligjore nenin 48, pika 1, germa "d" të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, ku pas njohjes me aktet e procedimit penal nr. 1087, të vitit 2019 nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe Drejtuesi i*

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Seksionit të veprave të tjera penale, është udhëzuar kryerja e veprimeve të tjera hetimore për prokurorin e çështjes, por nuk rezulton mënyra se si është njohur me aktet e procedimit Drejtuesi i Prokurorisë/Drejtuesi i Seksionit për nxjerrjen e këtij udhëzimi.

- Udhëzimi është i arsyetuar dhe në pjesën e disponimin përmban vetëm një pikë, atë të kryerjes së veprimeve të udhëzuara. Udhëzimi nuk rezulton se është i regjistruar në regjistrin e brendshëm të korrespondencës procedurale sipas nenit 20, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr.12/2020 të ndryshuar, por rezulton se ky udhëzim së bashku me dosjen i është dorëzuar Oficerit të Policisë Gjyqësore të ngarkuar me hetimet, po në datën 11.12.2020; nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos e zbatuar ose paqartësi.

2) *“Udhëzim nr. 20, datë 29.03.2021 për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, procedimi penal nr. 1344, i vitit 2020”*, me bazë ligjore nenin 6, paragrafi 2, nenin 43, germa “b” dhe “ç”, nenin 48 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, ligjin nr. 96/2016 të ndryshuar, Kodin e Procedurës Penale, bazuar në udhëzimin nr. 02, datë 29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori”, Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, udhëzimin e përgjithshëm nr. 65, të vitit 2020 të Drejtuesit të Prokurorisë. Pas njohjes me informacionin e prokurorit të çështjes, në lidhje me hetimet e procedimit penal nr. 1344, të vitit 2020, është udhëzuar kryerja e veprimeve të mëtejshme hetimore.

- Udhëzimi është i arsyetuar dhe në pjesën ku udhëzohen veprimet konkrete parashikohen edhe pika mbi faktin që prokurori i ngarkuar me hetimin në rast se vendos të mos i ndjekë udhëzimet të njoftojë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë, si dhe udhëzimi dhe përgjigjet me shkrim të prokurorit të çështjes t’i bashkëngjiten akteve të fashikullit të procedimit penal. Udhëzimi është protokolluar në regjistrin e brendshëm me nr. 963, datë 31.03.2021, në rubrikën e kalimit të akteve tek Drejtuesi dhe është marrë nga prokurori po në datën 31.03.2021, sipas nenit 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos e zbatuar ose paqartësi.

3) *“Udhëzim nr. 08, datë 03.02.2021, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale në procedimin penal nr. 1150, të vitit 2020”*, me bazë ligjore të njëjtë si në udhëzimin më sipër, ku pas njohjes me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: ndryshimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me masën e sigurimit “garanci pasurore” për shtetasin R. B., i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 283/1, 284/1, 278 të Kodit Penal, Drejtuesi i Prokurorisë ka udhëzuar që: *“Në bazë të nenit 249/2 të K. Pr. Penale, të ushtrohet ankimi ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe të kërkohet në Gjykatën e Apelit Vlorë: “Ndryshimin e vendimit të Gjykatës Fier datë 01.02.2021, që ka caktuar masën e sigurimit garanci pasurore për të hetuarin R. B.; Lënien në fuqi të masës së sigurimit “arrest në burg” për të hetuarin R. B., të caktuar me vendimin nr. 62-2020-3865 (1290), datë 16.10.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor; Në bazë të nenit 34/l të K. Pr. Penale, t’i njoftohet akuza shtetasit R. B., për veprat penale të parashikuara*

nga nenet 283/2, 284/2 e 278/2, 3 të Kodit Penal; Në bazë të nenit 34/1 të K. Pr. Penale shtetasitt'i njoftohet akuza për veprat penale 283/2 e 284/2 të Kodit Penal; Në bazë të nenit 327, pika 6, germa "b", pasi të jenë respektuar të gjitha parashikimet dhe afatet ligjore të këtij neni, t'i kërkohet gjyqtarit të hetimeve paraprake dërgimi i çështjes penale për gjykim".

- Udhëzimi është i arsyetuar dhe në pjesën ku udhëzohen veprimet konkrete parashikohen edhe pika mbi faktin që prokurori i ngarkuar me hetimin në rast se vendos të mos i ndjekë udhëzimet të njoftojë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë, si dhe udhëzimi dhe përgjigjet me shkrim të prokurorit të çështjes t'i bashkëngjiten akteve të fashikullit të procedimit penal. Udhëzimi sipas nenit 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, është protokolluar me nr. 349, datë 04.02.2021 i është dorëzuar Drejtuesit dhe po në datën 04.02.2021 ka dalë nga Drejtuesi dhe i është dorëzuar prokurorit. Nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos e zbatuar ose paqartësi.
- Udhëzimi jo i detyrueshëm si më sipër edhe në këtë rast vlerësohet si në tejkalim të konceptit të udhëzimit të parashikuar nga ligji me nr. 97/2016, i ndryshuar dhe Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, për Drejtuesin. Ky i fundit në rastin konkret nuk ka udhëzuar kryerjen e veprimeve hetimore ose procedurale, por ka udhëzuar qëndrimin që duhet të mbajë prokurori në rastin konkret, duke imponuar bindjen e tij me atë të prokurorit, për rrjedhojë duke ndërhyrë në pavarësinë e prokurorit si një parim i garantuar në ligj.

4) "Udhëzim nr. 294, datë 01.02.2021 për çështjen penale nr. 895 të vitit 2020", me bazë ligjore nenin 6, paragrafi 2, nenin 43, gerrat "b" dhe "ç", nenin 48 të ligjit nr. 97/2016 të ndryshuar, ligjin nr. 96/2016, të ndryshuar, Kodin e Procedures Penale dhe bazuar në udhëzimin nr. 02, datë 29.12.2016 "Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori". Udhëzimi është nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë, pasi është njohur me kërkesën për heqje dorë të prokurorit në kuadër të procedimit penal nr. 895 të vitit 2020, duke udhëzuar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore.

- Udhëzimi është i arsyetuar dhe në pjesën e disponimit përmban vetëm një pikë, atë të kryerjes së veprimeve të udhëzuara. Udhëzimi jo i detyrueshëm i Drejtuesit të Prokurorisë Fier rezulton se është protokolluar me nr. 294, datë 01.02.2021 në regjistrin e korrespondencës së brendshme procedurale dhe dalë nga Drejtuesi po në datën 01.02.2021 tek prokurori, sipas nenit 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos e zbatuar ose paqartësi.
- Për sa i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre, rezulton se në periudhën e inspektimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, janë nxjerrë 4 (katër) udhëzime

jo të detyrueshme për çështje konkrete. Për udhëzimet jo të detyrueshme të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, rezulton se:

- Janë nxjerrë në respektim të mënyrës dhe procedurës së parashikuar nga neni 11, i Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ku 3 (tre) prej udhëzimeve jo të detyrueshme i përkasin kompetencës së Drejtuesit të Prokurorisë (neni 11/1-c i udhëzimit të përgjithshëm, neni 48/1-c, neni 43/ç i ligjit), dhe udhëzimi tjetër është nxjerrë nga Drejtuesi së bashku me Drejtuesin e Seksionit për prokurorët e seksionit që ai drejton (neni 11/1-ç i udhëzimit të përgjithshëm, neni 48/1-d i ligjit);
- Katër (4) udhëzimet jo të detyrueshme janë nxjerrë gjatë procesit të verifikimit të gjendjes së procedimit/çështjes (neni 11/2 i udhëzimit të përgjithshëm, neni 48/3 i ligjit) ku 1 (një) udhëzim jo i detyrueshëm për rastin e procedimit penal, ku ka të vendosur masë sigurimi “arrest në burg” (neni 11/2 i udhëzimit të përgjithshëm, neni 48/3 i ligjit);
- Udhëzimet jo të detyrueshme janë me shkrim dhe me arsyetimin përkatës (neni 11/2-a i udhëzimit të përgjithshëm, neni 48/4 i ligjit);
- Një (1) prej udhëzimeve jo të detyrueshme nuk figuron i regjistruar në regjistrin e brendshëm të korrespondencës procedurale, ndërsa 3 (tre) të tjerat u janë njoftuar prokurorëve nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e brendshëm në referim të nenit 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Për sa i përket zbatimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve jo të detyrueshme për të gjitha rastet, nuk ka përgjigje të prokurorit për të mos i zbatuar ose paqartësi. Për sa referohet nga aktet nuk arrihet të konkludohet si apo sa janë zbatuar veprimet e udhëzuara dhe sa ka ndikuar zbatimi i udhëzimit jo të detyrueshëm në ecurinë e hetimeve dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, duke raportuar thjesht se lidhur me mënyrën e përfundimit të çështjeve, ku nga Drejtuesi janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme, 4 procedime penale ishin ende në fazë hetimi, ndërsa për 1 procedim penal nga ana e prokurorit të çështjes është vendosur pushimi i akuzës për 2 të pandehur dhe është dërguar në gjykatë kërkesa për gjykim për 3 të pandehur, pra, nuk ka kërkesë për mbikëqyrje sipas nenit 8/2, pika c) dhe nenit 14 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë**

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë informohet se gjatë periudhës kohore 01.10.2020–31.03.2021 është proceduar me nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete për disa nga prokurorët e kësaj prokurorie. Referohet se për këto udhëzime jo të detyrueshme nuk rezulton që të ketë patur oponenca apo pretendime nga ana e prokurorëve, të cilët i kanë vlerësuar si orientuese në hetimet e kryera nga ana e tyre, pra, prokurorët kanë qenë dakord me udhëzimet e dhëna.

Sipas regjistrimit të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale mund të nxirren këto të dhëna në lidhje me udhëzime jo të detyrueshme të Drejtuesit të Prokurorisë:

- 1) « Udhëzim jo i detyrueshëm për procedimin penal nr. 962/2020 », i cili rezulton nga regjistri i komunikimeve të brendshme, ku është protokolluar me nr. 28/9, datë 28.09.2020 dhe me aq të dhëna sa pasqyrohen në këtë regjistër si numër protokollit i udhëzimit vendoset data/muaji dhe rezulton se udhëzimi është nxjerrë në momentin e caktimit me short të materialit prokurorit. Udhëzimi nuk është dërguar bashkëlidhur.
- 2) « Udhëzim jo i detyrueshëm për procedimin penal nr. 146/2021 », i cili rezulton nga regjistri i komunikimeve të brendshme, ku është protokolluar me nr. 9/3, datë 09.03.2021, pasi udhëzimi nuk është dërguar bashkëlidhur. Edhe në këtë rast udhëzimi pasqyrohet po njësoj në regjistër, ndërsa nuk evidentohet nëse është nxjerrë në momentin e caktimit me short të materialit prokurorit apo gjatë verifikimit të ecurisë së çështjes.
- 3) « Udhëzim jo i detyrueshëm për procedimin penal nr. 24/2021 », i cili rezulton nga regjistri i komunikimeve të brendshme, ku është protokolluar me nr. 10/3, datë 10.03.2021, por udhëzimi nuk është dërguar bashkëlidhur. Udhëzimi pasqyrohet i regjistruar me numër protokollit sipas datës/muajit dhe nuk evidentohet nëse është nxjerrë në momentin e caktimit me short të materialit prokurorit apo gjatë verifikimit të ecurisë së çështjes.
- 4) « Udhëzim jo i detyrueshëm për procedimin penal nr. 365/2020 », i cili rezulton nga regjistri i komunikimeve të brendshme, ku është protokolluar me nr. 17/3, datë 17.03.2021. Udhëzimi nuk është dërguar bashkëlidhur, ndërsa nga regjistri rezulton se është nxjerrë gjatë verifikimit të ecurisë së çështjes.
- 5) « Udhëzim jo i detyrueshëm për procedimin penal nr. 72/2021 », i cili rezulton nga regjistri i komunikimeve të brendshme, ku është protokolluar me nr.18/3, datë 18.03.2021. Udhëzimi nuk është dërguar bashkëlidhur. Si numer protokollit vendoset data/muaji, ndërsa nga regjistri nuk evidentohet nëse është nxjerrë në momentin e caktimit me short të materialit prokurorit apo gjatë verifikimit të ecurisë së çështjes.
- 6) « Udhëzim jo i detyrueshëm për procedimin penal nr. 562/2020 », i cili rezulton nga regjistri i komunikimeve të brendshme, ku është protokolluar me nr. 31/3, datë 31.03.2021. Udhëzimi nuk është dërguar bashkëlidhur. Edhe në këtë rast udhëzimi pasqyrohet me numër protokollit data/muaji, ndërsa rezulton se është nxjerrë gjatë verifikimit të ecurisë së çështjes.

- Për sa i përket mënyrës dhe procedurës që ndiqet në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe mbikëqyrjes së zbatimit të tyre në këtë prokurori, rezulton se ato i referohen procedurës së parashikuar në nenin 11, të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, në lidhje me kompetencën e Drejtuesit të Prokurorisë për të nxjerrë udhëzime të tilla për prokurorët e prokurorisë që drejton. Përderisa nuk na janë vendosur në dispozicion udhëzimet konkrete dhe nga mosplotësimi i saktë i rubrikave të regjistrit, megjithëse udhëzime të tillë figurojnë të regjistruara në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale në referim të nenit 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe rezulton se i është






njoftuar prokurorit kundrejt nënshkrimit në regjistër, ngelet i paqartë verifikimi i fazës kur janë nxjerrë këto udhëzime, kryesisht nga Drejtuesi, në momentin e regjistrimit/referimit të veprës penale apo gjatë verifikimit të ecurisë së procedimit/çështjes, si dhe nuk mund të gjykohet në lidhje me arsyetimin e tyre, paqartësive ose jo nga prokurori për zbatimin e tyre.

- Për sa i përket zbatimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të dhëna referohet se janë marrë parasysh nga prokurorët, por nuk jepet informacion si apo sa janë zbatuar veprimet e udhëzuara, sa ka ndikuar ose jo zbatimi i udhëzimeve jo të detyrueshme në hetimin dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes, referuar nenit 8/2, pika c) dhe nenit 14 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër

Nga të dhënat e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, rezulton se nga Drejtuesi i kësaj prokurorie janë nxjerrë 10 (dhjetë) udhëzime jo të detyrueshme, duke respektuar formalisht detyrimet ligjore në bazë të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.

- 1) Udhëzim nr. 76/2018, datë 09.10.2020, që lidhet me procedimin penal nr. 76, viti 2018, datë 07.10.2020 **në fazë gjykimi**. Udhëzimi është nxjerrë mbi bazë të kërkesës së palëve për zëvendësimin e prokurorit që përfaqëson akuzën në gjyq dhe bazuar në informacionin e datës 07.10.2020 të prokurorit. Me këtë akt udhëzohet prokurori të vijojë përfaqësimin e akuzës në gjyq.
- 2) Udhëzim nr. 480/2020, datë 09.10.2020, që lidhet me procedimin penal nr. 480/2018 datë 07.10.2020, **në fazë gjykimi**. Udhëzimi është nxjerrë mbi bazë të kërkesës së palëve për zëvendësimin e prokurorit që përfaqëson akuzën në gjyq dhe bazuar në informacionin e datës 07.10.2020 të prokurorit. Me këtë akt udhëzohet prokurori të vijojë hetimet dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq.
- 3) Udhëzim nr. 1124/2013, datë 16.10.2020, që lidhet me informacionin, njëherazi kërkesën e datës 09.10.2020 të prokurorit të çështjes, për zëvendësimin e tij në hetimet e procedimit penal nr. 1124/2013, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 të K. Penal, etj. Me këtë akt udhëzohet prokurori të vijojë hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq. Regjistruar komunikimi në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 11 prot, datë 19.10.2020.
- 4) Udhëzim nr. 1144/2020, datë 19.10.2020, që lidhet me informacionin, njëherazi kërkesë me datë 18.10.2020, e prokurorit të çështjes për zëvendësimin e tij në gjykimin e procedimin penal nr. 1144/2020, datë 18.10.2020 që bën fjalë për veprat penale të parashikuara nga neni 178 dhe 179 të K. Penal. Me këtë akt udhëzohet prokurori të vijojë hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq. Regjistruar komunikimi në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 14/1 prot, datë 19.10.2020.
- 5) Udhëzim nr. 24/4, datë 02.11.2020, që lidhet me informacionin datë 02.11.2020 të prokurorit të çështjes për procedimin penal nr. 751/2020, datë 11.06.2020, ku prokurori parashtron se nuk ka vend për ngritjen e grupit hetimor. Me këtë akt

udhëzohen dy prokurorë për vijimin e hetimeve dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq si grup hetimor në çështjet penale me nr. 751/2020, nr. 988/2020 dhe nr. 1301/2020, të bashkuara. Regjistruar komunikimi në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 24/41 prot., datë 03.11.2020.

- 6) Udhëzim nr. 34/2, datë 04.12.2020, që lidhet me kërkesën e Drejtuesit datë 23.11.2020 për gjendjen e disa procedimeve penale të mbartura në hetim të vitit 2017 dhe të vitit 2018, në lidhje me të cilat prokurori i çështjeve ka dhënë informacion me nr. ___prot (ska), datë 26.11.2020. Me këtë akt udhëzohet çregjistrimi dhe arkivimi i procedimit penal nr. 146/2018, (i cili rezulton se është dërguar në gjykatë për pushim dhe për të është marrë vendim gjykate për pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit); si dhe në procedimet penale të vitit 2018 të kryhen veprimet e mundshme hetimore dhe nëse vlerësohet nga prokurori të merren vendimet e pezullimit. Regjistruar komunikimi në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 34/2 prot., datë 04.12.2020.
- 7) Udhëzim nr. 42/1, datë 07.12.2020, që lidhet me informacionin e datës 11.11.2020 të prokurorit të çështjes për procedimin penal nr. 1749, viti 2018 që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K. Penal, i gjykuar, ku i pandehuri është dënuar me orë pune në interes publik bazuar në nenin 63 të K. Penal. Prokurori ka kërkuar në informacion nëse duhet ose jo të bëhet ekzekutimi i menjëhershëm dhe kush duhet të nxirte urdhrin e ekzekutimit (prokurori i çështjes apo ai i ekzekutimeve) dhe Drejtuesi me udhëzimin jo të detyrueshëm udhëzon prokurorin të arkivojë procedimin penal nr. 1749/2018, së bashku me shkurtimin e vendimit dhe se ekzekutimi i vendimit do të bëhet me marrjen formë të prerë nga prokurori i ekzekutimeve.
- 8) Udhëzim nr. 9/1, datë 15.01.2021, që lidhet me informacionin nr. 9, datë 14.01.2021 të prokurorit të çështjes, i cili pasi evidenton statistikën vjetore, kërkon zëvendësimin nga një procedim penal në hetim i vitit 2019 dhe disa të vitit 2020, që bëjnë fjalë për vepra penale të rënda dhe janë me të arrestuar duke vënë në dukje gjendjen e saj shëndetësore. Me këtë akt udhëzohet prokurori të vijojë hetimin në procedimet penale të cituara. Regjistruar komunikimi ndërmjet Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorit të çështjeve në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 9/1 prot., datë 04.12.2020.
- 9) Udhëzim nr. 24/1, datë 20.02.2021, që lidhet me informacionin e datës 18.02.2021 të prokurorit të çështjes, lidhur me kallëzimin penal nr. 221, të vitit 2021 që bën fjalë për veprat penale të parashikuara nga nenet 130/1 dhe 247 të K. Penal. Në aktin e Drejtuesit udhëzohet prokurori të vijojë hetimet, me kryerjen e veprimeve të mangëta nga oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar për çështjen, ose një oficer tjetër i policisë gjyqësore që do të caktohet prej prokurorit. Regjistruar komunikimi në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 24/1 prot., datë 22.02.2021.
- 10) Udhëzim nr. 28/1, datë 24.02.2021, që lidhet me informacionin nr. 27, datë 24.02.2021, të prokurorit të çështjes për procedimin penal nr. 186/2021 që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a të K. Penal, ku prokurori vlerëson nevojën e bashkimit të këtij procedimi me një procedim tjetër, sipas tij të kthyer nga gjykata për hetime të mëtejshme. Me këtë akt udhëzohet prokurori të vijojë hetimin në lidhje me procedimin penal nr. 186, të vitit 2021, pasi nuk ka vend për bashkimin

e procedimeve. Regjistruar komunikimi në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 28/1 prot., datë 24.02.2021.

- Sa më sipër parashtrohet, udhëzimet jo të detyrueshme të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, rezultojnë se përveç rreth 5 rasteve që janë nxjerrë pas informacionit nga prokurori për çështjet në hetim, ato nuk i përmbahen natyrës së udhëzimit jo të detyrueshëm të parashikuar në ligj dhe në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, edhe pse rezultojnë të jenë dhënë me shkrim dhe të arsyetuara,^[40] si dhe pasqyrojnë përfshirjen e udhëzimit në aktet e procedimit penal, sipas parashikimeve në nenin 11, pika 1, germa “c”, pika 2 germa “a” dhe pika 5^[41] të udhëzimit nr. 12 të vitit 2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Në disa raste çështjet kanë qenë në fazë gjykimi dhe ka pasur kërkesë nga palët apo nga vetë prokurori për zëvendësimin e tij, ndërkohë që nga Drejtuesi është proceduar me udhëzim për vazhdimin e përfaqësimit të çështjes në gjykim apo në hetim dhe jo me vendim për zëvendësim ose pranim ose jo të heqjes dorë sipas rasteve të parashikuara në ligj, pasi në rastin e çështjeve në gjykim nuk është e përshtatshme që akti të titullohet “udhëzim”. Duket sikur jemi para një akti për mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit referuar nenit 27 të K. Pr. Penale. Gjithashtu, pas përfundimit të gjykimit udhëzohet arkivimi i procedimit dhe se kur do të bëhet ekzekutimi i vendimit. Në këtë rast edhe pse duket se Drejtuesi nuk kishte mundësi tjetër për të kthyer përgjigjen mbi kërkesën e prokurorit të çështjes i cili e ka kërkuar vetë, me anën e një udhëzimi nga Drejtuesi mund të procedohej me vendim ose urdhër për rastin konkret. Në rastin e informacionit të prokurorit për bashkim të procedimeve, mund të ishin udhëzuar veprime të caktuara për çështjen konkrete, si dhe në rastin tjetër të procedohej me urdhër për ngritjen e grupit hetimor përveç udhëzimit jo të detyrueshëm të veprimeve hetimore. Përsa i përket përfaqësimit në gjykim prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë për rastet e parashikuara në nenin 15, pika 1 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.
- Referuar përmbajtjes së udhëzimeve jo të detyrueshme të sipërcituara, vetëm në njërin prej tyre^[42] identifikohet kërkesë e Drejtuesit të Prokurorisë për informacion drejtuar prokurorit të çështjes dhe përgatitja e informacionit nga prokurori mbi bazën e të cilit ka dalë udhëzimi jo i detyrueshëm nga Drejtuesi i Prokurorisë gjatë fazës së verifikimit të ecurisë së çështjeve penale në referim të nenit 11, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, ndërsa në rastet e tjera informacionet e prokurorëve i janë drejtuar Drejtuesit me iniciativën e tyre dhe pa kërkesë të Drejtuesit, ndërsa udhëzimi nr. 12/2020, i Prokurorit të

⁴⁰ 2. Neni 11, pika 2 germa “a” Udhëzimet duhet të jepën me shkrim dhe të arsyetuara.

⁴¹ 5. Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e prokurorit, i bashklidhen akteve të procedimit penal.

⁴² Udhëzimi nr. 34/2, datë 04.12.202, i nxjerrë mbi bazë informacioni me datë 26.11.2020 të prokurorit të çështjes, dhënë nga ky i fundit bazuar në kërkesën e drejtuesit me datë 23.11.2020.



Përgjithshëm, i ndryshuar, normon dhe garanton rastet kur informacioni bëhet i detyrueshëm nga prokurori dhe jo kur ai bëhet vullnetarisht prej tij, i cili kërkon të heqë dorë vetë nga disa garanci që i janë dhënë dhe me ligj [43].

- Udhëzimet jo të detyrueshme të nxjerra/dhëna nga Drejtuesi i Prokurorisë gjatë periudhës së inspektimit kanë të bëjnë kryesisht me informim nga ana e prokurorëve për ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, pra për procedime penale në fazë hetimi apo gjykimi dhe në asnjë rast me masa të sigurimit personal. Nga 10 udhëzimet jo të detyrueshme evidentohet se katër prej tyre lidhen me informim nga ana e prokurorit për përfaqësimin e akuzës në gjyq (Udhëzimi nr. 76/2018, datë 09.10.2020; Udhëzimi nr. 480/2020, datë 09.10.2020; Udhëzimi nr. 1144/2020, datë 19.10.2020; Udhëzim nr. 42/1, datë 07.12.2020) dhe 6 (gjashtë) të tjerët lidhen me informimin për ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale (Udhëzimi nr. 1124/2013, datë 16.10.2013; Udhëzimi nr. 24/4, datë 02.11.2020; Udhëzimi nr. 34/2, datë 04.12.2020; Udhëzimi nr. 9/1, datë 15.01.2021; Udhëzimi nr. 24/1, datë 20.02.2021 dhe Udhëzimi nr. 28/1, datë 24.02.2021). Përsa i përket afatit në nxjerrjen/dhënien e këtyre udhëzimeve jo të detyrueshme, i cili aplikohet në rastin e nxjerrjes së udhëzimit jo të detyrueshëm brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e informacionit mbi ecurinë e ushtrimit të ndjekjes penale apo mbi masat e sigurimit personal/pasuror, në përputhje me nenet 13, pika 2 dhe 14,[44] pika 3 e udhëzimit nr. 12/2020, të ndryshuar, nuk rezulton se evidentohet në udhëzimet jo të detyrueshme të cilat lidhen me informacionin e prokurorit për ecurinë e procedimeve penale.
- Sa i përket pasqyrimit në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë, rezulton se në një rast që i korrespondon numrit rendor 1066, datë 09.12.2020, të jetë pasqyruar shënimi lidhur me një udhëzim, për një informacion të dhënë nga prokurori, por që për të cilin nuk jepen të dhëna identifikuese se cilit procedim penal i përket si informacioni dhe udhëzimi. Ky udhëzim rezulton t'i jetë kaluar prokurorit në datën 09.12.2020 kundrejt nënshkrimit përmbri emrit të tij, në kolonën përkatëse të regjistrit të titulluar "Kalimi i akteve të firmosura tek prokurori, datë/orë".
- Nga informacioni i dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, rezulton se prokurorët zbatojnë detyrat që iu kërkohen në udhëzimet jo të detyrueshme dhe japin informacionin që iu kërkohet, por nuk përcaktohet koha kur ata kthejnë përgjigje në lidhje me kërkesat për informacion, për të vlerësuar nëse ky komunikim i brendshëm është në pajtim me udhëzimin nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 33, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër.

⁴³ Neni 8, pika 2, germa "c" Prokurori ka detyrimin të informojë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara.

⁴⁴ 3. Drejtuesi i prokurorisë mund të nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme jo më vonë se 3 (tre) ditë nga marrja e informacionit.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë**

Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, konstatohet se për periudhën kohore të inspektimit 01.10.2020 – 31.03.2021, referuar Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, nga Drejtuesi i Prokurorisë, janë nxjerrë udhëzimet jo të detyrueshme:

1. Udhëzimi jo i detyrueshëm nr. 1168, datë 16.02.2021, ku Drejtuesi i Prokurorisë udhëzon prokurorin e çështjes në lidhje me ecurinë e kallëzimit penal nr. 87, datë 20.1.2021, sikurse është pika 1 (një) e këtij udhëzimi për regjistrimin e procedimit penal. Përsa i takon këtij udhëzimi rezulton se ai evidentohet në regjistrin e komunikimeve të brendshme në datën 16.02.2021, ora 14:30 dhe marrja dijeni prej prokurorit, e udhëzimit jo të detyrueshëm, kundrejt nënshkrimit në regjistër në këtë datë. Nga përmbajtja e udhëzimit jo të detyrueshëm kuptohet se ai është dhënë me iniciativë të Drejtuesit në momentin e caktimit për ndjekje të prokurorit të kallëzimit penal. Bashkëlidhur materialeve që kanë mbërritur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është edhe vendimi i datës 05.02.2021 në emër të prokurorit të çështjes për mosfillimin e procedimit penal, lidhur me kallëzimin penal nr. 87, datë 20.1.2021, por në regjistrin e qarkullimit të korrespondencës nuk figuron të jetë i regjistruar data e dorëzimit të fashikullit të mosfillimit të Drejtuesi.
- Në lidhje me mënyrën dhe procedurën e nxjerrjes së këtij udhëzimi rezulton se materiali referues është regjistruar në prokurori në datën 20.01.2021, ndërsa udhëzimi jo i detyrueshëm nga Drejtuesi është nxjerrë pas kalimit të afatit 15 ditor, në datën 16.2.2021, pra nga këto të dhëna nuk është zbatuar korrektësisht parashikimi i nenit 48, pika 3 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, sipas të cilit *“Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, mund të jepen kryesisht në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, ose më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit”* dhe nenit 11, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. *“Udhëzimet mund të nxirren nga drejtuesi përkatës, në momentin e caktimit, të kallëzimit penal apo referimit të veprës penale dhe/ose të procedimit/çështjes, kur drejtuesi e vlerëson të nevojshme për mbarëvajtjen apo mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes”*.
- Në bazë të nenit 43, shkronja “ç”⁴⁵, nenit 48, pika 1 të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar dhe nenit 11, pika 1, shkronja “c”⁴⁶ të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, udhëzimet jo të detyrueshme të Drejtuesit për kryerjen e veprimeve procedurale nxirren para se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të

⁴⁵ ç) verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, udhëzon me shkrim, sipas nenit 48, të këtij ligji, kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale përpara se të merret vendimi mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake;

⁴⁶ Udhëzime jo të detyrueshme për kryerjen e veprimeve procedurale para se të merret vendimi për mënyrën e përfundimit të procedimit/çështjes konkrete, mund të jepen/nxirren nga c) Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë për prokurorët e prokurorisë që drejton;

procedimit/çështjes konkrete, ndërsa në rastin konkret udhëzimi jo i detyrueshëm i Drejtuesit të Prokurorisë, ka dalë pasi nga prokurori ishte marrë një vendim mosfillimi që në datën 05.02.2021, por që nuk dokumentohet në regjistër që kjo vendimmarrje tij, t'i jetë dorëzuar Drejtuesit që ai të kishte dijeni për të, para se të nxirrte udhëzimin jo të detyrueshëm, që në këto kushte do ta bënte atë të pazbatueshëm për prokurorin.

- Kompetenca e Drejtuesit të Prokurorisë sipas udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 4, datë 04.09.2020, për lehtësimin e zbatimit të tij, është ushtruar me nxjerrjen e 1 (një) udhëzimi jo të detyrueshëm. Sipas ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe udhëzimit të dalë në zbatim të tij, nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme nuk është kompetencë e detyruar për t'u ushtruar nga Drejtuesi, por përcaktohet qartë se kur nxirret.
- Sugjerohet që dhënia e informacionit për të gjitha çështjet që parashikohen në udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, të bëhet nga prokurorët në formë të shkruar ose përmes rrugës elektronike (emaili zyrtar) me qëllim që Drejtuesi i Prokurorisë të ketë një informacion më të plotë për gjendjen dhe ecurinë e hetimeve/procedimeve penale, masave të sigurimit, shuarjes së afateve të paraburgimit, vendimeve gjyqësore etj. Vetëm në bazë të një informacioni të tillë në kohë reale, mund të mundësohet nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme në rastet e parashikuara në mbështetje të veprimtarisë hetimore të secilit prokuror, me qëllim ushtrimin sa më të drejtë të ndjekjes penale në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor në mbrojtje të interesit publik, interesave ligjore të viktimave të veprave penale, sikurse edhe të vetë të drejtave ligjore të personave të ndaluar/arrestuar apo dënuar.

➤ Prokuroria e Apelit Vlorë

Nga informacioni dhe dokumentacioni i përgjithshëm nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Vlorë, lidhur me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", i ndryshuar, rezulton se për periudhën e kërkuar objekt inspektimi **nuk janë nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme.**

➤ Prokuroria e Apelit Tiranë

Për periudhën kohore të inspektimit 01.10.2020–31.03.2021, sipas informacionit të Drejtuesit të Prokurorisë kanë ushtruar funksionin e prokurorit në mënyrë të plotë, vetëm tre prokurorë. Për aktet e dy prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Tiranë si informacione apo konkluzione dhe deklarata për heqje dorë nga ankimi, sipas regjistrit dhe informacionit të sjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë, për periudhën e inspektimit **nuk rezultojnë të jenë nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme** dhe sipas Drejtuesit të Prokurorisë, kjo shpjegohet me faktin se qëndrimi ligjor i prokurorit të shortuar për përfaqësimin e çështjeve penale (qofshin kërkesa penale, çështje themeli apo dhe masa sigurimi) që pasqyrohet në këto akte, nuk ka qenë i ndryshëm nga i Drejtuesit të Prokurorisë. Këtë qëndrim ka mbajtur Drejtuesi i Prokurorisë edhe në lidhje

me kërkesën konkrete të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbi praktikën e ndjekur nga ana e Drejtuesit mbi pasqyrimin e qëndrimit të tij, përkundrejt informacionit të dërguar nga ana e prokurorit të apelit që ka përfaqësuar çështjen, duke u shprehur konkretisht se: *“Në mungesë të rasteve ku ka patur mosdakordësi apo mendim ndryshe me prokurorët e seancës, nuk ka patur shkak të nxirreshin udhëzime jo detyruese”*. Lidhur me këtë, Drejtuesi i Prokurorisë, ka vijuar gjithashtu edhe me shpjegimin për mënyrën sesi e kupton edhe plotësimin e rubrikës së regjistrimit të qarkullimit të brendshëm, duke u shprehur se: *“Edhe në rast se i referohemi regjistrimit të qarkullimit të brendshëm, ai është i konceptuar në mënyrë të atillë, ku në rubrikën e qëndrimit të drejtuesit, parashikohen vetëm rastet kur drejtuesi, pasi informohet, nxjerrë udhëzimin përkatës jo të detyrueshëm, kur ka qëndrim ndryshe dhe jo rastet e dakordësisë. Për më tepër, si Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe aktet e dala në zbatim të tij, kanë si qëllim të vetëm t’i mundësojë drejtuesit të informohet dhe të reagojë ndaj qëndrimeve të prokurorëve të seancave, për rastet kur ai i konsideron jo të drejta. Nga ana e drejtuesit, në rastet kur qëndrimi është gjykuar dhe konsideruar i drejtë, rrjedhimisht nuk mund të pasohet me akt, por thjesht është administruar informacioni, duke konsideruar të mjaftueshëm faktin që ka marrë dijeni për të.”*

- Në Prokurorinë e Apelit Tiranë për periudhën e inspektimit nuk është nxjerrë asnjë udhëzim jo i detyrueshëm. Nga Drejtuesi aktual i cili përfshin pothuaj të gjithë kohën e përcaktuar për inspektim, mosnxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme ka ardhur si rrjedhojë e mungesës së qëndrimit kundër, midis tij dhe prokurorëve përfaqësues të çështjeve, duke mos paraqitur problematika të cilat do të detyronin Drejtuesin e apelit për të dalë me një udhëzim konkret. Lidhur me mënyrën e të vepruarit për të vlerësuar pikërisht nxjerrjen e udhëzimit jo detyrues, sipas Drejtuesit në rrethanat e ngarkesës së madhe të punës dhe faktit të mbulimit të kësaj ngarkese, vetëm me 3 prokurorë nga 9 të tillë, është proceduar shpesh edhe në mënyrë verbale, ku gjithmonë qëndrimi i tij ka qenë dakordësues me qëndrimin e prokurorit përfaqësues të çështjes në gjykim, dakordësi e pasqyruar në aktet e përpiluara nga prokurorët dhe të nënshkruar me dakordësi nga ai si Drejtues. Nga të dhënat e marra mbi aktet e përgatitura nga prokurorët e seancave, ku shprehet qëndrimi i këtyre të fundit i ndryshëm nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë apo dhe vetë vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rezulton se në të është vendosur nënshkrimi dakordësues i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit.
- Këtë qëndrim të tij Drejtuesi i Prokurorisë, lidhur me udhëzimet jo të detyrueshme, e mbështet edhe në atë sesi e kupton dhe interpreton udhëzimin e përgjithshëm, të Prokurorit të Përgjithshëm, objekt i këtij inspektimi, duke i fokusuar në qëllimin e informimit të Drejtuesit dhe reagimin e këtij të fundit në rast të një qëndrimi që vlerësohet prej tij si jo i drejtë.

➤ Prokuroria e Apelit Shkodër

Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Shkodër ka informuar se për periudhën kohore objekt inspektimi, në këtë prokurori kanë ushtruar funksionet vetëm 2 prokurorë nga 4 në organikë, dhe përse i përket udhëzimeve jo të detyrueshme të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe

përgjigje të mundshme të prokurorëve të çështjes në lidhje me udhëzimet jo të detyrueshme, **nuk rezulton dhe nuk evidentohen raste për të cilat ka qenë e nevojshme nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme.**

Përsa i përket udhëzimeve jo të detyrueshme në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, rezulton se edhe pse është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 50, datë 21.12.2020, i Drejtuesit të kësaj prokurorie dhe është krijuar regjistri i korrespondencës së brendshme procedurale, rezulton se nga Drejtuesi i kësaj prokurorie nuk është miratuar ndonjë udhëzim me karakter jo të detyrueshëm.

➤ **Prokuroria e Apelit Korçë**

Nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë është informuar se **nuk ka patur raste për të cilat ka qenë e nevojshme nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme.**

➤ **Prokuroria e Apelit Gjirokastrë**

Nga të dhënat e marrë nga Prokuroria e Apelit Gjirokastrë, konstatohet se për periudhën kohore të inspektimit 01.10.2020–31.03.2021, kjo prokurori që nga muaji korrik i vitit 2019 përfaqësohet nga 1 prokuror i vetëm, i cili ushtron edhe detyrën e Drejtuesit të përkohshëm pranë kësaj prokurorie. Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 18, pikat 1 dhe 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Gjirokastrë ka informuar se është njohur në kohë me Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë së prokurorit në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm”*, të ndryshuar dhe me detyrimin për zbatimin e tij. Por, duke qenë se ushtron detyrën e prokurorit i vetëm në Prokurorinë e Apelit Gjirokastrë, **detyrimi për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, nuk ka gjetur zbatim.**

➤ **Prokuroria e Apelit Durrës**

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Prokuroria e Apelit Durrës dhe sipas informacionit të Drejtuesit të kësaj prokurorie rezulton se për periudhën objekt inspektimi, **nuk ka patur çështje në të cilat Drejtuesi i Prokurorisë të ketë konstatuar nevojën për nxjerrjen e ndonjë udhëzimi jo të detyrueshëm.** Në lidhje me këtë fakt, nga Drejtuesi i Prokurorisë është shpjeguar se në kushtet kur në fund të muajit maj të vitit 2021 u plotësuan me prokurorë dy vende vakante, gjë që sjell lehtësimin e ngarkesës së Drejtuesit në angazhimin e çështjeve në gjykim, do të mbahen në fokus pikat 11 të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe pika 5 e udhëzimit nr. 1, datë 07.09.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, në lidhje me informimet nga prokurorët të çështjeve që shfaqin problematika dhe mendime ndryshe.

➤ **Prokuroria e Përgjithshme**

- **Nuk ka udhëzime jo të detyrueshme.**

3.4. Mënyra e informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë, te Prokurori i Përgjithshëm.

Kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale sipas nenit 43, germa "b" të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përfshijnë të drejtën e tij për të kërkuar informacion për ecurinë e procedimeve, të verifikojë ecurinë dhe përfundimin e çështjeve, dhe nëse është e nevojshme, të nxjerrë udhëzime me shkrim, sipas këtij ligji.

Në nenin 52, pika 2 të ligjit të mësipërm parashikohet se prokurorët kanë detyrimin të informojnë Drejtuesin e Prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me punën mbi çështje të caktuara dhe vendimmarrjen, si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit. i njëjti parashikim është përfshirë edhe në nenin 8, pika 2, shkronja "c" të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, se prokurori ka detyrimin të informojë Drejtuesin e Prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara. Në dispozitat e neneve 12 deri në 19 të këtij udhëzimi, parashikohen rastet e informimit të Drejtuesve të Prokurorisë nga prokurorët dhe të Prokurorit të Përgjithshëm nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, të cilat lidhen me:

- ecurinë dhe problemet e veprimeve të para hetimore në rastet e ngjarjeve të ndodhura përgjatë kryerjes së gatishmërisë dhe/ose mbi ecurinë e procedimit penal, përpara përfundimit të tij;
- rastet kur gjykata i kthen aktet prokurorit në lidhje me shkaqet dhe ecurinë e mëtejshme të hetimit;
- kërkesat drejtuar gjykatës të cilat nënshkruhen nga zëvendës drejtuesi i prokurorisë ose Drejtuesi i Seksionit, në mungesë të Drejtuesit të Prokurorisë, kur janë të gatshëm sipas grafikut të gatishmërisë, lidhur me arrestimet në flagrancë, ndalimet, masat e sigurimit personal dhe/ose pasuror, mjetet për kërkimin e provës, sigurimin e provës, për aktet drejtuar insitucioneve të vuajtjes së dënimit me burgim, masat mjekësore apo shërbimeve policore;
- procedimin penal ku do të nxirren urdhra ndalimi ose do t'i drejtohen gjykatës kërkesa për caktimin e masave të sigurimit arrest në burg, arrest në shtëpi, kërkesa për aplikimin e sekuastrove preventive, konservative apo për hetimin pasuror ku do të kërkohet aplikimi i masave ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr. 10192/2009;
- procedimet penale ku janë vendosur masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, apo është aplikuar sekuastroja preventive, konservative, apo për hetime pasurore ku janë aplikuar masa ndaj pasurisë në kuadër të ligjit nr. 10192/2009, për gjendjen e procedimit penal apo hetimit pasuror;

- ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror 20 (njëzet) ditë përpara se prokurorët të vendosin përfundimin e hetimeve, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore në një procedim penal apo të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin në çdo hetim pasuror, në të cilin Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme ose u është kërkuar sa më sipër prej tij, në momentin e regjistrimit të procedimit penal apo hetimit pasuror për shkak të rëndësisë së tij;
- kur gjykata nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me deklarinimin e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit nr. 10192/2009, në lidhje me vendimin dhe nëse do të ushtrojë apelim;
- rastet kur pas ushtrimit të apelit nga prokurori janë zbuluar prova ose rrethana të reja që i shërbejnë rigjykit të çështjes së ankimuar, dhe sipas rastit të përgatisë shtesë ankimin;
- në mungesë të Drejtuesit të Prokurorisë, prokurori është i detyruar t'i përgjigjet kërkesave për informacion të zëvendës drejtuesit të parashikuara në nenet 12, 13, 14 dhe 15 të udhëzimit të përgjithshëm;
- informimin e Drejtuesit të Seksionit brenda kompetencave që i janë caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë, në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi, në rastet kur i janë deleguar kompetencat për informimin nga ky i fundit;
- informimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit nga prokurori që përfaqëson çështjen ose akuzën në gjykatën e apelit ndaj të pandehurit me masë sigurimi "arrest në burg", jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara përfundimit të afateve të paraburgimit;
- rastet kur gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, në lidhje me vendimin dhe nëse do të ushtrojë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit.
- informimin e Prokurorit të Përgjithshëm nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, në lidhje me natyrën dhe problematikën e çështjeve që shqyrtohen në Gjykatën e Lartë ose Gjykatën Kushtetuese me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm dhe për shkeljet e ligjit penal dhe/ose ligjit procedural penal në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq të evidentuara në përfaqësimin e çështjeve nga prokurorët e prokurorive të shkallës së parë dhe të prokurorive të apeleve me juridiksion të përgjithshëm.

Sipas ligjit dhe Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, informimi është detyrim i prokurorit mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë, por në raste të caktuara edhe paraprakisht pa u kërkuar nga Drejtuesi.

- Në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para:

Informimi pa kërkesë të Drejtuesit të Prokurorisë bëhet në rastet kur:

- prokurori do të nxjerrë urdhër ndalimi ose do të kërkojë në gjykatë masa të sigurimit personal "arrest në burg", "arrest në shtëpi", masa të sigurimit pasuror "sequestro preventive", "sequestro konservative", apo në një hetim pasuror ku do të kërkojë masa në kuadër të ligjit nr. 10192/2009, ai informon paraprakisht Drejtuesin, me qëllim që t'i mundësojnë këtij të fundit ushtrimin e kompetencës për të nxjerrë udhëzim jo të

detyrueshëm në këto procedime penale. Në këtë rast udhëzimi jo i detyrueshëm **mund** të nxirret brenda 1 (një) dite nga informacioni, pra, para se prokurori ta ketë paraqitur urdhrin e ndalimit apo kërkesën për masë para Drejtuesit. *(Udhëzimi mund të parashikonte si përjashtim në rastet e emergjencës për të ndaluar një person apo për të marrë dhe ekzekutuar një masë sigurimi, që nuk lejon informimin dhe pritjen e nxjerrjes së udhëzimit jo të detyrueshëm nga drejtuesi);*

- prokurori ka ushtruar apel kundër vendimit të gjykatës dhe kur pas shqyrtimit gjyqësor kanë dalë prova ose rrethana të reja që i shërbejnë rigjykimit të çështjes së ankimuar, ai duhet të njoftojë Drejtuesin e Prokurorisë dhe sipas rastit të përgatisë shtesë ankimi, si dhe të njoftojë prokurorin dhe/ose Drejtuesin e Prokurorisë pranë gjykatës që shqyrtohet ankimi.

Informimi bëhet vetëm mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë në rastet kur:

- në çështjet që janë vendosur masat e mësipërme ai ka të drejtë t'i kërkojë prokurorit të çështjes që ta informojë paraprakisht, por jo më vonë se 1 (një) muaj para se të përfundojnë afatet e paraburgimit në lidhje me veprimet hetimore të kryera, provat e administruara, gjendjen e procedimit penal apo hetimit e gjykimit pasuror, pyetjen e të pandehurit ose të personit nën hetim dhe personave të tjerë, si dhe përshkrimin e të dhënave të marra. Udhëzimi jo i detyrueshëm **mund** nxirret brenda 3 (tre) ditëve nga informacioni;

- për ecurinë e procedimit penal apo hetimit pasuror, kur Drejtuesi më parë ka dhënë udhëzim jo të detyrueshëm apo e ka kërkuar që në momentin e caktimit të çështjes, informacioni i cili duhet t'i paraqitet jo më vonë se 20 (njëzet) ditë para se prokurorët të vendosin përfundimin e hetimeve paraprake, shpalljen e moskompetencës lëndore apo tokësore apo para se të kërkojnë konfiskimin ose vendosin pushimin në çdo hetim pasuror për shkak të rëndësisë së tij. Udhëzimi jo i detyrueshëm **mund** të nxirret jo më vonë se tre (3) ditë nga marrja e informacionit;

- vendimet e gjykatës nuk kanë pranuar kërkesat e prokurorit në lidhje me deklarimin e fajësisë, cilësimin juridik të veprës, llojin e dënimit dhe konfiskimin në bazë të nenit 36 të Kodit Penal ose ligjit nr. 10192/2009, prokurori informon Drejtuesin e prokurorisë brenda 3 (tre) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do ushtrojë ankim kundër vendimit;

- mbi ecurinë dhe problemet e veprimeve të para hetimore në rastet e ngjarjeve të ndodhura përgjatë kryerjes së gadishmërisë;

- në rastet e kthimit të akteve nga gjykata, prokurori duhet të informojë Drejtuesin për shkaqet e kthimit dhe ecurinë e veprimeve hetimore të caktuara nga gjykata, brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa e Drejtuesit.

o Në Prokuroritë e Apelit prokurorët informojnë Drejtuesin e Prokurorisë së Apelit me kërkesë të këtij të fundit, për rastet kur:

- Gjykata e apelit që nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit;

- për çështjet me të pandehur me masë sigurimi "arrest në burg", prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë të paktën 10 (dhjetë) ditë para përfundimit të afateve të paraburgimit në gjykimin në apel.

Informimi nga prokurorët e apelit bëhet pa kërkesë të Drejtuesit të Prokurorisë së apelit në rastin kur pas ushtrimit të rekursit kundër vendimit të gjykatës, prokurori i apelit merr dijeni kryesisht ose nga prokurori i shkallës së parë për rrethana të reja, i cili duhet të njoftojë Drejtuesin e Prokurorisë së apelit dhe sipas rastit mund të përgatisë shtesë rekursi, si dhe njofton prokurorin dhe/ose Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë (prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme që përfaqëson çështjen në Gjykatë të Lartë ose Prokurorin e Përgjithshëm).

Në lidhje me informimin e Prokurorit të Përgjithshëm, neni 38, pika 2, shkronja "f" të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, parashikon: "2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: f) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore e kushtetuese të prokurorisë".

Në raportet midis Drejtuesve në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në nenin 42, shkronja l) të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, midis kompetencave të drejtuesit në drejtimin e prokurorisë, parashikohet se: "Drejtuesi i prokurorisë informon çdo 3 (tre) muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit".

Në nenin 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, parashikohet se: "1. Prokurori i Përgjithshëm mund të marrë periodikisht të dhëna dhe informacione nga prokuroritë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre. 2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm përgatisin, brenda muajit shkurt të çdo viti, Raportin Vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës dhe ia paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm. Raporti publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme".

Po këto dispozita të ligjit gjenden në nenin 10, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, lidhur me informimin periodik, ku parashikohet se: "Drejtuesit e prokurorive, informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose ecurinë e veprimtarisë së prokurorisë që ata drejtojnë, si dhe përgatisin dhe dërgojnë Raportin Vjetor në formën dhe sipas treguesve të përcaktuar, raport i cili miratohet me urdhër të tij".

Në referim të neneve 42, 43 dhe 50 e 52 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe zbatim të neneve 8, pika 2, shkronja "c" dhe 10, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, në marrëdhëniet ndërmjet prokurorit dhe Drejtuesve në prokurori, midis këtyre dhe Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me mënyrën e informimit/raportimit, për periudhën e inspektimit rezulton se:



➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë**

• **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Lidhur me këtë lloj akti, nga të dhënat e sjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se për periudhën e inspektimit evidentohen 2 (dy) kërkesa. Në fakt një kërkesë daton para datës së periudhës së inspektimit, por duke qenë se afati i përcaktuar nga prokurorët për dërgimin e informacionin ishte deri në datën 05.10.2020, vlerësohet që të trajtohet si akt brenda periudhës së inspektimit. Më konkretisht bëhet fjalë për kërkesën për informacion të Drejtuesit të Prokurorisë për të gjithë prokurorët, me nr. 11550 prot., dhe në vijim, datë 21.09.2020, të cilat i janë drejtuar në veçanti secilit prej prokurorëve.

Te kërkesa për informacion është vendosur si bazë ligjore neni 43, shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në vijim është vendosur qëllimi dhe objektivi që kërkohet të arrihet. Gjithashtu vihet re se përpara nxjerrjes së aktit në fjalë, Drejtuesi i Prokurorisë është treguar i kujdesshëm për të evidentuar edhe faktin se referuar prokurorit konkret, nga ana e tij paraprakisht është marrë informacioni lidhur me ngarkesën e tij, te zyra e regjistrimit.

Kërkesat për informacion kanë qenë për çështjet në hetim për një periudhë kohore mbi 6 muaj, duke kërkuar nga prokurorët evidentimin për çdo procedim të tillë të faktit penal, datën e regjistrimit të emrit që i atribuohet vepra penale nëse ka, datën e caktimit të masës së sigurimit nëse ka, ecurinë e hetimeve, urdhrat për kryerjen e veprimeve hetimore të prokurorit dhe kontrolli në vazhdimësi, oficeri i ngarkuar për kryerjen e veprimeve hetimore dhe nëse janë kryer këto veprime, shkak i mospërfundimit të veprimeve hetimore, çfarë pritet për përfundimin dhe konkludimin me vendimmarrje.

Për këto kërkesa rezulton se në pjesën e dispozitivit është urdhëruar kryesekretaria për të njoftuar të gjithë prokurorët kundrejt nënshkrimit, si dhe afati përkatës brenda të cilës duhet të jepet informacioni nga prokurorët. Për sa është urdhëruar më sipër, rezulton se për kërkesën për informacion nuk disponohet dokumentacion mbi mënyrën e dorëzimit tek prokurorët, ndërsa rezulton se ka të dhëna nga sekretaria, lidhur me kthimin e përgjigjes për kërkesat në fjalë, në datën 06.10.2020 ora 13:00.

Pavarësisht mënyrës, nga të dhënat e sjella nga zyra e prokurorisë konstatohet se për kërkesat sa më sipër të Drejtuesit të Prokurorisë, janë paraqitur informacione nga ana e disa prokurorëve. Më konkretisht nga 57 kërkesat e Drejtuesit të Prokurorisë drejtuar prokurorëve, janë përgjigjur me informacion brenda afatit të kërkuar 34 prokurorë.

Gjithashtu përveç sa më sipër, nga të dhënat e sjella nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është proceduar edhe me kërkesa të mëparshme për informacion nga prokurorët, të cilat rezultojnë me nr. 01 prot., në vijim datë 15.05.2019; nr. 776 prot., datë 10.02.2020; nr. 12811 prot., në vijim datë 05.10.2021.

Nga të dhënat e regjistrimit përkatës, të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës, rezultojnë edhe një informacion i një prokurori të datës 10.11.2020 për Drejtuesin e Prokurorisë, për të cilën është marrë përgjigje përkundrejt nënshkrimit të Drejtuesit në datën 23.11.2020. Një informacion i tillë nuk është evidentuar në dokumentacionin e sjellë nga Zyra e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në funksion të këtij inspektimi.

Lidhur me kërkimin e informacioneve nga Drejtuesi i Prokurorisë Tiranë, sipas raportit të Drejtuesit të Prokurorisë për punën e kësaj prokurorie për vitin 2021, evidentohet parashtrimi i faktit se janë kërkuar në mënyrë periodike informacione. Më konkretisht Drejtuesi i Prokurorisë shprehet se: *"Nga ana e drejtuesit të prokurorisë është kërkuar në mënyrë periodike informacion lidhur me ngarkesën e secilit prokuror, me ecurinë e çështjeve që lidhen me vepra penale prioritare të rekomanduara. Informacione periodike janë kërkuar edhe për ngarkesën e punës së oficerëve të policisë gjyqësore"*.

• **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Nga të dhënat e marra nga faqja zyrtare e Prokurorit të Përgjithshëm, rezultojnë se referuar detyrimit në bazë të ligjit nr. 97/2016 i ndryshuar, neni 50 dhe udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, objekt i këtij inspektimi, neni 10, pika 3, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Tiranë është bërë edhe raportimi vjetor për vitin 2020. Ky raportim vjetor rezultojnë të jetë dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën me nr. Extra prot., datë 25.05.2021.

Në këtë raport, nga Drejtuesi i Prokurorisë Tiranë janë evidentuar një sërë problematikash lidhur me informacionet/raportimin që duhet t'i dërgohet Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu më konkretisht, Drejtuesi i Prokurorisë shprehet se:

"... Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, referuar ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, udhëzimeve të drejtuesit të prokurorisë, në punën e përditshme gjatë vitit 2020, janë konstatuar edhe problematika të ndryshme:

Konstatohet se jo në çdo rast, zbatohen nga prokurorët e kësaj prokurorie udhëzimet dhe kryesisht ato udhëzime, që në pjesën dërrmuese nuk janë zbatuar kanë të bëjnë pikërisht me raportimin e të dhënave statistikore. Kjo vjen edhe si pasojë e ngarkesës në punën e tyre, në ushtrim të funksioneve sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kushtetutës. Për këtë arsye, në këtë raportim jemi munduar të pasqyrojmë në mënyrë më të plotë të gjitha të dhënat e grumbulluara pas një konsultimi me të gjithë prokurorët.

Gjithashtu përsa i përket të dhënave statistikore që raportohen në Prokurorinë e Përgjithshme është e nevojshme që të rishihen dhe përmirësohen tabelat statistikore, me qëllim që në to të gjejnë pasqyrimet e ndryshimeve të ndodhura".

Nuk ka të dhëna të tjera lidhur me raportimin 3 (tre) mujor sipas parashikimit të nenit 42, shkronja "I" të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në



Republikën e Shqipërisë”,⁴⁷ i ndryshuar. Nga dokumentacioni i sjellë nga zyra e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në funksion të inspektimit, dhe shkresat përkatëse shoqëruese nuk përcaktohet konkretisht nëse ka të dhëna lidhur me raportimin 3 (tre) mujor si për periudhën e inspektimit dhe jashtë periudhës së inspektimit.

Lidhur me regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, konstatohet ekzistenca e një regjistri të tillë. Mbatja e regjistrit përkatës të korrespondencës së brendshme, është normuar nga Drejtuesi i Prokurorisë me udhëzimin e përgjithshëm me nr. 26, datë 30.07.2020 “Mbi marrëdhëniet në prokurori dhe mënyrën e informimit të drejtuesit të prokurorisë” dhe me urdhrin e veçantë nr. 5311, datë 11.09.2020 “Për krijimin e regjistrit të brendshëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, ku është ngarkuar edhe personi përgjegjës për përgatitjen dhe printimin përkatës, dhe duke i lënë një afat kohor përkatës. Referuar udhëzimit të Drejtuesit të Prokurorisë, aktet përkatëse që do të gjenin pasqyrim në udhëzim janë komunikimet e brendshme mes Drejtuesit dhe prokurorëve, duke përfshirë: a) kërkesa për informacion nga Drejtuesi, kthimpërgjigjen nga prokurori, udhëzimet jo detyruese të nxjerra, komunikimet vijuese prokuror-Drejtues mbi çështje të caktuara. b) shkresat për firmë nga Drejtuesi mbi aktet apo materialet që i drejtohen gjykatës. c) shkresat për firmë nga Drejtuesi mbi aktet apo materialet bashkëlidhur që lidhen me pezullimin e procedimit, shpalljen e moskompetencës, vendimet e mosfillimit.

Nga leximi i regjistrit të vënë në dispozicion, konstatohet se nuk janë reflektuar të gjitha zërat sipas modelit përkatës në drejtim të plotësimit të të dhënave sipas emërtimit përkatës të kolonës. Më konkretisht konstatohet se regjistri ka 27 kolona dhe në këtë regjistër janë të plotësuar vetëm kolonat me numër 7 “nr. procedimit tek rubrika”, nr. 24 “data/ora” te rubrika “Korrespondenca për të tretët/kalimi i akteve nga prokurori për firmë tek drejtuesi”; nr. 26 “datë/ora”; tek rubrika “Korrespondenca për të tretët/kalimi i akteve të firmosura te prokurori” dhe nr. 27 te rubrika “Nënshkrimi i marrësit (data/ora, emër, mbiemër)”. Plotësimi i këtyre kolonave rezulton të mos jetë bërë plotësisht sipas emërtimit. Kështu tek kolona nr. 7 ku është vendosur numri i procedimit penal rezulton të jetë bërë sipas emërtimit, te kolona nr. 24 ku është vendosur emri i prokurorit^[48] rezulton të mos jetë bërë sipas emërtimit datë/orë, tek kolona nr. 26 ku është vendosur data rezulton të jetë pjesërisht sipas emërtimit pasi mungon ora e kalimit të akteve, dhe tek kolona nr. 27, ku është vendosur firma nuk rezulton të jetë plotësisht sipas emërtimit duke qenë se kërkon datën/orën, emrin e mbiemrin. Gjithashtu konstatohet se në këtë regjistër është pasqyruar kryesisht lënda përkatëse e aktit të regjistruar nga prokurori, si edhe në disa raste e shoqëruar me veprën penale, por e shkruar në disa kolona që referuar të dhënave të përgjithshme të sjellë nga zyra e prokurorisë, duket se nuk i përkasin emërtimit të zërit. Kështu sipas lëndës së pasqyruar

⁴⁷ Është kërkuar informacion konkretisht për këtë por nuk ka një përgjigje.

⁴⁸ Vetëm në dy fletë regjistri emri i prokurorit është vendosur tek kolona nr. 25. Më konkretisht e para në regjistrin e vitit 2020, me nr. 52 fletë sipas numërtimit të zyrës që e ka dërguar, që fillon në datën 06.11.2020 dhe përfundon më datë 19.11.2020, të gjitha rreshtat; dhe me nr. 170 fletë sipas numërtimit të zyrës që e ka dërguar, që fillon me datën 22.02.2021 dhe e fundit në rresht mban datën 12.01.2021, të gjitha rreshtat. Si dhe pjesërisht në një fletë regjistri tek kolona nr. 25, me nr. 86 të fletës sipas numërtimit të zyrës që e ka dërguar, dhe bëhet fjalë për emrat e dy prokurorëve në dy rreshtat e para.

rezulton se aktet që kanë gjetur pasqyrim janë kryesisht kërkesat përkatëse të prokurorëve për masë sigurimi, kërkesa për pushim procedimi, gjyq, të cilat rezultojnë të shkruara në pjesën e rubrikës “Udhëzime jo të detyrueshme të Drejtuesit të Prokurorisë ose Seksionit”. Dhe si të tilla, duket që shkrimi i këtyre të dhënave pasqyron të dhënat mbi shkresat shoqëruese të akteve/materialeve që i drejtohen gjykatës, të cilat do duhet të ishin shkruar tek kolona nr. 25.

Vetëm në një rast evidentohet se është regjistruar akti “dhënia e informacionit nga prokurori” në rubrikën “informacionet” kolona nr. 22, që i përket datës 10.11.2020 dhe prokurorit përkatës, për të cilën rezulton data korresponduese 23.11.2020 i kalimit të akteve të firmosura tek prokurori.

Datat përkatëse të cilat reflektohen sipas përshkrimit sa më sipër në kolonën nr. 26, fillojnë nga data 01.10.2020 deri në 31.03.2021. Kjo datë, ashtu sikurse e përmendëm më sipër tek vendi në rubrikën e regjistrimit, pasqyron datën e kalimit të akteve tek prokurori pas nënshkrimit nga Drejtuesi. Ndërkohë që lidhur me datën e dorëzimit të aktit nga prokurori për t’u firmosur tek Drejtuesi sipas rubrikës që përkon në kolonën 24, rezulton në mungesë pasqyrimi për vitin 2020 dhe në vitin 2021 është evidentuar në disa raste (73 çështje) data në këtë rubrikë, por nën emërtimin “lënda”, kolona nr. 25 dhe që gjithsesi nuk ka vijimësi datë në kolonën pasardhëse me nr. 26. Gjithashtu për të theksuar është se edhe në këto raste të fundit të evidentimit të datës së kalimit të akteve nga prokurori për firmë tek Drejtuesi, që i përkasin regjistrimit të periudhës së vitit 2021, evidentohet se këto data i përkasin në shumë raste vitit 2020, çka krijon konfuzion në mënyrën e leximit.

Për mënyrën e plotësimit të regjistrimit, konstatohet se ka një shënim të vendosur poshtë formatit në formën e udhëzimit (modeli i ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme) “Në evidentimin e një praktike shkruhet numri i plotë që merr dokumenti në regjistrin e protokollit. Nën numrin e plotë shkruhen fraksionet e numrit të plotë që marrin të gjitha dokumentet e një praktike deri në mbylljen e saj. Poshtë numrit të plotë rezervohen rreshta për të regjistruar dokumentet me fraksion të praktikës së dhënë. Praktikant midis tyre ndahen nga njëra-tjetra me vijë të trashë. Kur lind nevoja, praktika mund të transformohet në një faqe tjetër të regjistrimit, duke vënë shënimin: “kalon në faqen...””.

- Për sa më sipër, lidhur me mënyrën e informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm, konstatohet se për sa rezulton nga të dhënat e sjella, në Zyrën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është proceduar me informacion nga prokurorët e çështjeve drejtuar Drejtuesit të zyrës, si dhe me informacion nga ky i fundit drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.
- Informacioni nga prokurorët është paraqitur pas kërkesës me shkrim të Drejtuesit të Prokurorisë, i cili ka përcaktuar arsyen përkatëse dhe kohën e përmbushjes së kësaj kërkesë. Kërkesat kanë qenë të fokusuar në drejtim të marrjes së informacionit lidhur me procedimet penale për të cilat hetimet kanë zgjatur mbi 6 muaj. Këto kërkesa, janë të mbështetura plotësisht në nenin 43, shkronja “b” dhe neni 50, pika 2 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, ku janë parashikuar kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë në

funksion të ushtrimit të kompetencave të tij si Drejtues si në aspektin procedural dhe atë administrativ. Nëpërmjet kërkesave lidhur me ecurinë e hetimeve për këtë kategori çështjesh, Drejtuesi i Prokurorisë me marrjen e informacionit përkatës, do të jetë në gjendje të vlerësojë veprimtarinë e prokurorit të çështjes në drejtim të ecurive të procedimeve penale, problematikat e hasura si në drejtim të respektimit të afateve procedurale nga njëra anë, por edhe respektimit të të drejtave të subjekteve procedurale të një procedimi penal, për t'u vijuar më tej me mundësinë e nxjerrjes së udhëzimeve qoftë të përgjithshme procedurale dhe administrative të cilat janë të detyrueshme, ashtu edhe për çështje konkrete jo të detyrueshme.

- Për periudhën objekt inspektimi rezulton se ka informacione të paraqitura nga prokurorët, në përgjigje të kërkesës së Drejtuesit, e cila daton para periudhës së inspektimit. Kërkesa për informacion ka qenë e drejtuar për secilin prokuror të zyrës së prokurorisë dhe rezulton se më pak se gjysma e prokurorëve është përgjigjur.
- Kërkesa për informacion me të njëjtin fokus, ka patur nga Drejtuesi edhe për periudhat para dhe pas inspektimit, për të cilat është vërejtur moskthim përgjigje nga prokurorët të cilëve iu është drejtuar. Nga të dhënat përkatëse referuar shkresave të zyrës së prokurorisë, rezulton se për një kërkesë të Drejtuesit për vitin 2019, nuk janë sjellë të dhëna mbi përgjigje të prokurorëve, ndërsa për tjetrën të vitit 2021, janë sjellë vetëm 3 përgjigje nga 20 që duhet të ishin.
- Në përfundim lidhur me këto kërkesa për informacion, konkludohet se nuk ka një zbatim të duhur nga ana e prokurorëve të çështjes, të detyrimit ligjor për dhënien e informacionit Drejtuesit të Prokurorisë në kohë dhe sa herë kërkohet prej tij.
- Gjithashtu konstatohet se kërkesat në fjalë nuk gjejnë pasqyrim në regjistrin e korrespondencës së brendshme referuar parashikimit përkatës në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, neni 20, si edhe vetë udhëzimit të përgjithshëm të nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me nr. 26, datë 30.07.2020.
- Rregjistri në fjalë rezulton i krijuar referuar parashikimeve të udhëzimeve të përgjithshme të sipërpërmendur, por nuk gjenden të pasqyruara kërkesat për informacion dhe të gjitha përgjigjet përkatëse të prokurorëve, të cilat rezultojnë se janë përpiluar si akte. Kështu vetëm në një rast është evidentuar regjistrimi i dhënies së informacionit nga prokurori përkatës, që mban datën 10.11.2020 (për procedimin penal me nr. 7166/1/2020).
- Në drejtim të mbajtjes së regjistrit, vlen të theksohet gjithashtu se nuk është mbajtur në mënyrën e duhur në drejtim të pasqyrit të të dhënave sipas zërave. Ashtu siç është evidentuar edhe më sipër gjatë pasqyrit të hedhjes së të dhënave të regjistrit në fjalë, në të nuk lexohen qartë të dhënat lidhur me llojin e komunikimit-udhëzim jo i detyrueshëm, informacionet apo korrespondenca me të tretët, kohën e dorëzimit nga ana e prokurorit dhe kohën e daljes nga Drejtuesi i Prokurorisë.
- Për sa i përket raportimit të Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm, konstatohet se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është dërguar te Prokurori i Përgjithshëm, Raporti Vjetor i punës për vitin 2020, si një detyrim i parashikuar në nenin 50, pika 2 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar. Ky detyrim, referuar shkresës me

nr. Ekstra prot., datë 24.05.2021 me anë të të cilës është dorëzuar raporti, rezulton i përbushur në tejkalim të periudhës së parashikuar në këtë dispozitë.

- Nuk ka të dhëna të evidentuara referuar dokumentacionit të sjellë nga zyra e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me raportimin 3 (tre) mujor mbi gjendjen e kriminalitetit, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, që brenda periudhës së inspektimit i përkasin dy të tilla në muajt dhjetor 2020 dhe mars 2021.
- Konstatohet se lidhur me këto raportime, në raportin vjetor të punës për vitin 2020, Drejtuesi i Prokurorisë paraqet si problem mbledhjen e të dhënave nga ana e prokurorëve.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës**

- **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, pasi është njohur me ngarkesën e procedimeve penale në hetim nga ana e prokurorëve ka përpiluar "Kërkesën për informacion" datë 22.09.2020, lidhur me procedimet penale të mbartura në hetim nga vitet e tjera dhe nga viti 2018, apo me persona të arrestuar mbi tre muaj në hetim, duke kërkuar: - të dhëna mbi datën e regjistrimit dhe veprën penale për të cilën hetohet; - një përshkrim të shkurtër të faktit; - veprimet hetimore të urdhëruara dhe të kryera në këto procedime penale; - çfarë veprimesh hetimore pritet të kryhen për përfundimin e hetimeve dhe cila është perspektiva e mundshme në kohë për përfundimin e tyre.

Kërkesa mbështetet në dispozitat ligjore të neneve 43, germat "b", "c", "ç" dhe 52/2 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Sipas kërkesës, informacioni i kërkuar duhet t'i vendoset në dispozicion Drejtuesit deri në datën 02.10.2020 dhe pas marrjes së informacioneve, drejtuesi dhe Drejtuesit e Seksioneve, të nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme për procedimet penale që paraqesin problematika. Kërkesa nuk paraqet numër protokolli sipas regjistrimit të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, fleta e të cilit nuk është vendosur në dispozicion për të konstatuar pasqyrimin e saj aty dhe të prokurorëve, të cilët kanë marrë dijeni në datën përkatëse. Referuar Raportit Vjetor për vitin 2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, kërkesa duhet t'u jetë drejtuar të 24 prokurorëve që gjatë vitit 2020, ka patur në organikën e saj kjo prokurori, ku përfshihen një Drejtues, një zëvendës drejtues dhe njëzet e dy prokurorë sektori. Në lidhje me këto kërkesa rezulton se është paraqitur vetëm përgjigjja e një (1) prokurori, i cili ka përgatitur informacionin e kërkuar në datën 02.10.2020 për procedimet penale të mbartura në hetim duke ia ka dërguar Drejtuesit të Prokurorisë nëpërmjet emailit zyrtar, përveç prokurorëve që mund të mos kenë patur procedime të mbartura dhe me të arrestuar mbi tre muaj.



Nga informacioni i Drejtuesit të Prokurorisë Durrës rezulton se duke parë situatën e pazakontë, ku gjatë gjithë kësaj periudhe prokurorët dhe stafi prekej vazhdimisht nga COVID-19, ushtrimi i kompetencave ka qënë në përputhje me kushtet e krijuara dhe se informacioni i është referuar në vazhdimësi, në mënyrë verbale nga prokurorët e tjerë.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është përpiluar një "Kërkesë për informacion" në datën 01.10.2020 për procedimin penal nr. 1466/2019, regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 85, 199/a 248, 186 të Kodit Penal, çështja e tërmetit. Kërkesa ka si bazë ligjore nenin 42, germa "gj", nenin 43, germa "b" dhe "ç" e vijues të ligjit nr. 97/2016, të ndryshuar, si dhe nenet 24, 25 e vijues të K. Pr. Penale me objekt të saj kërkimin e informacionit për të verifikuar ecurinë e hetimeve, meqenëse është një nga prioritetet e punës së prokurorisë për vitin 2020, në lidhje me faktin penal që hetohet, urdhrat e delegimit të veprimeve hetimore nga prokurorët dhe kontrolli i tyre në vijëmësi, kryerja e detyrave të lëna nga oficerët e policisë gjyqësore, kohëzgjatja e hetimit dhe arsyet e zgjatjes, veprimet që kanë mbetur pa kryer. Kërkesa nuk paraqet numër protokollit sipas regjistrimit të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, fleta e të cilit nuk është vendosur në dispozicion për të konstatuar pasqyrimin e saj aty dhe të prokurorëve, të cilët kanë marrë dijeni në datën përkatëse. Prokurorëve u kërkohet të përgatisin informacionin për Drejtuesin deri në datën 15.10.2020. Nga tre prokurorët e ngarkuar me hetimin e çështjes në datën 10.11.2020 është dërguar me email, në funksion të informacionit për Drejtuesin, kërkesa për gjykim e këtij procedimi penal.

Po kështu sipas Drejtuesit të Prokurorisë mbi bazën e informacionit të kërkuar për përgatitjen e analizës 9 mujore dhe vjetore në lidhje me zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, është kërkuar sipas emailit të datës 07.10.2020 informacion lidhur me çështjet e suksesshme brenda datës 10.10.2020, ku nga një prokuror është përcjellë informacion në datat 07-08.10.2020. Nga ana e Drejtuesit të Seksionit janë sjellë të dhënat e kërkuara me anë të email-it zyrtar, ku në lidhje me këtë kërkesë është përgatitur informacion nga dy prokurorë, i cili i është përcjellë Drejtuesit të Prokurorisë nëpërmjet emailit në datën 13.10.2020.

Bazuar në nenin 16 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, me urdhrin nr. 86, datë 02.12.2020 për delegimin e kompetencave dhe firmës për shkak të infektimit nga virusi COVID 19, nga Drejtuesi i Prokurorisë i janë deleguar kompetencat Zv/Drejtuesit të Prokurorisë, për të ushtruar me përgjegjësi detyrat dhe kompetencat e Drejtuesit të Prokurorisë, përcaktuar në nenin 42 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurës Penale, deri në datën 12.12.2020.

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3^[49] të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, sa i përket detyrimit për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, rezulton se është përgatitur Raporti Vjetor, ku pasqyrohen të dhënat e kërkuara sipas drejtimeve të përcaktuara në këtë shkresë. Rraporti i është dërguar Prokurorit të Përgjithshëm, me shkresën nr. 378, datë 12.03.2021 (verifikuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme), ndërsa elektronikisht raporti është dërguar në datën 02.03.2021 sipas emailit zyrtar të vendosur në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Gjatë periudhës së inspektimit rezultojnë edhe informacione të përgatitura nga Drejtuesi i Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm si ai i kërkuar me shkresën nr. 968/5, datë 02.10.2020 ku "Kërkohet informacion mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020" për 9 mujorin e 2020. Prokurori i Përgjithshëm në përgjigje të kësaj shkrese është informuar në mënyrë të detajuar me shkresën nr. ska, datë 19.10.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Durrës, në lidhje me zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në Luftën kundër Kriminalitetit për vitin 2020, sipas pikave të kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me veprat penale kryesisht të shpërdorimit të detyrës, pastrimit të produkteve të veprës penale, trafikimit, hetimit pasuror apo çdo vepre penale me rëndësi. Sipas informacionit të Drejtuesit janë zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 11/2020, e plani i veprimit të miratuar me urdhrin nr. 112/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm në zbatim të këtyre rekomandimeve, lidhur me organizimin e një mbledhjeje të përgjithshme të prokurorëve të cilët janë njohur me rekomandimet prioritare, si dhe pas diskutimeve është nxjerrë një plan veprimi me nr. 79, datë 23.09.2020 për të siguruar zbatimin e Rekomandimeve Prioritare. Gjatë 9 mujorit rezulton se në zbatim të udhëzimit nr. 10/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, është nxjerrë urdhri nr. 6, datë 30.07.2020 për organizimin e brendshëm duke krijuar katër seksione në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Kërkesës për informacion të Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me kërkesat e Rezolutës së Kuvendit dhe planit të veprimit, rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, i ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. ska, datë 21.10.2020 dhe emailit zyrtar në datën 22.10.2020. Prokurori i Përgjithshëm është informuar se në përgjigje të shkresës nr. 943/6, datë 05/10/2020, në lidhje me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020, janë zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 5/2018 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj të miratuar me urdhrin nr.103, datë 17.07.2020.

Gjithashtu, me shkresën nr. 68, datë 14.01.2021 në kuadrin e përgatitjes së Raportit Vjetor, Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar informacion nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së para dhe të apelit, për sa i përket kërkesave të Rezolutës së

⁴⁹ "Drejtesit e prokurorëve, informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm me të dhëna të sakta mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose për ecurinë e veprimtarisë në prokuroritë që drejtojnë, si dhe përgatisin e dergojnë raportin vjetor në formën dhe sipas treguesve të përcaktuar, raport i cili miratohet me urdhër të tij."

Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të prokurorisë për vitin 2019”, datë 18.06.2019. Mbi bazën e shkresës nr. 68, datë 14.01.2021, mbi paraqitjen e Raportit Vjetor 2020 nga prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe të apeleve, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë udhëzimi nr. 3, datë 19.02.2021, me qëllim përgatitjen e të dhënave statistikore nga zyra e regjistrit dhe sekretarja e statistikave.

Nuk ka të dhëna të tjera lidhur me raportimin 3 mujor sipas parashikimit të nenit 42, shkronja “l” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,^[50] i ndryshuar. Nga dokumentacioni i sjellë nga Zyra e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës në funksion të inspektimit, dhe shkresat përkatëse shoqëruese nuk përcaktohet konkretisht nëse ka të dhëna lidhur me raportimin 3 mujor për periudhën e inspektimit.

- Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezultojnë se është kërkuar informacion lidhur me procedime penale të mbartura, apo me persona të arrestuar mbi tre muaj në hetim, me synim verifikimin e ecures dhe përfundimit të çështjeve të mbartura, rritjen e cilësisë dhe shpejtësisë së hetimit të çështjeve penale.
- Lidhur me mënyrën e informimit të Drejtuesit të Prokurorisë nga prokurori, konstatohet se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, me bërjen e 26 (njëzet e gjashtë) kërkesave të Drejtuesit të Prokurorisë, nga të cilat 24 (njëzet e katër) me karakter të përgjithshëm për procedimet penale në tërësi të secilit prokuror, 1 (një) kërkesë në veçanti për një procedim të caktuar për shkak të rëndësisë së tij dhe 1 (një) kërkesë në lidhje me zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020.
- Në lidhje me këto kërkesa/informacione vlerësohet se si aktet e Drejtuesit dhe përgjigjet e prokurorit duhet të jenë konform neneve 8, pika 2, shkronja “c” dhe 14, pika 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, të pasqyruara në regjistrin e komunikimeve të brendshme, për të garantuar transparencën e marrëdhënieve midis Drejtuesit dhe prokurorëve dhe të drejtat e detyrimit që lindin nga ligji nr. 97/2016, i ndryshuar dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij.
- Gjithashtu, nuk vihen re raste të tjera kërkesash të Drejtuesit të Prokurorisë që përfshihen në kreun IV të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, në lidhje me ecurinë dhe problematika në kryerjen e veprimeve të para hetimore për ngjarjet gjatë gadishmërisë, për rastet e kthimit të akteve nga gjykata, në lidhje me informimin për përfaqësimin e akuzës në gjyq, mbi ecurinë e ndjekjes penale apo hetimit pasuror pasi Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për këto procedime, dhe përveç një rasti, kërkesa të Drejtuesit në momentin e regjistrimit të procedimit penal dhe gjatë ecures së hetimit për çështje që vlerësohen me rëndësi apo në procedimet penale me masa sigurimi personal të parashikuara nga nenet 238, 237 dhe pasuror.
- Lidhur me kërkesat për informim, konstatohet se kryesisht ka një zbatim të duhur nga ana e prokurorëve të çështjes, të detyrimit ligjor për dhënien e informacionit Drejtuesit

⁵⁰ Është kërkuar informacion konkretisht për këtë por nuk ka një përgjigje.



të Prokurorisë sa herë kërkohet prej tij dhe në afatin e caktuar, por nga një pjesë e paketë e prokurorëve. Për shembull kërkesa e datës 22.09.2020 për 24 prokurorë me afat të përgatitjes së informacionit deri në datë 02.10.2020, rezulton se nga prokurori i vetëm që është paraqitur informacion është respektuar ky afat, duke paraqitur atë në datën 02.10.2020. Për kërkesën e datës 07.10.2020 me afat për të paraqitur informacion brenda datës 10.10.2020, informacioni i dy prokurorëve është dërguar nga Drejtuesi i Seksionit në datën 13.10.2020. Për prokurorët e tjerë në lidhje me këto kërkesa dhe as nëpërmjet regjistrit të komunikimeve të brendshme nuk mund të evidentohet nëse nuk kanë pasur procedime sipas objektit të kërkesës apo ata nuk i janë përgjigjur kërkesës së Drejtuesit. Për kërkesën e datës 01.10.2020 me afat të përgatitjes së informacionit deri në datën 15.10.2020, nga prokurorët është dërguar informacioni (kërkesa për gjykim) në datën 10.11.2020.

- Për sa i përket informimit dhe raportimit të Drejtuesit të Prokurorisë të Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, referuar nenit 10, pika 3, me dërgimin e Raportit Vjetor për vitin 2020, si dhe informacione të kërkuara nga Prokurori i Përgjithshëm në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2020 dhe Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020.
- Nuk ka të dhëna referuar dokumentacionit të sjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, lidhur me raportimin 3 mujor mbi gjendjen e kriminalitetit, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "l" të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, e cila si periudhë brenda kohës së inspektimit korrespondon me fundin e vitit 2020 dhe një raportim tjetër në muajin mars 2021, ndërsa brenda muajit shkurt 2021 parashikohet përgatitja dhe dërgimi i Raportit Vjetor për vitin 2020.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

- Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët

Në lidhje me këtë drejtim të inspektimit rezulton se nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është bërë kërkesa për informacion dhe dorëzim aktesh me nr. 45 PBD, datë 13.10.2020, me të cilën i është kërkuar prokurorit të çështjes të dorëzojë tek Drejtuesi i Prokurorisë aktet e procedimit penal me nr. 1151/2019 dhe informacion deri në datën 17.10.2020, me qëllim "*Ushtrimin e kompetencave ligjore të drejtuesit të prokurorisë dhe nevojës për ruajtjen e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale*".

Kërkesa e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 45 PBD, datë 13.10.2020, rezulton se është në përputhje me nenin 12, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, mbi bazën e të cilit prokurori informon Drejtuesin sipas kërkesës së tij, mbi ecurinë e procedimit penal, përpara përfundimit të tij. Nga ana tjetër prokurori ka detyrimin të informojë Drejtuesin e Prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara.

Nga prokurori nuk është paraqitur informacion për rastin konkret, por siç është analizuar me sipër, në datën 13.10.2020 me dorëzimin e akteve të procedimit penal nga prokurori i çështjes është paraqitur dhe kërkesë për heqje dorë nga hetimi i çështjes penale nr. 1151, të vitit 2019. Pas shqyrtimit të akteve Drejtuesi i Prokurorisë ka nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm, ku ka udhëzuar kryerjen e veprime të tjera, si dhe me vendimin e datës 14.10.2021 nga Drejtuesi i Prokurorisë është pranuar heqja dorë e prokurorit të çështjes dhe është vendosur zëvendësimi i tij me një prokuror tjetër.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan i është kërkuar informacion prokurorit të çështjes dhe nga prokurori është dhënë informacioni i datës 28.12.2020, në lidhje me procedimin penal nr. 1562, të vitit 2018. Kërkesa e Drejtuesit për informacion është bërë pas administrimit të praktikës nr. 868/1 prot., datë 10.12.2020 të Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kërkesës së datës 24.11.2020 së shtetases S. Xh., në kartelën shoqëruese të praktikës të datës 14.12.2021.

Të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në marrëdhëniet procedurale me Drejtuesit e prokurorisë sipas nenit 8, pika 2-c të udhëzimit të përgjithëm nr. 12/2020, të ndryshuar, përfshijnë edhe detyrimin e prokurorit për të informuar Drejtuesin e Prokurorisë sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me ecurinë e procedimeve/çështjeve të caktuara. Ky detyrim është plotësuar nga prokurori i çështjes edhe pse jo mbi bazën e një kërkesë të mirëfilltë për informacion të Drejtuesit sipas dispozitave të mësipërme të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, por nëpërmjet shënimit në kartelë.

Gjithashtu, nga Drejtuesi i Prokurorisë është hartuar akti "Tërheqje vëmendje" me nr. 47 PBD, datë 20.10.2020, për prokurorin e çështjeve në lidhje me trajtimin dhe dhënien zgjidhje të materialeve dhe çështjeve penale në fazë verifikimi/hetimi paraprak, duke i dhënë përparësi procedimeve penale të mbartura nga vitet e mëparshme. Akti i mësipërm është me qëllim "Ushtrimin e kompetencave ligjore të drejtuesit të prokurorisë dhe dilijencës për ruajtjen e kushtetushmërisë dhe ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale". Në vijim nga Drejtuesi i prokurorisë është përpiluar dhe shkresa nr. 1455 prot., datë 23.11.2020, me lëndë "Mbi mënyrën e trajtimit të çështjeve penale", drejtuar në adresën e banimit të prokurorit, ku i është kërkuar informacion me shkrim në lidhje me qëndrimet që do të mbante ai për çështjet penale në hetim dhe në gjykim, për shkak të paaftësisë së tij të përkohshme për punë për arsye shëndetësore. Sa më sipër i kërkohet, me qëllimin e zbatimit të nenit 27 të K. Pr. Penale, për të mundësuar zëvendësimin e prokurorit nëse jep pëlqimin për zëvendësim, si dhe në rast të kundërt po në bazë të nenit 27 të K. Pr. Penale, për arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve në proces, si dhe respektimin e ligjshmërisë, do të vendoset zëvendësimi i prokurorit pa pëlqimin e tij.

Me informacionin e datës 01.12.2020 nga prokurori i këtyre çështjeve është kthyer përgjigje, duke informuar se po në datë 01.12.2020, ndërpreu lejen për paaftësi të përkohshme për punë për arsye shëndetësore dhe për shkak dhe të gjendjes shëndetësore dhe ngarkesës së akumuluar, pavarësisht se është kthyer në punë ka kërkuar përjashtimin e tij nga shorti elektronik.

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**



Nga aktet e dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, rezulton se nga Drejtuesi i Prokurorisë është përgatitur dhe dërguar informacioni me nr. 10125 prot., datë 19.10.2020 në përgjigje të kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 943/6 prot., datë 05.10.2020 “Mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020” dhe nr. 968/5 prot., datë 02.10.2020 “Mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”.

Me shkresën nr. 35 prot., datë 06.01.2021 me lëndë “Dërgim informacioni në lidhje me praktikën tuaj nr. 1914 prot., datë 30.12.2020 “Kërkesë për informacion”, drejtuar Drejtorisë së Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme nga Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan është informuar Prokurori i Përgjithëm midis të tjerash në lidhje me:

- i. Masat e marra për zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar dhe konkretisht:
 - është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 “Në bazë dhe për zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.
 - pas muajit korrik 2020 deri në fund të vitit 2020, janë nxjerrë akte të tjera në zbatim të ligjit dhe konkretisht 3 udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, është mbajtur 1 akt konstatimi për çështje konkrete, si dhe është bërë 1 kërkesë për informacion për çështje konkrete.
 - regjistri i qarkullimit të brendshëm datë 21.09.2020 dhe deri më datë 31.12.2020, në këtë regjistër janë bërë shënime për 2424 materiale të qarkulluara. Sugjerohet që për shkak të numri të madh të shënimeve të ndryshme në këtë regjistër, të shihet mundësia e rishikimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, ku në këtë regjistër të parashikohet vetëm pasqyrimi i urdhrave dhe udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë, kërkesat e Drejtuesit për informacion dhe informacionet e prokurorëve për çështje konkrete, si dhe vendimarrja e Drejtuesit të Prokurorisë për bashkimin e çështjeve dhe zëvendësimet e prokurorëve apo oficerëve të policisë gjyqësore.
- ii. Masat e marra për zbatimin e urdhrit të përgjithshëm nr. 120, datë 08.09.2020 “Për miratimin e disa shtesave në “Rregulloren Standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”.
- iii. Masat e marra për zbatimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë periudhës janar-dhjetor 2020.

Sa i përket detyrimit për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja “l” dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 10, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, periudha e inspektimit, përkon dhe me periudhën e hartimit të Raportit Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për vitin 2020. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se është dërguar Raporti Vjetor mbi punën e bërë dhe gjendjen e kriminalitetit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për vitin 2020, protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. 68/3 prot., datë 23.02.2021.



Në zbatim të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, rezulton se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, regjistri i qarkullimit të brendshëm të akteve ka filluar të funksionojë nga data 21.09.2020. Në të janë pasqyruar të gjitha aktet e nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë, urdhra dhe udhëzime të ndryshme, kërkesa për informacion për çështje konkrete, informacionet e prokurorëve për çështje konkrete, vendimmarrje të Drejtuesit të Prokurorisë për bashkime çështjesh dhe zëvendësime prokurorësh, apo oficerësh të policisë gjyqësore, dosjet penale të përfunduara nga prokurorët, si dhe për dosjet penale në regjistër janë shënuar dhe mënyra e përfundimit të hetimit dhe mënyra e përfundimit të gjyqësorëve të ndryshme për çështje konkrete.

Për periudhën nga data 01.10.2020 deri më datë 31.03.2021 rezulton se të dhënat e hedhura në këto regjistra përfshijnë gjithsej 5 regjistra, ku:

-Në një regjistër gjenden të dhënat e regjistruara me nr. Regjistri 283, datë 01.10.2020 deri në regjistrimin me nr. Regjistri, datë 04.11.2020. Ky regjistër figuron i hapur me datë 21.09.2020;

-Në një regjistër gjenden të dhënat e regjistruara me nr. Regjistri 1384, datë 04.11.2020 deri në regjistrimin me nr. Regjistri 2078, datë 14.12.2020;

-Në një regjistër gjenden të dhënat e regjistruara me nr. Regjistri 2079, datë 14.12.2020 deri në regjistrimin me nr. Regjistri 2424, datë 05.01.2021;

-Në një regjistër gjenden të dhënat e regjistruara me nr. Regjistri 1, datë 05.01.2021 deri në regjistrimin me nr. Regjistri 791, datë 18.02.2021;

-Në një regjistër gjenden të dhënat e regjistruara me nr. Regjistri 792, datë 18.02.2021 deri në regjistrimin me nr. Regjistri 1390, datë 31.03.2021. Ky regjistër mbyllet me nr. Regjistri 1534 datë 13.04.2021.

- Për sa i përket mënyrës së informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori rezulton se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, në tre raste me kërkesa të Drejtuesit të Prokurorisë për informacion drejtuar prokurorëve të çështjes, por vlerësohet se si aktet e Drejtuesit dhe përgjigjet e prokurorit duhet të jenë konform neneve 12, pika 2 dhe 14, pika 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar të pasqyruara në regjistrin e komunikimeve të brendshme, për të garantuar transparencën e marrëdhënieve midis Drejtuesit dhe prokurorëve dhe të drejtat e detyrimit që lindin nga ligji nr. 97/2016, i ndryshuar dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij dhe jo akte që nuk parashikohen në ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, pa i titulluar në mënyrë të atillë që duken si një masë disiplinore. Kërkesa për informacion do të shërbente për t'u realizuar nga Drejtuesi qëllimi i ushtrimit të kompetencave ligjore dhe dilijencës për ruajtjen e ligjshmërisë në ushtrimin e ndjekjes penale.
- Gjithashtu, për periudhën e inspektimit nuk rezultuan raste të tjera kërkesash dhe informimi të Drejtuesit të Prokurorisë sipas kreut IV të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, parashikuar nga nenet 12, pikat 2 dhe 3, nenet 13 dhe 14 të këtij udhëzimi.
- Për sa i përket informimit dhe raportimit të Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ka një zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, sipas neneve 10, pika 3, duke dërguar Raportin Vjetor, duke dërguar

informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 dhe mbi “Zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”, si dhe është dërguar informacioni i kërkuar midis të tjerash në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të ndryshuar, në lidhje me masat e marra për zbatimin e urdhrin të përgjithshëm nr. 120, datë 08.09.2020 “Për miratimin e disa shtesave në “Rregulloren Standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm” dhe në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3, datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier**

• **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Në referim të nenit 43 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe zbatim të neneve 8, pika 2-c dhe 14, pika 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, rezultojnë kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe informacionet e dhëna nga prokurori:

- i) Kërkesë për informacion nr. 463, datë 10.02.2021, drejtuar prokurorit të çështjes, ku i është kërkuar informacion në lidhje me kërkesën për zëvendësim masë sigurimi dhe qëndrimin e prokurorit në seancë për shtetasin V. T. Kërkesa është protokolluar në regjistrin e brendshëm me nr. 463, datë 10.02.2021. Përgjigjja e prokurorit është kthyer me shkrim në kërkesë në datën 10.02.2021 se *“grykimi nuk është zhvilluar, në seancë jemi për rrëzimin e kërkesës”*.
- ii) Kërkesë për informacion nr. 73, datë 12.01.2021, drejtuar prokurorit të çështjes, për qëndrimin e prokurorit në seancë gjyqësore për kërkesën e të dënuarit B. K., dënuar për nenin 79/dh të Kodit Penal, para marrjes së vendimit nga gjykata. Informacioni është paraqitur nga prokurori me shkrim pa datë, pasi ka përfunduar në datën 16.04.2021 gjykimi, ku gjykata ka deklaruar të papranueshme kërkesën e të dënuarit B. K. Kërkesa është e regjistruar në regjistrin e brendshëm me nr. 73, datë 12.01.2021, ndërsa informacioni i prokurorit nuk figuron i regjistruar në regjistër dhe është arkivuar në datën 28.04.2021.
- iii) Kërkesë për informacion nr. 609, datë 15.12.2020 drejtuar prokurorit të çështjes në lidhje me procedimin penal nr. 861/2019, regjistruar për veprën penale të shkakimit të vetëvrasjes. Informacioni i prokurorit me shkrim nuk ka datë dhe nuk figuron i regjistruar në regjistrin e brendshëm.
- iv) Informacion i prokurorit të çështjes për procedimin penal nr. 1123, të vitit 2018 i datës 10.12.2020, regjistruar në regjistrin e brendshëm me nr. 522/1, datë 10.12.2020. Kërkesë e Drejtuesit me shkrim nuk na është vendosur në dispozicion, por në regjistër figuron me nr. 522, datë 07.12.2020 e regjistruar kërkesa “Informacion zyrtar për L. Ll.”.

- v) Informacion i datës 06.01.2021 i prokurorit, mbi procedimet e mbartura në vitin 2021 në kuadër të urdhrit nr. 80, datë 11.12.2020 të Drejtuesit 'Mbi marrjen e masave për mbylljen e regjistrave, mbledhjen dhe plotësimin e tabelave statistikore, nxjerrjen e të dhënave dhe përgatitjen e informacioneve për Raportin Vjetor të vitit 2020. Informacioni është regjistruar në regjistrin e qarkullimit të brendshëm me nr. 15/1, datë 06.01.2021.
- vi) Kërkesë për informacion e Drejtuesit të Prokurorisë mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër krimit të organizuar për vitin 2020, protokolluar me nr. 193, datë 13.10.2020.
- vii) Informacion i prokurorit të çështjes datë 28.12.2020 për procedimin penal nr. 1347, të vitit 2020, në lidhje me kërkesën për informacion të Drejtuesit. Kërkesa e Drejtuesit nuk na është vendosur në dispozicion, por në regjistër figuron me nr. 753, datë 23.12.2020, me shënimin "Kërkesë për informacion" dhe me nr. 753/1, datë 28.12.2020 është i regjistruar informacioni i prokurorit.
- viii) Informacion i prokurorit të çështjes mbi procedimet penale nr. 571/2017 dhe nr. 863/2017 të datës 15.02.2021. Kërkesa e Drejtuesit është e regjistruar me nr. 494, datë 12.02.2021, por nuk na është vendosur në dispozicion fizikisht. Përgjigjja e prokurorit është e protokolluar me nr. 494/1, datë 15.02.2021.
- ix) Kërkesë për informacion e Drejtuesit nr. 390, datë 05.02.2021 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me qëndrimin që do të mbahet për kërkesën e mbrojtësit për zëvendësimin e masës së sigurimit për shtetasin E. R., në procedimin penal nr. 85/2021. Nga prokurori është dhënë informacioni i protokolluar me nr. 390/1, datë 08.02.2021., mbi masën e sigurimit dhe informacioni me nr. 390/2, datë 08.02.2021 mbi mënyrën e përfundimit të çështjes. Informacionet e prokurorit rezultojnë pa datë.
- x) Kërkesë për informacion e Drejtuesit me nr. 797, datë 10.03.2021, drejtuar prokurorit të çështjes për procedimin nr. 1486/2020. Nga prokurori është përgatitur informacioni i datës 11.03.2021. Në regjistër figuron e regjistruar kërkesa e Drejtuesit me nr. 797, datë 10.03.2021.
- xi) Kërkesë për informacion nr. 168, datë 15.01.2021 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me procedimin penal nr. 890/2020. Informacioni i prokurorit është datë 18.01.2021, i cili figuron i regjistruar në regjistër me nr. 168/1, datë 18.01.2021.
- xii) Kërkesë për informacion nr. 812/1, datë 12.03.2021 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit për shtetasin E. B., nga "arrest në burg" në "arrest në shtëpi" nga gjykata në datën 12.3.2021 për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal në procedimin penal nr. 40/2021. Informacioni i prokurorit është i datës 12.3.2021, ndërsa në regjistër është protokolluar me nr. 812/2, datë 12.03.2021, ankimi i prokurorit kundër vendimit të gjykatës.
- xiii) Kërkesë për informacion nr. 493, datë 11.02.2021 drejtuar prokurorit të çështjes për fazën e hetimeve të procedimit penal nr. 1300, të vitit 2020. Nga prokurori është përpiluar informacioni pa datë në lidhje me procedimin nr. 1300, të vitit 2020, regjistruar në regjistrin e brendshëm me nr. 493/1, datë 16.02.2021.
- xiv) Kërkesë për informacion nr. 570, datë 12.02.2021 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me kërkesën e paraqitur nga E. S., dhe V. S., për heqje sekuestro të vendosur në



funkcion të procedimit penal nr. 506/2012. Në datën 17.02.2021, me nr. 570/1, është regjistruar përgjigjja e kthyer shtetasve të interesuar nga Drejtuesi.

- xv) Kërkesë për informacion nr. 810/1, datë 12.03.2021 drejtuar prokurorit të çështjes në lidhje me procedimin penal nr. 1344, të vitit 2020, regjistruar për nenet 123 dhe 164 të Kodit Penal, se në çfarë faze janë veprimet hetimore të kryera, etj. Informacioni i prokurorit pa datë, me shënimin "kthim përgjigje datë 12.03.2021" dhe figuron i pasqyruar në regjistrin e qarkullimit të brendshëm datë 12.03.2021.
- xvi) Kërkesë për informacion nr. 394, datë 08.02.2021 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me kërkesat e të dënuarve për lirim me kusht që janë përfaqësuar nga ana e tij në gjykatë në muajin janar 2020. Sa ka qenë numri i kërkesave? Cili ka qenë qëndrimi i prokurorit dhe cili ka qenë vendimi i gjykatës? Nuk rezulton përgjigje nga prokurori.
- xvii) Kërkesë për informacion nr. 645, datë 17.12.2020 drejtuar prokurorit të çështjes për gjendjen e hetimeve paraprake të procedimit penal nr. 1182, datë 19.10.2020 regjistruar për veprën penale të "Vjedhja" të parashikuar nga neni 134 i K. Penal, ku infomacioni i kërkuar të dorëzohet brenda datës 23.12.2020, së bashku me fashikullin e procedimit penal nr. 1182, të vitit 2020. Informacioni i prokurorit rezulton me nr. 645/1, datë 18.12.2020.
- xviii) Kërkesë për informacion nr. 307, datë 22.10.2020 drejtuar dy prokurorëve të seksionit të ekzekutimeve, si prokurorët që ndjekin kërkesat që lidhen me nenin 59 të Kodit Penal "Pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë", në lidhje me të dënuarit me burgim, çështjet me ankim të drejtëpërdrejtë në gjykatë (neni 59 i K. Pr. Penale), gjykimet civile (kërkesa në përputhje me Kodin e familjes, Heqja/ Kufizimi i zotësisë për të vepruar, Shpallje i zhdukur/i vdekur, Kompensim për burgim të padrejtë) dhe çështjet për të cilat prokurori ngre padi në gjykatë, të cilët duhet të paraqisnin informacion për kërkesat e përfunduara në lidhje me disponimin e gjykatës brenda datës 30 të çdo muaji.

Nga njëri prej prokurorëve të ekzekutimeve është përgatitur informacioni datë 30.10.2020, për periudhën 01.10.2020-31.10.2020, duke informuar se kishte përfunduar gjykimi për 8 (tetë) kërkesa për lirim para kohe me kusht, sipas nenit 64 të K. Penal, ku për 7 (shtatë) prej të cilave është vendosur rrëzimi apo deklarimi i papranueshëm, ndërsa në 1 (një) kërkesë është pranuar nga gjykata, konkretisht i dënuari F. H., për të cilin është kërkuar rrëzimi dhe është ankimuar vendimi. Nuk ka përfunduar gjykimi i kërkesave të tjera sipas objektit të kërkesës për informacion.

Gjithashtu, po nga i njëjti prokuror është përgatitur dhe informacioni regjistruar me nr. 555, datë 10.12.2020, për periudhën 01.11.2020-30.11.2020, sipas të cilit rezulton se ka përfunduar gjykimi për 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa për lirim para kohe me kusht, sipas nenit 64 të K. Penal, Qëndrim në shtëpi, sipas nenit 59/a të K. Penal, si edhe për përfitim nga amnistia dhe shuarje dënimi, ku për 10 (dhjetë) prej të cilave është vendosur deklarimi i papranueshëm, ndërsa në 1 (një) kërkesë është pranuar nga gjykata, konkretisht i dënuari K. Xh., për qëndrim në shtëpi, konform nenit 59/a/ç të K. Penal, për të cilin është kërkuar rrëzimi dhe është ankimuar vendimi. Nuk kanë përfunduar gjykimi i kërkesave të tjera sipas objektit të kërkesës për informacion.

Nga prokurori tjetër nuk rezulton të jetë paraqitur informacion në lidhje me kërkesën e Drejtuesit.

- xix) Kërkesë për informacion nr. 222, datë 15.10.2020 drejtuar prokurorit të çështjes për çështjen penale në ngarkim të shtetasës T. T., ku përveç informacionit të datës 14.10.2020, kërkohen vendimet e gjykatës së seancës paraprake dhe kërkesa për informacion e gjyqtarës së seancës paraprake. Nuk rezulton përgjigje për këtë kërkesë, por rezulton se nga prokurori është paraqitur informacioni i datës 14.10.2020, regjistruar me nr. 222/1, datë 15.10.2020.
- xx) Kërkesë nr. 627/1, datë 16.04.2020, drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me çështjen penale ndaj shtetasit O. K., Nuk ka informacion me shkrim nga prokurori, por me shkrim dore në kërkesë shënohet "objekti llogaritje paraburgimi për kohën që ka qenë jashtë shtetit", shënuar në regjistër për datën 17.12.2020 në rubrikën "dhënia e informacionit nga prokurori". Kërkesa për informacion e Drejtuesit shënohet në rubrikën e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe përgjigja e prokurorit në të njëjtin numër dhe rresht me kërkesën e Drejtuesit.
- xxi) Kërkesë nr. 628, datë 16.12.2020 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me çështjen penale ndaj shtetasit L. F. Nga prokurori nuk ka informacion me shkrim, por është paraqitur shkresa e Zyrës së Interpolit nr. 15109, datë 14.12.2020 dhe me shkrim dore në kërkesë është bërë shënimi "kërkesë në gjykatë nga kërkuesi L. F., me objekt llogaritje paraburgimi". Kërkesa për informacion e Drejtuesit shënohet në rubrikën e udhëzimeve jo të detyrueshme.
- xxii) Kërkesë për informacion nr. 464, datë 10.02.2020, drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me procedimin penal nr. 1215/2016. Informacioni i prokurorit rezulton i datës 11.02.2020, regjistruar në regjistrin e brendshëm në datën 11.02.2020. Lënda "Kërkesë për informacion" shënohet në rubrikën e korrespondencës për të tretët.
- xxiii) Kërkesë për informacion të sigluar nga Drejtuesi në shkresën e Ministrisë së Drejtësisë nr. E-175/4, datë 13.11.2020. Informacioni i prokurorit figuron i regjistruar në regjistrin e brendshëm me nr. 465, datë 17.11.2020.
- xxiv) Kërkesë për informacion nr. 754, datë 23.12.2020 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me procedimin penal nr. 1838/2018, të kthyer nga gjykata. Informacioni i prokurorit datë 23.12.2020, i cili nuk është pasqyruar në regjistër. Lënda "Kërkesë për informacion" shënohet në rubrikën e korrespondencës për të tretët.
- xxv) Kërkesë për informacion nr. 215, datë 14.10.2020 drejtuar prokurorit të çështjes në lidhje me "Kërkesën e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, gjyqtarit të seancës paraprake, në lidhje me çështjen penale në ngarkim të të pandehurës T. T, etj. Nga prokurori është përpiluar informacioni i datës 14.10.2020, regjistruar me nr. 215/1, datë 14.10.2020. Lënda "Informacion Drejtuesit të Prokurorisë" i cili shënohet në rubrikën e korrespondencës për të tretët.
- xxvi) Kërkesë për informacion nr. 385, datë 5.2.2021, drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me procedimin penal për shtetasin E. D. Informacioni i prokurorit është me nr. 385/1, datë 08.02.2021. Si kërkesa për informacion dhe informacioni i prokurorit shënohet në rubrikën e korrespondencës për të tretët.
- xxvii) Kërkesë për informacion nr. 569, datë 14.12.2020 drejtuar të gjithë prokurorëve, ku kërkohet informacion për procedimet penale të kthyera nga gjykata në vitin 2020 që aktualisht janë në hetim: Nr. i procedimit, data e regjistrimit, neni, personi në hetim apo i pandehur, masa e sigurimit. Në lidhje me këtë kërkesë rezulton informacioni i një



prokurori i datës 15.12.2020, regjistruar me nr. 615, datë 16.12.2020 për kthimin e procedimit penal nr. 528, të vitit 2019 për hetime. Informacioni i prokurorit si lëndë shënohet në rubrikën e korrespondencës për të tretët. Informacioni i një prokurori tjetër pa datë, ku informon se nuk ka asnjë procedim në hetime të kthyer nga gjykata në vitin 2020.

xxviii) Kërkesë për informacion nr. 569/1, datë 14.12.2020, drejtuar të gjithë prokurorëve, ku kërkohet informacion për procedimet penale të rifilluara në 2020 që aktualisht janë në hetim: Nr. i procedimit, data e regjistrimit, neni, data e rifillimit, personi në hetim apo i pandehuri (nëse ka), masa e sigurimit. Në lidhje me këtë kërkesë rezultojnë informacioni i një prokurori datë 20.12.2020, për procedimet penale të rifilluara në vitin 2020, regjistruar me nr. 569/1, datë 21.12.2020; informacioni datë 20.12.2020 i një prokurori tjetër mbi procedimet e rifilluara në 2020, i paprotokolluar në regjistër, por me numër në akt 569/1, datë 21.12.2020.

xxix) Rikërkesë për informacion nr. 353, datë 04.02.2021 drejtuar prokurorëve të seksionit të ekzekutimeve, të cilët duhet të kishin paraqitur informacion për kërkesat e përfunduara në lidhje me disponimin e gjykatës brenda datës 30. Nisur nga sa më sipër, duke qenë se nga ana e tyre nuk bëhen shënime në regjistër, kërkohet nga Drejtuesi i Prokurorisë dhënia sa më parë e këtij informacioni dhe marrja e masave për t'u kryer shënime në regjistër. Në lidhje me këtë kërkesë me nr. 353/2, datë 05.02.2021, rezultojnë informacioni i njërit prej prokurorëve, sipas të cilit rezultojnë se nga ana e tij si prokuror në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale të formës së prerë nuk është ndjekur asnjë kërkesë që lidhet me nenin 59 të K. Penal "pezullim të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënie në provë". Nuk është ndjekur asnjë çështje që ka të bëjë me gjykimet civile dhe kompensim për burgim të padrejtë. Në datën 04.02.2020 rezultojnë informacioni i prokurorit tjetër, regjistruar me nr. 353/1, datë 04.02.2021, sipas të cilit për periudhën 01.01.2021-31.01.2021 ka përfunduar gjykimi për 10 (dhjetë) kërkesa, prej të cilave: 3 (tre) për lirim para kohe me kusht, sipas nenit 64 të K. Penal, rrëzuar ose deklaruar e papranueshme kërkesa dhe për një rast është kërkuar rrëzimi nga prokurori dhe pranuar nga gjykata, vendim ndaj të cilit është ushtruar ankimi; 1 (një) shuarje dënimi është deklaruar i papranueshëm. Si kërkesa për informacion dhe informacioni i prokurorit shënohet në rubrikën e korrespondencës për të tretët.

xxx) Informacion nr. 200, datë 14.10.2020 i prokurorit të çështjes mbi pushimin e procedimit penal nr. 955/2020, për shkak të zbatimit të masës së shmangies nga prokurori.

• **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3^[51] të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, sa i përket detyrimit për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në

⁵¹ "Drejtuesit e prokurorive, informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm me të dhëna të sakta mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose për ecurinë e veprimtarisë në prokuroritë që drejtojnë, si dhe përgatisin e dërgojnë raportin vjetor në formën dhe sipas treguesve të përcaktuar, raport i cili miratohet me urdhër të tij."

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, periudha e inspektimit për të cilën kërkohet informacion 01.10.2020 deri 31.03.2021, përkon me periudhën e hartimit të Raportit Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për vitin 2020 dhe rezultojnë se Drejtuesi ka nxjerrë urdhrin nr. 80, datë 11.12.2020 “*Mbi marrjen e masave për mbylljen e regjistrave, mbledhjen dhe plotësimin e tabelave statistikore dhe nxjerjen e të dhënave dhe përgatitjen e informacioneve për Raportin Vjetor të vitit 2020*”.

Me shkresën nr. 7767, datë 16.10.2020, është dërguar informacion mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020. Me shkresën nr. 7893, datë 21.10.2020 është dërguar informacion mbi zbatimin e rezolutës të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 dhe me shkresën nr. 1580, datë 21.02.2021 është dërguar Raporti Vjetor për vitin 2020 për Prokurorinë Fier.

Në zbatim të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020n rezultojnë se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka të hapur regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale sipas formatit të miratuar me udhëzimin e përgjithshëm nr.12/2020, të ndryshuar. Regjistri fillon me numrin rendor 1, datë 09.09.2020 dhe është mbyllur me nr. 842, datë 31.12.2020. Për vitin 2021 rezultojnë se janë hapur 2 regjistra që përfshijnë periudhën e inspektimit, regjistri nr. 1, i cili fillon me nr. rendor 1, datë 05.01.2021 dhe mbyllet me nr. 587, datë 15.02.2021; regjistri nr. 2 vijon me numrin 588, datë 16.02.2021 dhe mbyllet me nr. 1151, datë 28.04.2021.

- Për sa më sipër, lidhur me mënyrën e informimit të Drejtuesve nga prokurori rezultojnë se në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, nga Drejtuesi i Prokurorisë është proceduar me rreth 28 kërkesa për informacion drejtuar prokurorëve, të cilët kanë përgatitur informacionin e kërkuar në përgjigje të kërkesave, përveç rreth 5 rasteve ku prokurorët nuk kanë dhënë informacion. Vlerësohet se si aktet e Drejtuesit dhe përgjigjet e prokurorit duhet të jenë konform neneve 12, pikat 2-3, 13, 14 e 15, pika 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, të pasqyruara në regjistrin e komunikimeve të brendshme. Gjithashtu, nuk vihen re raste të tjera informimi të Drejtuesit të Prokurorisë sipas kreut IV të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Për sa i përket informimit dhe raportimit të Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, referuar nenit 10, pika 3, me dërgimin e Raportit Vjetor për vitin 2020, si dhe informimi i Prokurorit të Përgjithshëm mbi bazën e kërkesave të tij për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare dhe Rezolutës së Kuvendit.
- Konstatohet parregullsi dhe mangësi në lidhje me plotësimin e regjistrit të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale të cilat janë evidentuar më sipër tek pasqyrimi i regjistrimit të kërkesave/informacioneve të prokurorëve, si dhe regjistrimit të udhëzimeve jo të detyrueshme.

➤ **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë**

- **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Në referim të nenit 43 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe zbatim të neneve 8, pika 2- c dhe 14, pika 1 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, nga Drejtuesi i Prokurorisë rezulton:

- a) Kërkesë për informacion datë 12.10.2020 drejtuar prokurorit të çështjes për procedimin nr. 948/2020. Në regjistër nuk pasqyrohet informacion i prokurorit për këtë kërkesë (të paktën deri në datën 31.03.2021 që është fundi i periudhës së inspektimit).
- b) Kërkesë për informacion datë 29.10.2020 drejtuar prokurorit të çështjes, për procedimet penale të vitit 2017. Informacioni nga prokurori rezulton i pasqyruar në regjistër datë 30.11.2020 dhe 14.11.2020.
- c) Kërkesë për informacion datë 29.10.2020, drejtuar prokurorit të çështjes, për procedimin penal nr. 1282/2017. Informacioni i prokurorit rezulton i pasqyruar në regjistër datë 29.10.2020.
- d) Kërkesë për informacion datë 29.10.2020, drejtuar prokurorit të çështjes, për procedimet penale të viteve 2016 dhe 2017. Në regjistër nuk pasqyrohet informacion i prokurorit për këtë kërkesë (të paktën deri në datën 31.03.2021 që është fundi i periudhës së inspektimit).
- e) Kërkesë për informacion datë 29.10.2020 drejtuar prokurorit të çështjes për procedimet penale 2015-2017. Në regjistër nuk pasqyrohet informacion i prokurorit për këtë kërkesë (të paktën deri në datën 31.03.2021 që është fundi i periudhës së inspektimit).
- f) Kërkesë për informacion datë 22.2.2021 drejtuar prokurorit të çështjes, në lidhje me procedimet penale të vitit 2018. Informacioni i prokurorit rezulton i pasqyruar në regjistër datë 29.10.2020. Për disa procedimet të tjera penale të vitit 2018, në regjistër nuk pasqyrohet informacion i prokurorit për këtë kërkesë (të paktën deri në datën 31.03.2021 që është fundi i periudhës së inspektimit).

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3^[52] të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, sa i përket detyrimit për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është dërguar një kopje e raportimit të kryer nga Drejtuesi i Prokurorisë mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për vitin 2020. Sipas të dhënave të Drejtuesit të Prokurorisë krahas këtij raportimi nga ana e kësaj prokurorie kryen edhe raporte të tjera periodike që lidhen me kategori të

⁵² "Drejtuesit e prokurorisë, informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm me të dhëna të sakta mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose për ecurinë e veprimtarisë në prokuroritë që drejtojnë, si dhe përgatisin e dërgojnë raportin vjetor në formën dhe sipas treguesve të përcaktuar, raport i cili miratohet me urdhër të tij."

caktuara veprash penale që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, krimin ekonomik, për çështjet me të mitur, etj. Këto informacione përcillen me email pranë sektorit përkatës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në zbatim të nenit 20, pika 2, germa "a" deri tek germa "dh" të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, në përputhje edhe me modelin e lidhjes I bashkëlidhur udhëzimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Korçë, është krijuar regjistri i posaçëm që dokumenton dhe regjistron pikërisht të gjitha të dhënat që lidhen me kërkesat për informacion nga Drejtuesi tek prokurorët, dhënien e informacionit nga prokurori për çdo rast, nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, apo refuzimin e ndjekjes së udhëzimeve. Në këtë regjistër, që ka filluar të plotësohet prej datës 07.09.2020 janë dokumentuar të gjitha të dhënat që parashikon neni 20/2, gerrat "a", "b", "c", "d", "dh", të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Sekretarja e Drejtuesit të Prokurorisë është ngarkuar në mënyrë specifike për të mbajtur pikërisht gjithë praktikën e komunikimeve zyrtare mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve. Bashkëlidhur është vënë në dispozicion një kopje e regjistrit të komunikimeve të brendshme mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve, në përputhje me nenin 20 të udhëzimit të sipercituar, ku konstatohet rregullshmëria e plotësimin të tij.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër

• Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët

Për periudhën objekt inspektimi rezulton se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër janë drejtuar 42 kërkesa në drejtim të prokurorëve të çështjes të natyrave të ndryshme kryesisht për gjendjen e procedimeve penale në hetim, kallëzimeve penale etj., të shpërndara në këtë mënyrë, 4 (katër) kërkesa në muajin tetor; 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa në muajin nëntor datë 23 dhe 24 nëntor; 10 (dhjetë) kërkesa në janar, datë 13 dhe 18 janar dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa në mars, datë 18 dhe 24 mars.

Nga kërkesat për informacion që iu janë drejtuar katër prokurorëve në muajin tetor, të cilat evidentohen të jenë dërguar në të njëjtën ditë, datë 23.10.2020, përgjigje me shkrim Drejtuesit i ka kthyer vetëm njëri prej prokurorëve në datën 26.10.2020, e cila rezulton të jetë kthyer brenda dy ditëve.

Nga kërkesat për informacion që iu janë drejtuar 10 prokurorëve në muajin nëntor, të cilat evidentohen të jenë dërguar në të njëjtën ditë, datë 23.11.2020 dhe një prokurori në datën 24.11.2020, përgjigje me shkrim Drejtuesit i ka kthyer vetëm njëri prej prokurorëve, përgjigje nr. 34, datë 23.11.2020 e cila rezulton të jetë kthyer brenda ditës.

Nga kërkesat për informacion që iu janë drejtuar 8 prokurorëve në muajin janar, të cilat evidentohen të jenë dërguar në të njëjtën ditë, datë 13.01.2021 dhe një prokurori, kërkesë për informacion edhe në datën 18.01.2021, përgjigje me shkrim Drejtuesit i kanë kthyer dy prej prokurorëve, një përgjigje nr. 12/1, datë 18.01.2021 dhe një përgjigje nr. 18/1, datë 18.01.2021), të cilat rezultojnë të jenë kthyer brenda ditës.

Nga kërkesat për informacion që iu janë drejtuar 10 prokurorëve në muajin mars, të cilat evidentohen të jenë dërguar në të njëjtën ditë, datë 18.03.2021 dhe datë 24.03.2021, përgjigje

me shkrim Drejtuesit i është kthyer vetëm në lidhje me kërkesën për informacion datë 18 mars 2021. Rezultojnë të kenë kthyer përgjigje 4 prokurorë, përgjigje me nr. 40 prot, datë ska, përgjigje nr. 41/1, datë 19.03.2021, përgjigje nr. 42/1, datë 23.03.2021 dhe përgjigje nr. datë 19.03.2021. Kërkesat për informacion/informacionet e prokurorëve më konkretisht paraqiten:

- Kërkesa për informacion nr. 18 prot., datë 23.10.2020, për të cilën prokurori ka informuar me nr. 18/1 prot., datë 26.10.2020 dhe kërkesa për informacion nr. ska prot., datë 23.10.2020, lidhur me gjendjen e kallëzimeve penale në dorë.
- Kërkesa për informacion nr. ska prot., datë 23.11.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë, drejtuar prokurorëve të çështjeve për gjendjen e procedimeve penale në hetim (të viteve 2016, 2017, 2018).
- Informacion datë 26.11.2020 e prokurorit të çështjes drejtuar drejtuesit të prokurorisë për kërkesën nr. 34 prot, datë 23.11.2020.
- Informacion nr. 12/1 prot (G. S) datë 18.01.2021 e prokurorit të çështjes drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë me lëndë "Mbi kërkesën për informacion nr. 12, datë 18.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë.
- Informacion nr. ska, datë 18.01.2021 e prokurorit të çështjes drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë me lëndë "Mbi kërkesën për informacion nr. 15 prot., datë 18.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë.
- Kërkesa për informacion nr. 4 deri në nr. 8 (nr. prot, ska), datë 13.01.2021 e Drejtuesit të Prokurorisë drejtuar prokurorëve të çështjeve, për gjendjen e kallëzimeve penale në vitin 2020, (të paregjistruara si procedime penale dhe as vendosur mosfillimi i procedimit penal).
- Kërkesa për informacion nr. 36 deri në 45 (nr. prot, ska), datë 18.03.2021 e Drejtuesit të Prokurorisë, drejtuar prokurorëve të çështjeve, për gjendjen e procedimeve penale në hetim të vitit 2016, 2017 dhe të vitit 2018.
- Informacion i prokurorit të çështjes protokolluar me nr. 41/1, datë 19.03.2021, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë në lidhje me kërkesën për informacion për procedimin penal nr. 1075/2017.
- Informacion i prokurorit të çështjes protokolluar me nr. 45/1, datë 19.03.2021, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë në lidhje me kërkesën për informacion të Drejtuesit për procedimin penal nr. 878/2017.
- Informacion i prokurorit të çështjes, protokolluar me nr. 42/1, datë 23.03.2021, drejtuar Drejtuesit në lidhje me kërkesën për informacion të Drejtuesit për procedimin penal nr. 1630/2018,
- Kthim përgjigje (pa prot, dhe pa datë) nga prokurori i çështjes, Drejtuesit për kërkesën me shkresën nr. 40, datë 18.03.2021, në lidhje me procedimin penal nr. 1755/2017.
- Kërkesa për informacion nr. 46 deri nr. 52 prot, datë 24.03.2021, për gjendjen e një sërë kallëzimesh penale të viteve 2019, 2020, 2021 të paregjistruara si procedime penale dhe as vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Pjesë e dokumentacionit të dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në funksion të inspektimit tematik janë dhe tre informacione që i janë drejtuar

Drejtuesit nga prokurorë të çështjes, nga të cilët nga një prokuror përkatësisht me datë 18.02.2021 dhe 24.02.2021 dhe një i prokurorit tjetër, të cilët lidhen me të njëjtin procedim penal (nr. 1052/2019). Këto informacione rezultojnë të jenë kryer kryesisht nga këta prokurorë.

Nga kërkesat e Drejtuesit të Prokurorisë, drejtuar prokurorëve të çështjes, rezulton se ato që i përkasin vitit 2000 janë të paprotokolluara, me përjashtim të njëres prej tyre (kërkesa me nr. 18 prot, datë 23.10.2020). Kërkesa me datë 13.11.2020, evidentohet në regjistrin e qarkullimit të brendshëm, por nuk rezulton fizikisht.

• **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, përsa i përket detyrimit të Drejtuesit të Prokurorisë për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rezulton se nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie nuk është përcjellë informacion për zbatimin e këtij detyrimi ligjor. Periudha për të cilën kërkohet informacion, përkon me periudhën e hartimit të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër për vitin 2020, raport i cili i është përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm me shkresën nr. 1942 prot, datë 01.03.2021, të protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. 68/19 prot., datë 04.03.2021.

I është dhënë informacion Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me një shkresë të Prokurorisë së Përgjithshme për masat e marra për zbatimin e dy udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ku përfshihet edhe udhëzimi nr. 12/2020, i Prokurorit të Përgjithshëm dhe urdhrin nr. 120/2020.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër konstatohet se Regjistri i Qarkullimit të Brendshëm të Korrespondencës, i parashikuar në Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, neni 20/2 nga germa "a" deri "dh" që përmban të gjitha të dhënat lidhur me kërkesat për informacion të Drejtuesit tek prokurorët, dhënien e informacionit nga prokurori për çdo rast Drejtuesit të Prokurorisë, udhëzimet jo të detyrueshme që nxjerr ky i fundit për prokurorët, apo refuzimi i ndjekjes së udhëzimeve etj., është mbajtur referuar periudhës së inspektimit. Regjistri ka filluar të plotësohet nga data 14.09.2020 nga sekretarja e ngarkuar nga Drejtuesi i Prokurorisë në mënyrë specifike për të mbajtur të gjithë praktikën e komunikimeve zyrtare mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve.

- Bazuar në nenin 20 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër në përputhje dhe me modelin e lidhjes 1, bashkëlidhur udhëzimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, është krijuar regjistri i posaçëm që dokumenton dhe regjistron të gjitha të dhënat lidhur me kërkesat për informacion nga Drejtuesi tek prokurorët, dhënien e informacionit nga prokurori për çdo rast, nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme. Regjistri i qarkullimit të brendshëm të akteve, ka filluar të vihet në veprim në datën 14.08.2020 dhe

nga sekretarja e caktuar për të mbajtur regjistrin, është rakorduar me prokurorët dhe regjistrin, ku numri rendor i akteve të regjistruara protokollohet.

- Në këto regjistra pasqyrohen kërkesa të ndryshme për marrje informacion, udhëzime jo të detyrueshme të nxjerra në zbatim të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe udhëzime të përgjithshme të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga këqyrja e fletëve të regjistrit të komunikimeve të brendshme të dërguara nga Prokuroria Shkodër, në kolonën "Lënda" rezultojnë të dhëna sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzimin nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, lidhur me llojin e shkresave që i kalohen për firmë Drejtuesit. Drejtuesi i Prokurorisë i ka kërkuar prokurorëve informacion në lidhje me statusin e kallëzimeve që kanë në dorë, në lidhje me faktin për regjistrimin e procedimit penal apo mosfillimit të procedimit penal.
- Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2020 janë regjistruar gjithsej 51 kërkesa, kërkesa për informacione, udhëzime jo të detyrueshme, informacione nga prokurorët. Nga këto akte 9 raste janë udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, 26 janë raste të informacioneve mbi çështjet në hetim, kallëzime të paregjistruara, procedime penale të mbartura etj., dhe 23 raste kërkesa dhe informacione për bashkim të procedimeve, heqje dorë, zëvendësime etj.

➤ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

• Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka dërguar informacion se bazuar në nenin 43, pika "b" të ligjit nr. 97/2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në nenin 12 e vijues të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar u ka kërkuar informacion prokurorëve mbi procedimet penale, të cilat pasqyrohen në regjistrin e komunikimeve të brendshme dhe ka marrë informacionin përkatës prej tyre.

Një rast është kërkesa për informacion që Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë i ka drejtuar prokurorit të çështjes, lidhur me ecurinë dhe gjendjen e procedimit penal nr. 903/2020. Kërkesa është regjistruar në regjistrin e komunikimeve të brendshme me nr. 1358, datë 08.03.2021. Në lidhje me këtë kërkesë rezulton se prokurori ka dhënë informacion në datën 09.03.2021, duke dhënë përgjigje të plotë të të gjitha kërkesave të parashtruara nga Drejtuesi i Prokurorisë në lidhje me ecurinë e procedimit penal (gjithsej 9 fletë). Gjithashtu, bashkangjitur kësaj praktike që ka të bëjë me marrjen e informacionit në lidhje me ecurinë dhe gjendjen e procedimit penal nr. 903/2020, gjenden edhe:

- Kërkesa e datës 03.03.2021, protokolluar, e shtetasit K. P., babait të viktimës A. P., për përjashtimin e prokurorit, nga procedimi penal nr. 903/2020, kërkesë kjo që është e regjistruar me nr. 503, datë 05.03.2021 në Krysekretarinë e Prokurorisë;

- E njëjta kërkesë, në lidhje me shkaqet dhe pretendimet për përjashtimin e prokurorit rezulton e paraqitur edhe në datën 04.03.2021, ku i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Rasti tjetër është kërkesa për informacion që Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë i ka drejtuar prokurorit të çështjes, që të japë informacion me shkrim lidhur me ecurinë dhe gjendjen e procedimit penal nr. 1604/2014. Kjo kërkesë është regjistruar në regjistrin e komunikimeve të brendshme me nr. 1160, datë 16.02.2021 dhe marrja dijeni për kërkesën nga prokurori i çështjes rezulton në datën 22.02.2021. Lidhur me këtë kërkesë, rezulton se prokurori i çështjes i ka dhënë përgjigje në mënyrë të plotë të gjitha kërkesave të parashtruara nga Drejtuesi në lidhje me procedimin penal nr. 1604, të vitit 2014, përsa i përket masës së sigurimit, veprimeve procedurale të kryera dhe planifikuar për t'u kryer nga prokurori përkatës dhe oficerët e policisë gjyqësore me delegim (*gjithsej 6 fletë*).

Një rast tjetër është kërkesa për informacion që Drejtuesi i Prokurorisë Vlorë i ka drejtuar prokurorit të çështjes, që të japë informacion me shkrim lidhur me ecurinë dhe gjendjen e procedimit penal nr. 2268/2016, kërkesa e cila është regjistruar në regjistrin e komunikimeve të brendshme me nr.1759, datë 06.04.2021. Në bazë të kësaj kërkesë, drejtuesi i prokurorisë ka marrë prej prokurorit informacion brenda ditës, në datën 06.04.2021, duke e vënë në dijeni drejtuesin e prokurorisë se hetimi për procedimin penal nr. 2268/2016, ka përfunduar dhe se në datë 01.04.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkesë për pushimin e çështjes (*gjithsej 8 fletë*). Nga krahasimi i të dhënave për komunikimin ndërmjet drejtuesit dhe prokurorit të çështjes me ato të pasqyruar në regjistrin e komunikimeve të brendshme vërehet se data në regjister e kërkesës figuron 14.04.2021, ora 13:30 dhe jo 06.04.2021, siç rezulton në dokumentacionin fizik (*çka mund të jetë edhe gabim material apo regjistrim me vonesë i këtij informacioni në Regjistrin e Brendshëm*).

• Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, përsa i përket detyrimit të Drejtuesit të Prokurorisë për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, rezulton se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë nuk është përcjellë informacion për zbatimin e këtij detyrimi ligjor të informimit periodik. Në lidhje me raportimin vjetor periudha e inspektimit, përkon me periudhën e hartimit të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për vitin 2020, raport i cili i është përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm me email në datë 17 mars 2021 "Mbi analizën vjetore 2020".

Bazuar në nenin 20 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, është krijuar regjistri i komunikimeve të brendshme, ku janë pasqyruar në të kërkesat e ndryshme për marrje informacion, nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme, sipas modelit të regjistrit referuar kësaj dispozite. Regjistri për komunikimin e brendshëm midis

Drejtuesit dhe prokurorëve në zbatim të udhëzimit nr. 12/2020, të ndryshuar, është krijuar në datën 2 shtator 2020. Në regjistrin për komunikimin e brendshëm, në veprimet administrative të kryera me nr. 1 rendor, datë 02.09.2020, pasqyrohet urdhri i Drejtuesit të Prokurorisë drejtuar kancelarisë për vënien në dispozicion të një kopjeje të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, në dijeni të gjithë prokurorëve. Pavarësisht se nuk është zhvilluar një mbledhje për të diskutuar rëndësinë që mbart njohja dhe zbatimi i udhëzimit nr. 12/2020, të ndryshuar, vënia në dijeni e tij, është bërë nëpërmjet qarkullimit, si akt nënligjor.

Nga këqyrja e fletëve të regjistrit të komunikimeve të brendshme të dërguara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kolonën "Lënda" rezultojnë të dhëna sikurse kërkohet në udhëzimin nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, mbi llojin e shkresave që i kalohen për firmë Drejtuesit. Nga këqyrja fizike e fletëve të regjistrit për qarkullimin e brendshëm të shkresave, kolonat paraqiten me mungesë të dhënash sqaruese lidhur me prokurorin që jep informacion apo kërkon shpjegime nga Drejtuesi, çështjen përkatëse, apo trajtimin përfundimtar të informacionit.

- Për periudhën e inspektimit, përsa i përket detyrimit të Drejtuesit të Prokurorisë për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, konstatohet se nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë nuk është përcjellë informacion për zbatimin e detyrimit ligjor të raportimit periodik. Lidhur me këtë çështje duhet theksuar fakti se edhe pse janë miratuar një sërë aktesh procedurale me karakter të përgjithshëm me qëllim marrjen e masave, në kuadrin e planit të veprimit mbi prioritetet të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Vlorë, mungon dhënia e informacionit për Prokurorin e Përgjithshëm, çdo tre muaj në lidhje me rezultatet e arritura. Është hartuar dhe dërguar Raporti Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për vitin 2020.
- Mungesa e dhënies të një informacioni në një periudhë të shkurtër një apo disa mujore, lidhet me faktin se parashikimi i dhënies së infomacionit çdo tre muaj që zë vend në nenin 42, pika l) të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e cila duhet të reflektohet edhe në nenin 6 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 4, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të kësaj prokurorie, për arsye se këto dispozita parashikojnë detyrueshmërinë e dhënies së informacionit nga Drejtuesit e prokurorive në mënyrë periodike. Neni 10 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, referon tek neni 50 i ligjit që lidhet me raportimin vjetor dhe që ka një afat të caktuar dhe raportimet e tjera periodike janë të përmendura konkretisht në nenin 42, shkronja l dhe si të tilla afatet janë të qarta referuar këtyre informacioneve të Drejtuesit përkundrejt Prokurorit të Përgjithshëm.

➤ **Prokuroria e Apelit Vlorë**

- **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**



Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Vlorë lidhur me udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", i ndryshuar, rezulton se për periudhën e kërkuar objekt inspektimi nuk ka kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë apo personi i deleguar prej tij, si dhe informacione të prokurorëve të kësaj prokurorie, sipas parashikimeve në Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar.

Pas komunikimit me Drejtuesin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, është kthyer në formë elektronike^[53] përgjigje në lidhje me zbatimin e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar. Në këtë informacion Drejtuesi aktual ka informuar se paraardhësi i tij^[54] për shkak të ngarkesës në institucionin që ai përfaqëson, nuk ka patur mundësi të krijonte regjistrin e qarkullimit të brendshëm të akteve procedurale, sikurse kërkohet në udhëzimin nr. 12/2020, të ndryshuar. Ai sqaron se nga fundi i vitit 2020 deri në fillim të vitit 2021 nga katër prokurorë që përmban organika, ka patur efektiv vetëm një prokuror. Nga janari i vitit 2021 deri në muajin shtator 2021 që ishte komanduar Drejtuesi i parë, për shkak të situatës së krijuar nuk krijoi regjistrin e komunikimeve të brendshme. Në fund të muajit shtator 2021, që është komanduar Drejtuesi aktual situata ishte e njëjtë, përveç faktit se kësaj prokurorie i është shtuar dhe një prokuror tjetër i ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Pavarësisht faktit që ende regjistri i komunikimeve të brendshme nuk është krijuar, Drejtuesi i ri i komanduar shprehu përgjegjësinë dhe detyrimin që si Drejtues i institucionit, në një kohë sa më të shpejtë, të marrë të gjitha masat për të përmbushur porositë dhe orientimet në bazë të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, përse i përket detyrimit të Drejtuesit të Prokurorisë për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rezulton se nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie nuk është përcjellë informacion për zbatimin e detyrimi ligjor të raportimit periodik. Në përmbushje të nenit 50, pika 2 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, është hartuar raporti vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për vitin 2020, raport i cili i është përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm me shkresën nr. 664 prot., datë 02.07.2021, të protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. 68/59 prot., datë 05.07.2021 "Mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Vlorë për vitin 2020".

⁵³ e mail me datë 01.02.2022 i Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë.

⁵⁴ Shkarkuar me vendimin nr. 448, datë 21.09.2021 të KPK.



- Lidhur me periudhën e inspektimit, bazuar në informacionin e përcjellë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Vlorë, për shkak të ngarkesës në këtë institucion, nuk ka patur mundësi të krijojë regjistrin e qarkullimit të brendshëm të akteve procedurale sikurse kërkohet në udhëzimin nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar (*informacion ky që është administruar në muajin shkurt 2022 në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*). Në këtë mënyrë, vlerësohet se pavarësisht arsyeve të përmendura nga Drejtuesi i Prokurorisë ai ka patur kohën e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet që lidhen me zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar në këtë Prokurori dhe prej muajit shtator 2021 deri në kthimin e përgjigjes, ku tashmë ishte shtuar dhe një prokuror tjetër nuk kishte krijuar ende rregjistrin e korrespondencës së brendshme procedurale. Mbajtja e regjistrit të qarkullimit të brendshëm, si detyrim i vendosur në udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm i shërben mbarëvajtjes së punës dhe respektimit të marrëdhënieve korrekte midis Drejtuesve dhe prokurorëve në Prokurorinë e Apelit Vlorë.

➤ **Prokuroria e Apelit Tiranë**

- **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Për periudhën kohore të inspektimit, organika e Prokurorisë së Apelit Tiranë përfshinte 9 prokurorë, ndërkohe që sipas informacionit të Drejtuesit të Prokurorisë për periudhën në fjalë, kanë ushtruar funksionin e prokurorit në mënyrë të plotë vetëm tre prokurorë. Drejtuesi i Prokurorisë e ka përshkruar mbulimin e ngarkesës nga tre prokurorët, si një ngarkesë mjaft të madhe në përballimin e çështjeve penale.

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 18, pikat 1 dhe 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Tiranë janë depozituar pranë Drejtuesit të Prokurorisë 50 informacione dhe 54 konkluzione/deklarata shkresore (deklaratat lidhen me heqjen dorë nga ankimi i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor), kur qëndrimi ligjor i prokurorit të shortuar për përfaqësimin e çështjeve penale në apel (qofshin kërkesa penale, çështje themeli apo dhe masa sigurimi) të ketë qenë i ndryshëm nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë apo dhe vetë vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Për periudhën e inspektimit, nga të dhënat e marra rezulton se nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit Tiranë, janë ushtruar 6 rekurse, nga dy për secilin prej tre prokurorëve që kanë ushtruar detyrën në këtë prokurori.

Në vitin 2021 konstatohen sërish paraqitja e informacioneve/konkluzione/heqje dorë nga i njëjti prokuror nga numri rendor 1, datë 08.01.2021 deri në numrin rendor 34, në datë 25.03.2021, që është data e fundit referuar periudhës së inspektimit. Gjithsej, edhe sipas dokumentacionit të dërguar, rezultojnë të jenë përgatitur nga prokurori i mësipërm 50

informacione (viti 2020 dhe 2021), 1 konkluzion dhe 1 heqje dorë nga ankimi i prokurorit ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor të vitit 2021.

Nga informacionet e paraqitura nga prokurori i Prokurorisë së Apelit Tiranë rezultojnë se 49 prej tyre janë lidhur me mosushtrimin e rekursit prej tij, dhe 1 rezultojnë të jetë informacion për ushtrimin e rekursit. Periudha kohore nga data e vendimit të Gjykatës së Apelit deri në datën e informacionit të prokurorit të apelit varion nga 1 ditë deri në 24 ditë.

Nga çështjet në fjalë, rezultojnë se ka patur edhe ankime nga ana e prokurorëve të çështjeve të shkallës së parë, dhe në to konstatohet se nga ana e prokurorit të seancës në apel është përkrahur ankimi. Për rastet e tjera, ku ka patur ankime nga personi nën hetim/i pandehuri/mbrojtësi, konstatohet se prokurori i seancës në apel ka mbajtur qëndrim lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Lidhur me këto çështje, nga ana e prokurorit të apelit janë përpiluar informacionet duke shprehur qëndrimin e tij për mosushtrimin e rekursit, pasi nuk janë kushtet ligjore të parashikuar nga neni 432 i K. Pr. Penale.

Nga të dhënat sa më sipër, rezultojnë se nga informacionet e njërit prej prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Tiranë drejtuar Drejtuesit të Prokurorit të Apelit, deri në datë 14.12.2020 referuar udhëzimit para ndryshimeve të datës 14.12.2020, 11 prej tyre janë brenda afatit 5 ditor.^[55]

Lidhur me konkluzionin dhe dekaratën e heqjes dorë, nga prokurori i apelit është hequr dorë në 2 raste nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë, ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor për ndryshimin e llojit të dënimit.

Në regjistrin e qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, ku figurojnë dy akte të një prokurori, të titulluara "deklaratë heqje dorë nga ankimi i ushtruar nga prokurori..." dhe "konkluzione për ankimin e vendimit penal..." ndërkohë që një gjë e tillë nuk evidentohet për prokurorin tjetër, nga Drejtuesi i Prokurorisë është shpjeguar se prokurori i çështjes ka zgjedhur këtë formë informimi për këto dy raste për shkak të ngarkesës së lartë në punë dhe ka depozituar kopjen e aktit të dorëzuar në gjykatë si mënyrë informimi. Ndërkohë prokurori tjetër, duke qenë se nuk ka ndjekur formën e aktit informues, por i ka paraqitur Drejtuesit kopjen e aktit që do të depozitonte në gjykatë, ku pasqyrohet qëndrimi dhe arsyetimi i tij, nuk ka menduar mundësinë për regjistrimin e tyre në këtë regjistër.

⁵⁵ Neni 18, pika 2 para Udhëzimit me nr. 12, datë 20.07.2020, parashikonte se: "Në rastet kur gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, prokurori jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditëve informon drejtuesin e prokurorisë të apelit nëse do të ushtrojë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit."

Kjo dispozitë ka ndryshuar me Udhëzimin nr. 16, datë 14.12.2020, duke parashikuar se: "Në rastet kur gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, prokurori informon drejtuesin e prokurorisë së apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga kërkesa e këtij të fundit, për vendimin dhe nëse do të ushtrojë rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit."

Në konkluzionet e prokurorit të dytë, konstatohet se bëhet fjalë për çështje në të cilat ankues rezulton të jetë personi nën hetim dhe qëndrimi i prokurorit ka qenë për ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor të evidentuara këto në 41 çështje. Deklaratat për heqje dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor evidentohen në 9 çështje.

Drejtuesi i Prokurorisë është shprehur lidhur me komunikimin, Drejtues nga njëra anë dhe prokurorit të caktuar për përfaqësimin e çështjes nga ana tjetër, duke e parë edhe në këndvështrimin e ngarkesës së madhe të punës së krijuar në zyrën e Prokurorisë së Apelit, ku megjithëse organika parashikonte 9 prokurorë, mbulimi i ngarkesës është bërë nga 3 prokurorë. Kështu lidhur me këtë, Drejtuesi i Prokurorisë shprehet se: *"Kjo situatë ka bërë që dhe diskutimi i çështjeve mes prokurorëve dhe drejtuesit (sidomos për sa i përket masave të sigurimit ku afatet e zhvillimit të seancës janë në kuadër tre ditor nga marrja e njoftimit për seancë) të realizohet shpesh dhe në mënyrë verbale (gjithnjë për rastet kur kemi qëndrim të ndryshëm në atë të shkallës së parë) dhe në çdo rast qëndrimi dhe mendimi juridik për çështjen ka qenë dakordësues dhe kjo dakordësi pasqyrohet në aktet e përpiluara nga prokurorët e të nënshkruara me dakordësi nga drejtuesi".*

Mbi praktikën e ndjekur në Gjykatën e Apelit, mbi llojin e korrespondencës procedurale, Drejtuesi i Prokurorisë ka shpjeguar se: *"... çdo dosje penale që vjen nga kjo gjykatë, në bazë të shortit të hedhur nga kjo e fundit, bëhet hyrje në dy regjistrat përkatës, atë të çështjeve penale me objekt masa sigurimi dhe atë të çështjes së themelit. Më pas hidhet shorti në prokurorinë e apelit, mbi bazën e të cilit, dosjet u vihen në dispozicion prokurorëve të shortuar, të cilët pasi njihen me aktet dhe bëjnë fotokopje të materialeve që ata konsiderojnë të nevojshme, kthejnë dosjet gjyqësore, të cilat po me protokoll, depozitohen në gjykatë. Krahas këtyre regjistrave është dhe regjistri i korrespondencës, ku pasqyrohen shkresat e ndryshme me çdo institucion ku përfshihet dhe gjykata e apelit".*

Lidhur me kërkesën mbi numrin e çështjeve për të cilat nuk është ushtruar rekurs, për periudhën e inspektimit, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, është informuar se *"nga ana e njërit prej prokurorëve janë paraqitur 52 informacione, nga të cilat nuk është ushtruar rekurs për 49 raste, nga të cilat 17 çështje i përkasin gjykimit në themel dhe pjesa tjetër për masa e sigurimit. Nga ana e prokurorit tjetër me aktin e datës 06.10.2021 është informuar se nuk është ushtruar rekurs në 18 raste masa sigurimi dhe 4 çështje themeli.*

Nga ana e drejtuesit të prokurorisë ka patur 9 (nëntë) çështje themeli (ku ndryshimi qëndron në diferenca në masa dënimi apo lloj dënimi dhe vetëm një rast ndryshim cilësimi juridik të veprës penale dhe në një rast vendimmarrje e gjyqtarit të hetimeve paraprake për dërgimin e çështjes për gjykim) 1 (një) rast me objekt gjykim kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe 18 çështje masash sigurimi ku vendimmarrja e gjykatës ka qenë e ndryshme nga kërkesat tona në seancë gjyqësore.

Pas ndryshimeve që Kodi i Procedurës Penale, pësoi me ndryshimet e ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017, objekti i rekursit të vendimeve të gjykatës së apelit, pësoi një kufizim, duke

evidentuar si mundësi rekursi vetëm për rastet kur evidentohet: 1. Mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; 2. Mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore; 3. Vendim i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ky ndryshim ligjor, passolli një vendimmarrje tashmë të konsoliduar të Gjykatës së Lartë, me pasojë mospranimin e ankimeve të bëra si nga organi i akuzës, ashtu dhe nga palët e tjera në procesin penal, kur rastet ishin debat mbi fuqinë provuese të akteve në gjykim, masat e dënimit si dhe vetë masa e sigurimit ku analizohej përshtatshmëria e masës së sigurimit me nevojat e sigurimit dhe rrethana e faktit. Në këto kushte, objekt diskutimi janë konsideruar rastet kur ligji procedural mundëson realizimin e rekursit dhe jo çdo vendimmarrje ndryshe e Gjykatës së Apelit, me qëndrimin e organit të akuzës. Ky qëndrim mundëson mosbërjen e rekurseve formale, element i cili sjell jo vetëm uljen e efektshmërisë së rekurseve, por dhe një ngarkesë fiktive dhe që ndikon drejtëpërdrejt në punën e Gjykatës së Lartë.”

Në informacionin e datës 06.10.2021 të prokurorit të prokurorisë së apelit, mbi mosbërjen e rekurseve dhe të arsyeve lidhur me qëndrimin në fjalë në çështjet në gjykim që u përkasin masave të sigurimit personal dhe të çështjeve të themelit, referuar periudhës së inspektimit, janë dhënë sqarime lidhur me rastet për të cilat konkluzioni i prokurorit ka qenë i ndryshëm nga vendimmarrja e Gjykatës së Apelit dhe konkretisht për 18 raste lidhur me masat e sigurimit personal dhe 4 raste për çështjet e themelit. Për çështjet në gjykim për masat e sigurimit personal, prokurorja është shprehur si arsye mosvlerësimin e saj të ushtrimit të rekursit pasi nuk ishin kushtet e parashikuara nga neni 432 i K. Pr. Penale, duke marrë në konsideratë edhe praktikën e Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme, praktikën e prokurorisë së apelit të diktuar nga praktika e Gjykatës së Lartë. Dhe në vazhdim, në këto rrethana për këto raste nuk është bërë informacion, duke u shprehur se: “pasi kam vlerësuar se duke qenë raste ku nuk vihej në diskutim ndonjë shkelje ligjore, informacionet me shkrim ishin të panevojshme. Duhet t’ju informoj se në asnjë rast nuk bëhet fjalë për vepra të rënda penale, me pasojë të rënda dhe në asnjë rast nuk bëhet fjalë për persona të dënuar më përpara për ndonjë vepër penale. Kanë qenë raste që lidhen direkt me vlerësimin e gjykatës që natyrisht jo gjithmonë është i njëjtë me vlerësimin e prokurorit”. Lidhur me çështjet e themelit për të cilat nuk është ushtruar rekurs bëhet fjalë për 4 raste, dhe për to pasi ka dhënë arsyet për mosushtrimin e rekursit për secilin rast lidhur me veprën, masën e dënimit e moshën e të pandehurit, është shprehur se: “Edhe këto raste janë konsideruar nga ana ime si të panevojshme për informim, pasi është jashtë çdo diskutimi që të ketë shkelje ligjore, por janë çështje vlerësimi të provave dhe rrethanave nga ana e gjykatës, pra jemi jashtë kushteve të nenit 432 të K. Pr. Penale”.

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtuesit është

informuar Prokurori i Përgjithshëm me të dhënat mbi gjendjen e kriminalitetit dhe/ose ecurinë e veprimtarisë në Prokurorinë e Apelit Tiranë, në tre raste, e më konkretisht:

1. Evidenca e treguesve për çështjet e shqyrtuara në themel, sipas veprave penale në Prokurorinë e Apelit Tiranë për periudhën janar-dhjetor 2020, sipas shkresës me nr. 116 prot., datë 09.02.2021.
2. Analiza vjetore e veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Tiranë për periudhën janar-dhjetor 2020, e dërguar me shkresën me nr. 67 prot., datë 26.02.2021 pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Evidenca e treguesve për çështjet e shqyrtuara në themel, sipas veprave penale në Prokurorinë e Apelit Tiranë për periudhën janar-mars 2021, e dërguar me shkresën me nr. 496 prot., datë 07.06.2021 pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Për periudhën e inspektimit, konstatohet se regjistri i qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, i parashikuar në udhëzimin nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, ku pasqyrohen informacionet përkatëse të prokurorëve, në lidhje me çështje të veçanta, drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit, si dhe udhëzimet jo të detyrueshme që nxjerr ky i fundit për prokurorët, është mbajtur duke filluar nga data 29.07.2020, që i përket numrit rendor 1 dhe ku është përshkruar informacioni i një prokurori dërguar Drejtuesit të Prokurorisë, e cila i është kthyer më pas prokurorit më datë 31.07.2020, më pas, numri rendor 2, vazhdon më datë 23.10.2020 të të njëjtit prokuror, duke u përmbyllur viti 2020 me numrin rendor 19 me paraqitjen e informacioneve nga i njëjti prokuror.

Për aktet dhe informacionet si më sipër, si dhe aktet e tjera konkluzione/deklaratë heqje dorë, rezulton se pasqyrohen në regjistër, duke u shënuar për secilin prej tyre një numër protokolli përkatës që përkon edhe me numrin rendor, emrin e prokurorit pa nënshkrim përkatës; data e dorëzimit nga prokurori për firmë tek Drejtuesi; data e kalimit të akteve nga prokurori për firmë tek Drejtuesi që në të gjitha rastet, është e njëjtë me datën e dorëzimit nga prokurori për firmë tek Drejtuesit; data e kalimit të akteve të firmosura tek prokurori që rezultojnë të jenë me një diferencë prej 24-48 orësh, duke mos përlllogaritur ditët e shtuna dhe të diela (janë vetëm disa informacione për të cilat nuk është shënuar data e kalimit të akteve tek prokurori dhe konkretisht në numrat rendor 2-27); dhe në fund nënshkrimi i marrësit që është nëpunësja përkatëse e zyrës së prokurorisë.

Këto akte të përshkruar si më sipër të prokurorit të Prokurorisë së Apelit që rezultojnë të jenë përshkruar edhe në regjistër, nuk janë të gjitha të nënshkruara nga Drejtuesi i Prokurorisë. Konstatohet nga këto akte, se vetëm konkluzioni dhe heqja dorë janë të nënshkruar nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, me shënimin "dakord me qëndrimin e prokurorit".

Nga të dhënat në regjistrin në fjalë, nuk konstatohen informacione/konkluzione/heqje dorë apo ndonjë akt tjetër procedural në emër të ndonjë prokurori tjetër, përveç një prokurori. Ndërkohë që nga dokumentacioni i dërguar, rezulton se në këtë periudhë inspektimi, janë përgatitur konkluzione/heqje dorë edhe nga një prokuror tjetër i kësaj prokurorie, dhe të cilat

rezulton se janë të nënshkruar nga Drejtuesi i Prokurorisë, me shënimin "dakord", "dakord me prokurorin" dhe "dakord me qëndrimin e prokurorit". Konstatohet gjithashtu se akt "deklaratë për heqje dorë nga ankimi ndaj vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë" nga prokurori në fjalë, janë 3 për vitin 2020 dhe 6 për vitin 2021; akt "konkluzione përfundimtare" janë 15 të vitit 2020 dhe 28 për vitin 2021.

Në informacionin e përcjellë nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë, është përfshirë edhe nxjerrja, në zbatim të udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Apelit Tiranë" në të cilën, janë normuar dhe marrëdhëniet mes Drejtuesit dhe prokurorëve dhe pasqyrimi i akteve në regjistrin përkatës. Kjo rregullore rezulton të jetë e datës 16.04.2021 dhe si e tillë, për shkak se është jashtë afatit të periudhës së inspektimit, nuk do të trajtohet.

- Lidhur me mënyrën e informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm", konstatohet se:
- Në Prokurorinë e Apelit Tiranë në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm ka filluar mbajtja e regjistrin përkatës të korrespondencës së brendshme procedurale, që në datën 29.07.2020, që i përket numrit rendor 1, por në të janë pasqyruar vetëm informimet e një prokurori, nga tre prokurorë efektivë në këtë zyrë. Informimet kanë qenë kryesisht lidhur me mosushtrimin e rekursit sipas parashikimeve të nenit 18 të udhëzimit dhe një rast ka qenë për ushtrimin e rekursit. Në këtë zyrë prokurorie ka patur edhe raste të tjera të mosushtrimit të rekursit, për të cilën nga Drejtuesi i Prokurorisë është arsyetuar si mënyrë e të proceduarit nga vetë prokurori në rrethanat e komunikimit verbal e kushtëzuar nga të qenit efektivë vetëm të tre prokurorëve njëri prej të cilëve në funksionin e Drejtuesit.
- Gjithashtu është konstatuar se në Prokurorinë e Apelit Tiranë, informimi i Drejtuesit të Prokurorisë bëhet edhe për deklaratat e heqjes dorë nga ankimi i prokurorit pranë gjykatës së shkallës së parë dhe konkluzionet përfundimtare të prokurorit të seancës, kur qëndrimi i tij është i ndryshëm nga prokurori i shkallës së parë apo edhe vendimi i gjykatës së srethit gjyqësor. Ky informim nuk gjen pasqyrim gjithmonë në regjistrin e korespondencës së brendshme procedurale, dhe kjo sipas Drejtuesit në varësi të mënyrës së informimit që është ndjekur nga secili prokuror.
- Lidhur me informimet përkatëse nga prokurorët e seancave tek Drejtuesi i Prokurorisë, nuk konstatohet që të ketë kërkesë të Drejtuesit për këto informacione.
- Në Prokurorinë e Apelit Tiranë, është konstatuar edhe informimi nga Drejtuesi i kësaj zyre te Prokurori i Përgjithshëm, dhe konkretisht informacion mbi gjendjen e kriminalitetit në funksion të parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, si dhe përgatitur raportin vjetor përkatës në funksion të detyrimit sipas nenit 50 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar. Konstatohet se dërgimi i evidencave të treguesve të çështjeve në themel sipas veprave penale është kryer në shkurt dhe qershor të vitit 2021. Dhe raportin vjetor sipas parashikimit konkret të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, është nisur për në Prokurorinë e Përgjithshme brenda muajit shkurt.

➤ **Prokuroria e Apelit Shkodër**

• **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Shkodër ka informuar se për periudhën kohore objekt inspektimi, në këtë prokurori kanë ushtruar funksionet vetëm dy prokurorë nga katër në organikë, ndër të cilët dhe Drejtuesi i Prokurorisë, i cili është caktuar përkohësisht në datën 16.11.2020 në detyrën e Drejtuesit aktual. Ai ka shpjeguar se përse i përket kërkesave për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe përgjigje të mundshme të prokurorëve të çështjes, nuk ka evidentuar raste për të cilat ka qenë e nevojshme bërja e kërkesave për informacion.

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër, me urdhrin nr. 40/1, datë 25.11.2020 "Për hapjen e regjistrit për qarkullimin e brendshëm të akteve në Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër" është krijuar regjistri për qarkullimin e brendshëm të akteve, i cili ka filluar të plotësohet dhe të funksionojë normalisht për dokumentimin dhe qarkullimin e shkresave, akteve dhe materialeve të tjera procedurale në këtë prokurori, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 20, pika 2 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Lidhur me komunikimin mes Drejtuesit dhe prokurorëve është vënë në dispozicion kopje e regjistrit të komunikimeve të brendshme midis Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve.

• **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Përse i përket këtij lloji informimi rezulton se me shkresën nr. 21, datë 11.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër, në bazë të kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm është informuar ky i fundit lidhur me funksionimin e Prokurorisë së Apelit Shkodër, udhëzimeve dhe akteve të nxjerra në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të ndryshuar.

Gjithashtu, me shkresën nr. 41, datë 15.01.2021, të Prokurorisë së Apelit Shkodër, është informuar Prokuroria e Përgjithshme lidhur me problematikat e gjyqimit, si dhe projekt udhëzimin lidhur me mënyrën e krijimit të fashikujve të gjyqimit, njësimit të praktikës, standardizimit dhe koordinimit të punës në zbatim dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar.

Në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, përse i përket detyrimit të Drejtuesit të Prokurorisë për informim periodik mbi gjendjen e kriminalitetit dhe Raportim Vjetor pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rezulton se nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie nuk janë përcjellë të dhëna për informim periodik të Prokurorit të Përgjithshëm, ndërsa mbi hartimin e Raportit Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit Shkodër për vitin 2020, ky raport i është përcjellë



Prokurorit të Përgjithshëm me shkresën nr. 231 prot., datë 24.02.2021, të protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr. 68/5 prot., datë 26.02.2021.

Përsa i përket mënyrës së informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori, si dhe informimi dhe raportimi i Drejtuesit të Prokurorisë te Prokurori i Përgjithshëm, konstatohet se:

- Në Prokurorinë e Apelit Shkodër, edhe pse është miratuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 50, datë 21.12.2020, i Drejtuesit të prokurorisë evidentohet se nuk ka kërkesa të mirëfillta për informacion sipas udhëzimit të përgjithshëm ndaj prokurorit që ushtron detyrën në këtë prokurori, si dhe nuk evidentohet nëse informimi i Drejtuesit bëhet nga deklaratat e heqjes dorë nga ankimi i prokurorit të gjykatës së shkallës së parë dhe konkluzionet përfundimtare të prokurorit të seancës, kur qëndrimi i tij është i ndryshëm nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë apo edhe vendimi i gjykatës së rrethit gjyqësor.
- Në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.12/2020, të ndryshuar, është krijuar dhe ka filluar mbajtja e regjistrit përkatës të korrespondencës së brendshme procedurale.
- Në Prokurorinë e Apelit Shkodër, është konstatuar edhe informimi nga Drejtuesi i kësaj zyre të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe hartimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, ndërsa nuk u konstatua informacion periodik mbi gjendjen e kriminalitetit në funksion të parashikimeve të nenit 42, shkronja "l" të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar. Është përgatitur Raporti Vjetor përkatës në funksion të detyrimit sipas nenit 50 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe nisur për në Prokurorinë e Përgjithshme brenda muajit shkurt 2021.

➤ Prokuroria e Apelit Korçë

• Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët

Nga Prokuroria e Apelit Korçë është përcjellë informacioni se mbi kërkesat për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë apo personi i deleguar prej tij, për periudhën e inspektimit 01.10.2020-31.03.2021, rezulton se prokurori i apelit Korçë në datën 09.10.2020 ka informuar Drejtuesin e Prokurorisë së Apelit Korçë, për heqjen dorë nga ankimi i prokurorit për çështjen penale "Ankim kundër vendimit nr. 286, datë 17.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me objekt "Vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit nën hetim R. H.". Drejtuesi i Prokurorisë pasi është njohur me informacionin, është shprehur dakord me kërkesën e prokurorit për heqjen dorë nga apeli i prokurorit. Shënimi i Drejtuesit datë 9.10.2020 është bërë me shkrim dore në aktin e prokurorit "Informacion për heqje dorë nga ankimi i prokurorit", ndërsa është

shënuar në regjistrë në datën 09.10.2020. Ky informacion i prokurorit të apelit Korçë rezultoi i protokolluar me nr. 3, datë 09.10.2020 në LPKB.^[56]

• **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Mbi praktikën e informimit dhe raportimit pranë Prokurorit të Përgjithshëm nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 është raportuar te Prokurori i Përgjithshëm mbi veprimtarinë e këtij institucioni nëpërmjet "Raportit mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Korçë për periudhën 01.01.2020-31.12.2020".

Në zbatim të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, rezultoi se mbi udhëzimin e përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë, është krijuar libri i protokollit të komunikimeve të brendshme (LPKB) sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar dhe ka filluar plotësimi dhe administrimi i tij sipas procedurës së përcaktuar në nenin 20 të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Lidhur me komunikimin mes Drejtuesit dhe prokurorëve është vënë në dispozicion kopje e regjistrit të komunikimeve të brendshme midis Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve, i cili rezultoi i plotësuar sipas parashikimeve të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.

- Për sa i përket mënyrës së informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori rezultoi se nuk ka raste konform neneve 8, pika 2, shkronja "c" dhe 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr.12/2020, të ndryshuar. Një rast ka të bëjë me informacionin e prokurorit të apelit për heqjen dorë nga ankimi i prokurorit të shkallës së parë, për të cilën nga Drejtuesi i Prokurorisë është rënë dakord, duke bërë shënim me shkrim dore në aktin e prokurorit. Ky informacion i prokurorit të apelit Korçë rezultoi i protokolluar me nr. 3, datë 09.10.2020 në LPKB⁵⁷. Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 12/2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, neni 18 "Informimi për përfaqësimin e çështjes në gjykatën e apelit", sipas të cilit prokurori informon Drejtuesin e Prokurorisë së apelit mbi gjendjen e gjykimit të çështjes në apel për çështjet me të pandehur me masë sigurimi arrest në burg, në rastet e mospranimit nga gjykata të kërkesave të prokurorit të apelit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës penale, llojin dhe/ose masën e dënimit nëse do të ushtrojë ankim kundër

⁵⁶ Sipas formatit standard të regjistrit "Në evidentimin e një praktike, shkruhet numri i plotë që merr dokumenti në regjistrin e protokollit. Nën numrin e plotë shkruhen fraksionet e numrit të plotë atë që marrin të gjitha dokumentet e një praktike deri në mbylljen e saj. Poshhtë numrit të plotë rezervohen rreshta për të regjistruar dokumentet me fraksion të praktikës së dhënë. Praktikën ndahen nga njera tjetra me një vijë të trashë. Kur lind nevoja praktika mund të transferohet në një faqe tjetër të regjistrit duke vënë shënim : "Kalon në faqen...".

⁵⁷ Sipas formatit standard të regjistrit "Në evidentimin e një praktike, shkruhet numri i plotë që merr dokumenti në regjistrin e protokollit. Nën numrin e plotë shkruhen fraksionet e numrit të plotë atë që marrin të gjitha dokumentet e një praktike deri në mbylljen e saj. Poshhtë numrit të plotë rezervohen rreshta për të regjistruar dokumentet me fraksion të praktikës së dhënë. Praktikën ndahen nga njera tjetra me një vijë të trashë. Kur lind nevoja praktika mund të transferohet në një faqe tjetër të regjistrit duke vënë shënim : "Kalon në faqen...".

vendimit të gjykatës së apelit, si dhe në rastet se pas ushtrimit të rekursit ka ardhur në dijeni të rrethanave të reja që i shërbejnë gjykimit të çështjes së rekursuar.

- Sipas pikës 2, të nenit 20 të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, rezulton se është krijuar dhe mbahet libri i Protokollit të Komunikimeve të Brendshme (LPKB) sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1, të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Për sa i përket informimit dhe raportimit të Drejtuesit të Prokurorisë të Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, sipas neneve 10, pika 3, në lidhje me dërgimin e Raportit Vjetor për vitin 2020.

➤ Prokuroria e Apelit Gjirokastër

- **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Nga të dhënat e marra nga Prokuroria e Apelit Gjirokastër, konstatohet se për periudhën kohore të inspektimit 01.10.2020-31.03.2021, kjo prokurori nga muaji korrik i vitit 2019 përfaqësohet nga një prokuror i vetëm, i cili ushtron edhe detyrën e Drejtuesit të përkohshëm pranë kësaj prokurorie.

Për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 18, pikat 1 dhe 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Gjirokastër, ka informuar se është njohur në kohë me udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar dhe me detyrimin për zbatimin e tij. Por, duke qenë se ushtron detyrën e prokurorit i vetëm në Prokurorinë e Apelit Gjirokastër ai ka shpjeguar se kërkesat për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe informacionet e dhëna nga prokurori sipas parashikimeve të udhëzimit të përgjithshëm nr.12/2020, të ndryshuar dhe krijimi i regjistrit të komunikimeve të brendshme mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve, sipas parashikimeve të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, prej tij si Drejtues dhe njëkohësisht prokuror i vetëm në Prokurorinë e Apelit Gjirokastër nuk kanë gjetur zbatim.

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është përcjellë informacioni se për periudhën e inspektimit, në lidhje me parashikimet e nenit 10, pika 3 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, sa i përket detyrimit për informim dhe raportim pranë Prokurorit të Përgjithshëm, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja "I" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është zbatuar ky detyrim sipas ligjit për sa i përket raportimit vjetor. Periudha brenda së cilës zhvillohet inspektimi datë 01.10.2020 deri në datë 31.03.2021, përkon edhe me periudhën e hartimit të Raportit Vjetor mbi ecurinë e punës në Prokurorinë e Apelit Gjirokastër për vitin 2020, raport i cili i është përcjellë Prokurorit të Përgjithshëm me email në datë 09.03.2021 "Mbi analizën vjetore 2020".

- Lidhur me Prokurorinë e Apelit Gjirokastër në bazë të faktit që në këtë prokurori ka ushtruar detyrën vetëm një prokuror, njëkohësisht dhe Drejtues i saj, për periudhën e inspektimit, konstatohet se nuk mund të gjenin zbatim kërkesa të Drejtuesit/informacione të prokurorit, si dhe krijimi i regjistrit të qarkullimit të brendshëm të korrespondencës procedurale, i parashikuar në nenin 20 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, pasi qëllimi i këtij regjistri është të pasqyrohen të gjitha komunikimet e brendshme mes Drejtuesit dhe prokurorëve, shkresave, akteve apo materialeve bashkëlidhur, ndërmjet tyre dhe kërkesave/informacioneve të përmendura më sipër, si dhe udhëzimet jo të detyrueshme që mund të nxirrte Drejtuesi për prokurorët.

➤ **Prokuroria e Apelit Durrës**

- **Kërkesa për informacion nga Drejtuesi i Prokurorisë për prokurorët**

Sipas informacionit të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, lidhur me informimin mbi përfaqësimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, sipas përcaktimeve të nenit 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës, u ka kërkuar vazhdimisht prokurorëve (nuk dokumentohet), që në dosjet e shortuara, secili prej tyre, të mbajë në vëmendje rastet e përfundimit të afateve të masave të sigurimit përpara datës së planifikuar për gjykimin e themelit të çështjes, informimin e Drejtuesit mbi rastet e identifikuar dhe procedimin në të tilla raste, me dërgimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës të kërkesave për shuarjen e masave të sigurimit. Kërkesa e Drejtuesit për mbajtjen në vëmendje dhe identifikimin e këtyre rasteve është bërë prezente vazhdimisht edhe në mbledhjet e prokurorëve të thirrura nga ana e tij, duke u pasqyruar edhe në procesverbalet me shkrim të këtyre takimeve (për ilustrim procesverbali bashkëlidhur). Në lidhje me këtë fakt, Drejtuesi i Prokurorisë ka shpjeguar se për shkak të mungesës së organikës së prokurorëve, si dhe të ngarkesës së vetë Drejtuesit të Prokurorisë pothuajse të barabartë me ngarkesën e prokurorëve të tjerë, është ndjekur metodika e diskutimit paraprak të çështjeve dhe nuk ka rezultuar për çështje me rëndësi për ushtrimin e ndjekjes penale të prokurorit, që prokurorët për qëndrim ndryshe, të informojnë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë sipas udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Ndërsa, për çështje të tjera të një shkalle më të lehtë, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë nuk është bërë ndërhyrje për qëndrimin që prokurori ka vlerësuar të mbajë në gjykim përse i përket dënimeve alternative, dënimeve me marzh dënimi të vogël, apo dhe në ndonjë rast në lidhje me masat e sigurimit ku nuk është përkrahur ankimi i prokurorit të shkallës së parë.

Lidhur me detyrimin e prokurorit të çështjes për informimin e Drejtuesit nëse do të ushtrojë apo jo rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit në rastet kur kjo gjykatë nuk ka pranuar kërkesat e prokurorit lidhur me fajësinë, cilësimin juridik të veprës, llojin dhe/ose masën e dënimit, informohet se, në praktikën e Prokurorisë së Apelit Durrës, prokurori menjëherë pas

përfundimit të çështjes, përmbyll fashikullin e gjykimit të prokurorit, me kartelën informuese të ecurisë së çështjes, e cila ndër të tjera përmban edhe një rubrikë mbi vlerësimin e prokurorit për ushtrimin e rekursit. Kjo kartelë, i paraqitet Drejtuesit, i cili, në disa raste kur konstaton se prokurori i çështjes nuk do të ushtrojë rekurs, u kërkon të pasqyrojnë në kartelë arsyet për mosushtrimin e rekursit (për ilustrim, modeli i kartelës bashkëlidhur).

- **Informacion/raportim i Drejtuesit të Prokurorisë për Prokurorin e Përgjithshëm**

Lidhur me informimin dhe raportimin pranë Prokurorit të Përgjithshëm, në zbatim të nenit 42, shkronja "I" të ligjit nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar për të garantuar zbatimin e udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës, ka nxjerrë akte të brendshme si:

-Udhëzimi nr. 1, datë 07.09.2020 "Për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, komunikuar dhe përcjellë Sektorit të Monitorimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

-Është hartuar rregullorja e funksionimit të Prokurorisë së Apelit Durrës, e cila është miratuar me urdhrin nr. 4, datë 27.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit. Ky akt i është komunikuar për njohje dhe zbatim prokurorëve dhe administratës së Prokurorisë së Apelit Durrës, si dhe është përcjellë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 84 prot., datë 27.01.2021.

-Për mbarëvajtjen dhe funksionimin e Prokurorisë së Apelit Durrës, janë nxjerrë gjithashtu edhe urdhra të brendshëm, përmes të cilëve janë ngarkuar detyra dhe përgjegjësi prokurorëve dhe punonjësve si për shembull për caktimin e zëvendës prokurorit, për caktimin e prokurorit për akses në databaza, për caktimin e prokurorit dhe nëpunësit koordinator në marrdhëniet me publikun dhe mediat, për caktimin e nëpunësit përgjegjës për programin e transparencës, urdhër për kryerjen dhe ndarjen e detyrave funksionale të administratës, si dhe urdhra të tjerë për mbarëvajtjen administrative të institucionit.

-Në zbatim të nenit 50, pika 2 të ligjit nr. 97/2016 "*Për organizimin, dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", të ndryshuar, Drejtuesi ka paraqitur brenda afatit ligjor, Raportin Vjetor të veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Durrës për vitin 2020. Ky raport është dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 218 prot., datë 25.02.2021.

Sa i përket regjistrin të komunikimeve të brendshme, sipas pikës 2, të nenit 20 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar dhe pikës 12 të udhëzimit nr. 1, datë 07.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës, qarkullimi i shkresave, akteve dhe materialeve hetimore, mes Drejtuesit dhe prokurorëve, kryhet përmes protokollimit në regjistrin e komunikimeve të brendshme. Në funksion të këtij komunikimi kryesekretarja krahas librit të protokollit të korrespondencave shkresore hyrëse dhe dalëse, ka krijuar Librin e Protokollit të Komunikimeve të Brendshme (LPKB) sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, dhe vijon me mbajtjen dhe administrimin e tij sipas procedurës



së përcaktuar në nenin 20 të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, (bashkëlidhur, fotokopje të librit LPKB).

- Për sa i përket mënyrës së informimit të Drejtuesve në prokurori nga prokurori rezulton se nuk ka raste të dokumentuara, konform neneve 8, pika 2, shkronja "c" dhe 18 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, pra, informacione të prokurorëve, mbi bazën e kërkesave të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit. Për këtë, sipas qëndrimit të Drejtuesit të Prokurorisë ndiqet praktika e vjetër me mbajtjen e një karteje në përfundim të gjyqimit të çështjes në apel, si dhe mbahet qëndrimi i diskutimit paraprak të çështjeve me prokurorët, ndërkohë që duhet të respektohen parashikimet e procedurës së nenit 18, pikat 1 e 2 të udhëzimit të përgjithshëm, duke i pasqyruar rastet e informimit sipas kësaj dispozite në regjistër.
- Për sa i përket informimit dhe raportimit të Drejtuesit të Prokurorisë të Prokurori të Përgjithshëm, rezulton se është zbatuar udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, sipas neneve 10, pika 3, duke dërguar Raportin Vjetor, është hartuar rregullorja e funksionimit të Prokurorisë së Apelit Durrës, janë nxjerrë gjithashtu edhe urdhra të brendshëm.
- Sipas pikës 2, të nenit 20 të udhëzimit nr. 12/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, rezulton se është krijuar libri i Protokollit të Komunikimeve të Brendshme (LPKB) sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.
- Sipas raportit vjetor për vitin 2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës rezulton se prokurorët pranë Gjykatës së Apelit Durrës në shumicën e rasteve kanë përkrahur ankimet e bëra nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si në Gjykatën e Apelit Durrës, ashtu dhe duke ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Po kështu vetëm në raste të veçanta rezulton se në disa raste nga prokurorët e apelit nuk është bërë përkrahja e ankimit të ushtruar nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës duke hequr dorë nga ankimi.

➤ Prokuroria e Përgjithshme

Nga Prokuroria e Përgjithshme janë përcjellë praktikat lidhur me informimin dhe raportimin pranë Prokurorit të Përgjithshëm nga ana e Drejtuesve të Prokurorive sipas parashikimeve të nenit 42, shkronjat "g" dhe "l" dhe nenit 50 të ligjit nr. 97/20 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe praktikën dokumentare të Sektorit të Monitorimit në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar.

- A) Në kuadër të informimit të Prokurorit të Përgjithshëm ka rezultuar se gjatë periudhës së marrë në inspektim nëpërmjet shkresës nr. 968/5, datë 01.10.2020 Prokurori i Përgjithshëm ju ka kërkuar prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, **informacion mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të**

Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020. Në kuadrin e zbatimit të Rekomandimeve Prioritare "Për ... luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020" miratuar me vendimin nr. 501, datë 24.06.2020, të Këshillit të Ministrave, udhëzimit të përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm" dhe urdhrin nr. 112, datë 27.07.2020 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e "Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020", të cilat u janë dërguar prokurorive me shkresën nr. 968/4, datë 27.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, në cilësinë e autoritetit që mbikëqyr zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe kujdeset për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, me synim për të monitoruar zbatimin tyre, Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar informacion për ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve, udhëzimit të përgjithshëm nr. 11/2020 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 112/2020, për zbatimin e rekomandimeve, të shoqëruar me treguesit statistikor për 9 mujorin e vitit 2020, dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet e prokurorisë, arritjet dhe problematikat, si dhe nevojat legislative apo buxhetore që vlerësohen se ndikojnë në zbatimin e tyre.

Prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, ju është kërkuar të informojnë në lidhje me masat administrative të marra sipas ligjit për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimin e një plan veprimi për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare, në përputhje me specifikat dhe gjendjen e prokurorisë; masat e marra në drejtim të riorganizimit të brendshëm; masat procedurale të marra në fazën e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzave/çështjeve në gjykim, në drejtimet dhe çështjet ligjore të trajtuara në rekomandime, si dhe për të lehtësuar dhe garantuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, në drejtimet: nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete në fazën e hetimeve paraprake për veprat penale sipas kompetencës lëndore dhe në drejtimet prioritare të rekomanduara; verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara; masat procedurale të marra nga prokurorët lidhur me rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit dhe për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 11/2020, ose udhëzimeve të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë për të garantuar zbatimin e tij, për rritjen e efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit dhe zbatimi i institutëve të reja të procedimit penal, sipas prioriteteve të rekomanduara, duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim i paligjshëm në vendimmarrjen e tyre, në drejtimet e përcaktuara, zbatimi i udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në fuqi, përfshirë dhe udhëzimin e përgjithshëm nr. 5/2018 "Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale" sipas fushave/drejtimeve prioritare të rekomanduara.

Në lidhje me sa më sipër, Drejtuesve të Prokurorive ju është kërkuar përcjellja e informacionit brenda datës 18.10.2020 në Prokurorinë e Përgjithshme, (zyrtarisht dhe në formë elektronike), të shoqëruar me aktet e nxjerra (udhëzim i përgjithshëm dhe/ose plan veprimi) në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 11/2020, mbi rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020.

Gjithashtu, gjatë periudhës së marrë në inspektim nëpërmjet shkresës nr. 943/6, datë 05.10.2020 Prokurori i Përgjithshëm ju ka kërkuar prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit, **informacion në kuadër të zbatimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019"** datë 18.06.2020 dhe urdhrin nr. 103, datë 17.07.2020 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020", të cilat janë dërguar për njohje e zbatim në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm me shkresën nr. 943/3 prot., datë 17.07.2020 të Prokurorisë së Përgjithshme. Në kuadër të monitorimit të zbatimit të tyre, Prokurori i Përgjithshëm ka kërkuar informacion për ecurinë e zbatimit të kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2020 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 103/2020, për zbatimin e saj, të shoqëruar me treguesit statistikor për 9 mujorin e vitit 2020, dhe me shpjegime mbi angazhimet e prokurorive, arritjet dhe problematikat, si dhe nevojat legjislative apo buxhetore që vlerësohen se dikojnë në zbatimin e tyre.

- ✓ **Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para** ju është kërkuar të informojnë në lidhje me masat administrative të marra sipas ligjit për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimin e një plan veprimi për të siguruar zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës, si dhe të dhëna të ndryshme në lidhje me kryerjen e hetimeve të thelluara për zbulimin e formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale; forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimit; rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për të rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe veçanërisht rritjen e kapaciteteve profesionale në luftën kundër pastrimit të parave e produkteve të veprimtarisë kriminale, krimit financiar dhe hetimeve pasurore, për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve/produkteve kriminale, numrin e hetimeve paralele për veprën penale të pastrimit të parave sipas tipologjive, në zbatim edhe të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, hetimet financiare e hetimet pasurore sipas tipologjive dhe sekuestrimin e aseteve/produkteve të veprës penale, si dhe mbi zbatimin e udhëzimit nr. 5/2018 "Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale" lidhur me trajtimin e viktimave dhe mbrojtjes së tyre gjatë procedimit penal në hetim dhe në gjykim, si dhe trajnimin e koordinatorëve të viktimave.

Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit me juridiksion të përgjithshëm ju është kërkuar të informojnë mbi ecurinë e çështjeve si më sipër, gjatë procesit të shqyrtimit të ankimeve në gjykatën e apelit, qëndrimet e mbajtura nga prokurorët me kërkesat e tyre dhe vendimmarrja e gjykatës në lidhje me to, arritjet dhe problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të tyre dhe sugjerime për marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen e tyre.

Drejtimesve të prokurorive ju është kërkuar përgatitja e informacionit dhe përcjellja e tij brenda datës 21.10.2020 në Prokurorinë e Përgjithshme, (zyrtarisht dhe në formë elektronike), të shoqëruar me aktet e nxjerra (udhëzim i përgjithshëm dhe/ose plan veprimi) në zbatim të planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 103/2020, për zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020.

Në përgjigje të kërkesave të Prokurorit të Përgjithshëm rezultojnë se Drejtuesit e Prokurorisë kanë dërguar në afat, por edhe pas kalimit të afatit,^[58] informacionin e kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjithashtu, në materialin e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 969/1 prot., datë 02.07.2021 nuk rezultojnë përgjigje me informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Prokuroria e Apelit Tiranë, Prokuroria e Apelit Shkodër dhe Prokuroria e Apelit Gjirokastrë.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës** në përgjigje të shkresës nr. 968/5 prot., datë 02.10.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka informuar me shkresën nr. 4139/1, datë 19.10.2020, në lidhje me zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, ecurinë e zbatimit të këtyre rekomandimeve dhe udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 11/2020, si dhe planit të veprimit të miratuar me udhëzimin nr. 112/2020, për zbatimin e rekomandimeve. Në përgjigje të shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 943/6 prot., datë 05/10/2020, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. 4137/1, datë 21.10.2020 ka dërguar informacion në lidhje me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 dhe urdhrin nr. 103, datë 17.07.2020 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020".

Sipas informacioneve të dërguara rezultojnë se janë zbatuar udhëzimi dhe urdhrat e sipërcituar lidhur me organizimin e mbledhjeve të përgjithshme të prokurorëve, të cilët janë njohur me rekomandimet prioritare dhe Rezolutën e Kuvendit, si dhe pas diskutimeve është nxjerrë një plan veprimi me nr. 79, datë 23.09.2020, për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare/kërkesave të Rezolutës së Kuvendit. Në drejtim të riorganizimit të brendshëm gjatë 9 muajve të vitit 2020, në zbatim të udhëzimit nr. 10/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm është nxjerrë urdhri nr. 69, datë 30.07.2020, për organizimin e brendshëm me krijimin e katër seksioneve. Për secilin nga prioritetet janë parashikuar masa konkrete, subjektet që do t'i zbatojnë, buxhetin e prokurorisë, i cili mbulon secilin prej këtyre masave. Gjithashtu, janë informuar të dhëna lidhur me veprat penale objekt i rekomandimeve prioritare, numrin e procedimeve të regjistruara dhe të përfundura, tipologjitë dhe problematikat, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe format e veçanta të bashkëpunimit. Sipas udhëzimit nr. 5/2018 "Rregullat për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale" në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ushtron rolin e koordinatorit për subjektet me status të posaçëm. Lidhur me masat procedurale gjatë fazës së hetimeve, ushtrimin të ndjekjes penale, përfaqësimit në gjykatë të akuzave/çështjeve Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ka informuar se prokurorët janë udhëzuar që të

⁵⁸ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër
Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës

përdorin urdhrat penale dhe marrëveshjet e fajësisë; në raste të veçanta, kur është çmuar e nevojshme, janë përpiluar udhëzime me karakter jo të detyrueshëm; është kërkuar informacion lidhur me procedime penale të mbartura, apo me persona të arrestuar.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan** me shkresën nr. 10125, datë 19.10.2020, ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me informacionin e kërkuar prej tij me shkresat nr. 943/6, datë 05.10.2020 "Mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020" dhe nr. 968/5, datë 02.10.2020 "Mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020".

Sipas informacionit të dhënë nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, janë marrë masat e nevojshme organizative për zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2020. Nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan janë nxjerrë urdhra dhe udhëzime të ndryshme për të mundësuar zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë të datës 18.06.2020, për funksionimin e policisë gjyqësore, për organizimin e seksioneve, për standardet e referimit të materialeve verifikuese dhe hetimit të çështjeve penale në lidhje me pastrimin e produkteve të vepres penale dhe hetimet pasurore; është nxjerrë plan veprimi i datës 27.07.2020 "Për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan"; është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 39, datë 07.09.2020 "Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"; është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 44, datë 09.10.2020 "Në bazë dhe për zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridksionit të Përgjithshëm"; janë nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete. Pas krijimit të seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimin e terrorizmit dhe hetimet pasurore është organizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë takim me prokurorët dhe Drejtuesin e këtij seksioni, duke ju bërë të ditur dhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit dhe Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave për vitin 2020 me qëllim rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve financiare. Informacioni vijon me numrin e procedimeve të regjistruara dhe të përfundura për veprat penale objekt i rezolutës dhe i rekomandimeve prioritare, si ato të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, përvetësimi i parave ose i mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale, veprat penale në fushën e doganave, në fushën e tatimeve dhe taksave, hetimin pasuror, korrupsionin, dhuna në familje, etj. Sipas udhëzimit nr. 5/2018 "Rregullat për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe



dëshmitarëve të veprave penale” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ushtron rolin koordinatori për subjektet me status të posaçëm.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier** ka dërguar informacionet me shkresën nr. 7893, datë 21.10.2020, në lidhje me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe me shkresën nr. 7767, datë 16.10.2020 mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, miratuar me VKM nr. 501, datë 24.06.2020, duke informuar se është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm “Për lehtësimin e zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”, si dhe urdhri “Për miratimin e planit të veprimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për zbatimin e “Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”. Në mbledhjet e përgjithshme të prokurorëve në Prokurorinë Fier prokurorët janë njohur në vazhdimësi me këto rekomandime me qëllim zbatimin efikas të tyre.

Informacioni në lidhje me zbatimin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit përfshin edhe numrin e procedimeve penale të dërguara për kompetencë pranë Prokurorisë së Posaçme, masat e marra në drejtim të riorganizimit të brendshëm, ku është nxjerrë urdhri nr. 62, datë 25.07.2020 “Për organizimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 10, datë 17.07.2020 “Për masat administrative dhe procedurale, për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe në hetimet pasurore në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”. Informacioni vijon me numrin e procedimeve të regjistruara dhe të përfunduara për kërkesat dhe veprat penale objekt i rezolutës, si bashkëpunimi ndërkombëtar, veprat penale të pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, veprat penale në fushën e tatimeve dhe taksave, hetimin pasuror, dhuna në familje, procedimet penale me të mitur, etj., si dhe zbatimit të udhëzimit nr. 5/2018 “Rregullat për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale” duke përzgjedhur prej muajit qershor 2019 koordinatorin pranë kësaj prokurorie.

Informacioni mbi zbatimin e Rekomandimeve Prioritare përfshin të dhëna për çështjet me të mitur, për çështjet e regjistruara kryesisht, marrdhëniet juridiksionale me jashtë, veprat penale në fushën e tatim taksave, krimet seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore, dhuna në familje, vjedhje duke shpërdoruar detyrën dhe shpërdorimi i detyrës, korrupsioni, vepra kundër mjedisit, vepra në fushën e narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose kriminale, materialet hetimore apo kallëzimet penale të dërguara për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme, bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare, zbatimit të urdhrit penal, gjykimin me marrëveshje për vepra penale prioritare të rekomanduara. Mbi bazën e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë Fier, është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 65, datë 04.09.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier". Lidhur me nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është informuar se është nxjerrë udhëzimi nr. 42, datë 20.05.2020 për kryerjen e veprimeve e mëtejshme procedurale në procedimin penal nr. 492, viti 2020. Lidhur me masat e marra nga Drejtuesi i Prokurorisë në kuadrin e masave që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare, është sqaruar se verifikimi i ecurisë dhe përfundimit të çështjeve për veprat penale të rekomanduara, ka qenë në vëmendje të Drejtuesit të Prokurorisë në çdo mbledhje të përgjithshme të zhvilluar me prokurorët, si dhe në mbledhjet me shefat e seksioneve. Lidhur me udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në fuqi, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Fier janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme me qëllim lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, të cilat u janë komunikuar të gjithë prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës, dhe institucioneve të tjera të interesuara. Si udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, ashtu dhe udhëzimet e Drejtuesit të Prokurorisë janë bërë objekt i mbledhjes me prokurorët, me qëllim kuptimin dhe zbatimin sa më efikas të tyre.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë** ka dërguar informacion me shkresën nr. 5790, datë 20.10.2020, në vijim të kërkesës me nr. 943/6, datë 05.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2020 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 103/2020, për zbatimin e saj. Me shkresën nr. 5799, datë 20.10.2020 ka dërguar informacion në përgjigje të kërkesës me nr. 968/5 prot., datë 02.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, udhëzimit të përgjithshëm nr. 11/2020 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 112/2020, për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020.

Informacioni përfshin të dhëna mbi masat administrative të marra sipas ligjit për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimin e një plan veprimi për të siguruar zbatimin e kërkesave/rekomandimeve të Rezolutës, ku në këtë drejtim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, ka sjellë në vëmendjen specifike të të gjithë prokurorëve kërkesat e Rezolutës, nëpërmjet mbledhjeve me të cilët kanë ngritur problematikën e konstatuar dhe arritjen e rezultateve; të dhëna që evidentojnë dhe tregojnë kryerjen e hetimeve të thelluara për zbulimin e formave të bashkëpunimit të veçantë në kryerjen e veprimtarisë kriminale; rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional për të rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale dhe veçanërisht rritjen e kapaciteteve profesionale në luftën kundër pastrimit të parave e produkteve të veprimtarisë kriminale, krimin financiar dhe hetimeve pasurore, për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve/produkteve kriminale; të dhëna që evidentojnë forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër krimin; të dhëna (statistikore dhe analitike) mbi numrin e hetimeve paralele për veprën penale pastrimi i parave sipas tipologjive, në



zbatim edhe të udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, procedimeve pasurore gjatë vitit 2020, nevojave për burime njerëzore, si dhe vlerësimi i gjendjes dhe adresimi i nevojave për trajnim të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe mbi zbatimin e udhëzimit nr. 5/2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale” lidhur me trajtimin e viktimave dhe mbrojtjes së tyre gjatë procedimit penal në hetim dhe në gjykim, si dhe trajnimin e koordinatorëve të viktimave.

Në informacionin e dërguar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, udhëzimit të përgjithshëm nr. 11/2020 dhe planit të veprimit të miratuar me urdhrin nr. 112/2020, për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, sa i takon masave administrative të marra sipas ligjit për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm dhe për hartimin e miratimit të një plan veprimi për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare, në përputhje me specifikat dhe gjendjen e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, në rastin konkret është vlerësuar nxjerrja e një udhëzimi të përgjithshëm, duke ju referuar përmbledhjes së rekomandimeve me qëllim dhënien e një orientimi më të qartë prioritetive të qeverisë. Në fokus të veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, ka qenë vënia e theksit të prokurorit të pavarur, i cili drejton me efikasitet hetimin e një çështjeje penale, parë që nga ana tjetër është veprimtaria e gjykatës ajo që përbën edhe mekanizmin kryesor të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit. Në lehtësim të garantimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm është disponuar me nxjerrjen e udhëzimeve nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë. Ky i fundit ka disponuar me nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje të veçanta. Njëkohësisht është kërkuar informacion për ecurinë e çështjeve të caktuara, me qëllim vënien e theksit tek veprimet hetimore të cilat çmohen me rëndësi për finalizimin me sukses të hetimit të një çështjeje të caktuar penale. Informacioni përfshin të dhënat mbi veprat penale kundër korrupsionit dhe krimin financiar, kundër krimin të organizuar, pastrimin e produkteve të veprës penale, aplikimin gjatë vitit 2020 institutet e reja të Kodit të Procedurës Penale të ndryshuar, urdhrin penal, gjykimin me marrëveshje, gjykimi i drejtpërdrejtë, bashkëpunimit institucional dhe veprave të tjera penale objekt i rekomandimeve.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër** në përgjigje të shkresës nr. 985/5, datë 02.10.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm ka dërguar informacion me shkresën nr. 7700/1, datë 20.10.2020, lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, si dhe në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020 “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm”, dhe urdhrin nr. 112, datë 27.07.2020 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020”. Me shkresën nr. 7699/1, datë 23.10.2020, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, në përgjigje të shkresës nr. 943/6, datë 05.10.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, është dërguar informacion në lidhje me masat e marra për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2019”, datë 18.06.2020

dhe urdhrin nr. 103, datë 17.07.2020 "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020".

luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, si dhe i udhëzimit të përgjithshëm Nr. 11, datë 20.07.2020 «Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm», dhe urdhrin nr. 112, datë 27.07.2020, «Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020», kjo duke pasur parasysh detajimet e mjaftueshme të këtyre akteve nënligjore dhe kohën e nxjerrjes së tyre. Nga ana tjetër, janë nxjerrë urdhra dhe udhëzime konkrete për çështje të caktuara nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe është kërkuar informacion në lidhje me çështje konkrete objekt i Rekomandimeve Prioritare, në lidhje me veprat penale në fushën e korrupsionit, veprat penale në fushën e narkotikëve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose vepimtarisë kriminale, hetimeve pasurore, procedimeve penale që janë hetuar me metodat speciale të hetimit, në lidhje me masat e dënimit për veprat penale në fushën e korrupsionit e shpërdorimit të detyrës, në fushën e narkotikëve, apo krimet kundër personit, procedimet penale me të mitur, në lidhje me forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, etj. Edhe në lidhje me udhëzimin nr. 5/2018 «Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale», informohet se është bërë një punë e kënaqshme jo vetëm me shpërndarjen dhe njohjen e tij, por edhe me zbatimin në praktikë të udhëzimit dhe dhënien e asistencës dhe mbështetjes së viktimave të veprës penale apo edhe dëshmitarëve.

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës në përgjigje të shkresës nr. 943/6, datë 05.10.2020 ka dërguar informacionin e kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 1050, datë 26.10.2020 për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë. Me shkresën nr. 1027, datë 21.10.2020 është dërguar informacioni mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020, i kërkuar me shkresën nr. 968/5, datë 2.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Me këto informacione janë parashtruar në mënyrë të përmbledhur, treguesit e përgjithshëm të punës në Prokurorinë e Apelit Durrës për periudhën janar - shtator të vitit 2020, për veprat penale në luftën kundër: korrupsionit, krimet të organizuar, pastrimit të parave, trafikimit, lëndëve narkotike, terrorizmit, nxitjes së urrejtjes, familjes dhe mjedisit, sipas rekomandimeve të Rezolutës dhe Këshillit të Ministrave.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë** ka informuar me shkresën nr. 548, datë 21.10.2020 për zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë datë 18.06.2020 dhe me shkresën nr. 540, datë 16.10.2020 ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm për zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020.

Informacioni i kësaj prokurorie përfshin, të dhënat lidhur me gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit, veprat penale kundër narkotikëve, veprat penale kundër krimit të organizuar, veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, masat e sigurimit, etj. Për vitin 2020 është parë si objektiv kryesor rritja e nivelit të përfaqësimit të akuzës në apel dhe ndjekja me përparësi e çështjeve në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, si dhe të urdhrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë** në përgjigje të shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm nr. 943/6, datë 05.10.2020 ka informuar me shkresën nr. 793, datë 20.10.2020, mbi zbatimin e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe urdhrin nr. 103, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutes së Kuvendit datë 18.06.2020".

Kjo Prokurori në përgjigjen e saj ka informuar se Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe urdhri nr. 103, datë 17.07.2020, i Prokurorit të Përgjithshëm, dhe materialet bashkëlidhur tyre, u janë shpërndarë të gjithë prokurorëve të kësaj zyre, me qëllim njohjen dhe trajtimin e tyre në mbledhjen e zakonshme periodike të prokurorëve të kësaj zyre. Këto materiale janë shqyrtuar në mbledhjen e prokurorëve të datës 20.07.2020. Nga diskutimet e prokurorëve u arrit në përfundimin, se për shkak të natyrës së përfaqësimit të akuzës në apel, ku nuk ka hetim paraprak dhe as seksione të policisë gjyqësore, nuk është e nevojshme që nga Drejtuesi i kësaj zyre të nxirrej një udhëzim i përgjithshëm i posaçëm për këtë çështje, pasi përcaktimet e urdhrin nr. 103, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit që shoqërojnë materialin janë të mjaftueshme për udhëheqjen e veprimtarisë së prokurorit të apelit në çështjet e trajtuara nga Rezoluta e Kuvendit dhe me fokus kryesor veprat penale në fushën e pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale. Gjithashtu, në të njëjtën mbledhje është rënë dakord që prokurorët të informojnë gjatë mbledhjeve periodike të rregullta, mbi çështjet e përfshira në Rezolutën e Kuvendit dhe urdhrin nr. 103, datë 17.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë** me shkresën nr. 785, datë 16.10.2020 i ka dërguar informacion Prokurorit të Përgjithshëm në përgjigje të shkresës së këtij të fundit me nr. 985/5, datë 02.10.2020, lidhur me, mbi zbatimin Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020.

Sipas informacionit, rezulton se udhëzimi i përgjithshëm nr. 11, datë 20.07.2020 së bashku me urdhrin nr. 112, datë 27.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe materialet bashkëlidhur tyre, u janë shpërndarë të gjithë prokurorëve, me qëllim njohjen dhe trajtimin e tyre në mbledhjen e zakonshme periodike të prokurorëve të kësaj zyre, ku në datën 07.09.2020 është zhvilluar një takim i posaçëm për këtë temë. Lidhur me masat administrative të brendshme, nga diskutimet e prokurorëve u arrit në përfundimin se për shkak të natyrës së përfaqësimit të akuzës në apel, nuk ishte e nevojshme që nga Drejtuesi

i kësaj zyre të nxirrej një udhëzim i përgjithshëm i posaçëm për këtë çështje, pasi edhe në këtë rast përcaktimet e udhëzimit nr. 11, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Plani i Veprimit që shoqërojnë materialin janë të mjaftueshme për udhëheqjen e veprimtarisë së prokurorit të apelit në çështjet prioritare. Lidhur me masat procedurale në fazën e përfaqësimit të akuzës në gjykim, nga mbledhja e përbashkët e prokurorëve u ra dakord që në të gjitha rastet e çështjeve të përfshira në rekomandimet prioritare, prokurorët, në përputhje me ligjin, të përkrahin qëndrimet apo apelimet eventuale të prokurorëve të shkallës së parë të gjyqimit, për sa u përket elementeve të tillë sikurse deklarimi i fajësisë, caktimit të llojit dhe masave të dënimit ndaj autorëve të veprave penale që përfshihen në rekomandimet prioritare. Së fundi, lidhur me përfaqësimin e akuzës në çështje ndaj të miturve në konflikt me ligjin apo ku viktimat është i mitur, nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Vlorë është informuar se me urdhrin përkatës të Drejtuesit të zyrës është krijuar seksioni për të mitur, me qëllim që ndaj këtyre subjekteve të zbatohen të gjitha garancitë e Kodit të Drejtësisë për të Miturit dhe të legjislacionit specifik.

B) Me shkresën nr. 1914, datë 30.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorive të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 97/2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*", - nenit 38, pika 2, shkronja "b" për mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, - nenit 38, pika 2, shkronja "i", për t'i kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë inspektime tematike ose hetime për shkelje individuale në lidhje me zbatimin e këtyre udhëzimeve nga Drejtuesit apo prokurorët, - nenit 38, pika 2, shkronjat "c" dhe "f", për të siguruar mbarëvajtjen e punës në prokurori përmes ushtrimit të funksioneve nga ana e Drejtuesve, si dhe në cilësinë e autoritetit që kujdeset për ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, në kuadër edhe të raportimit vjetor mbi gjendjen e kriminalitetit në Kuvendin e Shqipërisë, iu është kërkuar informacion në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, nga Drejtuesi i Prokurorisë:

a) për nxjerrjen e udhëzimit të përgjithshëm për të lehtësuar zbatimin e tij; b) për nxjerrjen e akteve të tjera sipas ligjit, (numrin total të udhëzimeve jo të detyrueshme, kërkesave për informacion, etj), si dhe c) të dhëna në lidhje me regjistrin e qarkullimit të brendshëm të akteve. Gjithashtu, është kërkuar informacion mbi masat e marra për zbatimin e urdhrin nr. 120, datë 08.09.2020 "*Për miratimin e disa shtesave në "Rregulloren Standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm" e miratuar me urdhrin nr. 32/2017"* dhe mbi masat e marra në zbatim të udhëzimit nr. 3, datë 29.12.2016 "*Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori*", nga Drejtuesi i Prokurorisë për hedhjen e shortit elektronik, në periudhën janar - dhjetor 2020.

Drejtuesve të Prokurorive iu është kërkuar përgatitja e informacionit dhe përcjellja e tij brenda datës 12.01.2021 në Prokurorinë e Përgjithshme (zyrtarisht dhe në formë elektronike), i shoqëruar me aktet e nxjerra (udhëzim i përgjithshëm dhe/ose urdhra) në përmbushje të detyrimeve ligjore të kësaj kërkesë për informacion. Në lidhje me këtë kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, në materialin e përcjellë nga Prokuroria e



Përgjithshme me shkresën nr. 969/1 prot, datë 02.07.2021, nuk rezultojnë përgjigje me informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokuroria e Apelit Gjirokastrë.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës** në përgjigje të shkresës së mësipërme ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm me shkresën nr. 30, datë 11.01.2021, lidhur me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, se Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Durrës ka nxjerrë udhëzimin nr. 1, datë 07.09.2020, për nxjerrjen e të cilit ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme duke dërguar edhe një kopje të këtij udhëzimi. Nuk ka patur raste për të cilat ka qenë e nevojshme nxjerrja e akteve të tjera, si udhëzime jo të detyrueshme, kërkesa për informacion etj. Me udhëzimin e Drejtuesit të Prokurorisë nr. 1, datë 07.09.2020, është krijuar edhe libri i protokollit të komunikimeve të brendshme (LPKB) sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të udhëzimit nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, dhe ndërkohë ka filluar edhe mbajtja dhe administrimi i tij sipas procedurës së përcaktuar në nenin 20 të Udhëzimit nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar.
- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë** me shkresën nr. 10, datë 12.01.2021, ka kthyer përgjigjen, se Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Korçë ka nxjerrë udhëzimin nr. 1, datë 10.09.2020 dhe nuk ka patur raste për të cilat ka qenë e nevojshme nxjerrja e akteve të tjera, si udhëzime jo të detyrueshme, kërkesa për informacion etj. Me udhëzimin nr. 1, datë 10.09.2020, është krijuar edhe libri i protokollit të komunikimeve të brendshme (LPKB) sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr. 1 të udhëzimit nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, dhe ndërkohë ka filluar edhe mbajtja dhe administrimi i tij.
- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Shkodër** ka informuar me shkresën nr. 21, datë 11.01.2021, se duke qenë në dijeni të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie është nxjerrë një udhëzim i përgjithshëm për të lehtësuar zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe janë nxjerrë akte të tjera, siç është ai për menaxhimin e çështjeve në prokurorinë e Apelit Shkodër, për hapjen e regjistrit për qarkullimin e brendshëm të akteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, etj.
- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë**, me shkresën nr. 2/1, datë 12.01.2021 ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm lidhur me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 *"Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm"*, të ndryshuar, duke i bërë të ditur, se nuk rezultojnë udhëzime të përgjithshme, akte apo kërkesa për informacion të nxjerra në funksion të këtij udhëzimi.
- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës** ka informuar me shkresën nr. 105, datë 11.01.2021, në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit



të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, sipas të cilave është prokuruar menjëherë regjistri përkatës, si dhe është zhvilluar mbledhja për njohjen e të gjithë prokurorëve me udhëzimin, se në zbatim të tij ishin nxjerrë gjithsej 8 (tetë) udhëzime jo të detyrueshme, dhe u është kërkuar informacion të gjithë prokurorëve lidhur me procedimet e mbartura nga viti 2018 dhe më parë, si dhe procedimet penale me persona të arrestuar në hetim mbi 3 muaj.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan** ka informuar me shkresën nr. 35, datë 06.01.2021, në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar. Sipas këtij informacioni, është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit të Prokurorisë nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 "Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12 dt. 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm". Pas muajit korrik 2020, deri në fund të vitit 2020, janë nxjerrë akte të tjera në zbatim të ligjit dhe konkretisht 3 (tre) udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, është mbajtur një akt konstatimi për çështje konkrete, si dhe është bërë një kërkesë për informacion për çështje konkrete.
- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier** ka informuar me shkresën nr. 9956/1, datë 08.01.2021, në lidhje me masat e marra në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, se në datën 04.09.2020 është nxjerrë udhëzimi nr. 65 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe Drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier". Përsa u përket akteve të tjera, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është nxjerrë një udhëzim jo i detyrueshëm për prokurorin e çështjes, janë bërë 16 (gjashtëmbëdhjetë) kërkesa për informacion, dhe pjesa tjetër janë komunikimet me të tretët. Në lidhje me protokollin e brendshëm të qarkullimit të akteve, është informuar se në datën 09.09.2020 u fillua mbajtja këtij regjistri, i cili dhe fillon me numër rendor 1 dhe mbaron me numër rendor 981.
- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër** me shkresën nr. 295, datë 08.01.2021, ka informuar Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm me nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar. Sipas informacionit, me administrimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, janë marrë masa nga Drejtuesi i Prokurorisë për shpërndarjen dhe njohjen e tij nga të gjithë prokurorët e kësaj prokurorie. Gjithashtu, udhëzimi në fjalë është trajtuar edhe në mbledhjen e prokurorëve dhe është diskutuar për mënyrat e zbatimit të tij. Në vijim të zbatimit të këtij udhëzimi dhe me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij, nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë udhëzimi i përgjithshëm nr. 33, datë 04.09.2020 «Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër». Gjithashtu, ka filluar zbatimi në praktikë i tij, duke nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme dhe kërkesa për informacion drejtuar prokurorëve në lidhje me çështje konkrete apo procedime penale të caktuara. Në vijim, është miratuar dhe nxjerrë regjistri i qarkullimit të brendshëm të akteve, që ka filluar të vihet në veprim në

datën 14.09.2020, në zbatim të parashikimeve të udhëzimit të përgjithshëm dhe gjatë periudhës shtator-dhjetor 2020, janë regjistruar kërkesa për informacione, udhëzime jo të detyrueshme, informacione nga prokurorët, si dhe rakordime të tjera, gjithsej 51 (pesëdhjetë e një) kërkesa. Nga këto, 9 (nëntë) raste janë udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, 26 (njëzet e gjashtë) raste lidhen me kërkesa për informacion në lidhje me dosjet në hetim, kallëzimet e paregjistruara, procedimet penale të mbartura, etj.

- ✓ **Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë** me shkresën nr. 13839/1, datë 14.01.2021, ka informuar në lidhje me masat e marra për zbatimin e udhëzimit nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar. Në zbatim të udhëzimit të mësipërm, është nxjerrë urdhri me karakter të detyrueshëm, duke specifikuar çdo detajim në funksion të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm. Janë nxjerrë udhëzime jo të detyrueshme apo edhe kërkesa për informacione.



4. Konkluzione:

Inspektimi u zhvillua dhe përfshi veprimtarinë e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, në të gjitha nivelet, duke u ndalur konkretisht në 7 (shtatë) prokurori pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë, të cilat përfaqësojnë edhe prokuroritë më të mëdha në vend, në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm të apelit dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Të dhënat e administruara nga zyrat e prokurorive të sipërpërmendura, për periudhën e inspektimit, mundësuan njohjen dhe konstatimin e efektivitetit të veprimtarisë së tyre mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar.

Nga këto të dhëna, u konstatua njohje e udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 12/2020 nga të gjitha zyrat e prokurorive subjekte të inspektimit, por jo një zbatim tërësor në funksion të përmbushjes së qëllimit të tij, e lidhur me rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, mes prokurorëve me Prokurorin e Përgjithshëm, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Konstatimet në secilën prej zyrave të inspektuara, evidentonin angazhimin për zbatimin e Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, në kuadër të zbatimit të ligjit me nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i dalë pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, që konsistonin në një decentralizim të pjesshëm funksional të prokurorisë në dallim nga sistemi i mëparshëm, ku prokuroria funksiononte si një organ i centralizuar. Këto ndryshime u diktuan nga problematikat⁵⁹ e vërejtura në funksionimin dhe organizimin e prokurorisë si një organ i centralizuar dhe thellësisht hierarkik, ndër të cilat edhe në drejtim të mungesës së pavarësisë funksionale të prokurorëve gjatë hetimeve paraprake, si rezultat i centralizimit të thellë të sistemit, që u njihte kompetenca të gjera prokurorëve më të lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, në veçanti, mbi hetimet e kryera nga prokurorët më të ulët.

Referuar sa më sipër, Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm objekt i këtij inspektimi, do të reflektonte një garanci më shumë në disiplinimin e autoritetit të prokurorëve më të lartë në raport me prokurorët e çështjes, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe pavarësisë së veprimtarisë së tyre nga njëra anë dhe për të siguruar uniformitetin e veprimtarisë së prokurorisë si organ i ndjekjes penale.

⁵⁹ shih Analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri hartuar dhe i miratuar me vendimin nr.14, datë 30.07.2015, nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar "Për Reformën në Sistemin e Drejtësisë", i ngritur me vendimin nr. 96/2014, datë 27.11.2014; Relacioni i projektligjit "Për prokurorinë në Republikën e Shqipërisë", miratuar me ligjin nr.97/2016.

Por konstatimet evidentuan në të gjitha nivelet e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm çështje të zbatimit të kufizuar dhe joefiçent të tij në disa drejtime, të analizuar për secilën zyrë në këtë raport dhe që do të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur më poshtë. Në të njëjtën kohë, çështje të tilla të lidhura me zbatimin e Udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, nuk u pasuan me konstatime të tjera si përpara ashtu edhe gjatë këtij inspektimi, të cilat në vlerësimin tërësor të tyre bazuar në kuptimin e një shkeljeje disiplinore sipas përcaktimit në nenin 101 të ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, do të mund të identifikonin veprime/mosveprime apo sjellje të magistratëve, si fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit disiplinor sipas procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Theksojmë këtu faktin, se nga të dhënat e marra për periudhën e inspektimit, nuk rezultoi ndonjë rast, që nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë si prokurori më i lartë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave sipas nenit 5, pika 5 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12 datë 20.07.2020, i ndryshuar, të jetë kërkuar fillimi i verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit lidhur me zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme. Po kështu, nuk ka pasur të dhëna lidhur me kërkesa të tilla edhe nga prokurorët përkundrejt Drejtuesit të Prokurorisë, zëvendësdrejtuesit, sipas parashikimeve të nenit 5, pika 6 të të njëjtit udhëzim. Në këtë vlerësim, është marrë në konsideratë edhe trajtimi dhe vendimi me nr. 31, datë 24.02.2022 i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilat lidhen me faktin e mosmbajtjes së regjistrit të komunikimeve të brendshme në një zyrë prokurorie pranë gjykatës së shkallës së parë, duke pamundësuar pasqyrimin e komunikimeve midis drejtuesit dhe prokurorit të çështjes në drejtim të kohës së dorëzimit për firmë me qëllim kalimi në gjykatë të një dosje hetimore, detyrim ky i parashikuar në nenin 20 të udhëzimit të Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12/2020. Në këtë vendim, ndër të tjera është arsyetuar se *“Nga përmbajtja e pikës 1 të nenit 20 të udhëzimit të sipërcituar konstatojmë se qëllimi i mbajtjes së regjistrit është tërësisht administrativ, për të garantuar transparencë në marrëdhëniet drejtues prokurorie-prokuror me qëllim për të garantuar respektimin e të drejtave dhe detyrimeve që lindin nga Ligji për Statusin. Regjistri nuk parashikon detyrime apo afate, se kur aktet apo kërkesat duhet të depozitohen pranë zyrës së drejtuesit të prokurorisë, pasi këto detyrime dhe afate janë parashikuar nga ligji procedural penal, ligje të tjera apo nene të tjera të Udhëzimit nr. 12/2020, por shërben vetëm për të dokumentuar datën dhe orën e dorëzimit, si dhe datën dhe orën e djaljes nga zyra e drejtuesit të prokurorisë. ... Duke iu kthyer arsyetimit të fillimit rezultoi se, mosmbajtja e regjistrit të komunikimeve të brendshme, mbi qarkullimin e shkresave/akteve/materialeve hetimore mes drejtuesit dhe prokurorëve të çështjeve, nuk ka sjellë asnjë pasojë, si për prokurorinë ashtu edhe për palët në proces. Në lidhje me arsyetimin e Inspektorit, se sjellja e magistratit ... “përbën mospërmbushje të detyrës së prokurorit, duke cënuar pozitën dhe figurën e një drejtuesi prokurorie i cili para së gjithash për shkak të faktit që konsiderohet prokurori më i lartë për të gjithë prokurorët e zyrës që drejton duhet të respektojë ai i pari udhëzimet e një prokurori më të lartë për të kërkuar zbatimin e udhëzimeve të tij përkundrejt tyre, që gjithsesi i janë dhënë si e drejtë dhe kompetencë përkishtë nga i ligj të cilin ai si magistrat nuk e zbaton tërësisht” çmojmë se, një arsyetim i tillë nuk është i bazuar, në rastin konkret. Në referim të Vendimit nr. 75/2002, të Gjykatës Kushtetuese, për të vlerësuar nëse veprimet apo*

mosveprimet e magistratit janë të tilla që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magistratit, ato do të vlerësohen rast pas rasti dhe kjo e lidhur me rrethanat e kryerjes dhe momentin subjektiv. Nga ana e magistratit ... është sqaruar në parashitjet e tij para Këshillit si dhe gjatë seancës dëgjimore, se: " mosmbajtja e regjistrit ka ndodhur edhe për arsye teknike dhe infrastrukture ". Gjithashtu, në kushtet kur ky regjistër është tërësisht administrativ dhe ka për qëllim të dokumentojë komunikimet e brendshme, mbi qarkullimin e shkresave/ akteve/ materialeve hetimore mes drejtuesit dhe prokurorëve të çështjeve, nuk mund të thuhet se mosmbajtja e këtij regjistri ka dëmtuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Referuar pikës 4, të nenit 134, të Ligjit për Statusin, e cila parashikon se: "... Referuar nenit 82 të Ligjit për Statusin, ku ndër të tjera parashikohet, se: Vlerësimi i veprimtarisë së kryetarit bazohet në këto burime: a) dosja personale e kryetarit; ... g) vendime përfundimtare për masa disiplinore, për shkak të pozicionit të kryetarit, ... i) çdo burim tjetër që evidenton veprimtarinë profesionale të kryetarit...", çmojmë se, sjellja e magistratit ... duhet të mbahet në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit etik dhe profesional si kryetar."

Më konkretisht, nga të dhënat e administruara nga zyrat e prokurorive subjekte të këtij inspektimi, u konstatua se:

- Në rastin e udhëzimeve të përgjithshme të Drejtuesve të Prokurorisë, sipas parashikimeve të nenit 42, pika g); nenit 43, pika dh); nenit 46, pika, 1, 2 dhe 4 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar se: "Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm", dhe neneve 5, pika 1 e 10, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, referuar temës objekt të inspektimit dhe fokusit të saj në tre drejtime kryesore, rezultoi se nga prokurorët më të lartë, Drejtues të Prokurorive të Shkallës së Parë dhe të Apelit janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme, më së shumti në drejtim të lehtësimit të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar dhe të tjera, ashtu si edhe nga disa Drejtues të Prokurorive nuk janë marrë masa të tilla. Nga veprimtaria e trembëdhjetë (13) prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të marra në studim për një periudhë 6 mujore, nga data 01.10.2020 deri në datën 31.03.2021, rezulton se nga nëntë (9) Drejtues përkatësisht të Prokurorive Tiranë, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë dhe të Apelit Shkodër, Korçë dhe Durrës, është nxjerrë nga një (1) udhëzim i përgjithshëm i këtij karakteri, përveç Drejtuesve të Prokurorive Elbasan, Fier, Tiranë dhe Shkodër, nga të cilët janë nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë Elbasan edhe tre (3) udhëzime të tjera të përgjithshme (ku njëri është përsëri për lehtësimin e zbatimit të një udhëzimi tjetër të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm) dhe nga Drejtuesit e Prokurorive Fier, Tiranë dhe Shkodër edhe nga një (1) udhëzim i përgjithshëm tjetër për çështje të tjera të funksionimit të prokurorisë. Nga Drejtues të tjerë, përgjithësisht të Prokurorive të Apelit, është më e theksuar mungesa e udhëzimeve të përgjithshme, si në Prokuroritë e Apelit Vlorë, Tiranë dhe Gjirokastrë (në këtë të fundit për shkak se Drejtuesi ka qenë prokuror i vetëm), nga të cilat vetëm në tre (3) prej prokurorive të Apelit Durrës, Shkodër dhe Korçë janë nxjerrë këto udhëzime nga shtatë (7) të tilla të

inspektuara, ndërsa mungon plotësisht nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme dhe e kërkesave për informacion/ informacione të prokurorëve.

- Konstatohet se në periudhën 6 mujore për të cilën është zhvilluar ky inspektim, udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, nuk është zbatuar nga Drejtuesit e Prokurorive të Apelit, ndërkohë që në Gjykatën e Apelit gjykohen një numër i lartë çështjesh dhe me rëndësi bazuar tek raportet vjetore të prokurorive të apelit. Nga këto prokurori, vetëm në Prokuroritë e Apelit Durrës, Shkodër dhe Korçë, është nxjerrë nga Drejtuesi i tyre një udhëzim i përgjithshëm për lehtësimin e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, ndërsa në prokuroritë e tjera të Apelit Vlorë, Tiranë dhe Gjirokastrë, nuk është nxjerrë asnjë udhëzim i përgjithshëm, si dhe në të gjitha prokuroritë nuk ka udhëzime jo të detyrueshme dhe kërkesa për informacion/ informacione të prokurorëve që përfaqësojnë akuzën në gjykimin në apel sipas parashikimeve të udhëzimit të përgjithshëm për këtë shkallë të gjykimin.
- Drejtuesit e Prokurorive rezultojnë se kanë marra masa me karakter të brendshëm organizativ, duke i vënë në dijeni të gjithë prokurorët në lidhje me përmbajtjen e udhëzimit nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar. Në rastet kur për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, është referuar se nuk janë nxjerrë udhëzime për lehtësimin e zbatimit të tij, pasi është direkt i zbatueshëm dhe thuhet se udhëzimi i përgjithshëm është diskutuar në mbledhje, mungon procesverbali i mbledhjes në lidhje me këtë fakt, por rezulton se prokurorët janë njohur me udhëzimin duke e shpërndarë me e-mail. Edhe kur nuk referohet që është zhvilluar mbledhje, por udhëzimet e përgjithshme u janë shpërndarë për njohje prokurorëve, nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme duhet të diskutohet në mbledhjet e prokurorëve në lidhje me problematikat e zbatimit të tyre.
- Në asnjë rast udhëzimet e përgjithshme të Drejtuesve të Prokurorive nuk rezultojnë të jenë ankimuar nga ndonjë prokuror i prokurorisë përkatëse pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, referuar nenit 47, pika 1 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar dhe nenit 5, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, kur prokurori vlerëson se udhëzimi i përgjithshëm i Drejtuesit është i pabazuar në ligj, apo është haptazi në kundërshtim me ligjin. Në asnjë prej udhëzimeve të përgjithshme, në pjesën e dispozitivit, nuk është pasqyruar e drejta e ankimit si pjesë e anës formale të aktit.
- Udhëzimet me karakter të përgjithshëm me disa përjashtime, përgjithësisht janë në harmoni me udhëzimin nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, dispozitat urdhëruese të ligjit Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe K. Pr. Penale, lidhur me rolin dhe veprimtarinë e Drejtuesit të Prokurorisë në kuadër të administrimit, informimit, transparencës dhe llogaridhënies së veprimtarisë hetimore dhe ushtrimit të ndjekjes penale në prokurorinë përkatëse.

- Në veçanti, në udhëzimet e përgjithshme të nxjerra nga disa Drejtues të Prokurorive janë evidentuar disa parashikime, që duket se nuk janë në përputhje/ apo në tejkalim të parashikimeve të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, si rasti i Udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan me nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm”; Udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër me nr. 33 prot, datë 04.09.2020 “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë”; Udhëzimit të përgjithshëm nr. 50, datë 21.12.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Shkodër “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë, dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”; Udhëzimit të përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë dhe Udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës me nr. 1, datë 07.09.2020 “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm”, që nuk kanë reflektuar ndryshimet e ndodhura sipas udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 16/2020, si rasti i Udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan me nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm”; Udhëzimit të përgjithshëm me nr. 65, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Fier “Mbi rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”; Udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër me nr. 33 prot, datë 04.09.2020 “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë”; Udhëzimit të përgjithshëm nr. 04, datë 04.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë Vlorë; Udhëzimit të përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020 të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Korçë dhe Udhëzimit të përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Durrës me nr. 1, datë 07.09.2020 “Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, që duket se nuk janë në përputhje/ apo kërkohet harmonizim me Kodin e Procedurës Penale dhe Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm ku mbështetet nxjerrja e udhëzimit nga Drejtuesi apo mospërputhje ndërmjet dispozitave të vetë udhëzimit në fjalë, përkatësisht në rastet e Udhëzimit me nr. 55 PBD, datë 11.12.2020 “Mbi kryerjen e ekspertimeve toksikologjike-kliniciste-adiktologjike” dhe Udhëzimit të përgjithshëm nr. 19 PBD, datë 03.03.2021 “Mbi ekzekutimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave të sigurimit “arrest në shtëpi”, si dhe mbi rregullat për njoftimin dhe shoqërimin e personave nën hetim/pandehur me masa sigurimi “arrest në shtëpi” me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore” të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

- Për sa i përket çështjes së udhëzimeve të përgjithshme vërehet se neni 46 i ligjit nr. 97/2016 i ndryshuar, në pikat 3 dhe 4, ndan prokurorët më të lartë që sipas pikës 1 nxjerrin udhëzime të përgjithshme të arsyetuara me shkrim, të natyrës administrative ose procedurale. Për Prokurorin e Përgjithshëm, në pikën 3, përcaktohet në mënyrë specifike se mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për koordinimin e punës ndërmjet prokurorive të ndryshme apo mes tyre dhe Policisë Gjyqësore, të përfshira në hetime të përbashkëta, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale; për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale, bazuar në vendimet gjyqësore; për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, për luftën kundër kriminalitetit; dhe për raste të tjera që nuk kanë lidhje me çështje konkrete. Pika e 4 e nenit 46 të ligjit përcakton se: Drejtuesit e Prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Pra, sipas dispozitës ligjore rezulton se janë të parashikuara shprehimisht çështjet për të cilat mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme Prokurori i Përgjithshëm dhe për të cilat mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme Drejtuesit e Prokurorive.
- Në pikën 2, shkronja “a” të nenit 7 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, është parashikuar se rregullat që disjelojnë autoritetin e Drejtuesve të Prokurorive si prokurorë më të lartë, në respekt të parimeve të ligjshmërisë dhe pavarësisë në ushtrimin e funksioneve të prokurorit janë:
 - a) respektimi i procedurës ligjore nga prokurori më i lartë për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme me shkrim dhe të arsyetuara:
 - i) për të siguruar zbatimin e ligjit material penal e ligjit procedural penal në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës/çështjes në gjykim, ushtrimin e të drejtës së ankimit nga prokurori dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, bazuar në vendime gjyqësore njësuase ose unifikuese të Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; (duke ju referuar në këtë rast nenit 438 të K. Pr. Penale mbi ndryshimin e praktikës gjyqësore në bazë të vendimeve të Kolegjit Penal dhe Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).
 - ii) për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë për luftën kundër kriminalitetit, që përcaktojnë përparësitë për zbatimin e politikës penale dhe/ose mënyrat e ndjekjes së tyre;
 - iii) për përcaktimin e një tërësi kriteresh në zbatim të ligjit dhe unifikuar vendimmarrjen për çështje apo grup çështjesh ligjore të njëjta, që trajtohen ose kualifikohen ndryshe nga prokurorët në të njëjtën prokurori ose në prokurori të ndryshme me juridiksion të përgjithshëm.
- Nga këto parashikime ligjore dhe nënligjore, duket se formulimi i nenit 7, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, jep kuptimin për nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme të detyrueshme nga Drejtuesit e Prokurorive si prokurorë më të lartë edhe për çështjet që i takojnë Prokurorit të Përgjithshëm sipas nenit 46 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, megjithëse nga asnjë prej Drejtuesve të Prokurorive nuk është

nxjerrë ndonjë udhëzim i përgjithshëm në këto fusha. Neni 7 i udhëzimit të përgjithshëm përcakton drejtimet për të cilat mund të jepen udhëzime të përgjithshme dhe nga vetë formulimi i pikave i), ii), iii) në këtë nen, kuptohet se ato i takojnë Prokurorit të Përgjithshëm. Neni 10 i udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar parashikon rastin e nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme nga Drejtuesit e Prokurorive për lehtësim të zbatimit të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, ndryshe nga neni 46, pika 4 i ligjit sipas të cilit Drejtuesit mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme jo vetëm për lehtësim, por edhe drejtpërdrejt të natyrës administrative ose procedurale.

- Në periudhën e marrë në inspektim, për rastet kur ligji dhe udhëzimi lejon nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, u konstatuan raste të nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme pas kërkesës për informacion të Drejtuesit të Prokurorisë, ashtu sikurse nga Drejtuesi është marrë informacioni pa u proceduar me nxjerrjen e udhëzimit sipas vlerësimit të tij, çfarë do të thotë, se kompetenca për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme ushtrohet mesatarisht pak, si në rastin kur nga prokurori është marrë informacioni i kërkuar apo edhe kryesisht nga Drejtuesi (njëkohësisht udhëzimi i përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar parashikon edhe thjesht informimin e Drejtuesit pa vijimin me nxjerrjen e udhëzimeve të detyrueshme). Në fakt, për këtë duhet patur parasysh koha dhe ngarkesa, si dhe fakti se edhe në rastet e parashikuara, nxjerrja e udhëzimeve jo të detyrueshme për prokurorët më të lartë është një mundësi e tyre dhe jo detyrueshmëri. Konkretisht, në analizën e kërkesave për informacion dhe udhëzimeve jo të detyrueshme, në total, për të gjitha prokuroritë, rezulton se janë nxjerrë brenda periudhës 6 mujore, 35 (tridhjetë e pesë) udhëzime jo të detyrueshme, ndërsa numri i kërkesave të Drejtuesve mund të llogaritet mbi 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) të tilla, që u japin mundësinë Drejtuesve të Prokurorisë për të nxjerrë udhëzim jo të detyrueshëm.
- Nga Drejtuesit e Prokurorive evidentohet kuptim dhe zbatim jo në harmoni me parashikimet e nenti 48, pika 3 të ligjit 97/2016, i ndryshuar, sa i takon nxjerrjes kryesisht të udhëzimeve jo të detyrueshme, të cilat duhet të jepen në momentin e referimit të veprës penale ose regjistrimit të kallëzimit penal dhe caktimit me short të prokurorit përkatës. Për këtë moment, Drejtuesit vijnë në dijeni nga zyra e regjistrimit në prokurori, e cila njofton Drejtuesin për çdo vendim për regjistrimin e procedimit penal të marrë nga prokurorët sipas neni 12, pika 1 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të ndryshuar apo bazuar në rregulloren standard mbi përdorimin e regjistrave, ku përcaktohet se çdo material kallëzues pasi regjistrohet në sekretari, verifikohet nga Drejtuesi, i cili urdhëron bërjen e shënimeve në regjistrin përkatës.
- Gjithashtu u evidentuan edhe raste të nxjerrjes së udhëzimeve jo të detyrueshme në rastet e kërkesave të palëve apo nga vetë prokurori për zëvendësimin e tij, me anë të të cilave është udhëzuar vazhdimi i përfaqësimit të çështjes në gjykim apo në hetim. Për këto udhëzime konstatohet se nuk i përmbahen natyrës së udhëzimit jo të detyrueshëm të parashikuar në ligj dhe në udhëzimin e përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr.

12/2020, të ndryshuar edhe pse rezultojnë të jenë dhënë me shkrim dhe të arsyetuara, por se referuar mënyrës së inicimit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet, duket sikur jemi para një akti për mospranimin e kërkesës për zëvendësimin e prokurorit referuar nenit 27 të K. Pr. Penale, për të cilën nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë procedohet me vendim.

- Në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme, jo në të gjitha rastet bëhet e qartë mënyra e ardhjes në dijeni të drejtuesit, për materialet për të cilat do të jepet udhëzimi. Kjo ka të bëjë me mënyrën dhe procedurën për nxjerrjen e udhëzimit jo të detyrueshëm mbi bazë kërkesë të drejtuesit dhe informacionit të prokurorit apo kryesisht nga ky i fundit. Siç u përmend, evidentohet se në rastin kur drejtuesi i prokurorisë ka marrë informacion nga prokurorët, mbi bazën e kërkesës së tij, ky informacion nuk është pasuar me nxjerrjen e ndonjë udhëzimi jo të detyrueshëm, ashtu siç ka edhe raste që udhëzimi jo i detyrueshëm nuk ndjek procedurën e parashikuar në dispozitat e veçanta të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm. Është e rëndësishme të theksohet kjo, duke patur në konsideratë edhe qëllimin e kërkimit të informacionit, si një kompetencë e Drejtuesit të Prokurorisë gjatë ushtrimit të ndjekjes penale. Gjithashtu, vihet re se një pjesë e mirë e udhëzimeve jo të detyrueshme nuk i përgjigjen natyrës dhe qëllimit të këtij lloji udhëzimi, ose përdoret në raste që parashikohet vetëm informimi. Evidentohet se vetëm në një rast ka patur kundërshtim të udhëzimit jo të detyrueshëm apo prokurori nuk ka qenë dakord me udhëzimin dhe ka kërkuar shpjegime me shkrim, por edhe në këtë rast nuk ka një ndjekje nga ana e Drejtuesit në drejtim të përsëritjes së udhëzimit sipas parashikimeve të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, si dhe nuk mund të konkludohet plotësisht se udhëzimet jo të detyrueshme kur janë dhënë janë ndjekur nga prokurorët. Në drejtim të procedurës evidentohet gjithashtu se evidentohen raste kur nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë në udhëzimin e përgjithshëm të tij, janë parashikuar afate me të shkurtra (3 ditë) për prokurorin për t'iu përgjigjur udhëzimit jo të detyrueshëm të nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë, ndryshe nga sa parashikohet në nenin 11 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar, sipas të cilit ky afat është 5 (pesë) ditë.
- Evidentohet se udhëzimet “Udhëzim jo i detyrueshëm” apo “Udhëzim i Përgjithshëm” të nxjerra nga zyrat e prokurorive objekt inspektimi, nuk kanë një unifikim në drejtim të formatit që ndjekin, duke filluar që nga titulli, përmbajtja, baza ligjore dhe disponimi, duke treguar qëllimin, pjesën hyrëse, pjesën arsyetuese dhe dispozitivin me pjesën udhëzuese. Fakti i konstatuar lidhur me udhëzimet jo të detyrueshme, evidentohet edhe brenda një prokurorie, si në rastin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.
- Në periudhën e inspektimit, përveç 2 (dy) rasteve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe 1 (një) rasti në bashkëpunim me Drejtuesin e Prokurorisë në Fier, vihet re fakti që Drejtuesit e Seksioneve nuk përfshihen në nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme në varësi edhe të veprave penale të rëndësishme.


- Në udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, ndër të tjera përcaktohet marrëdhënia procedurale mes Drejtuesit të Prokurorisë dhe prokurorëve, e cila është dhe një nga drejtimit ku u përqendrua inspektimi tematik, sipas të cilit Drejtuesi i Prokurorisë ka të drejtë të informohet, me kërkesë të tij, për çështje konkrete dhe për këto çështje mund të japë dhe udhëzime me shkrim për prokurorin e çështjes, të cilat nuk janë të detyrueshme për të. Mënyrat e informimit të Drejtuesit të Prokurorisë ndahen sipas niveleve të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm, ku sipas ligjit dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të ndryshuar, informimi është detyrim i prokurorit mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë, por në raste të caktuara edhe paraprakisht pa u kërkuar nga Drejtuesi. Në periudhën e marrë në inspektim nuk u konstatua ndonjë rast i informimit paraprakisht të Drejtuesit të Prokurorisë pa kërkesë të këtij të fundit, edhe pse në një periudhë 6 mujore mund të prezumohet se ka çështje në të cilat prokurorët kanë nxjerrë urdhër ndalimi apo kanë kërkuar masa të sigurimit personal, ndërsa kuptohet që pritshmëria në praktikë është se nga prokurorët nuk ka informacione të kësaj natyre me shkrim, edhe për faktin se nxjerrja masave të tilla mund të jetë diskutuar paraprakisht ose informacioni të jetë verbal. Gjithashtu, në lidhje me nenin 13 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar vlerësohet se është e rëndësishme të tregohet kujdesit i duhur në mbikëqyrjen procedimeve penale, ku janë të vendosura masat e sigurimit personal/pasuror apo hetimet pasurore, ku janë aplikuar masa ndaj pasurisë sa i takon afateve të masave të sigurimit apo masave ndaj pasurisë dhe mbarëvajtjes së këtyre procedimeve penale/pasurore, duke stimuluar prokurorët të jenë të kujdesshëm për të respektuar afatet e procedimit, si dhe duke zbatuar udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.
- Rezulton se në shumicën e rasteve, nuk informohet në kohën e duhur dhe nga të gjithë prokurorët pas kërkesave për informacion të Drejtuesve të Prokurorisë. Siç është cituar edhe nga disa Drejtues në raportet e tyre statistikore, kjo ka ndodhur pasi prokurorët paraqesin ankesa në lidhje me ngarkesën e tyre për sa i përket hetimit dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve penale. Në lidhje me kërkesat për informacion të Drejtuesit të Prokurorisë, u parashtrua se informacioni i prokurorëve mund të jetë edhe verbal, mënyrë kjo që mund të aplikohet paraprakisht, pasi komunikimi i Drejtuesit me prokurorin e çështjes nuk është vetëm me shkrim. Në këtë komunikim përfshihen edhe informacionet, të cilat janë normale të jepen edhe me gojë referuar periudhës së gatishmërisë sipas parashikimeve të nenit 12, pika 2 e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe gjatë periudhës së kërkesave për ndalim, për masa sigurimi, etj, të karakterit urgjente. Nuk mundet të kuptohet në këto raste, që çdo komunikim në funksion të ndjekjes penale, për të cilën Drejtuesi është edhe personi hierarkik përfaqësues i prokurorisë, të presë deri në përgatitjen e informacionit me shkrim nga prokurori i çështjes.
- Evidentohet fakti se, edhe pse janë miratuar një sërë aktesh procedurale me karakter të përgjithshëm me qëllim marrjen e masave, nuk ka pasur të dhëna për raportim periodik tek Prokurori i Përgjithshëm.

- Në Prokurorinë e Përgjithshme për periudhën 6 mujore të inspektimit nuk evidentohen të dhëna për ndonjë rast, që prokurorët e kësaj prokurorie informojnë Prokurorin e Përgjithshëm për çështjet që përfaqësojnë në Gjykatën e Lartë apo në Gjykatën Kushtetuese dhe si bëhet ky informim, siç është parashikuar në nenin 19 të udhëzimit të përgjithshëm nr.12/2020, të ndryshuar, sipas të cilit *“Prokurori në Prokurorinë e Përgjithshme që përfaqëson akuzën dhe/ose çështjen mbi rekurs në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë apo që përfaqëson Prokurorinë e Përgjithshme në gjykimin e çështjeve në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ose në Gjykatën Kushtetuese me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, informon për secilën çështje dhe në vazhdimësi Prokurorin e Përgjithshëm, për natyrën dhe problematikën e çështjeve që shqyrtohen në Gjykatën e Lartë ose Gjykatën Kushtetuese dhe për shkeljet e ligjit penal dhe/ose ligjit procedural penal në ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq të evidentuara në përfaqësimin e çështjeve nga prokurorët e prokurorive të shkallës së parë dhe të prokurorive të apeleve me juridiksion të përgjithshëm”*.
- Në periudhën kohore të inspektimit është evidentuar nxjerrja e një sërë udhëzimesh të përgjithshme nga Prokurori i Përgjithshëm për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të përmendura në pikën 3.2 të këtij raporti, si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre me anë të kërkesave për informacion. Lidhur me kërkesat e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, Rezolutës së Kuvendit dhe për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave, gjatë kësaj periudhe është evidentuar se nga disa zyra prokurorie ka munguar dërgimi i informacionit si, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Prokuroria e Apelit Gjirokastër (Prokuroria e Apelit Tiranë dhe Prokuroria e Apelit Shkodër rezultojnë se i janë përgjigjur vetëm kërkesës mbi zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar) dhe tek disa të tjera vonesa në dërgimin e informacionit si, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër dhe Prokuroria e Apelit Durrës. Lidhur me dërgimin e raporteve vjetore me qëllim raportimin në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit dhe për zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave për luftën ndaj kriminalitetit për vitin 2020, të gjitha prokuroritë kanë dërguar te Prokurori i Përgjithshëm raportet vjetore të veprimtarisë së tyre për vitin 2020 në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 50 të ligjit nr. 97/2016 të ndryshuar, ndonëse nga njëra zyrë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është dërguar në tejkalim të afatit.
- Bazuar në nenin 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm të shkallëve të para dhe të apelit është krijuar Regjistri i Korresponcës së Brendshme Procedurale (përveç Prokurorisë së Apelit Vlorë⁶⁰) sipas modelit të përcaktuar nga Prokurori i Përgjithshëm,

⁶⁰ Përgjigja me e_mail e datës 01.02.2022 e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë. Prokuroria e Apelit Shkodër ka krijuar regjistrin rreth 2 muaj pas hyrjes në fuqi të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të

The bottom of the page features several handwritten signatures in blue ink. To the right, there is a blue circular stamp with illegible text inside. The signatures appear to be from various officials, including the Inspector General and representatives of the prosecutive bodies mentioned in the text.

ndërsa për sa i përket të dhënave të këtij regjistri ato në disa prej prokurorive nuk pasqyrohen në përputhje me rubrikat përkatëse. Në këto regjistra pasqyrohen akte sipas parashikimeve të dispozitës së mësipërme si, kërkesa të ndryshme për marrje informacioni, udhëzime jo të detyrueshme të nxjerra në zbatim të udhëzimit nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, si dhe udhëzime të përgjithshme të Drejtuesve respektivë. Të dhënat e përftuara për periudhën e inspektimit në lidhje me udhëzimet e përgjithshme, udhëzimet jo të detyrueshme, kërkesat për informacion, informacionet e prokurorëve, raportimin periodik dhe vjetor, si dhe pasqyrimi i tyre në regjistrin e korresponcës së brendshme procedurale paraqiten edhe në mënyrë grafike si më poshtë.



- Nga të dhënat e marra, për periudhën e inspektimit, nuk rezulton ndonjë rast që nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë si prokurori më i lartë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave sipas nenit 5, pika 5 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12 datë 20.07.2020, i ndryshuar, të jetë kërkuar fillimi i verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit lidhur me zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme. Po kështu, nuk ka pasur të dhëna lidhur me kërkesa të tilla edhe nga prokurorët përkundrejt Drejtuesit të Prokurorisë, zëvendës drejtuesit sipas parashikimeve të nenit 5, pika 6 të të njëjtit udhëzim.

ndryshuar, me urdhrin nr. 40/1, datë 25.11.2020 "Për hapjen e regjistrit për qarkullimin e brendshëm të akteve në Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër".

NJËSIA E INSPEKTORËVE – INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

147

5. Rekomandime

1. Për Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe të Apelit:

- Duke pasur parasysh se udhëzimet e përgjithshme të Drejtuesve të Prokurorisë, që janë nxjerrë në zbatim dhe për lehtësim të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, janë nxjerrë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, rekomandohet përditësimi i tyre me ndryshimet e bëra me udhëzimin e përgjithshëm nr. 16, datë 14.12.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, konkretisht me dispozitat e neneve 14, 15, 17 dhe 18, si dhe për të mos cënuar pavarësinë dhe respektuar detyrimin e prokurorit për informim mbi bazën e kërkesës së Drejtuesit, harmonizimi përsa i përket një numri të dispozitave të këtyre udhëzimeve dhe udhëzimeve të tjera të përgjithshme të Drejtuesve, referuar ligjit Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe Kodit të Procedurës Penale.
- Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, rekomandohet rishikimi i Udhëzimit të përgjithshëm me nr. 39 PBD, datë 07.09.2020 "Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" lidhur edhe me pikat 9, 11 dhe 13 referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi; rishikimi i Udhëzimit të përgjithshëm me nr. 55 PBD, datë 11.12.2020 "Mbi kryerjen e ekspertimeve toksikologjike-klinicisteadiktologjike" të Drejtuesit të Prokurorisë Elbasan, lidhur me pikat 1 dhe 2 referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi; rishikimi i Udhëzimit të përgjithshëm nr. 19 PBD, datë 03.03.2021 "Mbi ekzekutimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e masave të sigurimit "arrest në shtëpi", si dhe mbi rregullat për njoftimin dhe shoqërimin e personave nën hetim/pandehur me masa sigurimi "arrest në shtëpi" me qëllim kryerjen e veprimeve hetimore", lidhur me rregullimet/plotësimet që vlerësohen të nevojshme, referuar edhe konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim.
- Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, rekomandohet rishikimi i Udhëzimit të përgjithshëm nr. 33 prot, datë 04.09.2020 "Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve, në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër", lidhur edhe me pikat 9, 11, 13, 14, 15 dhe 16, referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi.
- Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, rekomandohet rishikimi i Udhëzimit të përgjithshëm (pa numër), datë 07.09.2020 "Për rregullimin e



marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesit të prokurorisë”, lidhur edhe me pikat 6, 7 dhe 10 të këtij udhëzimi, referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi.

- Nisur nga fakti se numri dhe rëndësia e kërkesave për informacion, me qëllim për t’u mundësuar Drejtuesve nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme apo edhe vetëm për t’u informuar bazuar në udhëzimin e përgjithshëm nr. 12/2020, i ndryshuar, kushtëzohet aktualisht nga ngarkesa administrative/ burimet njerëzore, volumi i punës, si dhe përkushtimi dhe përgjegjshmëria e drejtimit dhe menaxhimit të Drejtuesve të Prokurorisë, për këtë arsye sugjerohet një riorganizim i strukturave të brendshme të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për të qenë sa më të informuar në lidhje me veprimtarinë funksionale të prokurorive që ata drejtojnë.
- Rekomandohet që udhëzimet jo të detyrueshme të jepen të strukturura në anën formale dhe t’i përgjigjen qëllimit të këtij lloj udhëzimi, kryesisht nga Drejtuesi në momentin e regjistrimit të kallëzimit/ referimit/ procedimit penal ose për verifikimin e ecurisë së tyre, duke respektuar procedurën e nenit 11 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020, të ndryshuar dhe më e rëndësishmja, nëse pranohet ndjekja e veprimeve të udhëzuara nga prokurori të mbikëqyret zbatimin në fazat e mëpasshme të procedimit penal.
- Drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit, në zbatim të nenit 10, pika 3 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, të ndërmarrin masa për të informuar Prokurorin e Përgjithshëm, në mënyrë periodike lidhur me gjendjen e kriminalitetit, sipas parashikimeve të nenit 42, shkronja “l” të ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Rekomandohet njohja e të gjithë prokurorëve të prokurorive të përfshira në inspektim me problematikat lidhur me mosdhënien e informacionit Drejtuesit të Prokurorisë dhe pasqyrimin e të dhënave në rregjistër, për t’u patur në konsideratë në vazhdim, duke qenë se shkelja e dispozitave ligjore referuese sipas nenit 21 të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12/2020 të ndryshuar mund të përbëjë shkak për shkelje disiplinore sipas ligjit dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj prokurorit dhe/ose Drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, sipas ligjit.

2. Për Prokuroritë e Apelit:

- Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër rekomandohet rishikimi i Udhëzimit të përgjithshëm nr. 50, datë 21.12.2020 “Për rregullimin e marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë, dhe prokurorëve në lidhje me informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër”, lidhur edhe me pikat 7 dhe 10, referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi.



- Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Korçë rekomandohet rishikimi i Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 1, datë 10.09.2020 "Në bazë dhe për zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm", të Drejtuesit të kësaj zyre, lidhur me pikën 7, referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi.
- Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës rekomandohet rishikimi i Udhëzimit me nr. 1, datë 07.09.2020 "Në bazë dhe për zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" të Drejtuesit të kësaj zyre, lidhur me pikën 7, referuar konstatimeve përkatëse për këtë udhëzim, pjesë e këtij raporti inspektimi.
- Në Prokuroritë e Apelit, për të cilat u konstatua se në asnjë rast nuk janë aplikuar kërkesa për informacion/ udhëzime jo të detyrueshme nga Drejtuesit e tyre/ informacione nga prokurorët, rekomandohet që Drejtuesit e tyre të vlerësojnë ushtrimin e kompetencave sipas udhëzimit të përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, për çështje që vlerësojnë se paraqesin rëndësi të faktit penal, përfaqësohen interesa vulnerabël apo përbëjnë interes publik, në mënyrë që edhe në këtë nivel të prokurorisë, të shërbejnë këto masa për zbatimin efektiv të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, në kuadër të informimit, transparencës dhe llogaridhënies të veprimtarisë përfaqësuese dhe ushtrimit të ndjekjes penale nga prokurori i apelit. Në këtë drejtim, mundet që si për Drejtuesit e Prokurorive të Apelit apo edhe të shkallës së parë të përcaktojnë një grup kriteresh ose në bazë të informacionit që ata marrin si Drejtues, për të vlerësuar rëndësinë e çështjeve për të cilat të kërkojnë informacion dhe kur është e nevojshme të procedojnë me nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme.
- Duke pasur parasysh mënyrën e të informuarit të ndryshëm, të konstatuar nga ana e prokurorëve të seancës në gjykimet në apel, rekomandohet që nga Drejtuesit e Prokurorive të Apelit të unifikohet kjo praktikë nëpërmjet nxjerrjes së një udhëzimi të përgjithshëm, si një atribut i parashikuar në ligjin me nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe më tej më konkretisht në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm me nr. 12 datë 20.07.2020, të ndryshuar. Kjo është e rëndësishme në funksion të qëllimit të garantimit të të drejtave dhe detyrimeve të prokurorëve në ushtrimin e funksioneve të tyre në kuadër të marrëdhënieve të tyre me Drejtuesit e Prokurorive si prokurorë më të lartë, dhe në funksion të mbarëvajtjes, efencës, ligjshmërisë dhe transparencës në veprimtarinë e prokurorisë si organ kushtetues i pavarur. Gjithashtu, duhet të nënvizohet me rëndësinë e unifikimit të praktikës, edhe fakti që megjithë ngarkesën e prokurorisë në kushtet aktuale, sipas udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm, informacioni duhet të jetë me

shkrim dhe komunikimi i prokurorëve me Drejtuesin e Prokurorisë së Apelit, të dokumentohet në regjistrin e komunikimeve të brendshme në përputhje me pikën 2 të nenit 20 të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, të ndryshuar, për rastet e parashikuara në nenin 18 të këtij udhëzim.

3. Për Prokurorinë e Përgjithshme:

- Në Prokurorinë e Përgjithshme, në të cilën u konstatua se në asnjë rast nuk është proceduar me udhëzime jo të detyrueshme nga Prokurori i Përgjithshëm dhe me informacione nga prokurorët e kësaj prokurorie, rekomandohet që të vlerësohet ushtrimi i kompetencave sipas udhëzimit të përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020, të ndryshuar, për çështje që çmohet se paraqesin rëndësi të faktit penal, përfaqësohen interesa vulnerabël apo përbëjnë interes publik, në mënyrë që edhe në këtë nivel të prokurorisë të shërbejnë këto masa për zbatimin efektiv të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar, në kuadër të informimit, transparencës dhe llogaridhënies të veprimtarisë së prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme referuar parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit me nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Në udhëzimin e përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të ndryshuar, sugjerohet të qartësohet formulimi i nenit 7, pika 2, në mënyrë të ngjashme me nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, për të mos konfunduar autoritetin e Drejtuesve të Prokurorisë në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme, në fusha të cilat nxjerrja e udhëzimit të përgjithshëm i takon Prokurorit të Përgjithshëm, ndërsa Drejtuesit në këto fusha mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e tyre. Kjo për faktin se në nenin 7, pika 2 të udhëzimit të përgjithshëm termi “prokuror më i lartë” nënkupton edhe Drejtuesit e Prokurorive për të nxjerrë udhëzime të përgjithshme edhe në drejtimit sipas nëndarjeve i), ii) dhe iii) dhe nuk bën ndarje të këtij termi siç ndodh në nenin 46 të ligjit nr. 97/2016, i ndryshuar, të përdorur në mënyrë të përgjithshme në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, i cili në mënyrë të shprehur përcakton Prokurorin e Përgjithshëm si autoritet për nxjerrjen e këtyre udhëzimeve të përgjithshme.
- Duke patur në konsideratë që udhëzimet e përgjithshme dhe udhëzimet jo të detyrueshme të nxjerra nga zyrat e prokurorive objekt inspektimi nuk kanë një unifikim në drejtim të formatit që ndjekin, rekomandohet krijimi i një modeli për këto akte për t’u zbatuar nga të gjitha zyrat e prokurorive.
- Duke patur në konsideratë mënyrën e mbajtjes së regjistrit të korrespondencës së brendshme procedurale, sugjerohet për Prokurorin e Përgjithshëm që të rishikojë modelin e regjistrit në drejtim të pasqyrimit të nënshkrimit të prokurorit kur dorëzon dhe merr aktin e pasqyruar. Në regjistrin e komunikimeve të brendshme të Prokurorive, të evidentohet data e miratimit të udhëzimit jo të detyrueshëm në raport me datën e kthimit të përgjigjes nga prokurori i çështjes. Shtimi i një kolone në regjistrin e komunikimeve



të brendshme, ku të pasqyrohen të dhëna mbi veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi përkatës, do t'i shërbente qëllimit të udhëzimit nr. 12/2020 për të rritur transparencën dhe efincencën në kontroll.

- Rekomandohet të forcohet koordinimi dhe monitorimi i ecurisë së zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12/2020 të ndryshuar, për rritjen e pavarësisë së prokurorisë dhe forcimin e kuptimit më të mirë të përgjegjësive nga çdo prokuror, me qëllim rritjen më tej të efincencës së veprimtarisë së prokurorisë dhe të efektivitetit në hetimet dhe ndjekjen penale, si dhe vijimin e nxitjes së prokurorëve nëpërmjet mbikëqyrjes efektive në punën e tyre sipas instrumenteve të udhëzimit, si dhe për evidentimin e rasteve që mund të procedohen në rrugë disiplinore gjatë zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm.
- Rekomandohet vijimi i bashkëpunimit të Drejtuesve të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit statistikor, të analizës dhe digjitalizimit të informacionit e regjistrave në prokurori, si dhe rritjen e kontributit të prokurorisë në hartimin e statistikave të njësuara në fushën e drejtësisë, që të shërbejnë si bazë për të analizuar kriminalitetin, politikën penale të zbatuar dhe efektivitetin e saj.

4. Për Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

- Rekomandohet marrja e masave për rritjen profesionale, si dhe vijimin e trajnimeve të prokurorëve me tema në kuadrin e ri ligjor të funksionimit të prokurorisë dhe të disa elementeve bazë si, përgjegjshmëria, profesionalizmi, integriteti dhe besueshmëria për garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorit dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj tij gjatë kryerjes së hetimeve, si dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies së prokurorit.

Propozime

Bazuar në nenin 147/d, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenin 194, pika 4 dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

PROPOZJMË:

1. Përfundimin e inspektimit tematik datë 01.06.2021 të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të Prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm”, i ndryshuar”.



2. Caktimin e periudhës nga data 01.01.2023 deri në datën 01.07.2023, si periudhë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

3. Të njoftohen Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Shkodër, Vlorë; Prokuroria e Apelit Vlorë; Prokuroria e Apelit Tiranë; Prokuroria e Apelit Shkodër; Prokuroria e Apelit Korçë; Prokuroria e Apelit Gjirokastrë; Prokuroria e Apelit Durrës; Prokuroria e Përgjithshme për përfundimin e inspektimit tematik, duke iu dërguar edhe një kopje të Raportit të Inspektimit.


4. Të njoftohet Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me Raportin e Inspektimit, duke iu dërguar një kopje të këtij raporti

INSPEKTORËT



Julian Zonja


Lindita Ziguri


Elena Pelushi


Alma Tafani


Joana Asimi


Besnik Maho


Saimir Hoxha